

DOMOSDOSHMERIA E ZBATIMIT TE PROKURIMIT ELEKTRONIK NE REPUBLIKEN E KOSOVES - MUNDESITE DHE SFIDAT

Msc. Besnik HAJDARI

Dorëzuar

Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin
Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit, me profil Menaxhim i
Sistemeve të Informacionit, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc.Dr. Nevila BACI

Numri i fjalëve: 68.909

Tiranë, Tetor 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se mbledhja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave në këtë punim janë krejtësisht origjinalë. Studimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Ky material nuk është prezantuar më parë në këtë institucion e as në ndonjë institucion tjetër të ngjashëm me të, për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij.

Besnik HAJDARI

ABSTRAKT

Dizertacioni doktoral shpjegon fushën e prokurimit publik, aplikimin në Republikën e Kosovës të prokurimit elektronik, që realizohet në mënyrë të digjitalizuar përmes pajisjeve dhe softuerit të teknologjisë informatike.

Prokurimi elektronik është prokurimi publik i digjitalizuar, që mënjanon kopjet fizike. Ky lloj prokurimi rrit transparencën dhe besueshmërinë për shpenzimin në mënyrë të drejtë të parave publike dhe krijon bindjen tek operatorët ekonomikë dhe tek të interesuarit se nuk bëhen favorizime dhe keqpërdorime të ligjeve dhe të rregulloreve të prokurimit publik.

Në Republikën e Kosovës prokurimi elektronik është në krijim e sipër. Tani është arritur në fazën testuese të softuerit për modulin bazik tenderimi elektronik. Kemi të bëjmë, pra, me një fushë dhe aktivitet të ri, që kërkon vëmendje të veçantë nga qeveria dhe institucionet e saj. Për rëndësinë dhe avantazhet e mëdha që ka e-Prokurimi, u zgjodh kjo temë për punimin tonë doktoral. Punimi shpjegon domosdoshmërinë e zbatimit të kësaj forme prokurimi, duke evidencuar kriteret dhe parimet e këtij aktiviteti, por edhe përgjegjësinë dhe rolin e madh që kanë qeveria dhe institucionet për zhvillimin me sukses të tij në Kosovë, sipas legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare. Një vend të rëndësishëm në studim zë trajtimi i procedurave elektronike në të gjitha fazat e prokurimit publik, i moduleve të planifikuara dhe i pajisjeve të nevojshme të teknologjisë informatike për realizimin e prokurimit elektronik. Në studim trajtohen problematikat e ndryshme dhe sfidat që paraqiten për zhvillimin e kësaj forme prokurimi sipas standardeve të ligjeve në fuqi dhe sipas modelit evropian. Lidhur me këto studimi synon të evidencojë jo vetëm avantazhet që ka kjo formë prokurimi ndaj formës tradicionale, e cila bazohet në letër, por edhe problemet me të cilat ballafaqohet në praktikë zgjerimi dhe konsolidimi i zbatimit të prokurimit elektronik në Kosovë, vështirësitë dhe pengesat që duhen kapërcyer.

Për aspektin teorik të kërkimit tonë doktoral, jemi mbështetur gjerësisht në literaturë dhe autorë vendas e të huaj, në burime të tjera dokumentare, të internetit etj. Duke e parë problemin edhe në aspektin juridik, punimi trajton krijimin dhe ndryshimet e legjislacionit që lidhet me prokurimin publik në tërësi dhe me atë elektronik në veçanti dhe nevojën e përafrimit të tij me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian. Të dhënat e mbledhura lidhur me praktikën e krijimit dhe zbatimit të deritanishëm të prokurimit elektronik në Kosovë janë përpunuar dhe analizuar me metodat krahasuese, analitike dhe juridike, duke synuar në arritjen e disa përfundimeve që mund të ndihmojnë në zhvillimin e mbarë dhe shtrirjen më të gjerë të përdorimit të prokurimit elektronik nga operatorët ekonomikë, institucionet qeveritare etj.

Punimi sjell të dhëna dhe fakte lidhur me realizimin e fazave të prokurimit elektronik, me metodat dhe funksionimin e tij, si dhe përfitimet e shumta që ai sjell. Punimi është parë dhe vlerësuar edhe nga ekspertë të kësaj fushe.

ABSTRACT

My doctoral dissertation elaborates on the field of public procurement by analyzing in short terms the development, implementation and transparency of public good, and then the main focus in this paper is the creation of the application of the Procurement in the Republic of Kosovo, where public procurement is elaborated through digitalisation by equipment and information technology software.

Electronic procurement is a digital public procurement that avoids physical copies. This kind of procurement increases transparency and credibility for fairly spending public money and creates the conviction of economic operators and those concerned that no favors and misuses of public procurement laws and regulations are made.

In the Republic of Kosovo, electronic procurement is under construction. Now is reached the test phase of the software for the basic electronic tendering module. We are therefore dealing with a new field and activity that requires special attention from the government and its institutions. For the importance and the great advantages of e-Procurement, this topic was chosen for our doctoral work. The paper elaborates on the necessity of implementing this form of procurement, evidencing the criteria and principles of this activity, but also the responsibility and the great role that the government and institutions have for its successful development in Kosovo, according to the applicable legislation and international standards. An important place in the study is the handling of electronic procedures in all phases of public procurement, the planned modules and the necessary IT equipment for the implementation of e-procurement. The study addresses the various issues and challenges that arise for the development of this procurement form according to the standards of the applicable laws and the European model. Regarding these studies, it aims not only to highlight the advantages of this form of procurement against the traditional form, which is based on the paper but also the problems that it faces in practice the expansion and consolidation of the e-procurement implementation in Kosovo, the difficulties and obstacles that are needed overcome.

For the theoretical aspect of our doctoral research, we are widely supported in literature from national and foreign authors, in other documentary sources, internet, etc. Looking at the problem in the legal aspect, the paper deals with the creation and changes of legislation related to public procurement in general and the electronic one in particular and the need for its approximation with the legislation of the European Union countries. The data collected regarding the practice of creating and implementing the electronic procurement process so far in Kosovo has been elaborated and analyzed by comparative, analytical and legal methods, aiming to reach some conclusions that can help in the wider development and broader scope the use of electronic procurement by economic operators, governmental institutions, etc.

My doctoral dissertation brings data and facts about the realization of electronic procurement phases, its methods and functioning, as well as the many benefits it brings. The work has been reviewed and evaluated by experts in this field.

DEDIKIM

*Këtë punim ia kushtoj familjes sime e, në
veçanti, vogëlushes sime Amela, dy vajzave
të vëllait, Oltës dhe Lunës, si dhe djalit të
vëllait Reisin, nipi i parë i prindërve të mi.*

FALËNDERIME

Në radhë të parë falënderoj udhëheqësen shkencore të punimit tim doktoral, Prof. Asoc. Dr Nevila BACI, e cila, me përkushtimin e saj, më ndihmoi dhe më mbështeti, duke më ofruar udhëzime shkencore dhe akademike. Ishte kënaqësi për mua që pata fatin të kem si udhëheqëse shkencore.

Falënderimin e dytë e kam për përgjegjësin e departamentit të Informatikës dhe, njëherit, profesorin tim të nderuar dhe shumë të respektuar Prof. Asoc. Dr Indrit BAHOLLI, ndihmën e të cilit nuk mund ta përshkruaj me fjalë. Ai më udhëzoi të fokusohem në punimin tim në këtë fushë të veçantë.

Dua të falënderoj në mënyrë të posaçme Bordin Drejtues dhe kolegët e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ku jam pjesë e stafit të rregullt, të cilët më kanë mbështetur dhe mirëkuptuar gjatë kohës së punës me këtë dizertacion.

Së fundi, falënderoj nga zemra familjen time, që më ka ofruar mbështetje në punën me doktoratën, duke veçuar këtu axhët e mi, Salihun, Rexhepin, Tahirin dhe axhën e ndjerë, Muharremin; prindërit dhe dy vëllëzërit e mi, pa mbështetjen e të cilëve nuk do të kisha arritur deri këtu. Në mënyrë të veçantë falënderoj gruan time, Edonën dhe vajzën time Amelën, të cilat më kanë ndenjur pranë gjatë gjithë kohës që jam marrë me punimin doktoral.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	2
ABSTRAKT.....	3
FALËNDERIME.....	6
PËRMBAJTJA.....	8
LISTA E FIGURAVE.....	10
LISTA E TABELAVE.....	11
LISTA E TABELAVE TË KOMPONENTEVE.....	12
LISTA E SHKURTIMEVE	14
Kapitulli I: HYRJE.....	15
1.1 Shtrimi i problemit.....	15
1.2 Objektivat e studimit.....	17
1.3 Hipotezat dhe pyetjet kërkimore.....	18
1.4 Kontributi i studimit.....	19
1.5 Metodologjia e përdorur.....	19
1.6 Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme.....	21
1.7 Struktura e studimit.....	21
Kapitulli II: ASPEKTE HISTORIKE DHE TEORIKE TË ZHVILLIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK.....	23
2.1 Vështrim historik i zhvillimit të prokurimit publik në botë dhe në Kosovë.....	23
2.2 Mbi përkufizimin e prokurimit publik.....	25
2.3 Format e prokurimit publik: tradicionale dhe prokurim elektronik... ..	27
2.3.1 <i>Prokurimi tradicional</i>	28
2.3.2 <i>Prokurimi elektronik</i>	28
2.4 Parimet e prokurimit sipas LPP.....	30
2.4.1 <i>Parimi i transparencës</i>	30
2.4.2 <i>Parimi i konkurrencës</i>	31
2.4.3 <i>Parimi i trajtimi të barabartë/Jodiskriminimi</i>	32
2.4.4 <i>Parimi i profesionalizmit</i>	33
2.5 Fazat e procesit të prokurimit.....	33
2.6 Kontrata në prokurimin publik dhe palët në proces.....	37
2.6.1 <i>Autoriteti kontraktor</i>	37
2.6.2 <i>Operatori ekonomik</i>	38
2.7 Përvoja ndërkombëtare në aplikimin e prokurimit elektronik.....	38
2.7.1 <i>Mësimet e nxjerra në nivel ndërkombëtar</i>	43
KAPITULLI III ASPEKTE JURIDIKE TE PROKURIMIT PUBLIK DHE RREGULLIMET INSTITUCIONALE.....	46
3.1 Vështrim mbi infrastrukturën ligjore të prokurimit publik.....	46
3.2 Nevoja për përmirësime në legjislacionin e prokurimit publik... ..	47
3.3 Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë europian.....	50

3.4 Qeverisja e prokurimit publik dhe rregullimet institucionale.....	53
3.5 Agjencitë përgjegjëse të prokurimit.....	54
3.5.1 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRrPP).....	55
3.5.2 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).....	56
3.5.3 Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).....	56
3.5.4 Njësi të tjera të lidhura me prokurimin.....	57
3.6 Probleme të trajnimit të zyrtarëve të prokurimit.....	59
3.7 Bashkëpunimi i AQP me institucione ndërkombëtare dhe vendore... ..	60
3.8 Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare.....	62
KAPITULLI IV STRATEGJIA DHE POLITIKAT E PROKURIMIT.....	62
4.1 Strategjia kombëtare e PP dhe problemet në zbatimin e saj.....	62
4.2 Vizioni dhe objektivat e strategjisë së prokurimit publik.....	63
4.3 Politikat e prokurimit publik.....	66
4.4 Planifikimi strategjik i prokurimit.....	67
4.5 Plani vjetor dhe individual i prokurimit.....	70
KAPITULLI V PROKURIMI ELEKTRONIK NË KOSOVË- ARRITJE DHE SFIDA.....	73
5.1 Gatishmëria për zbatimin dhe shtrirjen e e-Prokurimit në Kosovë – Sfidat dhe mangësitë.....	73
5.2 Komponentet e prokurimit publik.....	76
5.3 Infrastruktura teknologjike e sistemit të e-Prokurimit.....	87
5.4 Performanca dhe përdorimi i SPE.....	89
5.5 Metodat e prokurimit.....	89
5.5.1 Menaxhimi i marrëveshjes kornizë.....	93
5.5.2 Ankandi elektronik dhe ankandi i anasjelltë.....	95
5.6 Ndikimi i prokurimit elektronik dhe përfitimet prej tij.....	96
5.7 Sfidat e përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë....	100
5.8 Rreziqet që duhen menaxhuar në fushën e prokurimit.....	102
5.9 Korrupsioni në prokurimin publik dhe lufta kundër tij.....	104
KAPITULLI VI SPE - PROBLEME TË FUNKSIONIMIT TË TIJ.....	108
6.1 Funksionimi i SPE dhe përdorimi i tij.....	108
6.2 Kushtet për funksionimin e SPE.....	111
6.2.1 Portali i prokurimit.....	113
6.2.2 Regjistrimi.....	113
6.2.2.1 Regjistrimi i furnitorëve dhe i blerësve.....	114
6.2.2.2 Regjistrimi i zyrtarit të prokurimit.....	114
6.2.2.3 Regjistrimi i komisioneve.....	114
6.2.2.4 Regjistrimi i kompanive.....	115
6.2.3 Sistemi i ofertimit elektronik.....	115
6.2.4 Blerja elektronike.....	116
6.2.5 Sistemi i pagesave elektronike.....	118
6.2.6 Katalogët e elektronikë.....	119
6.3 Fushëveprimi i prokurimit elektronik.....	121
6.3.1 Ndihmesa përmes internetit.....	125

6.4 Infrastruktura Kryesore Publike (Nënshkrimet digjitale).....	127
6.5 Sistemeti e Menaxhimit të Prokurimit.....	127
6.5.1 Sistemi i Menaxhimit Informativ të Prokurimit	127
6.5.2 Interfejsi SIMF dhe Interfejsi Grafik i Përdoruesit	130
6.5.3 Sistemi i menaxhimit të rrjedhës së punëve.....	131
6.5.4 Moduli për menaxhimin e kontratave elektronike.....	131
6.5.5 Menaxhimi i profilit të përdoruesit dhe siguria e tij.....	133
6.6 Sistemet e sigorisë së informacionit	134
6.7 Komunikimi dhe kërkimi përmes SPE.....	136
6.8 Riinxhinierimi i Procesit të Punës (RPP).....	138
SHTOJCE.....	142
KAPITULLI VII KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	182
7.1 Përfundime të përgjithshme.....	182
7.2 Përgjigjet për Pyetjet kërkimore dhe vërtetimi i Hipotezave	183
7.3 Rekomandime.....	193
LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA.....	198

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 – Fazat e procesit të prokurimit.....	34
Figura 2 - Objektivat e prokurimit elektronik.....	65
Figura 3 – Aplikacionet e prokurimit elektronik.....	93
Figura 4 - Klasifikuesit e katalogut kundrejt identifikuesve.....	120
Figura 5 - Kushtet për zhvillimin e prokurimit elektronik.....	126
Figura 6 - Regjistri i informatave dhe SMIP.....	129
Figura 7 - Aspektet kryesore të zbatimit të prokurimit elektronik.....	138

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Zhvillimi i prokurimit elektronik/fazat e fillimit – përmbledhje..	35
Tabela 2 Përvoja ndërkombëtare në prokurimin publik.....	39
Tabela 3 Plani i veprimit të prokurimit elektronik.....	68
Tabela 4 Përmbledhje e vlerësimit të gatishmërisë për e-Prokurim.....	74
Tabela 5 Vlerësimi përmbledhës i ndikimit të E-Prokurimit në Kosovë...	99
Tabela 6 Orari i sistemit të prokurimit elektronik.....	124
Tabela 7 Lista e dokumenteve standarde.....	139
Tabela 8 Mbulueshmëria e dokumenteve standarde të ofertimit.....	139
Tabela 9 Terminologjitë e proceseve të E-Prokurimit.....	196

LISTA E TABELAVE TË KOMPONENTEVE

KOMPONENTI 1: QEVERISJA QEVERITARE.....	76
KOMPONENTI 2: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE.....	77
KOMPONENTI 3: PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI.....	78
KOMPONENTI 4: POLITIKAT.....	80
KOMPONENTI 5: LEGJISLACIONI DHE RREGULLIMI.....	81
KOMPONENTI 6: INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET E INTERNETIT.....	82
KOMPONENTI 7: STANDARDET.....	84
KOMPONENTI 8: INTEGRIMI I SEKTORIT PRIVAT.....	85
KOMPONENTI 9: SISTEMET (SISTEMET AKTUALE TË E-PROKURIMIT TË QEVERISË, NËSE KA).....	86

LISTA E SHKURTIMEVE

<i>AQP</i>	<i>Agjencia Qendrore e Prokurimit</i>
<i>BE</i>	<i>Bashkimi European</i>
<i>BPV</i>	<i>Bruto Prodhimi Vendor</i>
<i>BSHZH</i>	<i>Banka Shumëpalëshe Zhvillimore e Tregtisë Ndërkombëtare.</i>
<i>EP</i>	<i>Entiteti i Prokurimit</i>
<i>FPP</i>	<i>Fjalori i Përbashkët i Prokurimit</i>
<i>FRF</i>	<i>Faqja e Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë i Kombeve të Bashkuara</i>
<i>IKP</i>	<i>Infrastruktura Kryesore Publike</i>
<i>IMF</i>	<i>Fondi Monetar Ndërkombëtar</i>
<i>JV</i>	<i>Joint Venture/Ndërmarrje e Përbashkët</i>
<i>KB</i>	<i>Kombet e Bashkuara</i>
<i>KDP</i>	<i>Komisioni Drejtues i Projektit</i>
<i>KHP</i>	<i>Komisioni për Hapjen e Propozimit</i>
<i>KHT</i>	<i>Komisioni për Hapjen e Tenderit</i>
<i>KKP</i>	<i>Komision Këshillimor i Projektit</i>
<i>KP</i>	<i>Kërkesë për Propozim</i>
<i>KRrPP</i>	<i>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</i>
<i>KSHI</i>	<i>Kërkesë për Shprehjen e Interesit</i>
<i>KT</i>	<i>Kërkesë për Tender</i>
<i>KZP</i>	<i>Komisioni për Zbatimin e Projektit</i>
<i>M&V</i>	<i>Monitorim dhe Vlerësim</i>
<i>MNSH</i>	<i>Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit</i>
<i>NJDHT</i>	<i>Njoftim për Dhënien e Tenderit</i>
<i>NJMP</i>	<i>Njësia për Menaxhimin e Projektit</i>
<i>OBEZH</i>	<i>Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim</i>
<i>ONK</i>	<i>Ofertim Ndërkombëtar Konkurrues</i>
<i>OSHK</i>	<i>Ofertim Shtetëror Konkurrues</i>
<i>P</i>	<i>Parallogari</i>
<i>PPP</i>	<i>Partneriteti Publik Privat</i>
<i>PPSH</i>	<i>Pyetjet e Parashtruara më së Shpeshti</i>
<i>QK</i>	<i>Qeveria e Kosovës</i>
<i>RPP</i>	<i>Riinxhinierimi i Procesit të Punës</i>
<i>SHI</i>	<i>Shprehja e Interesit</i>
<i>SIMF</i>	<i>Sistemi Informues i Menaxhimit Financiar</i>
<i>SMIP</i>	<i>Sistemi Menaxhimit të Informacionit të Prokurimit</i>
<i>STE</i>	<i>Sistemi Tenderues Elektronik</i>
<i>TI</i>	<i>Teknologjia e Informimit</i>
<i>TIK</i>	<i>Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit</i>
<i>TKP</i>	<i>Treguesi Kryesor i Performancës</i>

<i>TR</i>	<i>Tabelë e Ratave</i>
<i>UNCITRAL</i>	<i>Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjin</i>
<i>UNSKDP</i>	<i>Kodi Standard për Produkte dhe Shërbime</i>

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Shtrimi i problemit

Në këtë hulumtim doktoral paraqesim domosdoshmërinë e aplikimit të prokurimit publik elektronik në Kosovë, vlerat dhe avantazhet që ka ky sistem, si edhe problematikat dhe sfidat që dalin për funksionimin sa më efikas dhe të rregullt të tij. Zhvillimi i gjithanshëm i vendit, ecja e tij në drejtim të progresit, në kuadrin e ekonomisë së tregut, kanë nxjerrë në pah nevojën e shfrytëzimit të teknologjisë së avancuar informatike edhe në fushën e prokurimit publik, për të zëvendësuar formën tradicionale të prokurimit, të bazuar në letër, me formën më të përparuar dhe bashkëkohore, prokurimin elektronik. Digjitalizimi i tërë dokumenteve dhe i procedurave të këtij procesi përmes përdorimit të internetit dhe të pajisjeve elektronike të komunikimit është bërë tani një prioritet i punës së institucioneve qeveritare dhe i administratës publike në Kosovë.

Prokurimi elektronik është transformimi i praktikave dhe i procedurave të prokurimit nga forma fizike, në atë elektronike. Përmes këtij sistemi, të gjitha kërkesat e prokurimit publikohen përmes internetit. Ky sistem i menaxhimit të prokurimit publik mundëson ruajtjen elektronike të të dhënave dhe vlerësimin teknik e financiar të ofertave. Në këtë kuptim, konkludojmë se sistemi i prokurimit elektronik nuk nënkupton vetëm publikimin e rezultateve të prokurimit, por përfshin tërë procesin e prokurimit, ashtu siç parashihet në ligj.

Në këtë studim theksohen avantazhet e mëdha dhe efektet pozitive që sjell zbatimi i prokurimit elektronik. Ai ndikon në eliminimin e pengesave dhe vështirësive që janë të pranishme në formën fizike të prokurimit, rrit besimin e të gjitha palëve të përfshira, mundëson që siguria të jetë maksimale. Ai ka një impakt pozitiv, pasi siguron konkurrencën, ndikon në rritjen dhe përmirësimin e transparencës dhe të efikasitetit të procesit të prokurimit publik.

Praktika tregon se edhe në Kosovë prokurimi elektronik po merr gjithnjë e më shumë përparësi në veprimtarinë e institucioneve qeveritare dhe të administratës publike. Tashmë kjo risi po vlerësohet si e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme, për vetë impaktin pozitiv që ka në zhvillimin e vendit. Në këto kushte, ka lindur nevoja që organizatat e sektorit publik dhe institucionet qeveritare ta organizojnë punën e tyre me një mendësi të re, që u referohet përdorimit të teknologjisë informatike, komunikimeve elektronike edhe në procesin e blerjeve të furnizimeve dhe shërbimeve apo të tenderimit të punëve publike. Ato po përpiqen në radhë të parë të sigurojnë kapacitetet teknologjike të nevojshme për realizimin e prokurimit elektronik, si dhe burimet njerëzore të afta për t'i shfrytëzuar me efektivitet të gjitha potencialet që pajisjet e teknologjisë informatike ofrojnë për aplikimin e prokurimit publik elektronik.

Por në studim vihet në dukje se këto përparësi të sistemit materializohen në praktikë duke u përballur me sfida të shumta, me vështirësi, pengesa dhe problematika të ndryshme, që dalin në fushën e prokurimit publik elektronik. Këto analizohen dhe

trajtohen në këtë punim doktoral, me synimin për të evidencuar rrugët e kapërcimit të tyre.

Lidhur me këtë, studimi konkludon se institucionet qeveritare dhe gjithë autoritetet kontraktuese duhet të njohin mirë dhe të zbatojnë në praktikë teoritë e reja të administrimit publik që vendosin kontratën në qendër të qeverisjes publike, të administrojnë procesin e prokurimit publik në mënyrë të përgjegjshme, transparente e llogaridhënëse, të promovojnë barazi mes operatorëve ekonomikë, të sigurojnë konkurrencë të shëndoshë, të paanshme, dhe përgjegjshmëri ndaj taksapaguesve për shpenzimin e drejtë dhe efikas të parasë publike. Theksi në punimin doktoral vihet te nevoja e zbatimit të kriterëve bazë të prokurimit publik, që parashikohen në legjislacionin e kësaj fushe, pasi vetëm kështu mundësohet realizimi i duhur i politikave, i prioritetëve, planeve dhe strategjive të prokurimit publik, për të realizuar procesin e prokurimit në mënyrë të ndershme dhe efikase, duke eliminuar shfaqjet dhe veprimet korruptive në tenderat e ndryshëm.

Vend të posaçëm në studim zë trajtimi i aspektit juridik, legjislacioni që rregullon sistemin e prokurimit publik në tërësi dhe të prokurimit elektronik, në veçanti. Studimi është i bazuar në kornizat ligjore të prokurimit publik, të vendosura nga sistemi legjislativ i Kosovës, konkretisht, në legjislacionin primar, përkatësisht, Ligji për Prokurimin Publik; dhe në legjislacionin sekondar, që përfshin aktet nënligjore, siç janë udhëzimet dhe rregulloret e brendshme të punës. Duke folur për tërësinë e ligjeve të hartuara në këtë fushë dhe për ndryshimet që janë bërë në to, jemi përpjekur të shtjellojmë domosdoshmërinë e zbatimit të drejtë të tyre në praktikë, pasi në praktikë vërehen shkelje dhe mjaft mangësi në këtë drejtim. Gjithashtu, theksohet nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të legjislacionit të kësaj fushe dhe e përputhjes së tij me legjislacionin ndërkombëtar e sidomos me atë të Bashkimit European.

Duke qenë se shtrirja e zbatimit të prokurimit publik elektronik është një ndër prioritetet e qeverisë së Kosovës, në studim sillen fakte dhe të dhëna se zbatimi i sistemit të prokurimit elektronik në vendin tonë është plotësisht i mundur, se ekzistojnë gatishmëria dhe vullneti i institucioneve qeveritare për ta implementuar sa më gjerësisht atë dhe janë bërë hapa konkretë për sigurimin e kapaciteteve teknologjike dhe të burimeve njerëzore të nevojshme. Analiza e këtyra të dhënave shtrihet edhe në evidencimin dhe shtjellimin e dukurive negative dhe të sfidave që dalin në zhvillimin e prokurimit publik elektronik.

Nga vëzhgimet e bëra në praktikë gjatë hulumtimit të këtij problemi, por edhe në mjaft raporte dhe analiza të organizatave dhe institucioneve të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë shoqërinë civile dhe mediat, del se prokurimi publik në Kosovë është një ndër fushat më të kritikuara ndërkombëtare dhe vendore. Në një Raport Progresi, të publikuar nga Komisioni European këto vitet e fundit konstatohet se “korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha, duke përfshirë prokurimin publik, dhe vazhdon të jetë një problem serioz që duhet të adresohet urgjentisht”. Ndaj, në punimin doktoral i kushtohet vëmendje faktit që, megjithë përpjekjet e bëra për luftën kundër korrupsionit, në Kosovë prokurimi publik shpeshherë është jotransparent; ka zbrazëti në legjislacionin e sistemit të prokurimit, të cilat lënë hapësira për manipulime me taksat e qytetarëve në tenderat e ndryshëm; ka veprime korruptive në

tendera, si shpërblime me kontrata publike të kompanive të papërgjegjeshme apo që janë në pronësi të politikanëve të pushtetshëm, të njerëzve të afërm apo të familjarëve të zyrtarëve të prokurimit, të afërt të kryetarëve të komunave, të zyrtarëve të prokurimit, e deri te veprimet që çojnë në zyrtarizimin e vetëm një tenderuesi, pa konkurrencë etj. Nuk kanë munguar edhe rastet kur në tendera veprohet edhe kur zyrtarë të prokurimit kanë konflikt interesi.

Për reduktimin e këtyre praktikave negative, theksohet në studim, një rol të madh luan implementimi i prokurimit elektronik, i cili ka një impakt pozitiv në këtë drejtim. Evidencimi dhe analiza e këtyre fakteve, i shkaqeve dhe i faktorëve që i ushqejnë ato bëhet me synimin që në mbyllje të studimit të arrihet në disa përfundime dhe rekomandime, që do të ndihmonin në ndërgjegjësimin e strukturave shtetërore dhe të autoriteteve kontraktuese për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e zbatimit gjithnjë e më gjerësisht të prokurimit publik elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.2 Objektivat e studimit

Objektivat kryesore të këtij dizertacioni janë:

Të theksojë dhe të argumentojë domosdoshmërinë dhe dobinë e efekteve dhe të rezultateve pozitive që sjellin prokurimi elektronik apo shërbimet e qeverisjes elektronike në rritjen e transparencës, në përmirësimin e cilësisë, të disponueshmërisë dhe të shpejtësisë së shërbimeve, në lehtësimin që u mundësohet bizneseve për të marrë shërbime që të ndërveprojnë me qeverinë dhe të reduktojnë koston e shpenzimeve etj.

Duke parashtruar dhe analizuar gjendjen e vendosjes dhe të funksionimit të sistemit të prokurimit publik elektronik në Kosovë sipas procedurave ligjore dhe administrative të prokurimit publik, studimi synon të evidencojë arritjet e deritanishme dhe problematikat që dalin në këtë fushë, si dhe të prezantojë potencialin e madh që ofrojnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit me qeverisjen elektronike, impaktin pozitiv që kanë ato për rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë për proceset e prokurimit publik.

Qëllimi i këtij punimi është t'i kontribuojë edhe reformimit të legjislacionit në fushën e prokurimit publik, me tendencë pasurimin e tij me dispozita të reja dhe efikase për prokurimin elektronik.

Studimi synon që, përmes prezantimit të mënyrës aktuale të funksionimit të prokurimit elektronik, t'u vijë në ndihmë autoriteteve kontraktuese dhe institucioneve qeveritare me informacione për prokurimin elektronik, për aplikimin e softuerit të tij, për modernizimin e proceseve të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, për përmirësimin e ndërveprimit mes sektorit publik dhe operatorëve ekonomikë dhe zbatimit në praktikë me ndihmën e sistemeve të informacionit.

Një tjetër objektiv i studimit është të nxisë ide të reja kreative për shfrytëzimin e TI-së për sistemin e prokurimit elektronik dhe për zbatimin e strategjisë së Qeverisjes Elektronike në Kosovë.

Synimi është që ky hulumtim t'u shërbejë të gjithë të interesuarve që përfshihen në procesin e prokurimit publik dhe të mbushë një boshllëk në fondin e studimeve dhe të literaturës mbi prokurimin publik dhe sidomos të prokurimit elektronik.

1.3 Hipotezat dhe pyetjet kërkimore

Duke pasur parasysh objektivat dhe qëllimin e studimit, me synim arritjen në disa përfundime dhe rekomandime lidhur me domosdoshmërinë dhe mundësinë e rritjes së implementimit të prokurimit elektronik në Kosovë, kemi ngritur këto hipoteza:

Hipoteza 1: Në Republikën e Kosovës është plotësisht i mundshëm zëvendësimi i formës tradicionale të prokurimit publik me prokurimin elektronik dhe shtrirja më masive dhe cilësore e prokurimit elektronik, pasi, tashmë, është krijuar një model i digjitalizimit të proceseve të prokurimit publik dhe i adaptimit në qeverisjen elektronike.

Hipoteza 2: Në Kosovë, në aspektin formal, ekziston korniza ligjore që rregullon funksionimin e sistemit të prokurimit publik elektronik, por sfidues mbetet zbatimi i këtyre ligjeve në praktikë.

Hipoteza 3: Sfidat e shumta, me të cilat ndeshet zbatimi i sistemit të prokurimit elektronik në Kosovë, janë të përballueshme, pasi institucionet qeveritare dhe agjencitë përgjegjëse të prokurimit e kanë gatishmërinë për kapërcimin e tyre.

Për arritjen e objektivave dhe të qëllimit të dizertacionit dhe për vërtetimin e hipotezave të mësipërme do të na ndihmojnë përgjigjet që do t'u jepen në studim këtyre pyetjeve kërkimore:

1. *Cilët janë modulet dhe shkalla e përdorimit të prokurimit elektronik nga biznesi dhe nga institucionet qeveritare në Kosovë?*
2. *Çfarë pajisjesh teknologjike dhe platformash janë përfshirë në krijimin e sistemit të informacionit dhe në realizimin e prokurimit elektronik?*
3. *Cilat janë përfitimet nga zbatimi i prokurimit elektronik dhe sfidat me të cilat përballlet zbatimi i këtij sistemi në Kosovë?*
4. *Si e rregullon legjislacioni i Kosovës veprimtarinë e prokurimit publik dhe prokurimin elektronik?*
5. *Sa i harmonizuar është ky legjislacion me atë të Bashkimit European dhe me legjislacionin e vendeve të rajonit?*
6. *Sa u përgjigjen kërkesave të kohës strategjia kombëtare dhe politikat qeveritare të prokurimit publik dhe roli i agjencive përgjegjëse dhe i qeverisë në zhvillimin e suksesshëm e të ndershëm të prokurimit publik elektronik?*
7. *Në ç nivel është ndërveprimi në procesin e prokurimit elektronik dhe sa ndikon ai në rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë së operatorëve*

ekonomikë në sistemin e prokurimit elektronik dhe të përfitimet nga zbatimi i tij?

1.4 Kontributi i studimit

Nëpërmjet paraqitjes së literaturës, studimeve dhe kërkimeve të kryera në lidhje me prokurimin elektronik dhe me qeverisjen elektronike në Republikën e Kosovës, si dhe të shqyrtimeve të bëra lidhur me përdorimin e saj nga bizneset, individët dhe institucionet shtetërore, mendojmë se studimi sjell kontribute në disa drejtime:

- Paraqet gjendjen aktuale të përdorimit të prokurimit elektronik në Republikën e Kosovës, përmes vendosjes së moduleve krahasuese për studimet e mëtejshme në lidhje me këtë fushë;
- Ndhmon përfituesit (administratën publike dhe bizneset) në identifikimin e avantazheve që kanë prokurimi elektronik dhe qeverisja elektronike.
- Ndhmon nëpunësit civilë, menaxherët e prokurimit, drejtorët e departamenteve për përmirësimin e vazhdueshëm, në mënyrë më të lehtë dhe më të shpejtë të performancës së punës së tyre lidhur me prokurimet.
- Do të nxitë drejtuesit e bizneseve, sidomos në fushën e TIK-ut, për avancimin e ideve të tyre për aplikacionet elektronike;
- Me analizat dhe përfundimet që nxjerr studimi do t'u vijë në ndihmë institucioneve monitoruese (auditorët, inspektorët, ekspertët e prokurimit) që të mund të identifikojnë më lehtë dhe më shpejt oportunitetet dhe problemet gjatë ofrimit të shërbimeve;
- Studimi paraqet interes edhe për qytetarët, që të rrisin ndërveprimin në sistemet e informacionit elektronik duke u bërë kështu protagonistë të ndryshimeve pozitive shoqërore;
- Punimi plotëson boshllëkun e kërkimeve të mirëfillta shkencore në këtë fushë.

1.5 Metodologjia e përdorur

Për trajtimin dhe analizën e problematikave të prokurimit elektronik i kemi kushtuar vëmendje përcaktimit të metodologjisë dhe të metodave që do të zbatonim gjatë punës me studimin doktorat. Procesi i punimit të kësaj teme ka kaluar në tri faza:

Faza e parë: njohja, mbledhja dhe përzgjedhja e materialit të nevojshëm teorik, e literaturës lidhur me fushën e prokurimit publik, që do të na ndihmonte për mbështetjen teorike të trajtimit dhe të analizimit të problematikave të studimit. Krahas kësaj, jemi ndalur posaçërisht në legjislacionin e Kosovës, që rregullon prokurimin publik dhe atë elektronik, si dhe në njohjen me dokumente bazë të strukturave qeveritare që përmbajnë strategjinë, politikat, kriteret dhe rregulloret për funksionimin normal të prokurimit publik në tërësi.

Duke shfrytëzuar këtë literaturë dhe burime të tjera dokumentare, evidencuam dhe nxorëm referencat përkatëse, lidhur me rëndësinë, vlerat dhe avantazhet e mëdha që ka sistemi i prokurimit elektronik, përvojën ndërkombëtare në këtë fushë, si edhe problematikat e përdorimit të këtij sistemi.

Faza e dytë: vëzhgimi nga ana jonë në praktikë dhe në terren i implementimit të sistemit të prokurimit elektronik në Republikën e Kosovës, të moduleve të realizuara sipas platformës elektronike, të procedurave të prokurimit publik; gjetja dhe evidencimi i të dhënave dhe fakteve lidhur me pajisjet teknologjike dhe me burimet njerëzore që realizojnë praktikisht funksionimin e këtij sistemi. Gjatë vërtetimit në terren kemi konstatuar dhe vlerësuar domosdoshmërinë e përmirësimit, reformimit dhe modernizimit të pandërprerë të prokurimit publik elektronik, të procedurave që aplikohen në prokurimin publik dhe atë elektronik, por edhe të administratës publike.

Faza e tretë: hartimi i studimit, formulimi i pjesës teorike të punimit, me fokus dhënien e përkufizimit të prokurimit publik nga autorë dhe institucione të ndryshme, vendas dhe të huaj, evidencimi i standardeve bashkëkohore, bazuar në literaturë, në legjislacion dhe në materiale dokumentare zyrtare. Vend kryesor këtu zë sistemimi dhe analizimi i të dhënave të mbledhura, dinamika e zhvillimit dhe e perfeksionimit të sistemit të prokurimit publik, evidencimi i problemeve, i mangësive dhe i faktorëve që e vështirësojnë funksionimin normal të këtij sistemi dhe nxjerrja e disa konkluzioneve lidhur me rrugët dhe mënyrat e eliminimit të këtyre mangësive.

Kjo metodologji ka bërë që punimi të mos mbetet thjesht në përshkrime teorike dhe tekniko-profesionale të sistemit të prokurimit elektronik, të standardeve të tij, por në të u bëhet një analizë e detajuar, në aspektin shkencor, këtyre problematikave dhe gjendjes faktike në këtë fushë.

Në këtë kuptim studimi ka karakter kërkimor dhe analitik, përshkrues dhe shpjegues, dhe përmban edhe disa përfundime dhe rekomandime.

Metodat e përdorura në këtë hulumtim janë:

Metoda historike, me të cilën realizohet një vështrim historik deri në ditët e sotme i çështjes së prokurimit publik elektronik, duke trajtuar zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të mekanizmave përgjegjëse, rregullatore dhe monitoruese në këtë fushë në aspektin kronologjik.

Metoda normative ka ndihmuar për të paraqitur atë që përbën normën, ligjin apo standardin e prokurimit publik elektronik; për të pasqyruar përkufizimin, kriteret dhe parimet e prokurimit publik dhe sidomos rregullimin juridik të kësaj çështjeje në Kosovë, por edhe trajtimin juridik ndërkombëtar të saj.

Metoda analitike ka qenë në bazë të hulumtimit, për të analizuar dhe përpunuar materialin teorik dhe empirik të grumbulluar.

Metoda krahasimore aplikohet për të krahasuar të dhënat për sistemin e prokurimit publik, për procedurat e tij, të dhënat apo statistikat mbi rastet e ndryshme të zhvillimit të prokurimit publik elektronik apo për krahasimin e legjislacionit të Kosovës me atë europian etj.

1.6 Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme

Fakti që, tashmë, në Kosovë është vendosur sistemi i prokurimit publik elektronik, duke shfrytëzuar teknologjinë e avancuar informatike, më nxiti të hulumtoj në këtë fushë, e cila përbën një risi që do të ndikojë mjaft në zhvillimin e vendit.

Ajo që më ka motivuar të zgjedh këtë temë për punim doktorature është edhe mungesa e studimeve të mirëfillta shkencore rreth këtij problemi, si dhe mungesa literaturës së mjaftueshme lidhur me këtë fushë.

Duke qenë në ekipin e përgatitjes së përshkrimit të raportit për krijimin e sistemit të prokurimit elektronik për Republikën e Kosovës, m'u dha mundësia të njihesha nga afër me vlerat dhe me problemet e zbatimit në praktikë të këtij sistemi dhe me sfidat me të cilat përballet ai. Kjo më shtyu të bëja një kërkim më të thelluar të përdorimit të teknologjisë informative me fokus qeverisjen elektronike dhe prokurimin publik dhe të caktoja këtë problematikë si temë për punimin tim doktorat.

Kështu, duke vlerësuar rëndësinë që ka një studim i tillë, vendosa të ndërmarr këtë punim doktorature, edhe pse jam doktoranti i parë në vendet e rajonit që i kushtoj kësaj fushe një hulumtim shkencor. Ky fakt më motivon edhe më shumë që të jap kontributin tim për të shtuar fondin e literaturës dhe të materialeve kërkimore lidhur me prokurimin elektronik në Republikën e Kosovës.

Së fundi, duke qenë i familjarizuar me këtë fushë, u nxita që, duke hulumtuar këtë temë, të rris më tej kualifikimin tim shkencor.

1.7 Struktura e studimit

Kreu i Parë bën një prezantim të përgjithshëm të çështjes së prokurimit publik, nevojës së zbatimit të prokurimit elektronik, ndikimin e tij në reformimin e prokurimit publik, si dhe rëndësinë që ka përdorimi i sistemeve informative në modernizimin e shërbimeve për qytetarët, komunitetin e biznesit nga institucionet shtetërore. Më tej vazhdohet me qëllimin dhe objektivat e këtij studimi, duke treguar dhe objektivat kryesore të tij. Po ashtu jepen hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit; kontributet që sjell studimi, metodologjia e përdorur për ta realizuar këtë punim, si dhe struktura e studimit.

Kreu i Dytë sjell një vështrim historik mbi prokurimin publik (lindjen dhe zhvillimin e tij). Pasi flitet për pëkuftizimet e ndryshme që jepen për prokurimin publik, në këtë kapitull trajtohen format e tij, forma tradicionale dhe ajo elektronike. Vend i rëndësishëm u është lënë parimeve themelore të prokurimit publik që përmban ligji i prokurimit publik. Pasi trajtohen fazat e procesit të prokurimit publik, kontrata dhe palët në proces, si autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë, kapitulli sjell disa përvoja ndërkombëtare në aplikimin e prokurimit publik në disa vende dhe mësimet që dalin prej tyre.

Kreu i Tretë shtjellon aspektet juridike të prokurimit publik elektronik, duke bërë një vështrim në legjislacionin ekzistues të kësaj fushe në Kosovë, thekson nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të tij dhe të harmonizimit gjithnjë e më mirë të infrastrukturës ligjore të Kosovës me legjislacionin europian, me Direktivat e KE dhe me dokumentet e organizatave ndërkombëtare lidhur me prokurimin publik. Një

tjetër çështje e rëndësishme që trajton ky kapitull është qeverisja e prokurimit publik, udhëheqja dhe rregullimet institucionale të tij. Pasi jepen përgjegjësitë dhe detyrat e agjencive përgjegjëse të prokurimit, *KRRPP*, *OSHP*, *AQP* etj., dhe problemi i burimeve njerëzore, trajtohet bashkëpunimi i agjencive me institucione ndërkombëtare dhe shkëmbimi i përvojës nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme.

Kreu i Katërt: shtjellon strategjinë kombëtare dhe politikat e prokurimit publik. Pasi flitet për vizionin dhe objektivat e strategjisë, kapitulli ndalet në politikat shtetërore të prokurimit publik, si dhe në çështje të planifikimit strategjik të prokurimit, në planifikimin e prokurimit dhe në menaxhimin e sistemit elektronik të prokurimit që po zbatohet në Republikën e Kosovës.

Kreu i Pestë merret me gatishmërinë që tregohet në Kosovë për zbatimin dhe shtrirjen e e-Prokurimit, me sfidat dhe mangësitë që vihen re në këtë fushë. Në të trajtohen komponentet e prokurimit publik dhe futja gjerësisht e përdorimit të prokurimit elektronik, infrastruktura teknologjike e sistemit të e-Prokurimit, performanca dhe shkalla e përdorimit të tij. Më tej kapitulli ndalet në metodat e prokurimit, në marrëveshjen kornizë, ankandin elektronik dhe ankandin e anasjelltë. Pasi flitet për ndikimin e SPE dhe për përfitimet prej tij, trajtohen me hollësi sfidat që duhen përballuar për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, rreziqet që duhen menaxhuar dhe lufta kundër korrupsionit në këtë fushë.

Kreu i Gjashtë ka në fokus problemet dhe kushtet e funksionimit të SPE, duke u ndalur te portali i prokurimit, regjistrimi, ofertimi elektronik, blerja elektronike, pagesat elektronike, katalogët elektronikë fushëveprimi e prokurimit, sistemet e menaxhimit informativ të prokurimit, si atë të informatave (SMIP), atë financiar *SIMF* dhe të përdoruesit *IGP*. Në fund shtjellohen sistemet e sigurisë, komunikimi dhe kërkimi përmes SPE-së, ndërveprueshmëria teknike e SPE dhe Riinxhinierimi i Procesit të Punës, dokumentet standarde të prokurimit etj.

Bibliografia mbyll punimin me listën e librave, artikujve, dokumenteve, referateve në konferenca shkencore, si dhe adresat e webfaqeve.

KAPITULLI II. ASPEKTE HISTORIKE DHE TEORIKE TË ZHVILLIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK

2.1 Vështrim historik i zhvillimit të prokurimit publik në botë dhe në Kosovë

Në Europë prokurimi publik filloi të zhvillohet në fillim të shekullit të 19-të. Në Francë, për shembull, historia e sistemit të mirëfilltë të prokurimit publik, me procedura të përgjithshme për çmimet e kontratës, me standarde, me formularë të kontratës dhe me shqyrtimin gjyqësor të ankesave, nis në vitin 1800, me Ligjin e 17 shkurtit, për punimet publike. Po në këtë vit, aspekte të ndryshme të prokurimit publik rregullohen edhe në Suedi, ku dispozitat e para mbuluan vetëm prokurimin e institucioneve të qeverisë.

Zhvillim të shpejtë pati prokurimi publik në Europë në fillim të shekullit të 20-të, sidomos pas Luftës së Parë Botërore, kur ndodhi që të miratoheshin shumë ligje që rregullonin prokurimin publik. Në vitet 1920, parlamenti i Suedisë miratoi rregulloren e parë të prokurimit, e cila me disa modifikime të herëpashershme është zbatuar deri në vitin 1994. Rregullorja ishte e detyrueshme për autoritetet qeveritare, por në të mungonin sanksionet. Kurse në vitin 1923 prokurimi publik u zbatua edhe në Itali, me "Dekretin Mbretëror" nr. 2440, datë 18 tetor 1923. Me këtë dekret u bë e mundur t'i hapej rruga kësaj veprimtarie, e cila shënon fillimin ose realizimin e një kontrate të nënshkruar për furnizimin më mallra, për shërbime apo kryerjen e ndonjë pune për institucionet publike dhe shtetërore.

Në këtë kohë, ky sistem përhapet edhe në vende të tjera të Europës Perëndimore. Është për t'u theksuar se, më 15 shkurt 1933, në Poloni, u miratua akti i parë për zbatimin e prokurimit publik, akt i cili mbeti në fuqi deri në vitin 1939. Pas lufte, në kohën e regjimit komunist, u zbatua sistemi i planifikimit qendror dhe, pa dyshim, nuk funksiononte ndonjë rregullore e veçantë lidhur me sigurimin e mallrave dhe shërbimet nga shteti dhe institucionet e tij. Me kalimin në ekonominë e tregut, në Poloni u hartua ligji i prokurimit publik, që hyri në fuqi më 1 janar 1995.

Në vitin 1934 sistemi i prokurimit publik vendoset në Estoni, ku u miratua ligji i parë për prokurimin publik, i cili mbeti në fuqi deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Pas luftës, nuk ka ekzistuar prokurimi publik deri në vitin 1995, kur parlamenti i Estonisë nxori një ligj modern mbi prokurimin publik.

Edhe në SHBA ka një sistem modern të prokurimeve dhe ekziston një infrastrukturë e tërë ligjore, që rregullon gjithë zhvillimin e këtij aktiviteti.

Nga ana e tij, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi ligjin nderkombëtar tregtar (United Nations Commission on International Trade Law – UNICITRAL), ka hartuar kornizat e prokurimeve publike, ligjin për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve (Uncitral Model Law on procurement of goods, construction and services with Guide to Enactment, 1994) që i nxit shtetet që dispozitat e tij t'i përfshijnë në legjislacionin e tyre.

Në Bashkimin Europian hapat e parë të legjislacionit për prokurimin publik prezantohen me "Traktatin e Romës". Më 25 mars 1957, u krijua në Romë Komuniteti Ekonomik Europian. Traktati ishte në thelb një Marrëveshje e Tregtisë së Lirë me qëllim heqjen e kufizimeve tregtare midis vendeve anëtare. Edhe pse ky Traktat nuk rregullonte drejtpërdrejt fushën e prokurimit publik në nivel të shteteve anëtare, ai vendosi parimet themelore të prokurimit publik. Por Direktivat e KE-së për Prokurimin do të dalin më vonë.

Objektivat kryesore të politikës së prokurimit publik të Bashkimit Europian janë: krijimi i kushteve për konkurrencë reale dhe jodiskriminuese të nevojshme për dhënien e kontratave publike, shpërndarjen racionale të parave publike, përmes zgjedhjes së ofertës më të mirë të paraqitur, qasjen e furnitorëve në një treg me mundësi të mëdha biznesi, dhe rritjen e konkurrencës në tendera. Për të mbështetur parimet e Traktatit të KE-së në fushën e prokurimit publik dhe për të hartuar udhëzimet e nevojshme për shtetet anëtare, në fillim të viteve '70, Bashkimi Europian nisi miratimin e një sërë direktivash për prokurimet, me të cilat rekomandohet, që shtetet anëtare të harmonizojnë dhe të përputhin ligjet e tyre të prokurimit publik.

Por në vendet e Europës Lindore veprimtaria e prokurimit publik filloi të zbatohet pas viteve '90, kur u miratuan edhe legjislacionet moderne të sistemit të ri të ekonomisë së tregut. Kështu, mund të themi se në Çeki ligji për prokurimin publik për herë të parë u hartua në vitin 1991; në Republikën e Shqipërisë, në vitin 1993, në Republikën e Maqedonisë në vitin 1998, ndërsa në Malin e Zi një ligj i tillë është miratuar shumë më vonë, në vitin 2001.

Në Kosovë prokurimi publik, si një fushë tejet specifike për shtetin e ri, ka filluar të paraqitet menjëherë pas përfundimit të luftës, në vitin 1999, ndaj dhe ka një histori të shkurtër, prej afro dy dekadash. Bazat e instalimit të prokurimit publik në Kosovë i kanë vendosur ndërkombëtarët përmes misionit të OKB në Kosovë, UNMIK. Akti i parë juridik që rregullon fushën e prokurimit publik në Kosovë u nxor nga UNMIK-u më 15 dhjetor 1999. Ky akt njihet me emrin "Udhëzimi i Administrimit Financiar", nr. 2/1999, për prokurimin publik në Kosovë. Ky Udhëzim bazohej në rregullat e prokurimit të Bankës Botërore dhe të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare "UNCITRAL". Më vonë, pas konstituimit dhe forcimit të institucioneve të Kosovës, parlamenti i Kosovës e rregulloi këtë fushë me ligj të veçantë, i cili hyri në fuqi më 9 qershor 2004 dhe njihet me emrin "Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë". Më 6 qershor 2007 ky ligj u ndryshua me disa amendamente, që e afrojnë atë me legjislacionin europian të prokurimit publik. Kjo bëri që të evitoheshin pengesat ligjore për integrimin e Kosovës në mekanizmat europianë.

Ligji në fjalë është përmirësuar me amendamente edhe në vitet 2009, 2010 dhe 2011. Këto shtesa dhe ndryshime kanë bërë që në Kosovë të kemi një ligj, i cili harmonizohet edhe më mirë me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik të BE-së. Aktet juridike dhe ligje bashkëkohore, e tërë infrastruktura ligjore e fushës së prokurimit publik që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Kosovës janë një bazë e mirë edhe për zhvillimin e prokurimit elektronik në vend.

Në fillim, ashtu si edhe në vendet e tjera në tranzicion, edhe në Kosovë prokurimet publike u përballën me vështirësi nga më të ndryshmet, pasi zyrtarët e angazhuar në këtë sistem kishin pak ose aspak përvojë dhe në tregun vendas mungonte konkurrenca e vërtetë. Edhe në këtë fushë, Kosova ishte një rast specifik, pasi ajo doli nga një luftë, që shkaktoi mjaft dëme edhe në ekonominë e saj. Administrata publike nuk e njihte traditën e prokurimit publik. Por me kalimin e viteve, me hartimin e politikave të prokurimit publik dhe me plotësimin e legjislacionit përkatës, me përcaktimin e rregullave dhe të mjeteve juridike, institucionet qeveritare dhe asministrata publike u futën në rrjedhën e realizimit të sistemit të prokurimit publik. Dhe mund të themi se brenda një kohe të shkurtër në fushën e prokurimit publik në Kosovë u shënuan disa rezultate. Këto u arritën edhe në saje të punës së ekspertëve ndërkombëtarë, që jo vetëm themeluan sistemin e prokurimit publik në Kosovë, por edhe organizuan praktikisht aktivitetet e prokurimit publik dhe, njëkohësisht, punuan për trajnimin e zyrtarëve vendas, të cilët në hapat e parë u aktivizuan në rolin e asistentëve. Po ashtu, ishin ndërkombëtarët, që ndihmuan me mjete dhe me përvojën e tyre për për zhvillimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në vend.

Funksionimi i sistemit të prokurimit publik në Kosovë shihet tani si një çështje e rëndësishme për menaxhimin e financave publike, bazuar në transparencën, konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në tendera. Realizimi me sukses i shumë projekteve të prokurimit, sidomos ato në infrastrukturë dhe në komunikimet, ka ndikuar në zhvillimin ekonomik të vendit, ka pasur një efekt të dobishëm në industri, në rritjen e punësimit, të konkurrencës etj. Pozitive kanë qenë edhe reformat që janë ndërmarrë në fushën e sistemit të prokurimit publik në Kosovë si edhe kontaktet dhe bashkëpunimi me ekspertë ndërkombëtarë të fushës së prokurimit publik.

2.2 Mbi përkufizimin e prokurimit publik

Lidhur me atë se çka është dhe çka vërtet nënkuptojmë me prokurim publik autorë të ndryshëm kanë ide dhe mendime të ndryshme. Fjala prokurim e ka prejardhjen e saj nga fjala latine “*procurare*”, që do të thotë “të tregosh kujdes për diçka”, “të administrosh diçka”. Pra, mund të themi se me “prokurim” nënkuptojmë një proces administrimi. Mbi këtë bazë kanë lindur dhe janë zhvilluar përkufizime të ndryshme për prokurimin publik.

Nga një vështrim i legjislacioneve të vendeve të ndryshme dhe nga studiues të huaj, vëmë re se *prokurimin publik* e përkufizojnë në mënyra të ndryshme.

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, të Shqipërisë: “Prokurim do të thotë blerje, marrje me qira ose çdo mënyrë tjetër e kontraktimit të mallrave, ndërtimeve dhe shërbimeve”. (LPP i Shqipërisë, 1995).

Në Kroaci, në Ligjin për Prokurim Publik, prokurimi përkufizohet si “blerja e mallrave dhe shërbimeve, kontraktimi i punëve, blerja apo marrja me qira ose lizing,

në pajtim me metodat dhe procedurat e përcaktuara, ku pala porositëse mund të shfrytëzojë mallrat apo shërbimet e prokuruarat” (LPP i Kroacisë, 2001).

Në Maqedoni, Ligji për Prokurim Publik përcakton se: “Prokurimi publik është procesi i shfrytëzimit të fondeve publike prej disa organeve publike, me qëllim sigurimin e burimeve të jashtme në përgjithësi prej ofertuesve komercialë” (LPP i Maqedonisë, 2005).

Ndërsa Zyra e Tregtisë Qeveritare e Britanisë së Madhe e përkufizon prokurimin publik si “... procesi ku institucionet e sektorit publik sigurojnë mallrat, shërbimet dhe punët nga palët e treta” (An Introduction to Public Procurement; page 3; OGC “Office of Government Commerce” London; www.ogc.gov.uk).

Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) e sheh prokurimin publik si një mekanizëm strategjik që menaxhon në mënyrë efikase shpenzimet e qeverisë në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve të ndryshme, inkurajon sinergji, sjell risi dhe rritje ekonomike dhe të tregut dhe, gjithashtu, garanton mbrojtjen e mjedisit, mundësi për të sjellë kursime financiare (OECD 2013).

Të ndryshme janë përkufizimet që japin për prokurimin publik edhe një mori autorësh dhe studiuesish të kësaj fushe.

Wayne dhe Wittig (2002:2) e kanë përkufizuar atë si “një proces biznesi brenda një sistemi politik”.

Dr. Tina Erzen bën këtë përcaktim: “Prokurimi publik mund të përkufizohet si aktivitet i institucioneve publike – shtetërore lokale dhe organeve që udhëhiqen nga e drejta juridike, në të cilat fondet publike shpenzohen për sigurimin e të mirave për interesin publik apo të përbashkët”(ERZEN, 2006)

Sipas Andrea Sundstrand: “Prokurimi publik paraqet blerjet publike të kryera nga qeveria, komunat, këshillat e qarkut, kompanitë publike, si dhe shoqatat e fondacionet, në mënyrë që të jenë në gjendje për të kryer aktivitetet e tyre të ndryshme”. (SUNDSTRAND, 2009)

Ndërsa prof. Sue Arrowsmith thekson se: “Prokurimi qeveritar, në përgjithësi, u referohet blerjeve nga ana e organeve qeveritare të mallrave dhe shërbimeve prej ofertuesve të jashtëm, që këto organe t’i kryejnë sipas rregullit detyrat që kanë të bëjnë me shërbimet publike”. (ARROWSMITH, Sue, “Government Procurement in WTO”: The concept and importance of Procurement” School of Law University of Nottingham; page 2).

Ndërsa në Kosovë, në Ligjin e Prokurimit Publik nr.04/L-042, përcaktohet: “Aktiviteti i prokurimit do të thotë çdo aktivitet që ndërlidhet me fillimin ose ekzekutimin e një procedure ose një aktiviteti tjetër që shpie ose që ka për qëllim të shpjerë drejt dhënies së një kontrate publike”(LPP i Kosovës Nr.04/L-042).

Kurse sipas dokumentit “Instruksion për Administrim Financiar” nr.2/1999: “Prokurim do të thotë blerja ose shitja e mallrave, punëve ose shërbimeve, duke përfshirë qiratë pa kufizimin e tyre, kërkesat për blerje, kërkesat e përhershme, lëshimin e licensave ose koncesioneve që priten të realizohen në të ardhura neto në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe përfitimet e shpronësimeve të tjera që janë në pronësi shtetërore apo publike përmes cilitdo instrument të kontraktimit” (IAF, 1999).

Siç shihet nga këto përkufizime, prokurimi publik, përgjithësisht, duhet nënkuptuar jo vetëm si procedurë administrative që shpie në dhënien e një kontrate publike, por edhe si aktivitet, që, në thelb, fillon me inicimin e prokurimit (hartimi i projektit që duhet realizuar, ideja artistike, paramasa, paralogaria etj.) dhe mbaron me realizimin e aktivitetit të interesit publik, që financohet nga fondet publike.

Prokurimi publik paraqet shpërfaqjen më të qartë të reformimit të administratës publike të ndërmarrë në dekadat e fundit. Reformat e kryera kanë bërë që të ndalet procesi i zgjerimit të sektorit publik, me arritjen më të madhe të përjasjes së re apo teorisë së re të administrimit publik, e njohur si teoria e kontraktualizimit.

Prokurimet janë në disa lloje, sipas obkektit që kanë. Kështu kemi:

Prokurime të punëve publike. Bëhet fjalë për realizimin (edhe ekzekutimin), ose projektimin bashkë me realizimin, të punimeve publike, që u mundësojnë organeve publike ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Për shembull, rikonstruksioni i një godine ku ushtron veprimtarinë organi publik, punimet për rikonstruksionin e zyrave, të një shkolle publike, të një spitali publik, ose ndërtimi i një fjetine në një repart ushtarak etj.

Prokurime të furnizimit me mallra. Bëhet fjalë për furnizimin me sendet që administrata publike ka nevojë për ushtrimin e veprimtarisë së saj. Këtu hyjnë vetëm sendet e luajtshme dhe jo sendet e paluajtshme.

Prokurimet e shërbimeve - për përmbushjen e nevojave që mund të ketë administrata publike për shërbime, si pastrimi e deri te shërbimet informatike. Shërbimet mund të jenë të shumëllojshme. Ato ndahen në shërbime materiale dhe në shërbime intelektuale

Prokurimet me objekt material të përzier. Këto kanë objekt në të njëjtën kohë punime dhe furnizime mallrash, ose shërbime dhe furnizime mallrash.

2.3 Format e prokurimit publik: tradicionale dhe elektronike

Prokurimi i mallrave, i punëve dhe shërbimeve është një hallkë strategjike që përfshin të gjithë procesin e blerjes, dhënies apo marrjes me qira të mallrave, punëve apo shërbimeve nga një ministri, departament apo administratë, qendrore apo rajonale. Kjo hallkë funksionon në mënyrë efikase, kur realizohet një koordinim i mirë ndërmjet katër shtyllave kryesore të këtij sistemi: kornizës ligjore, të shoqëruar me rregullore të detajuar; kuadrit institucional; fazave operacionale dhe menaxhimit të tenderave; sistemit të kontrollit, monitorimit dhe integritetit.

2.3.1 Prokurimi tradicional

Proceset tradicionale të prokurimit, të bazuara në letër, paraqesin mjaft probleme dhe aspekte negative. Ato përfshijnë informata menaxhuese jo të plota, procedura joefikase, kosto të lartë të përputhshmërisë për furnitorët dhe

departamentet, metodologji të thjeshta dhe të dobëta prokurimi dhe mungesë të madhe të transparencës. Insistimi në proceset prokurimit të bazuara në letër, gjithashtu, zvogëlon absorbimin e teknologjive produktive të informimit në ekonomi, në përgjithësi. Dhe, mbi të gjitha, kjo formë prokurimi lë shumë hapësira për shfaqjet e korrupsionit në nivel të lartë, për vjedhje dhe për shpërdorimin e parave publike në prokurimet në infrastrukturë, në shkolla, spitale, polici, ushtri etj.

Prokurimi publik tradicional karakterizohet nga:

- Blerje të pakoordinuara në qeveri, pasi departamente të ndryshme kanë kontrata të ndryshme dhe çmime të ndryshme për mallra të njëjta;
- Kosto të lartë të procesit, të ndërlidhur me testimin e tregut;
- Informata të vjetruara për tregun;
- Shpenzime pa kontratë me furnitorë;
- Procese joefikase të pagesës;
- Informata të vjetruara të auditimit;
- Menaxhim të kontratave, të prirë në gabime.

Në këtë formë tradicionale të prokurimit publik, zbehen mundësitë për përmirësimin e rezultateve shoqërore dhe ekonomike, për shkak se informatat kryesore për menaxhim dhe planifikim janë të paqasshme.

2.3.2 Prokurimi elektronik

Shumë nga problemet e mësipërme mund të kapërcehen, kryesisht, përmes shfrytëzimit të efektshëm të teknologjisë informative për prokurim elektronik, pasi kjo platformë ka mjaft avantazhe dhe sjell shumë përfitime. Ai ndikon në eliminimin e pengesave që janë të pranishme në formën fizike të prokurimit, rrit besimin e të gjitha palëve të përfshira, mundëson që siguria e të jetë maksimale, si dhe ndikon në rritjen dhe përmirësimin e transparencës dhe të efikasitetit të procesit të prokurimit publik.

Në Kosovë, platforma e prokurimit elektronik ka filluar të zhvillohet në fund të vitit 2014, me një projekt të financuar nga Banka Botërore, në kuadër të Projektit të Modernizimit të Sektorit Publik. Projekti parashikonte zhvillimin dhe implementimin e sistemit të e-Prokurimit; furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e informacioneve kryesore teknologjike në qendrën e të dhënave të pajisjeve harduerike, dhe shërbimet e nevojshme për drejtimin e sistemit të prokurimit elektronik; pakon softuerike të projektit, që do të funksionojë si një sistem i plotë, unik i prokurimit elektronik për të ndihmuar qeverinë e Kosovës në kryerjen e prokurimeve elektronike. Gjithashtu, projekti përfshinte ngritjen e Qendrës së të Dhënave në Ministrinë e Administratës Publike; trajnime të stafit që merren me prokurim, për sistemin e prokurimit elektronik, teknologjisë informative dhe të dhënave të qendrës harduerike dhe softuerike; ndërlidhjen e sistemit të e-Prokurimit me sistemet e jashtme për verifikimin e informacioneve në lidhje me regjistrimin e bizneseve etj.

E-Prokurimi nuk është thjesht një aplikacion softuerik, nuk është vetëm një zgjidhje teknike, por një program strategjik, një zgjidhje e plotë afariste. Nuk

mjaftojnë vetëm mjetet teknike për ta implementuar atë me sukses. Ky sistem bazohet në një zgjidhje standarde softuerike, të quajtur @Spin, e zhvilluar nga INFODOM. Kjo është implementuar në disa vende. Për funksionimin e këtij softueri të personalizuar në Kosovë, është dashur t'i shtohen atij disa funksione të përshtatura me infrastrukturën elektronike që kemi.

Platforma e prokurimit elektronik është e bazuar në rrjet, në automatizimin e punës së pjesëmarrësve në prokurim. Ky sistem ofron një përgatitje dhe administrim të sigurt, efikas dhe transparent të të gjitha dokumenteve në lidhje me tenderin, duke hequr të gjitha punët shkresore të panevojshme dhe duke siguruar një rrjedhje të dhënash të sigurt përgjatë gjithë sistemit. Ai bën të mundur transaksione të sigurt ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe komunitetit të biznesit kombëtar dhe ndërkombëtar. Sistemi i e-Prokurimit është i detyrueshëm, për të përmbushur Direktivën e BE-së (2014/24/BE) në këtë fushë (DIRECTIVE 2014/24/EU, 2014).

Impakti i madh pozitiv që ka ky sistem dhe epërsia e tij ndaj formës tradicionale të prokurimit duken në disa drejtime. Rrit transparencën në procedurat dhe praktikën e prokurimit; nxit dhe inkurajon pjesëmarrjen në tendera dhe promovimin e konkurrencës midis furnizuesve; rrit sigurimin e konfidencialitetit, të integritetit dhe të vërtetësisë të të gjitha transaksioneve dhe të të dhënave ndërmjet entiteteve të prokurimit dhe furnizuesve. Gjithashtu, përmes prokurimit elektronik shtohet efikasiteti në të gjithë procesin e prokurimit dhe minimizohet koha e ciklit të prokurimit; përmirësohet niveli i shërbimit për të gjitha palët e përfshira në prokurim.

Ai lehtëson shumë jo vetëm në përpilimin e dokumentacionit të tenderave, duke evituar shkresurinat në letër, por edhe i bën më të sigurt administrimin dhe konfidencialitetin e tij. Në këtë sistem minimizohet dekonspirimi i të dhënave, garantohet sekretin e ofertave përgjatë gjithë procesit. Përfitim i madh është se ky sistem minimizon kohën e aplikimit, ky dhe procedurat e tjera mund të kryhen kurdo dhe nga vendi ku ndodhen, pa qenë nevoja të paraqiten tek autoriteti kontraktues, gjë që pakëson shpenzimet që duhet të bëjnë. Operatorët ekonomikë i kryejnë punët jo më në letër, por me pajisje elektronike, përmes internetit, që nga shkarkimi dhe transferimi i dokumenteve, dhënia e ofertave apo informimi për procedurën e prokurimit. Paraqitja dhe kushtet e tenderit janë të standardizuara dhe, për rrjedhojë, lehtësohet shumë procesi i prokurimit. Shumë e rëndësishme është se sistemi prokurimit elektronik ngushton hapësirat për veprime korruptive. Ruajtja e të dhënave në server, u pret rrugën ndërhyrjeve të qëllimshme nga administruesit e sistemit.

Për të qenë të saktë dhe realistë, duhet thënë se ka edhe skepticizëm dhe mendime kundër implementimit të prokurimit elektronik në Kosovë. Disa e quajnë ende të parakohshëm, të tjerë shprehin frikën se prokurimi elektronik, në thelb, mund të ballafaqohet me dobësi në realizimin praktik, pasi e konsiderojnë atë një proces me rreziqe të larta. Ka pasur raste që përdorues të prokurimit elektronik kundërshtojnë përdorimin e internetit, përfshirë dhe kundërshtimin fetar të tij, bëjnë rezistencë ndaj konkurrimit dhe transparencës më të lartë që prodhon ky sistem, ngaqë mendojnë se me prokurimin elektronik krijohen mund të rrezikohet siguria e të dhënave, mund të ketë mashtrime etj. Por ata harrojnë që rreziqet ndaj sigurisë dhe mashtrimet janë të

pranishme në përmasa të mëdha në formën tradicionale të prokurimit publik, që bazohet në letër.

2.4 Parimet e prokurimit sipas LPP

Puna për arritjen e objektivave të prokurimit publik, krahas hartimit të një strategjie dhe të politikave efektive, që synojnë sigurimin e një sistemi efikas të prokurimit publik transparent dhe konkurrues mbështetet në disa kritere bazë, të cilat përcaktohen në dispozitat e Marrëveshjes e Komunitetit European, në direktivat që rregullojnë fushën e prokurimeve publike. Është e domosdoshme që këto parime të njihen dhe të kuptohen drejt nga të gjithë aktorët pjesëmarrës në prokurimin publik, pasi kështu njohin të drejtat e tyre, detyrimet që lindin prej tyre, si dhe kuptojnë domosdoshmërinë e zbatimit të këtyre parimeve në praktikë.

Në Kosovë këto kritere janë sanksionuar në Ligjin për Prokurimin Publik, që hyri në fuqi më 9 qershor 2004. Sipas tij parimet më prioritare të prokurimit publik janë:

-  **Transparenca**
-  **Konkurrenca**
-  **Trajtimi i barabartë/Jodiskriminimi**
-  **Profesionalizmi**

Këto parime qëndrojnë në bazën e procesit të prokurimit publik. Zbatimi tyre është tregues i respektimit të ligjit. Më poshtë po trajtojmë se çfarë përfaqëson secili prej tyre.

2.4.1 Parimi i transparencës

Me qëllim që aktivitetet e prokurimit të jenë sa më transparente, LPP kërkon që të gjitha njoftimet për aktivitetet e prokurimit, që u takojnë kontratave me vlera të mesme dhe të mëdha, pas publikimit të njoftimit të kontratës të publikohen në faqen zyrtare të prokurimit publik të Kosovës, duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara ose të negociuara (www.rks-gov.net/prokurimi). Publikimet duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë, edhe kur bëhet njoftimi për kontratë, edhe kur bëhet njoftimi për dhënie të kontratës apo për konkurs të projektimit.

Autoriteti kontraktues përgatit të gjitha dosjet e tenderave, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomikë gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit, që shpie drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë minimale, të vogël ose të mesme. Këto dokumente shkruhen në gjuhët zyrtare të Kosovës, kurse për kontratat me vlera të mëdha, publikimi dhe përgatitja e dosjes tenderike duhet të bëhet, përpos në gjuhët zyrtare të Kosovës, edhe në gjuhën angleze.

Çdo autoritet kontraktues mban një përmbledhje gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet prokurimi që kryen, pavarësisht nëse ky aktivitet rezulton me dhënien e kontratës ose jo. Dosjet për secilin tender përmbajnë të gjitha dokumentet, shënimet për secilin aktivitet prokurimi. Nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar me dhënien e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë duhet të jenë në dodje të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e kontratës. Nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar me ekzekutimin e një kontrate publike, atëherë një kopje të plotë të dosjes tenderike dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën përkatëse duhet të ruhen deri në përfundimin e saj.

Dokumentet ruhen, me qëllim që çdo palë e interesuar, sipas rastit, të kërkojë nga autoriteti kontraktues informata të detajuara lidhur me atë aktivitet. Autoriteti kontraktues është i detyruar t'i sigurojë qasje të arsyeshme në të gjitha të dhënat, përpos atyre që nga ana e operatorit ekonomik, qysh më parë janë klasifikuar si të dhëna sekrete me një shkresë përcjellëse të bashkangjitur në ofertë.

Të gjitha këto bëjnë të mundur zbatimin dhe respektimin e parimit të prokurimit publik, zhvillimit të Transparencës, me qëllim që të gjitha palëve që përfshihen në prokurim, madje edhe qytetarëve, t'u sigurohet informacion i pasur për të gjitha aspektet e procesit të prokurimit, për fondet, për fituesin, argumentet përse fitoi ai, si dhe për ecurinë e kontratës. Këto njoftime që jepen përmes internetit janë të qasshme nga të gjithë të interesuarit, duke realizuar kështu një transparencë të plotë, siç e kërkon ligji. Për fuqizimin e transparencës një potencial të madh ka prokurimi elektronik.

2.4.2 Parimi i konkurrencës

LPP kërkon që autoriteti kontraktues të mos ndërmarrë asnjë aktivitet ose procedurë prokurimi, që, në ndonjë mënyrë, e redukton ose e eliminon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për këtë qëllim përdoren procedura të hapura, përveç rasteve kur mund të autorizohet nga AQP për situatat në të cilat AQP e sheh të arsyeshme përdorimin e procedurave të tjera, sipas kërkesës me shkrim nga ana e autoritetit kontraktues. Kjo bëhet me qëllim për të garantuar pjesëmarrjen në prokurim të sa më shumë operatorëve të interesuar ekonomikë. Kjo kërkesë ligjore është vendosur obligative, me qëllim që gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit të ketë një konkurrencë të mirëfilltë dhe të arrihet vlera më e mirë e mundshme me mjetet në dispozicion.

Gjatë një aktiviteti prokurimi, nëse autoriteti kontraktues pranon më pak se tre tendera të përgjegjshëm, atëherë ai e anulon aktivitetin e prokurimit (LPP, nr.2003/17; Neni 30); dhe, nëse ende dëshiron të prokurojë lëndët përkatëse, duhet të fillojë një aktivitet të ri prokurimi për to.

Nëse autoriteti kontraktues e konsideron se një aktivitet prokurimi është më specifik dhe mungon një treg më i gjerë për ato produkte dhe nëse ka arsye bindëse për të besuar se anulimi i aktivitetit përkatës të prokurimit dhe fillimi i një aktiviteti të ri të prokurimit nuk do të rezultojë me paraqitjen e një numri më të madh se tre

tendera të përgjegjshëm, atëherë mund t'i drejtohet me një kërkesë me shkrim KRRPP-së për mundësinë e vazhdimit të aktivitetit të prokurimit, duke dhënë arsyet e mossigurimit të tre ose më shumë ofertuesve të përgjegjshëm. Sipas Ligjit për Prokurim Publik, të Shqipërisë, aktiviteti i prokurimit mund të vazhdojë të kryhet me sukses, nëse pranohen, së paku, dy tendera të përgjegjshëm (Ligji për Prokurimin Publik i Shqipërisë, nr.9643, datë 20.11.2006).

KRRPP, pas shqyrtimit të kërkesës, nëse konstaton se aktiviteti i prokurimit është zhvilluar në përputhje me ligjin dhe se nuk ka pasur kritere diskriminuese gjatë përgatitjes së dosjes së ofertimit, por tregu për produktet në fjalë është i rrallë, nxjerr vendimin, me të cilin i lejon autoritetit kontraktues vazhdimin e aktivitetit të prokurimit edhe në rastin kur pranon më pak se tre tendera të përgjegjshëm.

Edhe zbatimi i këtij parimi është me rëndësi të madhe, pasi ka të bëjë me faktin se para ligjit janë të gjithë të barabartë e, për rrjedhojë, të gjithë ata që i plotësojnë kushtet dhe kërkesat kanë të drejtë të përfshihen në procesin e prokurimit publik, pra, të konkurrojnë në një aktivitet të mirorganizuar sipas kornizës ligjore.

2.4.3 Parimi i trajtimi të barabartë/Jodiskriminimi

Sipas LPP, autoriteti kontraktues duhet t'i trajtojë njësoj dhe në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit, që shprehin interesim për të marrë pjesë në një aktivitet prokurimi. Nga autoriteti kontraktues kërkohet që të mos ekzekutojë asnjë fazë të aktivitetit të prokurimit që në një mënyrë a në një tjetër diskriminon apo favorizon një ose më shumë operatorë ekonomikë. Secilit autoritet kontraktues i ndalohet të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, të specifikojë lëndën që do të prokurohet, të ndajë ose të përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë prokurimi ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikim teknik, që ka për qëllim të favorizojë ose të diskriminojë njërin ose më shumë operatorë ekonomikë. Autoriteti kontraktues nuk duhet të krijojë ose të imponojë rrethana ose kushte që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomikë. Ai duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar të tilla veprime diskriminuese.

Ky parim kërkon që metodat e përzgjedhjes, të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë, duhet të saktësohen në njoftimin e kontratës ose të konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose për pjesëmarrje dhe në dosjen e tenderit. Asnjë kërkesë, kriter, specifikim, që nuk është saktësuar me kohë, nuk duhet të përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies së rezultatit. Pra, është fjala për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve, pa asnjë diferencim dhe diskriminim. Përzgjedhja e fituesit duhet të jetë në përputhje me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse në dokumentet e tenderit, të cilat kanë qenë transparente dhe të njëjta për të gjithë konkurrentët në prokurim.

Respektimi i këtij kriteri është themelor për mbarëvajtjen e procesit të prokurimit. Ai ka një impakt pozitiv në vërtetimin e faktit që jetojmë në një shoqëri moderne, ku të gjithë shihen si të barabartë edhe në aspektin e trajtimit të drejtë në aktivitetet e prokurimit publik.

2.4.4. Parimi i profesionalizmit

Cilësia e zhvillimit të procesit të prokurimit publik kërkon edhe burime njerëzore të kualifikuara, që janë në gjendje t'i kryejnë detyrat me profesionalizëm. Duke u bazuar në faktin se prokurimi publik në Kosovë është në fazat fillestare të zhvillimit dhe se nuk ekziston ndonjë institucion arsimor i posaçëm që përgatit dhe aftëson kuadro për fushën e prokurimit publik, ligji kërkon në mënyrë obligative aftësimin profesional për çdo vit të zyrtarëve që merren me prokurim publik.

Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit publik është një domosdoshmëri e padiskutueshme, pasi ka të bëjë me fatet dhe me cilësinë e proceseve të prokurimit. Përgjegjës për organizimin e trajnimeve në këtë fushë është Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Që të rritet profesionalizmi i punonjësve që angazhohen me realizimin e procesit, trajnimi duhet të zgjasë, së paku, dhjetë ditë pune brenda vitit. Programet e trajnimit përfshijnë të gjitha aspektet Ligjit për Prokurim Publik dhe praktikat më të avancuara ndërkombëtare të prokurimit, si dhe ato të BE-së. Për të gjithë zyrtarët e prokurimit të cilët kanë vijuar trajnimin, KRRPP organizon testimin e njohurive dhe të aftësive që ata kanë fituar. Ata që e kalojnë me sukses testin pajisen me certifikatë të profesionalizmit në prokurim, e cila është e vlefshme vetëm për një periudhë njëvjeçare. Vetëm ata persona të cilët kanë certifikatë të vlefshme për prokurim publik mund të kryejnë detyrën e kryesuesit të departamentit të prokurimit në një autoritet kontraktues.

2.5 Fazat e procesit të prokurimit dhe palët e kontratës

Procedura e prokurimit fillon dhe kalon nëpër disa faza, si planifikimi, sigurimi i mjeteve, përgatitja dhe publikimi i prokurimit publik, zgjedhja e ofertës më të mirë, mbrojtja ligjore e së drejtës nga prokurimi publik mbi procedurën etj. Këto procedura kanë aspektet e tyre administrative, materiale-juridike, si edhe aspekte të kontabilitetit, të punimit financiar.

Duke iu referuar Ligjit për Prokurim Publik, të Kosovës, Nr.04/L-042, vëmë re se procesi i prokurimit publik përfshin tri grupe aktivitesh, që mund klasifikohen në tri faza. Këto janë:

- 1. Përgatitja e procesit të prokurimit**
- 2. Zhvillimi i procesit të prokurimit**
- 3. Menaxhimi i kontratës**

Të paraqitura grafikisht, fazat e procesit të prokurimit jepen në figurën 1:




Figura nr.1 Fazat e procesit të prokurimit

Këto tri faza të prokurimit publik nënkuptojnë: planifikimin – përcaktimin e nevojave dhe vendimmarrjen për blerjen e mallrave, punëve, apo shërbimeve; rregullat përcaktuese për kontratat, që sigurojnë blerësit e këtyre mallrave, punëve, apo shërbimeve dhe procesin e administrimit të kontratës, për të siguruar performancë efektive.

Në mënyrë më të detajuar shërbimet dhe funksionet e prokurimit elektronik paraqiten në tabelën e mëposhtme, sipas secilës fazë dhe moduleve përkatëse.

Tabela 1 Zhvillimi i prokurimit elektronik/fazat e fillimit – përmbledhje

Faza	Moduli	Funksionaliteti
------	--------	-----------------

Faza kryesore 1	Shërbimet e përgjithshme/informative	Qasja në politikat e prokurimit, rregulloret dhe udhëzimet Shpallja e detyrueshme e mundësive për prokurim dhe e rezultateve të dhënies së kontratave në faqe të internetit Shkëmbimi i të dhënave dhe ndërveprimi Shpallja e detyrueshme e informatave nga monitorimi i performancës së prokurimit Kërkesat online dhe qartësimet
	Tenderimi elektronik	Shkarkimi i dokumenteve tenderuese online, ndryshimet etj. Dorëzimi i ofertave përmes zhbartjes të sigurt të dokumenteve dhe plotësimit online të formularëve nga furnitorët me transferim të sigurt, ruajtje të sigurt dhe konfirmim të pranimit Biblioteka e dokumenteve standarde të ofertimit në dispozicion online Shpallja e dhënies të kontratave etj.
	Menaxhimi i furnitorëve	Regjistrimi i furnitorëve Mundësimi i përfshirjes së furnitorëve Njoftimet e furnitorëve për mundësi të prokurimit Futja në listë të zezë të informatave që vihen në dispozicion online
	Menaxhimi i kërkesave	Përgatitja online e kërkesave, parallogaritjeve
	Kuotimi elektronik	Zbatimi i ftesave për kuotim për urdhërblertje të mallrave dhe shërbimeve të vlerave të ulëta.
	Menaxhimi i kornizave	Prokurimi nga marrëveshjet kornizë online
	Blerja elektronike/ menaxhimi i katalogut	Çështja e urdhërblertjeve për furnizim të mallrave
	Pagesat elektronike	Zbatimi i pagesave të brendshme (EMD, tarifa e transaksionit)
	Menaxhimi i kontratave elektronike	Zbatimi i menaxhimit të kontratës për furnizime të thjeshta
Faza kryesore 2	Shërbimet e përgjithshme/informative	Vënia në dispozicion e statistikave lidhur me furnizimet, nevojat dhe prokurimin e përgjithshëm të qeverisë Planet e prokurimit të vihen në dispozicion online
	Tenderimi elektronik	Gjenerimi automatik i dokumenteve të ofertimit nga shabllonet standarde të dokumenteve
	Menaxhimi i furnitorëve	Matja e performancës së furnitorëve përmes përdorimit të treguesve
	Blerja elektronike/ menaxhimi i katalogut	Prokurimi i bazuar në katalog për artikujt e vlerave të ulëta
	Menaxhimi i kontratave elektronike	Menaxhimi i kontratave të punëve të ndërlikuara me përcjellje të objektivave
	Pagesat elektronike	Zbatimi i pagesave dalëse, për shembull, pagesat e kontratave përmes mjeteve elektronike

Të avancuara	Menaxhimi i rrjedhës së punës elektronike	Rregullon dhe kontrollon autorizimet e deleguara dhe mban miratime dhe gjurmë të auditimit
	Kushtet e integritetit	Integrimi me SIME, etj.
	Ankandi elektronik	Zbatimi i ankandeve dhe i ankandeve të anasjelltë për kategoritë e identifikuar
	Kushtet e integritetit	Integrimi me procesin buxhetor, sistemet e menaxhimit të inventarit etj.

Në këtë tabelë shërbimet dhe funksionet e prokurimit elektronik paraqiten sipas fazave, të cilat duhen respektuar, pasi ndryshe ka qasje të rrezikut të papërputhshmërisë me kërkesat dhe kapacitetet e përdoruesit. Funksionet kryesore janë esenciale për fillimin e plotë të prokurimit elektronik. Ndërsa rekomandimet e avancuara mund të shtyhen për një fazë më të vonshme dhe të zbatohen varësisht nga progresi i programit. Tabela paraqet dallimin mes gjërave kryesore dhe atyre të avancuara. Ndërlíkueshmëria dhe kostot, si dhe kërkesat legjislative, çështjet e integritetit, ekspertiza dhe kuptimi i nënkomponenteve të ndryshme nënkuptojnë se rruga e rekomanduar e këtij zhvillimi fazor të strukturohet së bashku me linjat e paraqitura në tabelë .

Renditja e fazave të zbatimit të prokurimit elektronik në tabelë është në përputhje me përvojat nga shumë shtete, me një numër qasjesh dhe modelesh të ndryshme. Ajo ka qenë qasja e rekomanduar nga Banka Botërore, Banka Afrikane për Zhvillim dhe Banka Ndëramerikane për Zhvillim. Megjithatë, ky orar nuk është përshkrues dhe mund të ndryshojë sipas progresit të projektit. Është e rëndësishme se rekomandohet që zhvillimet e para dhe fillimi të përfshijë çështjet e informimit, publikimit, tenderimit elektronik dhe të kuotimit elektronik. Marrëveshjet kornizë duhet të përfshihen sapo të përgatiten dhe sa më shpejt që është e mundur – këto duhet të jenë në fokus të lartë. Për shkak se faqja qendrore e internetit lejon qasje në tërë dokumentacionin tenderues, kushtet për dhënien e qasjes kanë të bëjnë me nevojën për harmonizimin dhe standardizimin e procedurave.

Mirëmbajtja dhe operacionet e vazhdueshme të sistemeve duhet të përcaktohen në modelin e punës që i trajton çdo çështje të të hyrave, siç janë tarifat për aspektet e shërbimeve të prokurimit elektronik. Në dhënien e qasjes së hapur në dokumentet ofertuese dhe lejimin e tyre që të shkarkohen pas kërkesës, është e nevojshme që të verifikohet që versionet përfundimtare dhe juridikisht të vlefshme të atyre dokumenteve të vihen në dispozicion, që ato t'i përmbajnë të gjitha informatat relevante (përfshirë grafikët dhe planet), dhe që qartësimet e dhëna gjatë procesit të bashkëngjiten apo të jepen në vijim.

2.6 Kontrata në prokurimin publik dhe palët në proces

Teoritë e reja të administrimit publik vendosin kontratën në qendër të qeverisjes publike dhe nuk do të ishte tërësisht e gabuar të vlerësohej se kontrata në

fjalë është një mekanizëm i sektorit privat (Lane, J.Eric, 2000). Nga ana tjetër, shikuar nga aspekti i së drejtës administrative, këto kontrata konsiderohen kontrata administrative. Kodi i Procedurës Administrative e përkufizon kontratën administrative si marrëveshje, ku, të paktën, njëra nga palët është organ i administratës publike, me qëllim të krijojnë, të shuajnë apo të ndryshojnë një marrëdhënie juridike në fushën e së Drejtës publike.

Kontrata e prokurimit publik lidhet për të përmbushur nevojat e organit publik autoritet kontraktor. Kontrata ka objektin material, që i referohet natyrës së nevojës që kërkohet të përmbushet. Këto nevoja kanë të bëjnë me kryerjen e punimeve, me furnizimin e mallrave dhe me ofrimin e shërbimeve. Pra, kontratat variojnë në përputhje me llojet e prokurimeve.

Disa kontrata jepen për punë publike, me objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.

Kontrata publike të tjera kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave, ashtu siç ka edhe kontratat publike për shërbime. Gjithashtu, ka edhe kontrata me objekt material të përzier, për mallra dhe shërbime, që vlerësohen si kontratë publike për shërbime, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave dhe anasjelltas.

Duke qenë se prokurimi publik finalizohet me kontrata administrative, që përdoren më së shumti nga administrata publike, kuptohet që në këtë proces ka palë, midis të cilave lidhet kontrata, pra, midis autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

2.6.1 Autoriteti kontraktor

Ky është një organ publik që do të blejë mallra, shërbime apo kryerjen e punimeve. Si i tillë mund të jetë çdo institucion qeveritar, kushtetues, institucion publik i pavarur apo njësi e pushtetit vendor, që në përputhje me ligjin, blejnë mallra dhe produkte të ndryshme, shërbime dhe kryejnë punime të caktuara, duke vepruar me procedurat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktues është autoriteti publik, operatori i shërbimeve publike, ndërmarrja publike dhe/ose personi, komisioni ose kompania private, që operon në bazë të të drejtave të veçanta apo ekskluzive, ose ndërmarrja që ushtron aktivitete të prokurimit në emër të/ose për llogari të autoritetit publik ose operatorit të shërbimeve publike ose një ndërmarrje publike.

Autoriteti kontraktues mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen, pa marrë parasysh nëse aktiviteti rezulton ose jo në dhënien e kontratës ose konkursit të projektimit. Ai i siguron qasje të menjëhershme, të arsyeshme dhe pa pengesa në të dhënat çdo personi ose pale të interesuar, që ka të drejtë qasjeje në to, përveç informatave sekrete afariste të aktiviteteve të prokurimit të mbyllura, duke ruajtur kështu integritetin e të dhënave. Për këtë, ai u jep atyre një kopje të çdo materiali për të cilin ata interesohen, si dhe publikon në mënyrë elektronike, ligjin dhe rregullat e

prokurimit publik në webfaqen zyrtare në internet. Kopje të dokumenteve të aktivitetit të prokurimit autoriteti kontraktues ua siguron edhe ekspertëve shqyrtues, KRRrPP-së, OSHP-së, si dhe gjykatave kompetente.

2.6.2 Operatori ekonomik

Nënkupton furnizuesin, ofruesin e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve. Si të tillë janë kontraktuesit, furnizuesit dhe sipërmarrësit e shërbimeve, pra, personat fizikë, juridikë apo entet publike që ofrojnë kryerjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime. Në cilësinë e operatorit ekonomik mund të jetë edhe një organ publik, që i ofron këto dhe që shfrytëzon të drejtën për të marrë pjesë si kandidaë ose si ofertues në procedurat e prokurimit.

Përfshihet në këtu strukturat, që lidhin kontrata që përbëjnë marrëveshje të brendshme, janë substancialisht të njëjta, si të thuash, janë në marrëdhënie varësie dhe kontrolli midis tyre. Po ashtu, përjashtohen nga të qenit operatorë ekonomikë edhe ato organe publike që, nëpërmjet një kontrate, organizohen ta menaxhojnë së bashku një shërbim publik.

2.7 Nga përvoja ndërkombëtare në aplikimin e prokurimit elektronik

Përvoja e vendeve të ndryshme në këtë fushë është shumë e larmishme. Në disa vende, prokurimi elektronik zbatohet dhe pranohet shpejt, por ka edhe raste kur zbatimi i tij ka qenë i ngadalshëm apo nuk është aplikuar fare. Në Bashkimin Europian (BE) zhvillimi dhe zbatimi i prokurimit elektronik sipas standardeve ndërkombëtare, përgjithësisht, ka qenë i ngadalshëm.

Karakteristikat e prokurimit elektronik të vendeve të ndryshme janë mjaft të ngjashme. Dallime ka në aspekte të ligjeve, të doganave, të bazës së furnitorëve dhe të rregullimeve institucionale. Në tabelën 2 kemi veçuar përvojat e disa vendeve nga fusha e prokurimit elektronik, për të parë se çfarë politikash, sistemesh dhe komponentesh të prokurimit publik elektronik ndiqen në botë, me synimin për të identifikuar përvojat e mira, nga të cilat mund të përfitohet.

Tabela 2: Përvoja ndërkombëtare në aplikimin e e-Prokurimit

Vendi	Objektivat	Sistemi	Komponentet
-------	------------	---------	-------------

	e politikës		
Australia (qeveritë e shteteve)	Efikasiteti Përputhshmëria Konkurrenca Transparenca	Sistem unik në çdo shtet, me interfejs të veçantë SIMF, me standarde të hapura, i bazuar në internet, me entitete të shumta të blerësve/ furnitorëve	Shpallja elektronike Ofertim elektronik Kuotimi elektronik Blerja elektronike SIMP i integruar për menaxhimin, kontrollin dhe analizën e rrjedhës së punës
Mbretëria e Bashkuar	Transparenca Efikasiteti	Sisteme të shumëfishta, standarde të hapura, të bazuara në internet, me entitete të shumta të blerësve/furnitorëve	Plane të prokurimit Shpalljet elektronike Ofertimi elektronik Kuotimi elektronik Sisteme për menaxhimin e informatave
Portugalia	Efikasiteti Transparenca	Sistem unik në mbarë shtetin, me agjenci qendrore dhe me blerje të decentralizuara	Shpalljet elektronike Ofertimi elektronik Kuotimi elektronik Tendera elektronike Ankande elektronike Marrëveshje kornizë elektronike
Kili	Transparenca Efikasitet Konkurrenca	Sistem unik në mbarë shtetin, me interfejs të veçantë SIMF, standarde të hapura, i bazuar në internet dhe me entitete të shumta të blerësve/ furnitorëve	Shpalljet elektronike Ofertimi elektronik Kuotimi elektronik Blerje elektronike SIMP i integruar për menaxhimin, kontrollin dhe analizën e rrjedhës së punës, si dhe menaxhimin e kontratave
India (qeveritë e shteteve)	Transparenca Efikasitet Zhvillim	Sistem unik në çdo shtet, me interfejs të veçantë SIMF, me standarde të hapura, i bazuar në internet, me entitete të shumta të blerësve/furnitorëve	Shpalljet elektronike Ofertimi elektronik Kuotimi elektronik Blerje elektronike SIMP i integruar për menaxhimin, kontrollin dhe analizën e rrjedhës së punës
Kazakistani	Efikasiteti	Sistem unik, me interfejs unik SIMF, pjesërisht i zhvilluar, me entitete të shumta të blerësve / furnitorëve	Plani i prokurimit Kuotimi elektronik Ofertimi elektronik Ankandet elektronike të anasjellë, SIMP i integruar për menaxhimin, kontrollin dhe analizën e rrjedhës së punës

Koreja	Transparencë Efikasitet Zhvillim ekonomik Zhvillim i politikave	Sistem unik, me interfejs të veçantë SIMF, standarde të hapura, i bazuar në internet, me entitete të shumta të blerësve / furnitorëve	Shpalljet elektronike Ofertimi elektronik Kuotimi elektronik Ankandet elektronike të anasjellë Blerje elektronike SIMP i integruar për menaxhimin e rrjedhës së punës, kontroll dhe analizë, integrim me sistemet e tjera përcjellëse qeveritare
Singapori	Efikasiteti Përputhshmëria Konkurrenca	Sistem unik, me interfejs të veçantë, me standarde të hapura, i bazuar në internet, me entitete të shumta të blerësve / furnitorëve	Shpalljet elektronike Ofertimi elektronik Kuotimi elektronik Blerje elektronike SIMP i integruar për menaxhimin e rrjedhës së punës, kontroll dhe analizë

Ndërsa në vendet e Bashkimit European shohim që politikat e prokurimit publik fokusohen kryesisht në tregtinë ndërkufitare. Ky aspekt vuan nga mungesa e standardeve operacionale teknike dhe menaxhuese mes shteteve. Ndërsa në nivel shteti, prokurimi elektronik shpesh nuk konsiderohet si prioritar. Probleme të tjera lidhur me prokurimin elektronik në BE kanë të bëjnë me nënshkrimin e hershëm të Ligjit për UNCITRAL, përmes të cilit ndërlikohen kushtet për hyrje apo pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë në sistem. Modeli UNCITRAL që nga ajo kohë ka pësuar ndryshime thelbësore, por politikat dhe sistemet e shteteve të veçanta nuk janë ndryshuar. Po ashtu, këtu lind nevoja për njohje të ndërsjellë të identifikuesve elektronikë, të dokumenteve dëshmuuese dhe të kushteve të tjera për operatorët ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit përmes internetit, pra, në sisteme që janë më lehtë të përdorshme nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe që janë më të përshtatshme për ndërveprim teknik.

Në përpjekje për të trajtuar aspektet e njohjes/verifikimit të ndërsjellë, Komisioni European ka filluar të zbatojë sistemin e-CERTIS – një mekanizëm ky i informimit pa pagesë, ku jepen hollësitë e certifikatave të ndryshme dhe të atestimeve, që shpesh kërkohen në procedurat e prokurimit të shteteve anëtare të BE-së. Ky mekanizëm është krijuar për t'i ndihmuar operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktuese që, *së pari*, të kuptojnë se çfarë informate kërkohet nga shtetet veç e veç dhe, *së dyti*, për të identifikuar informatat e barasvlershme që janë të pranueshme nga të dyja palët.

Përveç këtij mekanizmi në BE ka edhe disa nisma të tjera për përdorimin sa më efikas të prokurimit, nga të cilat përmendim:

Sistemi TED (Tenders Electronic Daily) – është unik, i pranuar dhe shfrytëzohet për publikimin e njoftimeve të lartpërmendura në mbarë BE-në. Ai

shoqërohet me një infrastrukturë kompatible në nivel shteti. Falë këtij sistemi, në vitin 2009, mbi 90% e formularëve të dërguar në janë pranuar në mënyrë elektronike dhe në formate të strukturuar.

PEPPOL - është një rreth transporti, që u mundëson bizneseve partnerë në prokurim elektronik që t'i lidhin resurset e veta të TI, me qëllim realizimin e këmbimeve të sigurta dhe të besueshme të dokumenteve afariste. Ai menaxhohet nga organizatat e sektorit publik të shteteve të ndryshme të BE-së dhe është i bashkëfinancuar nga Komisioni Europian,

Sistemi Open e-PRIOR: Komisioni Europian e ka zhvilluar dhe e ka futur në përdorim për të mundësuar këmbimin e dokumenteve të strukturuar të katalogut elektronik, të porositjes elektronike dhe të faturimit elektronik mes Komisionit dhe furnitorëve të tij. Ky sistem e ofron këtë zgjidhje në një format të ripërdorueshëm dhe me burim të hapur.

Duke iu referuar Letrës së e Gjellbër, të KE-së, për zgjerimin e përdorimit të prokurimit elektronik në BE (2010) shohim se në mjaft vende anëtare ky sistem ka dhënë mjaft avantazhe dhe përfitime, që kanë të bëjnë me rritjen e transaksioneve dhe të efikasitetit të tyre, me shtimin e kursimeve të fonmdeve publike, shtimin e faturimit elektronik, uljen e kostos si rezultat i rritjes së konkurrimit të krijuar nga prokurimi elektronik etj.

Përfitimet nga prokurimi elektronik në disa vende të BE jepen në kutizën që vijon:

Agjencia italiane e rajonit të Emilia Romanjas, Intercent ER, ofron shërbime të prokurimit elektronik, që përfshijnë tregjet elektronike, katalogët elektronikë dhe ankandet elektronike, dhe tani është bërë pikëreferimi për 539 administrata (90% e agjencive vendore). Në vitin 2008, ajo përpunoi transaksione në shumë prej 419 milionë euro, me përfitime të efikasitetit prej 67.5 milionë euro dhe kursime në kohë prej 45 viteve të punës së njeriut.

Agjencia federale e Austrisë për prokurim e ka të centralizuar blerjen për autoritetet federale përmes funksionaliteve të prokurimit elektronik. Në vitin 2008, ajo raportoi kursime prej 178 milionë euro kundrejt vëllimit të prokurimit prej 830 milionë euro. Përfitimet duket se i tejkalojnë në masë të konsiderueshme kostot vjetore të mirëmbajtjes prej 5 milionë euro, të cilat janë më pak se 3% e kursimeve.

Që nga 1 shkurti 2005, të gjitha autoritetet kontraktuese në Danimarkë mund të pranojnë

N

Nga njohja me mënyrën e zbatimit të prokurimit elektronik në shtete të ndryshme, përvojat ndërkombëtare në këtë fushë lidhen me disa nga çështjet operationale dhe duhen marrë jo në mënyrë shabllone. Shumë rrallë ndodh që sistemi i prokurimit elektronik i krijuar në një shtet të zbatohet në mënyrë të suksesshme nga shteti tjetër, pa u ndryshuar dhe pa u përshtatur me kushtet e vendit.

Integrimi teknik dhe menaxhimi i standardeve teknike ndërkombëtare janë shumë të rëndësishëm. Por kërkohet kujdes që ato të përshtaten dhe të zbatohen në mënyrë krijuese. Në vende të ndryshme ndryshojnë praktikat. Po të shohim, fjala vjen, pagesat e shërbimit, del se kjo është një nga fushat më problematike të zbatimit të prokurimit elektronik. Në disa vende është e zakonshme pagesa edhe për regjistrimin përmes internetit, për shkarkimin e dokumenteve të ofertimit dhe për certifikatat digjitale. Problemi është se përdoruesit preferojnë që shkarkimi i dokumentit nga interneti të jetë pa pagesë, ndërsa dorëzimi i ofertës të mund të paguhet. Kjo është qasja më e mirë, sepse nuk dëmton transparencën dhe barazinë (të gjithë mund të kenë qasje pa pagesë në dokumentet e ofertimit). Po ashtu, nuk dëmton as konkurrencën, pasi dihet që, pavarësisht kësaj, furnitorëve, për dorëzimin e ofertave në letër u duhet të bëjnë shpenzime.

Në Kazakistanit zbatohet politika e përshpejtimit të prokurimit elektronik, pasi regjistrimi atje është falas, siç janë edhe të gjitha proceset e tjera. Edhe kjo është një qasje e preferuar, veçanërisht kur një shtet fillon për herë të parë të zbatojë prokurimin elektronik.

Një tjetër çështje është kur qeveria e një vendi i lë dyert e hapura edhe për ofertimet në letër, edhe pse ka implementuar dhe zbaton prokurimin elektronik. Kjo bëhet për dy qëllime, nga njëra anë, plotëson nevojat e furnitorëve në përshtatjen ndaj kushteve të reja, ndërsa, nga ana tjetër, nuk pengohet procesi, kur komunikimet elektronike janë të dobta dhe me probleme. Megjithatë, duhet thënë se kjo praktikë ngadalëson procesin e pranimit të sistemeve dhe mund të ngadalësojë avancimin e prokurimit elektronik, ndaj është mirë që ajo të zbatohet vetëm për një afat të caktuar.

Një problem mjaft i përhapur ka të bëjë me certifikatat digjitale. Nxjerrja e këtyre certifikatave është një dobësi potenciale e Infrastrukturës Publike Kryesore (IPK), pasi midis ofruesit të certifikatave digjitale dhe ofruesit të qeverisë ekziston një marrëdhënie komerciale. Qeveritë, zakonisht, kërkojnë standarde të larta lidhur me lëshimin e certifikatave digjitale dhe shpesh kanë dëshirë t'i licensojnë këto palë. Ky licensim gjithmonë ndodh në nivel vendor. Kjo bën që furnitorëve të mundshëm të jashtëm të qeverive të shteteve të ndryshme do t'u duhet të shkojnë në vendin përkatës për t'u pajisur me certifikatë digjitale, e cila kërkohej çdo vit. Një gjë e tillë haptazi paraqet pengesë të mundshme për konkurrencën. Nga ana tjetër, kjo nuk është e pranueshme sipas udhëzimeve të MDB-së.

Për këto arsye, në vende të ndryshme janë gjetur dhe aplikohen qasje më të mira. Për shembull, në Rusi, Bjellorusi dhe Kazakistan ekziston marrëveshja që sistemi i prokurimit elektronik të funksionojë në të gjithë anëtarët e Unionit Doganor. Një dispozitë e ngjashme ekziston edhe për shtetet e BE-së.

Një qasje tjetër që mund të zbatohet nga shtetet anëtare të këtyre entiteteve tregtare është politika e njohjes së ndërsjellë, sipas së cilës, një furnitor i një qeverie, i cili ka certifikatë digjitale në një shtet, të njihet automatikisht nga të gjitha shtetet e tjera anëtare, pa pasur nevojë që të reregjistrohet. Por kjo politikë nuk është e kënaqshme për Bankën Botërore, e cila i përmbahet idesë që koncepti i procedurës ndërkombëtare konkurruese të ofertimit është që kjo të jetë e hapur për ofertuesit e pothuajse secilit vend e jo vetëm brenda një blloku të mbyllur tregtar. Një zgjidhje alternative do të ishte që të njihen autoritetet me reputacion për certifikimet komerciale ndërkombëtare. Tanimë janë duke ndodhur zhvillime të reja, si për shembull, po synohet tregtia ndërkufitare, por këto zhvillime nuk janë të fokusuara tek Infrastrukturës Publike Kryesore.

Problematiche është edhe fakti se disa aspekte të prokurimit elektronik nuk kanë mundësi cilësore të nxjerrjes së informatave apo nuk kanë alternativa rezervë në rast të humbjes së të dhënave, duke mos qenë, kështu, në përputhje me kushtet e monitorimit, si në aksionet e ofertimit elektronik, ashtu edhe në ato të kthimit elektronik sipas rregullave të Bankës Botërore.

Gjithashtu, ka raste që prokurimi elektronik nuk zhvillohet në mënyrë të bashkërenduar në mbarë sektorin qeveritar, por i fragmentuar mes ministrive dhe departamenteve. Një qasje e centralizuar dhe e bashkërenduar është shumë më e mirë

nga aspekti i koston, efikasitetit dhe ndërveprimit. Fragmentimi i shumëfishon koston e sigurisë, shton dobësitë, si dhe kërkon që furnitorët të merren me vende të shumta.

Kjo nuk bie ndesh me politikat e decentralizimit, pasi e-Prokurimi është infrastrukturë teknike dhe e menaxhimit dhe nuk nënkupton prokurim të centralizuar.

Në rastet kur ofruesit e shërbimeve mirëmbajnë sistemin në cilësinë e palëve të treta, mund të ketë nevojë që këtij ofruesi t'i bëhet edhe auditimi. Marrëveshja për ofrimin e shërbimit duhet të përfshijë kushtin që qeveria ta bëjë auditimin ose t'ia besojë këtë një pale tjetër të pavarur. Për shembull, nga viti 1999-2002, një sistem gjithëpërfshirës i ofertimit elektronik, i udhëhequr nga qeveria e Australisë Perëndimore ofroi shërbimet e ofertimit për qeverinë lokale të Lidsit në Mbretërinë e Bashkuar (MB). Ky ka qenë shërbimi i parë i ashtuquajtur 'Cloud' i prokurimit elektronik i ofruar ndërkombëtarisht. Audituesi i qeverisë lokale të Lidsit në Mbretërinë e Bashkuar kishte qasje në të gjitha auditimet e sistemit, të bëra nga qeveria e Australisë Perëndimore.

Nga vështirimi i përvojës ndërkombëtare në zbatimin e prokurimit elektronik arrijmë në disa mësimet dhe konkluzione:

– *Prokurimi i qeverisë dallon nga ai në korporatat private.*

Pakot financiare (SIMF) në zgjidhjet ERP përfshijnë komponentet që tregtohen si 'prokurime elektronike'. Këto pako shpesh kanë fillet e tyre në vijat e furnizimit të industrive private dhe nuk mund t'u përshtaten mirë kushteve qeveritare, pa bërë një përshtatje dhe përmirësime të shtrenjta në rastet e daljes së versioneve të reja të SIMF-së.

– *Reforma e politikave ka ndikim në zbatimin e e-Prokurimit.*

Një politikë e përcaktuar mirë, që parashikon qartë dokumentet, procedurat dhe metodat e përbashkëta të prokurimit, jep rezultate më të mira, përcakton një numër të efektshëm standardesh, krijon potencial më të madh për inovacion dhe qeverisje publike efikase, që objektivizon dhe avancojnë dobietë për të gjitha palët e interesuara dhe minimizon favorizimin e ndonjë aktori në konkurrim.

– *Një biznes i konsoliduar mund të ofrojë kornizën për një program të suksesshëm të prokurimit elektronik.*

Me përkushtim domethënës financiar dhe me vlerësimin e dobive të investimit financiar arrihet krijimi i besueshmërisë për programin e prokurimit.

– *Fleksibiliteti në zhvillimin e procesit të prokurimit dhe në strukturat përkrahëse rrisin rezultatet e procesit.*

Prokurimi elektronik është një proces teknik, që mundëson transformimin e strukturave dhe të praktikave të organizatës. Fleksibiliteti në krijimin dhe në implementimin e sistemit dhe të proceseve të prokurimit mundëson identifikimin dhe përkrahjen e kërkesave të ndryshme të konsumatorëve.

– *Administrimi i prokurimit elektronik kërkon burime të afta.*

Prokurimi elektronik kërkon ekip shumëfunksional, me anëtarë që kuptojnë politikat dhe praktikën e prokurimit publik; që janë të aftë të standardizojnë dhe të ristrukturojnë proceset e punës; që kuptojnë kërkesat dhe aftësitë teknike të bizneseve; të bashkërendojnë menaxhimin e ndryshimeve dhe të hartojnë programe trajnimi. Shumica e këtyre çështjeve kanë të bëjnë me menaxhimin e zakonshëm të punës dhe

nuk kërkojnë ekspertizë teknike për nxjerrjen e vendimeve të duhura. Ato ndeshen edhe në Kosovë dhe kërkojnë përgjigje dhe zgjidhjet e duhura, me qëllim zhvillimin efikas të sistemit të prokurimit elektronik te ne. Shteti është i detyruar të zbatojë dhe të respektojë kornizën juridike të prokurimeve publike të vendosur në BE, sigurisht, me rregullim të legjislacionit vendor. Pa dyshim kërkohet mbështetje më e mirë në Direktivat e BE-së, me të cilat rregullohen prokurimet publike. Krahas tyre, Kosova ka marrë në konsideratë edhe sistemet e tjera të prokurimit që pasqyrohen në dokumente ndërkombëtare, si Marreveshja e OBT-së për Prokurimin Publik (MPP); Ligji Model i UNCITRAL-it, Udhëzimet e Prokurimit të Bankave të Zhvillimit Shumëpalësh (BZSHS), duke ndjekur shembujt e Bankes Botërore dhe BERZH-it.

KAPITULLI III. ASPEKTE JURIDIKE TE PROKURIMIT PUBLIK DHE RREGULLIMET INSTITUCIONALE

3.1 Vështrim mbi infrastrukturën ligjore të prokurimit publik

Legjislacioni ekzistues i Kosovës për prokurim dhe tregti elektronike është mjaft përkrahës për fushën e prokurimit elektronik, pavarësisht disa çështjeve që duhet të ndryshohen, siç është nënvizuar në pjesët e mëposhtme të këtij raporti. Përmes Ligjit bazë të prokurimit shprehimisht njihet dhe ofrohet prokurimi elektronik, si dhe disa nga metodologjitë e prokurimit në internet, siç janë ankandet e anasjella. Ligji rregullon edhe ngritjen e autoriteteve përgjegjëse për prokurimin.

Përgjithësisht, legjislacioni ekzistues rregullon mirë zhvillimin e prokurimit publik. Infrastruktura legjislative përfshin legjislacionin primar, Ligjin e prokurimit publik Nr. 04/L-042, i cili ka një rëndësi themelore për krijimin e kushteve të barabarta dhe të drejta për të gjithë bizneset dhe qytetarët e Kosovës në prokurim. Me këtë ligj, mundësohet zvogëlimi i hapësirës për korrupsion në prokurimin publik. Synimi i tij është të sigurojë shfrytëzimin sa më efikas, më transparent dhe më të drejtë të fondeve publike, të burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Ai përcakton qartë kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose janë të interesuar për aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen apo kanë të bëjnë me fondet dhe me burime të tilla. Me këtë ligj janë krijuar hapësirat dhe mjetet normative mbi të cilat do të bazohet i tërë procesi i prokurimit publik.

Ndërsa në legjislacionin sekondar, i cili përbëhet nga 7 pjesë, përfshihen Rregullorja e prokurimit publik dhe udhëzuesi operativ; Rregullat mbi procedurat e prokurimit (formularë, njoftime, dosja e tenderit, raportet e hapjes dhe të vlerësimit, dokumente të tjera standarde); Rregullat për menaxhimin e kontratës (plani i menaxhimit të kontratave); Kodi i etikës së prokurimit dhe deklaratat nën betim; Rregullat mbi shitjen e aseteve dhe 7 formularë; Rregullat për shqyrtimin e ankesave; Dokumentet për misionet diplomatike të Kosovës (udhëzimet dhe 9 formularë).

Me rëndësi është fakti që legjislacioni i prokurimit publik është i botuar në tri gjuhë (shqip, anglisht dhe serbisht), në ueb-faqen <http://krpp.rks-gov.net>

Dispozitat dhe kushtet bazë legjislative për prokurimin elektronik dhe tregtinë elektronike, përgjithësisht, janë të thjeshta, me status juridik. Ato kërkojnë që në këtë sistem prokurimi dokumentet të jenë elektronike dhe nënshkrime elektronike. Sipas ligjit, autorizohet qeveria të nxjerrë rregulla lidhur me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese, metoda që mund të përfshijnë një sistem dinamik të blerjes dhe blerjeve elektronike. Gjithashtu, autorizohet qeveria që në koordinim me KRPP-në të nxjerrë rregulla në lidhje me pajisjet e dorëzimit elektronik dhe pranimin e tenderave, si dhe për pajisjet për pranimin elektronik të

kërkesave për pjesëmarrje. Këto rregulla përfshijnë një nënshkrim të avancuar elektronik, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Kushtet e tjera procedurale për prokurim elektronik përfshijnë rregulloret dhe politikat, të cilat synojnë që:

- ✚ **Zbatimi dhe njohja e prokurimit elektronik të jetë në nivel të njëjtë me prokurimin manual;**

- ✚ **Të obligohet përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik nëpër agjenci sipas planit fazor. Rekomandohet që të mos lejohet ofertimi paralel (përdorimi i formularëve manualë dhe elektronikë) përtej një periudhe të shkurtër të përkohshme;**

- ✚ **Të ndryshohen kushtet e dokumenteve të ofertimit kurdo që kjo është e nevojshme për t'iu përshtatur prokurimit elektronik;**

- ✚ **Të pranohen metodologjitë e prokurimit përmes internetit, siç janë ankandet elektronike;**

- ✚ **Të obligohet regjistrimi i furnitorëve përmes internetit si parakusht për pjesëmarrjen në prokurimet qeveritare përmes sistemit të prokurimit elektronik, si dhe dorëzimi i përgjigjeve për ofertat përmes sistemit të prokurimit elektronik.**

Si kushte themelore lidhur me dokumentet elektronike dhe me nënshkrimet elektronike, identifikohen edhe një numër reformash të tjera legjislative, si:

- ✚ **Menaxhimi elektronik i arkivave;**

- ✚ **Mbrojtja dhe privatësia e konsumatorit;**

- ✚ **Ligjet për dëshmitë ligjore;**

- ✚ **Mbrojtja dhe besueshmëria e të dhënave;**

- ✚ **Prona intelektuale dhe e drejta e autorit;**

- ✚ **Kodet e praktikës së mirë.**

Edhe pse nga ana formale korniza legjislative është moderne dhe konsiderohet një arritje e madhe, e rëndësishme është zbatimi i saj në praktikë. Gjatë vënies në zbatim të ligjeve konstatohet se disa dispozita ligjore janë komplekse dhe krijojnë hapësira për interpretime të ndryshme, ndaj dhe zbatohen keq, duke lënë vend për abuzime dhe korrupsion, ashtu siç ka edhe shkelje të ligjit me qëllim abuzimesh dhe përfitimesh të paligjshme.

Këto bëjnë të nevojshëm ndryshimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit, për të eliminuar këto dukuri negative.

3.2 Nevoja për përmirësime në legjislacionin e prokurimit publik

Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, që hyri në fuqi më 9 qershor 2004, ishte bazuar në direktivat e KE-së për prokurimin. Ai ka ndryshuar në vitin 2007, dhe duke u përputhur me dy Direktivat e fundit të Prokurimit të BE-së, Nr. 17/2004 dhe 18/2004. Pra, edhe pse Kosova nuk është anëtare e BE, Ligji për Prokurimin Publik

Nr. 2003/17 të vitit 2004 dhe Ligji i ndryshuar Nr. 02 / L-99, i cili hyri në fuqi më 6 qershor 2007, janë në përputhje me legjislacionin e vendeve të BE.

Me ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë nr. 02 / L-99, i cili hyri në fuqi më 6 qershor 2007, u përfshinë në të shumica dërrmuese e kërkesave të dy Direktivave të fundit të KE-së, nr. 17/2004 dhe 18/2004. Ato kanë të bëjnë me çështje si:

- Marrëveshjet kornizë,
- Fillimi i zhvillimit të prokurimit elektronik,
- Transferimi i së drejtës në autoritetin kontraktues për të përdorur të gjitha procedurat e prokurimit, përveç procedurave të negociuara papublikimi i një njoftimi për kontratë,
- Themelimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, si organi i pavarur shqyrtues i ankesave,
- Krijimi dhe zhvillimi i një prokurimi elektronik publik në Kosovë,
- Mbajtja e dëshmimeve statistikore për të gjitha aktivitetet e prokurimit në Kosovë,
- Mbajtja e detyrueshme e trajnimeve vjetore të zyrtarëve të prokurimit,
- Kryerja nga Agjencia e Prokurimit Publik e prokurimeve për autoritetet e tjera kontraktuese nuk mund të bëhet pa autorizimin paraprak nga Qeveria e Kosovës,
- Auditimi i aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë bëhet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë.

Mund të konkludohet se prokurimi publik, si fushë tërësisht e re në Kosovë, ka arritur një shkallë të konsiderueshme zhvillimi. Mjaft reforma janë bërë brenda një periudhe të shkurtër dhe ka funksionuar trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i zyrtarët të prokurimit në Kosovë dhe jashtë saj. Mekanizmat e rishikimit janë bërë të efektshme dhe përgatitjet e proceseve të prokurimit publik kanë avancuar në mënyrë të moderuar.

Progres ka pasur edhe në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të prokurimit publik dhe të partneritetit publik privat me legjislacionin e Bashkimit European, në këtë fushë. Megjithatë, legjislacioni është dinamik dhe vazhdimisht ka nevojë për ndërhyrje, me qëllim që të përputhet sa më mirë me atë european, me Direktivat e BE-së për Prokurimin. Procesi i harmonizimit të tij synon të sjellë në Kosovë sisteme të avancuara dhe standardet e përparuara të prokurimit që zbatohen në vende anëtare të BE etj.

Mbështetur në një legjislacion të kompletuar, u bë e mundur që në Kosovë, brenda një kohe të shkurtër të themelohej një sistem krejtësisht i ri i prokurimit publik. Por ka qenë e pashmangshme që ligji të kishte edhe kufizime dhe mangësi të ndryshme. Disa dispozita linin vend për debat në interpretim dhe lidhur me efektivitetin e tyre. Kjo ka sjellë nevojën e ndryshimeve dhe të përmirësimeve të herëpashershme, në përputhje me kërkesat e kohës dhe të sistuatës. Po ashtu, ndryshime të shumta janë realizuar edhe në paketën dytësore ligjore të prokurimit, si të tilla përmendim:

Konkretisht, Neni 129 i ligjit, që përcakton KRRPP-në si përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe të programit të prokurimit, duket që përmban në formulim edhe rrezikun e krijimit të një konflikti të mundshëm të roleve të KRRPP-së. Sipas Ligjit, roli i KRRPP-së kryesisht ka të bëjë me mbikëqyrjen, rregullimin dhe specifikimin e praktikave më të mira dhe të kërkesave për kapacitete dhe, në parim, duhet të ketë rol minimal në fushën kontraktuale dhe operacionale. Rolet

operacionale, zakonisht, u përkasin entiteteve të prokurimit dhe vetëm rregullohen e monitorohen nga KRRPP-ja dhe entitetet e tjera mbikëqyrëse.

Gjykojmë se Paragrafi 4, i këtij neni, ku sanksionohet se “Përdorimi i prokurimit elektronik nuk është i obligueshëm. Autoritetet kontraktuese vendosin nëse dëshirojnë të përdorin metoda të tilla”, bie ndesh me politikat e qeverisë, e cila thekson se prokurimi elektronik është më i miri në aspektin e transparencës dhe qeverisjes. Ndërsa ligji parashikon që autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin sipas dëshirave të tyre, ta përdorin ose jo. Mendojmë se kjo dispozitë, e formuluar kështu, frenon aplikimin e prokurimit elektronik dhe dobëson qeverisjen e prokurimit publik.

Në vendet e BE-së disa aspekte të prokurimit janë të ndaluara, fjala vjen, disa nga marrëveshjet kornizë, që nuk bëhen përmes internetit (Direktiva e prokurimit 2004/18/EC; neni 1.6). Gjithashtu, ka vende europiane që prokurimin elektronik e kanë të obligueshëm për të gjithë. Në Portugali, p.sh., faktori kryesor i suksesit të madh të programit të prokurimit elektronik ishte se është i detyrueshëm (EC, 2010).

Problematika lidhur me funksionet e KRRPP nxjerr edhe neni 81, par.3, (Monitorimi i menaxhimit të kontratave nga entitetet e prokurimit), i cili e bën KRRPP-në përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë dhe për zbatimin e prokurimit. Ai bie ndesh me nenin 87, sipas të cilit KRRPP ka mandat edhe për të realizuar zhvillimin e prokurimit elektronik. Midis këtyre dy funksioneve që i atribuohen KRRPP nga dy nene të të njëjtit ligj, krijohen përplasje.

Për sa më sipër, kemi mendimin që paragrafi 4 i nenit 129, të LPP, të hiqet dhe KRRPP-së t’i lihet mandati i sistemit aty ku është e duhur, siç ka bërë tani me mandatin e shpalljes së tenderave në faqen qendrore të internetit. Po ashtu duhen parë edhe dy nenet 81 dhe 87.

Edhe legjislati i përmendur për nënshkrime elektronike (Ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit, 2012) është pak a shumë hibrid, pasi jep referencat në teknologji, por parashikon edhe neutralitet të plotë teknologjik. Kështu, ai shkon përtej disa dispozitave të Ligjit të prokurimit, të cilat kanë natyrë kufizuese ndaj përdorimit të dokumenteve elektronike. Por vërtetimi është më shumë çështje e menaxhimit të punës, sesa çështje teknologjike dhe ligji duhet t’i mëshojë aspektit të kërkesave biznesore dhe jo atyre teknologjike. Më parë është theksuar se Ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit (2012) parasheh nënshkrimet elektronike. Megjithatë, ai nuk specifikon metodën teknike për këtë qëllim. Këtë duhet ta përcaktojë KRRPP-ja. Ky është aspekt pozitiv i legjislatit, përmes të cilit parandalohen gabimet e atyre që kanë miratuar ligjin, që nuk është neutral nga aspekti teknologjik.

Mendojmë që edhe kjo mospërputhje dhe kundërvënie në legjislacion duhet parë dhe të eliminohet kufizimi i përmendur.

Legjislati ka nevojë të përmirësohet edhe në dispozitat që lidhen me kontratat. Në legjislacion nuk parashihen ndryshime të kontratave. Kjo kufizon kapacitetet e menaxhimit të prokurimit elektronik dhe mund të zvogëlojë vlerën e disa projekteve të ndërlikuara qeveritare të prokurimit. Legjislati ekzistues nuk parashikon variacionet e kontratave, as zgjatjen e tyre, por vetëm jep rekomandime për ndryshime në këto aspekte. Gjithashtu, ka dispozita ligjore apo rregullore që

pengojnë zhvillimin disa formave të marrëveshjeve kornizë, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në prokurim elektronik.

Edhe lidhur me dokumentet elektronike dhe me nënshkrimet elektronike, në legjislacion ka nevojë për një numër reformash legjislative, sidomos për: menaxhimin elektronik të arkivave; mbrojtjen dhe privatësinë e konsumatorit; ligje për dëshmitë ligjore; mbrojtjen dhe besueshmërinë e të dhënave; pronën intelektuale dhe të drejtat e autorit; për kodet e praktikës së mirë etj.

3.3 Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë europian

Hartimi i ligjeve të prokurimit dhe ndryshimet e përmirësimit që i janë bërë atij kanë pasur si synim që legjislacioni i prokurimit të jetë në përputhje me standardet europiane. Në parim, legjislacioni duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të siguruar ndërveprueshmëri me legjislacionin e ngjashëm në vendet e tjera. Pas miratimit të Ligjit model të UNCITRAL-it për tregtinë elektronike të vitit 1996, vendet e ndryshme kanë filluar të miratojnë ligje për këtë çështje. Megjithatë, nuk ka standarde universale ndërkombëtare në këtë fushë dhe, rrjedhimisht, këto ligje kanë fushëveprim të kufizuar, pasi zbatohen vetëm për transaksionet vendore në çdo vend, pa pasur ndonjë rregullim për transaksionet ndërkombëtare.

Brenda shteteve të ASEAN-it dhe të BE-së, çështja rreth Ligjit model të UNCITRAL-it (1996) për tregtinë elektronike është evidente. Qeveritë e këtyre shteteve kanë miratuar Ligjin model të vitit 1996, dhe nënshkrimet elektronike përdoren, por ai është interpretuar ndryshe nga legjislacione të vendeve të ndryshme, duke kufizuar, kështu, zbatimin e tij në prokurimet ndërkombëtare. Përveç prokurimit qeveritar, dëshmitë janë të pakta për pengimin e tregtisë ndërkombëtare, sepse partnerët privatë tregtarë, në përgjithësi, nuk mbështeten te këto procedura.

Në Kosovë, me ndërhyrjet e fundit që janë realizuar në ligje, rezulton se ato po afrohen gjithnjë e më shumë me legjislacionin europian, me qëllim që, në harmoni të plotë me të, të mos ketë pengesa ligjore në integrimin e Kosovës në organizmat europianë. Ndryshimet në legjislacion janë bërë edhe për ndërtimin e bazës ligjore për krijimin në Kosovë të platformës elektronike të prokurimit publik.

Kuptohet përafrimi në këtë fazë ka qenë ende i pjesshëm, kishte akoma disa çështje të rëndësishme që nuk ishin përshtatur me *acquis*. Ky përafrim i pjesshëm lidhet me faktorë të ndryshëm, që mund të grupohen në faktorë politikë, ligjorë dhe ekonomikë.

Synimi i ndryshimeve të kornizës ligjore mbi prokurimin publik ishte lehtësimi i implementimit të procedurave të prokurimit, sipas standardeve të Direktivave të BE-së. Implementimi në legjislacionin vendor i neneve të caktuara të Direktivës që një domosdoshmëri për mbarëvajtjen e prokurimit publik në Kosovë.

Lidhur me punën e bërë në këtë drejtim mund të përmendim se Udhëzimi i Administratës Financiare për Prokurimin Publik Nr.2/1999 u bazua në rregullat e prokurimit të Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara Komisioni për të Drejtën

Tregtare Ndërkombëtare "UNCITRAL", Ligji mbi Prokurimin Publik Nr. 2003/17 është bazuar në direktivat e prokurimit të BE-së. Themelimi i OSHP-së, si një organ shqyrtues i ankesave në publik prokurimi në Kosovë, bazohet në kërkesat e fundit të Direktivës së prokurimit, të BE-së nr.18/2004. Me krijimin e tri institucioneve qendrore të pavarura që raportojnë drejtpërdrejt në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës - KRRPP si organ legjislativ, AQP si organ ekzekutiv dhe OSHP si organ shqyrtues i ankesave – Kosova renditet si një nga vendet më të përparuara në Europë në lidhje me pavarësinë e vendimmarrjes së institucioneve qendrore të prokurimit, i cili rregullohet nga korniza ligjore për prokurimin publik, të harmonizuara me legjislacionin e BE-së.

Por që ligjet e Kosovës të përputhen sa më shumë me atë ndërkombëtar, ka ende nevojë që ato të përmirësohen më tej. Ndryshimet duhet të jenë të dukshme dhe për to duhen marrë opinione nga të gjitha palët e interesuara. Kjo mbetet një kërkesë e ditës, për eliminimin e defekteve të ndryshme që vihen re. Në këtë drejtim një ndihmesë të madhe po jep SIGMA, e cila është angazhuar, veç të tjerash, edhe në përkthimin e majft dokumenteve të Bashkimit European, me synim reflektimin e dispozitave të tyre në legjislacionin e Kosovës.

Korniza ligjore duhet të jetë në të njëjtën linjë me Direktivat e BE-së, të cilat rregullojnë fushën e prokurimeve publike dhe synojnë të krijojnë një treg dhe rritjen e mundësive të shteteve për bashkëpunim efikas në këtë fushë. Për secilin vend, por edhe për Kosovën janë shumë të rëndësishme rregullat, metodat dhe procedurat kryesore të përcaktuara në Bashkimin European në lidhje me zhvillimin e prokurimit publik nëpërmjet procedurave parimore dhe të barabarta ligjore.

Mendojmë se në legjislacionin e Kosovës duhet të reflektohen më shumë kërkesat e Dokumentit të gjelbër të KE-së për prokurimin elektronik, i cili bën fjalë edhe për disa çështje me shumë interes, si lidhur me metodologjinë e nënshkrimeve digjitale, me kushtet dhe zgjidhjet alternative në çështjet e vërtetimit dhe të identifikimit; me vendimin për avancimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara brenda planit të veprimt; me nivelin e sigurisë së nënshkrimit elektronik, që duhet të bazohet në vlerësimin e rrezikut të zgjidhjeve të dështuara të identifikimit/nënshkrimit në kontekstin e prokurimit.

Edhe Konventa për komunikimet ndërkombëtare elektronike, e elaboruar nga UNCITRAL, duhet të gjejë më shumë pasqyrim në legjislacionin e Kosovës. Kjo Konventë, e miratuar nga Asambleja e përgjithshme më 23 nëntor 2005 dhe e nënshkruar nga 18 shtete (2011), midis të cilave edhe Kina, Rusia, Koreja, Paraguaji, Kolumbia, Hondurasi dhe Panamaja. Konventa synon avancimin e sigurisë ligjore dhe të parashikueshmërisë së shitblerjes me rastin e përdorimit të komunikimeve elektronike në kontratat ndërkombëtare etj. Ajo është në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik, duke shkuar përtej PKI-së dhe duke pranuar çdo metodë verifikimi që mundëson, nga njëra anë, përcaktimin e identitetit të personit dhe, nga ana tjetër, përfshirjen personale të atij personi. Gjithashtu, pranon marrëveshjet mes palëve, marrëveshjet paraprake dhe porporcionalitetin mes mjeteve dhe qëllimit, përfshirë dëshmitë e tjera, duke pranuar fushëveprimin e aktiviteteve që renditen si me rrezik në përcaktimin e qasjes në vërtetim. Këto metoda konsiderohen si

ekuivalencë funksionale e nënshkrimeve elektronike, ku ligjet tradicionale kërkohen në bazë të qëllimit të avancimit të sigurisë ligjore.

Konventa e UNCITRAL-it e vitit 2006 vërteton se IKP-ja nuk është standard dhe se ka teknologji konkurruese të vërtetësisë që janë më pak të kushtueshme dhe më lehtë të kuptueshme nga bizneset. Ligji model i UNCITRAL-it dhe rregulloret e tjera të tregtisë elektronike, tentojnë të jenë neutrale nga aspekti i teknologjisë, në mënyrë që të mos pengojnë zhvillimin e këtyre teknologjive të reja.

3.4 Qeverisja e prokurimit publik dhe rregullimet institucionale

Qeverisja e prokurimit publik është me rëndësi thelbësore për besimin e qytetarëve ndaj qeverisë. Ajo është edhe një barometër i cilësisë së administratës publike, duke e bërë atë fokus prioritar të fuqizimit në shumicën e qeverive. Prokurimi publik, si një aspekt kyç i administratës publike, i cili lidh sistemin publik financiar me arritjet shoqërore dhe ekonomike, është përcaktues kryesor i cilësisë së shërbimeve dhe të infrastrukturës, si dhe i efektshmërisë së qeverisë. Ky funksion prek disa fusha: planifikimin, menaxhimin e programeve, hartimin e buxhetit etj.

Prokurimi publik konsiderohet, tashmë, një çështje e rëndësishme e qeverisë dhe e politikës në Kosovë. Aktualisht, nga media, komuniteti apo bizneset ai perceptohet shumë i domosdoshëm për të luftuar mungesën e transparencës dhe korrupsionin në tendera. Edhe trendi ndërkombëtar i performancës së prokurimit dhe evoluimi i qeverisjes së prokurimit është duke u kthyer drejt prokurimit elektronik, pasi ky sjell impakt të madh në produktivitetin e prokurimit, falë mundësive për të angazhuar metodologjitë më efektive të prokurimit, përmes teknologjisë. Në veçanti, kuotimi elektronik, si model i tërë sektorit të biznesit, bëhet më i lehtë.

Nisur nga këto konsiderata, por dhe nga përvoja ndërkombëtare e zbatimit të prokurimit elektronik, del se elementi thelbësor për zbatimin efikas të tij është qeverisja, udhëheqja e qeverisë. Kjo duhet të bëjë miratimin e strategjisë së prokurimit elektronik, të përcaktojë vizionin dhe objektivat shtetërore për prokurimin elektronik, si dhe të mundësojë autorizimin dhe furnizimin me resurse të agjencisë kryesore zbatuese, e cila bën përmirësimet e nevojshme në vazhdimësi.

Në Kosovë qeveria është e përkushtuar për udhëheqjen si duhet të procesit të prokurimit publik. Ajo ka hartuar strategjinë për zhvillimin dhe modernizimin e prokurimit, si dhe për miratimin e prokurimit elektronik. Për këtë qëllim, ajo ka hartuar dhe legjislacionin modern përkatës. Gjithashtu, qeveria ka caktuar një ministër që është përgjegjës për prokurimin dhe reformimin e tij dhe ka krijuar një agjenci përgjegjëse për prokurimin, Komisionin e Rregullimit të Prokurimit Publik (KRrPP),. Ky organizëm, i cili ka nivel të lartë të ekspertizës politike, legjislative, teknike dhe menaxheriale të prokurimit, realizon ekspertizën teknike, organizon bashkërendimin dhe bashkëpunimin brenda sektorit qeveritar, ka autoritetin dhe burimet e nevojshme për të udhëhequr. Ai ka autoritet të qartë për të mandatuar sistemin mbarëqeveritar, për të zhvilluar sistemin e prokurimit elektronik. KRrPP ka lidhje efektive pune me autoritetet përgjegjëse për teknologjinë dhe për qeverisjen elektronike, ka rolin

bashkërendues, institucional, ka kapacitetin e politikave dhe resurse për ta udhëhequr këtë veprimtari. Ngritja e kësaj agjencie në Kosovë ishte një zhvillim pozitiv, pasi ajo luan një rol strategjik ndërqeveritar në procesin e prokurimit.

Synimi i qeverisjes së prokurimit që të përdoret sa më gjerësisht prokurimi elektronik nxitet edhe nga fakti se jo vetëm shpenzimet qeveritare për prokurim janë në rritje, por edhe sepse ekziston rreziku i veprimeve korruptive. Lidhur me këtë, sipas OBEZH-it, në vitin 2002, prokurimi publik, në një formë apo në një tjetër, përbënte 70% të shpenzimeve qeveritare (Revista e OBEZH-it–, Vol. 2, No. 3, 2002). Ndërsa në vitin 2007, OBEZH konstatonte se “prokurimi publik është aktiviteti qeveritar më i rrezikuar ndaj humbjes, mashtrimit dhe korrupsionit, për shkak të ndërlikueshmërisë së tij, të madhësisë së rrjedhës financiare që krijon dhe të ndërveprimit të ngushtë mes qytetarëve dhe sektorit privat”.
(www.oecd.org/document/5/0,3343,en_2649_34135_41883909_1_1_1_1,00.html)

Dukuri dhe rreziqe të tilla, minimizohen me përdorimin e prokurimit elektronik, ndaj qeveria duhet të demonstrojë maksimalisht dhe publikisht vendosmërinë e saj për shtrirjen e sistemit të e-Prokurimit dhe të kërkojë nga institucionet e saj arritjen e rezultateve të pritshme në performancën e prokurimit publik, siç janë transparenca dhe kursimi i fondeve publike.

Sidoqoftë, edhe qeverisja elektronike ka nevojë të konsolidohet në mënyrë të pandërprerë që të arrijë objektivat e saj. Këto janë:

- ✚ Të sigurojë transparencë për të gjitha palët e interesuara;
- ✚ Të paksojë burokracinë dhe të rrisë efikasitetin;
- ✚ Të fuqizojë besimin në institucionet e qeverisë dhe të përmirësojë klimën e investimeve në vend;
- ✚ Të mandatojë kornizë të gjerë të prokurimit elektronik dhe një sistem të integruar prokurimi;
- ✚ Të zbatojë politikat operacionale dhe sistemore të prokurimit elektronik.

Edhe në aspektin e përfshirjes së të gjitha entiteteve qeveritare të të gjitha niveleve në programin e prokurimit publik, Kosova ka shënuar një arritje të madhe – pasi ka bërë realitet që të gjitha entitetet e qeverisë janë, tashmë, të përfshira nën një autoritet të vetëm rregullativ. Kjo duhet të nxisë që të përshpejtohet programi i qeverisjes elektronike, përfshirë dhe fuqizimin e administratës në të gjithë sektorët. Lidhur me këtë, është e nevojshme që krahas zbatimit politikave dhe të planit strategjik, të vazhdojnë reformat në fushën e prokurimit, të zhvillohet Riinxhinierimi i Procesit të Punës (RPP) dhe i metodave të reja që mundësojnë prokurimin elektronik, duke menaxhuar dhe zhvilluar më tej faqen ekzistuese të internetit, e cila është nisma më e suksesshme e e-Qeverisjes deri tani në Kosovë.

Në bazë të ligjeve, qeverisja elektronike ka autoritetin edhe të ndërmarrë veprime ligjore dhe sanksione ndaj përdoruesve që shkelin termat dhe kushtet e marrëveshjes së përdoruesit të sistemit.

Në Kosovë ka kërkesa të shumta për prokurimin elektronik nga operatorët ekonomikë dhe nga administrata, që kërkojnë të rriten transparenca dhe lufta kundër korrupsionit në tendera, të cilat perceptohen si faktorë që ndikojnë negativisht në klimën e investimeve në vend. Zgjerimi i aplikimit të prokurimit elektronik në vend

arrihet me mbështetjen dhe përkrahjen e politikës, të cilat në Kosovë nuk mungojnë. Por kërkohet që sistemi të funksionojë në nivel qendror dhe të ketë një infrastrukturë të përbashkët dhe unike të teknologjisë informative. Zhvillimi i ndarë i e-Prokurimit brenda ministrive apo departamenteve veç e veç do të copëzonte mundësitë, ndaj nuk duhet të vazhdojë më. Zhvillimi i copëzuar përmban rrezikun që sistemet të mos ndërveprojnë apo të mos kenë të dhëna bazë të përbashkëta, të cilat do të mundësonin vlerësimin e duhur të performancës dhe integrimin financiar, si edhe rrit rreziqet ndaj sigurisë së të dhënave.

Gjithashtu, ekziston nevoja për të pasur kapacitete në rregullimin e grupeve punuese/komisioneve ndërdepartamentale, me qëllim zhvillimin e aspekteve të ndryshme, siç është ai i ristrukturimit të procesit të prokurimit. Përfshirja e pushtetit vendor duhet të konsiderohet si optimale dhe është e rekomandueshme. Kjo nuk do të thotë që rregulloret, politikat, procedurat apo dokumentet e pushtetit vendor duhet të jenë të njëjta me ato të ministrive.

Qeverisja dhe menaxhimi i prokurimit publik duhet të jenë në nivelin e duhur, pasi dobësi i tyre, pa dyshim, zvogëlon aspektet zhvillimore dhe investimet e huaja të drejtpërdrejta. Këto efekte tanimë janë raportuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (1998), i cili ka identifikuar pasojat në nivel shteti, në aspektin e: (i) mbishpenzimeve në kapital, (ii) nënshpenzimeve në mirëmbajtjen e aseteve, (iii) infrastrukturës së cilësisë së dobët dhe (iv) të ardhurave të zvogëluara qeveritare. FMN-ja ka ardhur në përfundimin se qeverisja e dobët e prokurimit mund të rezultojë në një infrastrukturë që dobëson zhvillimin ekonomik të vendit, pasi do të pengohen investimet. Cilësia e dobët e prokurimit publik ul produktivitetin ekonomik të tij. Gjithashtu, një menaxhim i dobët i prokurimit publik pengon zhvillimin e konkurrencës së tregut, lë vend për veprime favorizuese për operatorë ekonomikë të caktuar, si dhe për humbje të parasë publike, ngaqë lejon pagesa më të shtrenjta për shërbimet dhe mallrat, duke rritur shpenzimet.

Për këto arsye, fuqizimi i qeverisjes së prokurimit konsiderohet në shumë vende opsioni më i rëndësishëm i zhvillimit.

3.5 Agjencitë përgjegjëse të prokurimit

Themelimi i sistemit të prokurimit dhe procesi i funksionalizimit të tij ndërlidhet ngushtë me vetë procesin e ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës që nga viti 1999 e këndeje. Që nga themelimi, sistemi ka evoluar, është plotësuar dhe përmirësuar përmes ndryshimeve dhe adaptimeve institucionale, legjislative dhe sistimore, duke zbatuar një numër reformash me qëllim që prokurimi publik të bëhet më efikas dhe me transparent dhe në përputhje me kërkesat, udhëzimet themelore të prokurimit dhe praktikat më të mira e BE-së.

Rregullimet institucionale të prokurimit elektronik në Kosovë janë të kënaqshme. Në bazë të ligjit janë ngritur një sërë institucionesh që drejtojnë dhe kontrollojnë zhvillimin e prokurimit publik, të cilat janë kompletuar me personel të aftë dhe të përkushtuar për kryerjen me profesionalizëm të detyrave. Përgjegjësitë e këtyre institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Roli i tyre qëndron në zbatimin

me rigorozitet të ligjit dhe të rregulloreve të zhvillimit të prokurimit elektronik, në zbatimin e procedurave që respektojnë parimet bazë të prokurimit, rritjen e profesionalizmit dhe të performancës së zyrtarëve të angazhuar me prokurimin elektronik dhe efikasitetit të procesit të prokurimit elektronik.

Strukturat kryesore institucionale për prokurim në Kosovë janë ndërtuar në përputhje me praktikat më të mira. Ato janë:

- (i) Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik, i cili përcakton rregullat dhe standardet e prokurimit, si dhe monitoron përputhjen e performancën;
- (ii) Agjencia qendrore e prokurimit në Thesar që është përgjegjëse për marrëveshjet kornizë, prokurimin e bashkërenduar dhe prokurimin ku kërkohet ekspertiza shtesë tek entitetet blerëse;
- (iii) Entitetet e decentralizuara të prokurimit;
- (iv) Autoriteti rregullator i prokurimit për trajtimin e ankesave.

3.5.1 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRrPP)

KRrPP ka filluar funksionimin në shkurt 2005, në cilësinë e një agjencie të pavarur rregullative dhe është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik. Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, Komisioni është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e legjislacionit sekondar, përfshi edhe rregullat e prokurimit, doracakët, udhëzimet, formularët standard, kontratat model, rekomandimet për përmirësimin e LPP-së dhe sistemit të përgjithshëm të prokurimit publik për Qeverinë dhe Parlamentin.

KRrPP është përgjegjës për:

- ☐ ngritjen e vetëdijes së autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë për kornizën e prokurimit publik,
- ☐ ofrimin e asistencës për zbatimin dhe interpretimin e LPP dhe të akteve nënligjore,
- ☐ monitorimin e përputhshmërisë së autoriteteve kontraktuese nëpërmjet sistemeve manuale dhe elektronike dhe
- ☐ të mbështesë IKAP-in (i cili është përgjegjës për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve të prokurimit) për të zhvilluar dhe për të ruajtur aftësitë dhe kompetencat e profesionistëve të prokurimit.

Gjithashtu, është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të prokurimit publik (për njoftimet, ftesat, dosjet e tenderit, raportet, ankesat dhe vendimet që kanë të bëjnë me secilin prokurim), për inicimin dhe mbështetjen e zhvillimit të e-Prokurimit, për mirëmbajtjen e një faqeje te internetit që ofron qasje në Regjistrin, në ligje, akte nënligjore dhe interpretimin e tyre. Ai ndjek zhvillimin e sistemit të informacionit për publikimin e njoftimeve, që mbulon tërë Kosovën dhe dhe mban një listë të autoriteteve kontraktuese.

KRrPP mbledh në mënyrë sistematike dhe analizon informacionin mbi procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna, përgatit dhe i dorëzon Kuvendit Kombëtar raporte vjetore për të gjitha aktivitetet që zhvillon. Së fundi, KRPP ka

përgjegjësinë të ndërveprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit, për çështjet që lidhen me prokurimin publik.

Pranë KRRPP është edhe departamenti i Teknologjisë Informativë, që ndjek zhvillimin strategjik të sistemit të informacionit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe statistikat e mbledhura për prokurim.

Si agjencia udhëheqëse, KRRPP vendos rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin e ligjit, krijon sistemet manuale dhe elektronike për të vëzhguar dhe monitoruar zbatimin e ligjit dhe të rregullave të nxjerra nga autoritetet kontraktuese, mbështet IKAP dhe autoritetet e tjera publike të trajnimit dhe arsimimit, për të siguruar arritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë kompetence në radhët e zyrtarëve të prokurimit.

Një fushë tjetër e veprimtarisë së KRRPP-së janë autoriteti dhe përgjegjësia e tij për të identifikuar përparësitë dhe dobësitë e sistemit të prokurimit; të përcaktojë ato fusha që kanë nevojë të përmirësohen dhe të bëjë rekomandimet e duhura për ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit.

3.5.2 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)

OSHP ka filluar punë në gusht 2008, si përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, lidhur me zbatimin e Ligjit të Prokurimit Publik dhe të Ligjit për Procedurën për dhënien për koncesione.

OSHP ka autoritetin dhe kompetencat për shqyrtimin e vendimeve administrative të lëshuara nga institucionet qendrore të prokurimit për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe për të rishikuar ankesat nga tenderuesit nën procedurën e shqyrtimit.

Në rast të paraqitjes së të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP shqyrton rastin dhe merr vendim ta skualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik.

Vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga gjykata kompetente, në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative.

3.5.3 Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)

AQP funksionon si një agjenci autonome ekzekutive me përgjegjësi të gjerë, lidhur me procedurat e prokurimit të nivelit qendror. Funksioni kryesor i Agjencisë është blerja qendrore. Ajo mund të vendosë që cilado procedurë e prokurimit, që duhet të udhëhiqet nga një autoritet kontraktues në Kosovë, të udhëhiqet nga vetë AQP në vend të autoritetit kontraktues, për arsye të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime, siç është formuluar në Ligjin e Prokurimit Publik. Këto funksione dhe përgjegjësi të specifikuara në ligj si agjencia i kryen kur autoriteti kontraktues është ndërmarrje në pronësi publike.

Ministria e Financave, krahas institucioneve të përshkruara më sipër, ka përgjegjësi dhe detyrat e veta në zhvillimin e prokurimit. Ajo:

- ✚ Bashkërendon zhvillimin dhe siguron realizimin e balancuar të buxhetit vjetor për administratën publike;
- ✚ Krijon buxhete shumëvjeçare dhe programe afatgjata për investime publike në bashkëpunim me institucionet e administratës publike;
- ✚ Bashkërendon me institucionet e administratës publike dhe, sipas nevojës, me donatorët multilateralë e bilateralë për çështjet që kanë të bëjnë me financimin nga donatorët dhe kontributet e dhuruara;
- ✚ Siguron përdorimin efektiv dhe transparent të fondeve të donatorëve për qëllimet e akorduara;
- ✚ Kujdeset që të gjitha të ardhurat dhe burimet e tjera të financimit nga institucionet e administratës publike, duke përfshirë dhe ndihmat financiare vullnetare, të regjistrohen sipas rregullave buxhetore;
- ✚ Siguron zbatimin e legjislacionit tatimor dhe doganor në Republikën e Kosovës;
- ✚ Bashkërendon dhe koordinon aktivitetet e institucioneve ndërkombëtare financiare.

Të gjitha këto funksione ajo i kryen edhe lidhur me të gjitha institucionet që përfshihen në aktivitetet e prokurimit publik.

3.5.4. Njësi të tjera të lidhura me prokurimin

Komisioni Drejtues të Projektit (KDP)

Që prokurimi elektronik të implementohet në çdo institucion të qeverisë, KRRPP-ja ka themeluar KDP-në, i cili përbëhet nga përfaqësuesit ekzekutivë të palëve kryesore të interesuara. KDP-ja është konsoliduar si grup i nivelit të lartë, që mban drejtimin dhe shtyllat e programit dhe më pak është i përfshirë në dhënien e ekspertizës teknike të hollësishme. KDP-ja punon për arritjen e një sërë synimesh, ndaj është me rëndësi që të gjithë anëtarët e KDP-së të jenë plotësisht në dijeni për të gjitha aspektet e programit të e-Prokurimit, përfshirë edhe shtyllat dhe objektivat e tij kryesorë.

Komisioni për Zbatimin e Projektit (KZP)

Përbëhet nga promovuesit apo kampionët e prokurimit elektronik, nga specialistë të TI-së të entiteteve qeveritare, të zgjedhur, kryesisht, në bazë të njohurive dhe të aftësive të tyre dhe jo sipas detyrës zyrtare. Këta individë duhet të mbesin në Komision, pavarësisht çfarëdo ristrukturimi të agjencive ku punojnë. Ky komision përkrahet nga Komisioni këshillëdhënës. dhe i raporton KDP-së.

Njësia për Menaxhimin e Projektit (NjMP)

Edhe pse Kosova aktualisht ka agjencinë udhëheqëse për prokurim elektronik dhe KDP-në, NjMP-ja ende nuk ekziston. Pavarësisht modelit të punës (a duhet të blihet sistemi i e-prokurimit, të zhvillohet nga jashtë apo të kontraktohet, të

rregullohet si BOO, BOT, BOOT ose PPP), NjMP-ja kërkohet për të menaxhuar projektin në mënyrë kompetente.

NjMP-ja ka role në dy faza: (i) gjatë zhvillimit dhe zbatimit të sistemit dhe (ii) për përkrahjen e vazhdueshme, kur prokurimi elektronik bëhet funksional.

NjMP-ja organizon grupe punuese/komisione ndërdepartamentale për të avancuar aspekte të ndryshme, siç është RPB. Detyrat e NjMP-së përfshijnë:

- + Menaxhimin e prokurimit strategjik dhe llogaridhënien për të, përkrahjen e përdoruesve, trajnimet dhe ndërlidhjen;
- + Specialistët e prokurimit që do të analizojnë trendet dhe kushtet e tregut, blerjen për qeverinë, këshilla rreth prokurimit, menaxhimin e marrëveshjeve kornizë;
- + Menaxheri i biznesit që do të menaxhojë marrëdhënien kontraktuale mes qeverisë dhe ofruesit të shërbimit, nëse shërbimi ofrohet nga pala e tretë, si dhe do të monitorojë mbarëvajtjen e punëve.
- + Përkrahjen e prokurimit në punonjës dhe në punët administrative;
- + Menaxherin/analistin e sistemit të prokurimit elektronik;
- + Specialistin e qendrës së të dhënave, të rrjetit dhe të sigurisë;
- + Specialistin për bazën e të dhënave dhe menaxhimin e saj, raportimi i prokurimit;
- + Programuesin e faqeve të internetit;
- + Përkrahjen për sportelin ndihmës;
- + Punonjësit e përkrahjes.

Kur sistemi është operacional, NjMP-ja vepron për të siguruar një operim të papenguar, mirëmbajtje të rregullt dhe menaxhim efikas të sistemit të prokurimit elektronik, kushte esenciale këto për qëndrueshmërinë e sistemit elektronik, dhe u ofron shërbim komuniteteve të prokurimit (të gjitha palëve të interesuara të përfshira).

Për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të sistemeve teknike dhe RPB, siç është specifikuar më lart, duhet të angazhohet një konsulent teknik, i cili mund të ndihmohet herë pas here nga konsulentë të prokurimit, që do të ndihmonte për udhëzimin e çështjeve strategjike, dhe RPB që kërkohet për përshtatjen e sistemeve të agjencisë për menaxhimin e prokurimit dhe krijimin e shablloneve standarde të ofertimit, raportimit dhe të menaxhimit, si dhe të kornizave të monitorimit.

Këshilli Këshillëdhënës i Projektit (KKP)

Ky është një grup këshillëdhënësish, që vijnë nga disa agjenci. Ai duhet të krijohet për të ndihmuar me zhvillimin dhe zbatimin dhe për të ndërtuar pronësi më të gjerë. Ky grup punues duhet të përfshijë Ministrinë e Infrastrukturës, Agjencinë për Medikamente, Ministrinë e Administratës Publike dhe pushtetin komunal – si entitete të rëndësishme për funksionimin e prokurimit. Për shkak të rëndësisë strategjike të BKP-së dhe të NJMP-së, është e rëndësishme që këto struktura të kenë stabilitet të ekspertizës.

3.6 Probleme të trajnimit të zyrtarëve të prokurimit

Që sektori i prokurimit publik të plotësojë detyrat dhe kërkesat e zhvillimit të vendit, dhe nevojat për rritjen e konkurrencës së tregut dhe përdorimin efikas të parave publike, ai ka nevojë për kapacitete njerëzore me aftësi profesionale, për personel të kualifikuar, por edhe me integritet. Shërbimet e prokurimit publik janë të larmishme dhe kërkojnë përgatitjen e duhur madje dhe të posaçme për prokurimin publik. Prandaj krahas përzgjedhjes së kujdesshme të zyrtarëve që do të punojnë në stafin e prokurimeve publiku, organizohet edhe trajnimi sistematik i tyre, me programe të miratuara. Këto programet për trajnime dhe ngritje të kapaciteteve të projektohen sipas nivelit të përfshirjes së personelit, pra janë edhe bazike, edhe të avancuara.

Për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim përgjegjëse është KRRPP. Ai identifikon personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset profesionale të prokurimit. Në bashkëpunim me IKAP-in, KRRPP organizon zhvillimin e këtyre kurseve dhe të dy këta organizma janë përgjegjës edhe për organizimin e provimeve.

Përvoja dëshmon se ngritja e kapaciteteve njerëzore të afta për sektorin e prokurimit është një domosdoshmëri për të siguruar zbatimin me sukses të procesit të këtij aktiviteti, sidomos atij elektronik. Edhe në BE, një prej faktorëve që ka ndikuar në rritjen e ngadaltë të projekteve të prokurimit elektronik është konsideruar mungesa e zyrtarëve kampionë që kanë të gjitha aftësitë e duhura, njohuritë, mundësitë dhe cilësitë e një drejtuesi, vendimmarrësi dhe menaxheri të suksesshëm. Një anketë në 15 shtete, që e kanë zbatuar me sukses prokurimin elektronik ka treguar se një prej mësimave më të rëndësishme të nxjerra ishte nevoja për ofrimin e trajnimeve për menaxherët, stafin dhe furnitorët e qeverisë. Mostrajtimi i kësaj çështjeje ka çuar në mungesën e besimit të sistemi i prokurimit elektronik dhe të zbatimi i vonuar i tij.

Edhe më shumë i domosdoshëm bëhet adresimi i këtij problemi për Kosovën, ku mungojnë përvoja dhe shumë mjete dhe mundësi në këtë fushë. Për zhvillimin dhe përmirësimin e trajnimeve të përdoruesve të e-Prokurimit, kërkohen mjete të shumta, oferta trajnimesh online, doracakë për përdorues me aplikacion demonstrues, transaksione të simuluar etj., të cilat duan edhe fonde të konsiderueshme që të realizohen.

Mendojmë se mund të hidhen hapat e parë edhe për zhvillimin e mësimave online të prokurimit, që njerëzit të marrin në rrugë elektronike njohuri mbi prokurimin. Ky mësim elektronik mund të ofrohet edhe në internet-kafe, ndërsa qendrat ekzistuese të trajnimeve të përdoren për trajnime me programe të avancuara.

Këto programe trajnuese, zakonisht, përfshijnë:

Një strategji për menaxhimin e ndryshimeve, e cila rrit sensibilizimin dhe pronësinë të personeli i prokurimit në tërë sektorin publik;

Një program 1-2 ditor për orientim dhe sensibilizim për të gjithë zyrtarët e prokurimit në sektorin publik;

Qasje në politikat e nivelit të lartë, menaxhimin dhe këshillat teknike përmes shërbimit të mbështetjes;

Një program sensibilizues për promovimin e objektivave dhe karakteristikave të e-prokurimit tek të gjitha palët e interesuara, përfshirë edhe ekzekutivët dhe zyrtarët e politikave.

Ky qëllim arrihet duke zbatuar sa më mirë strategjinë e trajnimeve të miratuar nga KRPP-ja, sipas të cilës duhet të trajnohen në mënyrë të detyruar sa më shumë zyrtarë të të gjitha palëve të interesuara, sipas aspekteve të prokurimit dhe strukturave të tij, dhe, pas kësaj, të licensohen. Rëndësi merr edhe niveli i kurrikulave të programeve trajnuese, gjë që kërkon bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë dhe me institucionet e specializuara të trajnimit. Për këtë, duhet angazhim më i madh i qeveria që ta lidhë trajnimin në prokurimin publik me politikën dhe strukturat e arsimit, të cilat janë në gjendje të zhvillojnë edhe kurrikula trajnimi për funksione specifike të prokurimit publik.

3.7 Bashkëpunimi i AQP me institucione vendore dhe ndërkombëtare

Agjencia e Qendrore e Prokurimit ka synuar vazhdimisht që të forcojë lidhjet dhe bashkëpunimin e strukturuar mes institucioneve përgjegjëse për prokurimin publik. Kjo ka ndihmuar në kordinimin e mirë të punëve dhe veçanërisht për të siguruar shkëmbimin e të dhënave dhe të informatave. Edhe më shumë duhet bërë në këtë drejtim për të diskutuar çështje planifikimit strategjik dhe vendosjes së prioriteteve, orientimet e zhvillimit të sistemit të prokurimit publik dhe implementimin me sukses të sistemit elektronik të prokurimit. AQP mban lidhje dhe bashkëpunon ngushtë edhe me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga AQP janë dhënë sqarime dhe këshilla për këto institucione, sipas kërkesave, me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat dhe atij të ankandit publik. Drejtues dhe përfaqësues të AQP kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar brenda vendit.

Në axhendën e vet AQP ka edhe bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare të prokurimit. Ajo ka zhvilluar aktivitete të shumta, sidomos me Zyrën e BE-së në Kosovë, me OECD / SIGMA -Paris, për mbikëqyrjen e procesit të prokurimit publik dhe reformat e sistemit, me Bankën Botërore etj. Përfaqësues nga Kosova marrin pjesë rregullisht në konferencat vjetore për Rrjetin e Prokurimit Publik në Europë, në takime ndërkombëtare, si dhe kanë vizituar dhe kanë pritur delegacione të institucioneve homologe të vendeve të rajonit e më gjerë. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është marrja e përvojës dhe nxjerrja e problematikave dhe praktikave të mira, që mund të përshtaten në Kosovë. AQP ka bërë disa vizita dhe takime jashtë shtetit për tema studimore me interes dhe për shkëmbim idesh dhe përvojash me vende të ndryshme. Po ashtu, anëtarë të Bordit të KRPP-së marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare lidhur me zhvillimin e sistemit të prokurimit publik dhe me reformat e këtij sistemi.

Qysh nga themelimi i sistemit të prokurimit publik, Kosova ka pasur mbështetjen dhe ndihmën e organizmave ndërkombëtare, si Banka Botërore, e cila ka

qenë vazhdimisht e përfshirë në të gjitha fazat e zhvillimit të këtij sistemi, ka organizuar seminare disaditore për trajnimin e zyrtarëve vendas të prokurimit, ka financuar disa projekte të prokurimit në Kosovë, ka ndjekur dhe ka bërë konstatime dhe vlerësime të herëpashershme për performancën dhe ecurinë e prokurimit publik në Kosovë, ka ndihmuar për përmirësimin e strukturës legjislative, të kapaciteteve të institucioneve të prokurimit publik etj. Pas pranimit të Kosovës si anëtar i Grupit të Bankës Botërore, në Qershor 2009, Banka Botërore në projektin e parë të huadhënies që i ofroi Kosovës përfshiu edhe prokurimin publik dhe zbatimin e prokurimit elektronike etj.

Këto janë një mbështetje e fuqishme edhe për implementimin sa më të gjerë të prokurimit elektronik në vendin tonë.

Bashkëpunim të ngushtë mban Kosova edhe me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor për shkëmbimin e përvojave në fushën e prokurimit publik. KRRPP i Kosovës ka lidhje të rregullta me Agjencinë e Prokurimit Publik në Shqipëri, me Zyrën e Prokurimit Publik të Sllovenisë, Komisionin e Prokurimit Publik të Malit të Zi, Zyrën e Prokurimit Publik në Maqedoni, Komisionin Shtetëror për Mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit publik në Kroaci.

Kosova në mënyrë të vazhdueshme ka treguar gatishmëri për të marrë pjesë në mënyrë aktive në nismat rajonale dhe angazhohet rregullisht për të fuqizuar bashkëpunimin bilateral dhe multilateral edhe në fushën e prokurimit publik. Pjesëmarrja në këto aktivitete ka shërbyer mjaft jo vetëm në rritjen e përvojës së institucioneve të prokurimit, por edhe në prezantimin e arritjeve, të ideve dhe të eksperiencës së Kosovës në këtë fushë.

KAPITULLI IV STRATEGJIA DHE POLITIKAT E PROKURIMIT

4.1 Strategjia kombëtare e prokurimit publik dhe problemet në zbatimin e saj

Siç e kemi vënë në dukje në Kosovë, duke filluar nga qeveria, ka një perceptim pozitiv për rëndësinë e prokurimit publik në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Sistemi i prokurimit publik, tashmë, është një përparësi strategjike e qeverisë. Duke filluar nga mesi i vitit 2000, në Kosovë kanë filluar reformat në fushën e prokurimit publik me qëllim që ai të bëhej më efikas dhe më transparent dhe në përputhje me kërkesat, udhëzimet themelore të prokurimit dhe praktikën më të mira e BE-së.

Por deri vitin e fundit, për prokurimin publik nuk ka qenë formuluar ndonjë strategji e posaçme, prandaj dhe ka pasur paqartësi dhe janë marrë masa të pjesshme për ndryshime shumë të shpeshta të ligjit për prokurimin publik. Fusha e prokurimit është trajtuar nëpër dokumente të veçanta strategjike. Megjithatë, dihet se ai ka edhe implikime më të gjera sociale, ekonomike dhe politike. Kosova vërtet hartoi legjislacionin përkatës, por ka pasur boshllëk të madh në dokumentacionon programatik të prokurimit publik. Kjo shtronte nevojën e ndërtimit të një strategjie kombëtare të prokurimit publik, që do të vinte në shinat e duhura gjithë punën për zbatimin e suksesshëm të sistemit të prokurimit.

Me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik u bë një hap i madh përpara në krijimin e një sistemi efektiv të prokurimit publik, në arritjen e sukseseseve në funksionimin e sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë, në përballimin e sfidave, dhe në vendosjen e praktikave sa më të mira të prokurimit, duke u mbështetur edhe në eksperiencën në vende të tjera. Ky dokument i rëndësishëm trajton problemet që shfaqen në zhvillimin e prokurimit publik, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe avancimin e tij, duke siguruar rritjen e konkurrencës, të transparencës dhe llogaridhënies, përdorimin efikas të parasë publike në interes të qytetarëve.

Në bazë të strategjisë është realizimi i reformave në sistemin e prokurimit publik, në përputhje me kërkesat bashkëkohore dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe krijimi i infrastruktura ligjore dhe institucionale për prokurimin publik. Zbatimi i kësaj strategjie i jep një shtysë realizimit të parimeve të prokurimit publik; rritjes së performancës të kapaciteteve njerëzore me trajnime bazë dhe të avancuara; harmonizimit të legjislacionit me direktivat e fundit të BE-së; përsosjes së komunikimit dhe informimit nga institucionet qendrore të prokurimit.

Për arritjen e këtyre qëllimeve strategjia presupozon ndërtimin e politikave adekuate, is dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit për zbatimin e saj. Kësisoj strategjia shihet edhe si një udhërrëfyes dhe synon forcimin e koordinimit të punës së institucioneve qendrore të prokurimit publik.

Në zbërthimin dhe zbatimin e kësaj strategjie buron edhe planifikimi strategjik i qeverisjes elektronike, që të japë orientime dhe udhëzime të qarta për këtë çështje të rëndësishme, të cilat shpeshherë në praktikë kanë munguar. Themi kështu, sepse ka

pasur edhe mangësi në udhëheqjen e-Prokurimi në Kosovë. Problematike ka qenë edhe mospërputhshmëria, e cila është përcjellë me probleme të kapacitetit të TI-së në shumë entitete. Nga ana tjetër, nuk ka pasur formulime të qarta rreth vizionit dhe objektivave të e-Prokurimit dhe fushëveprimi i tij nuk është kuptuar mirë nga palët e interesuara, deri edhe nga agjencia udhëheqëse (KRrPP), e cila nuk i ka kuptuar mirë aspektet e saj kryesore. Edhe menaxhimi i rrezikut nuk është i konsoliduar, kur është fjala për projektet e mëdha të prokurimit (prokurimi elektronik është projekt madhor), ndërsa menaxhimi dhe kontrolli i të dhënave ka nevojë për fuqizim.

Është e nevojshme që këto aspekte të trajtohen në një strategji për prokurimin elektronik, e cila duhet të parashikojë qartë një sistem të vetëm për të gjitha entitetet qeveritare dhe nivelet e qeverisë, pasi kështu teknologjia shfrytëzohet më mirë dhe në veçanti minimizohet dublimi i menaxhimit të sigurisë, menaxhimi i katalogut, dublimi i regjistrave të furnitorëve etj.

Përmes strategjisë së e-Prokurimit do të trajtoheshin edhe politikat dhe procedurat e qeverisë për menaxhimin e prokurimit elektronik, rrugët e aktivizimit të biznesit për t'i adresuar furnitorët aktualë të kontraktuar nga qeveria, furnitorët që nuk janë të kontraktuar dhe po ashtu për të punuar me industrinë e shërbimit që i mbështet aplikacionet e tregtisë elektronike. Po ashtu, synohet të ndërtohen shërbime elektronik të vlerës sa më të lartë, shërbimet mobile që janë tërheqëse për bizneset etj.

4.2 Vizioni dhe objektivat e strategjisë së prokurimit publik

Siç e përmendëm më sipër, Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik përmban vizionin, objektivat, masat dhe hapat që shërbejnë për zhvillimin sa më të suksesshëm të sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Duke hedhur vështrimin në perspektivë synohet që ky sistem të jetë kompetitiv me ato të vendeve të tjera.

Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik ka si vizion dhe mision të krijojë një sistem prokurimi sa më efikas, duke nxitur respektimin e parimeve të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtimin e drejtë dhe të barabartë të konkurrentëve. Përmirësimi i sistemit të prokurimit synohet të arrihet duke perfeksionuar monitorimin e zbatimit të ligjit të prokurimit publik, kualifikimin e personelit, përmirësimin e menaxhimit të prokurimit, të komunikimit mes aktorëve të prokurimit publik, si dhe shfrytëzimin e më gjerësisht të prokurimit elektronik etj.

Në përgjithësi rekomandohet që vizioni i prokurimit elektronik të udhëhiqet nga parimet bazë të prokurimit, duke përfshirë qeverisjen, efikasitetin dhe zhvillimin ekonomik e investimet dhe, nga aspekti më i përgjithshëm, të rrisë besimin në qeveri. Thënë në mënyrë më specifike, qëllimet kryesore të programit të prokurimit elektronik janë:


Rritja e aftësive të vendimmarrjes së zyrtarëve të prokurimit, duke dhënë informata domethënëse dhe gjithëpërfshirëse të prokurimit; përmirësimi i planifikimit financiar dhe buxhetimit; përmirësimi i transparencës në procedurat dhe praktikën e prokurimit; efikasiteti në procesin e prokurimit dhe minimizimi i kohës së ciklit të prokurimit; inkurajimi i pjesëmarrjes dhe avancimi i konkurrencës në mesin e

furnitorëve; kultivimi i ekonomisë së shkallës përmes bashkimit të kërkesës dhe maksimizimit të vlerës për para në procesin e prokurimit qeveritar; rritja e besimit të qytetarëve dhe të bizneseve në procesin qeveritar të prokurimit dhe në shfrytëzimin e fondeve publike. optimizimi i niveleve të inventarizimit përmes zbatimit të praktikave efikase të prokurimit; sigurimi i besueshmërisë, integritetit dhe autorësisë së të gjitha transaksioneve dhe të dhënave mes entiteteve të prokurimit dhe furnitorëve; përmirësimi i niveleve të shërbimit për të gjitha palët me interes të përfshira në prokurim elektronik.

Strategjia përmban edhe disa objektiva kryesore që shërbejnë për arritjen e qëllimit të përgjithshëm të saj. Si të tillë pëmendim:

Rritjen e efikasitetit të sistemit të prokurimit publik përmes vendosjes së rregullave dhe monitorimit të zbatimit të tyre; zbatimin e parimit të transparencës dhe qasjes në informata në të gjitha fazat e aktivitetit të prokurimit gjatë përdorimit të fondeve publike, rritjen e përgjegjësisë, të integritetit, llogaridhënies, kontrollit për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në prokurim publik; kualifikimin e vazhdueshëm të kuadrove të prokurimit; harmonizimin e vazhdueshëm të legjislacionit të prokurimit publik me kornizën ligjore të BE-së dhe shfrytëzimin e përvojës dhe të praktikave më të mira të shteteve anëtare të BE-së në fushën e prokurimit publik. Një tjetër objektiv mbetet edhe rritja e vetëdijes për prokurimin publik në Kosovë.

Këta objektiva të zgjeruar janë paraqitur në figurën 2: gjegjësisht, në qeverisjen e përmirësuar përmes transparencës dhe menaxhimit të përmirësuar të informatave, menaxhimit të punës dhe të dokumenteve dhe ndihmesës në udhëheqjen e zhvillimit ekonomik.






Figura 2 - Objektivat e prokurimit

Kuptohet, që për arritjen e këtyre objektivave kryesore shërbejnë edhe disa objektiva më specifike, që kanë të bëjnë me probleme më konkrete të praktikës së prokurimit publik. Edhe këto janë shumë të rëndësishme, ndaj kërkojnë vëmendjen e duhur. Ato kanë të bëjnë me çështje të tilla, si:

Palët e interesuara të jenë sa më të qarta sesi zhvillohet prokurimi; rritja e aftësive të vendimmarrjes së zyrtarëve të prokurimit; përmirësimi i planifikimit financiar dhe i buxhetimit; minimizimi i kohës së ciklit të prokurimit; inkurajimi i pjesëmarrjes dhe avancimi i konkurrencës mes furnitorëve; optimizimi i niveleve të inventarizimit përmes zbatimit të praktikave efikase të prokurimit; sigurimi i besueshmërisë, integritetit dhe i autorësisë së të gjitha transaksioneve dhe të dhënave mes entiteteve të prokurimit dhe furnitorëve; përmirësimi i niveleve të shërbimit për të gjitha palët e interesuara të përfshira në prokurim elektronik; rritja e besimit të qytetarëve dhe të bizneseve në procesin qeveritar të prokurimit dhe në shfrytëzimin e fondeve publike.

Rekomandohet që strategjia e prokurimit elektronik të parashikojë një sistem të vetëm për të gjitha entitetet qeveritare dhe nivelet e qeverisë. Në Kosovë tani po përdoret teknologjia informatike për tendera, për menaxhimin të sigurisë, të katalogut elektronik. Ky sistem po siguron regjistrimin e furnitorëve, si dhe përmirëson perspektivën e metodologjive alternative të prokurimit. Ndaj kërkohet që strategjia e prokurimit të mbështetet fuqimisht në këtë realitet të ri.

4.3 Politikat e prokurimit publik

Duke qenë se prokurimi publik është instrument i përbashkët për zhvillimin e biznesit dhe të industrisë, ndërveprimet e sektorit publik me tregjet vendore dhe ndërkombëtare rregullohen nga politikat e prokurimit, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë.

Hartimi i politikave shtetërore për prokurimin elektronik bëhet në bazë të prioriteteve, ligjit, strukturave publike institucionale dhe përvojave ndërkombëtare. Këto politika përfshijnë objektivat dhe masat për matjen e mbarëvajtjes së prokurimit. Ato mbështeten në pjesën e fushës së prokurimit publik të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, i cili ndër të tjera parashikon edhe aplikimin e platformës së prokurimit elektronik, modulën e tenderimit elektronik; miratimin e udhëzuesve operacionalë për prokurimin elektronik; krijimin e bazës teknologjike dhe të burimeve njerëzore; ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative të qeverisjes elektronike të prokurimit, trajnimet bazike dhe të avancuara të zyrtarëve për prokurimin elektronik etj.

Politikat e prokurimit lidhen, gjithashtu, me sistemin e menaxhimit të financave publike dhe synojnë përdorimin efikas të fondeve publike, parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe ngushtimin e hapësirave për abuzime në sistemin e prokurimit publik. Institucionet udhëheqëse të prokurimit publik janë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e këtyre politikave dhe të legjislacionit të prokurimit. Po ashtu, ekziston nevoja për zhvillim të mëtejshëm të disa prej metodave të prokurimit dhe të politikave lidhur me dhënien e argumenteve në favor të prokurimit elektronik.

Politikat e qeverisë për prokurimin mbështesin edhe objektivat e prokurimit elektronik. Por në bazë të tyre KRRPP duhet t'i përvijojë në planin e zbatimit dhe të ndërtojë punën e saj për të siguruar funksionimin sa më efikas të sistemit, për zhvillimin e instrumenteve të prokurimit elektronik, posaçërisht marrëveshjet kornizë, të cilat duhet të futen në përdorim brenda një afati të shkurtër. KRRPP-ja duhet t'i shqyrtojë politikat e prokurimit, që ato të jenë në përputhje me funksionimin efektiv dhe ekonomizues të teknologjisë së prokurimit dhe të jenë të mbështetura me këshilla të ekspertëve.

Përmirësimi i cilësisë së politikave të prokurimit dhe zbatimi i tyre natyrisht janë edhe rezultat i asistencës së jashtme.

Megjithatë, kërkesa për cilësi më të lartë të politikave të prokurimit, mbetet në rend të ditës. Sidomos politikëbërja në nivelin operacional të prokurimit, kërkon funksionimin më efikas të strukturës aktuale institucionale të planifikimit të politikave të prokurimit. Një planifikim realist dhe i bazuar mirë në të dhëna kërkon cilësi në statistika, në dokumentet strategjike, njohuri të mjaftueshme të gjendjes aktuale nëpër sektorët e ndryshëm të ekonomisë dhe të financave.

Rishikimi i politikave dhe i praktikave të prokurimit është një aspekt tjetër që kërkon vëmendjen e duhur. Për shembull duhen rishikuar ato praktika që kanë të bëjnë me kohën e mbylljes së dorëzimit të ofertave, pasi, zakonisht, koha e mbylljes së dorëzimit të ofertave është gjatë orëve të punës dhe në kohën kur interneti është shumë i ngarkuar. Ato mund të caktohen edhe jashtë orarit të punës, në orët e vona, kur ngarkesa e internetit është e ulët. Po ashtu duhen rishikuar afatet kohore të pranimit të tenderave, praktikat e komunikimeve, që mund të bëhen me pyetje dhe përgjigje, apo mënjanimi i rrugëve të kontaktit, siç janë numrat e telefonit dhe identifikuesit e personelit.

Pa dyshim që në zbatimin e mirë e të qëndrueshëm të politikave të prokurimit kontribuojnë edhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të tyre. Lidhur me to ka ende

probleme në Kosovë, pasi monitorimit të zbatimit të politikave nuk i kushtohet rëndësia e nevojshme nga të gjitha institucionet e prokurimit. Për eliminimin e mangësive në këtë fushë kërkohet që të avancohet plotësohet korniza ligjore mbi politikëbërjen, për ta bërë monitorimin të obligueshëm dhe pjesë të pandashme të politikave të prokurimit, për të siguruar që dokumentet e politikave të përmbajnë edhe matshmërinë e rezultateve. Nëse monitorimi i zbatimit të politikave është i dobët, vlerësimi i tyre është joekzistent.

Duke u ndalur në politikat lidhur me transaksionet elektronike, mund të themi se ato përfshijnë:

- ✚ Politikën e sigurisë së TI-së, përfshirë administratorin;
- ✚ Politikën e përdorimit të aplikacionit (përfshirë klauzolën për përgjegjësinë e kufizuar);
- ✚ Politikën e gjurmimit të auditimit;
- ✚ Planifikimin e vazhdimet të punës;
- ✚ Planifikimin e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë;
- ✚ Politikën e ruajtjes /Backup;
- ✚ Politikë e arkivimit;
- ✚ Pagesat elektronike/politikën e pranimeve.

Së fundi theksojmë se korniza e politikave të prokurimit elektronik, mbështetet në strategjinë e prokurimit elektronik, në politikat e qeverisjes dhe në politikat financiare. Përputhja midis tyre është një argument në favor të implementimit të prokurimit elektronik.

4.4 Planifikimi strategjik i prokurimit

Planifikimi është një pjesë shumë e rëndësishme e aktivitetit të një specialisti prokurimesh dhe plani strategjik i prokurimit përfaqëson një veprimtari që është kërkesë e ligjit.

Planifikimi i prokurimit përkufizohet si një proces i përdorur nga autoritetet kontraktore për të detajuar veprimtarinë blerëse për një periudhë të caktuar kohore. Për hartimin e planit specialistët e prokurimit bashkëpunojnë ngushtë me specialistët e buxhetit dhe me grupet e tjera të interesit. Planifikimi i prokurimit zbatohet për prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Plani strategjik për prokurim elektronik përfshin:

- ✚ **Objektivat dhe argumentet në favor të prokurimit elektronik;**
- ✚ **Funksionet e sistemit;**
- ✚ **Specifikimet teknike;**
- ✚ **Modelin e punës – kush do ta zhvillojë, kush do të jetë në pronësi dhe kush do ta përkrahë sistemin;**
- ✚ **Kushtet rreth kapaciteteve;**
- ✚ **Planin e zbatimit.**

Hapi i parë në procesin e planifikimit të prokurimit është plani i veprimit. Këtë po e paraqesim në tabelën e më poshtme.

Tabela 3 Plani i veprimit të prokurimit elektronik

Nr.	Iniciativa	Treguesi	Prioriteti	Veprimi	Detajet dhe udhëzimet
1	Inicimi				
	Njoftimi i kabinetit	Shkresa për kabinetin qeveritar që do të përgatitet nga KRRPP-ja	I menjëhershëm	Shpallja e vizionit, synimeve dhe objektivave kyçe, si dhe i përfitimeve të qeverisë Miratimi dhe prioritetizimi i bashkërendimit ndërqeveritar dhe i menaxhimit të ndryshimit. Caktimi i objektivave, i caqeve të performancës, i mbikëqyrjes, buxheti.	Politika dhe argumentet në favor të prokurimit elektronik Seksionet
2	Strukturat institucionale				
	Themelimi i strukturave mbështetëse dhe zbatuese	KRRPP-ja në konsultim me palët kyçe me interesit	I menjëhershëm	Rishikimi i komisionit drejtues të projektit Themelimi i komisionit për zbatimin e projektit Themelimi i njësisë për menaxhimin e projektit Themelimi i këshillit këshillëdhënës të projektit Krijimi i grupit punues prej agjencive pilote Inicimi i RPB-së Hartimi i termave të referencës dhe i orareve për takime	Seksionet
3	Zhvillimi i sistemeve të prokurimit elektronik				
	Angazhimi i zhvilluesit	KRRPP-ja	Afatmesëm	Finalizimi i specifikave teknike dhe funksionale dhe i standardeve, përfshirë edhe për katalogë Finalizimi i fazave të fillimit Reklamimi për RFT nga ICB Vlerësimi dhe dhënia e kontratës për zhvillim Fillimi i zhvillimit fazor – shih tabelën Inicimi i RPB me agjencitë pilot Themelimi i strukturave	Seksionet

				të trajnimit Hapja e sportelit ndihmës /qendrës së shërbimit dhe reklamimi në sektorin publik e privat	
4	Menaxhimi i projektit				
	Menaxhimi dhe raportimi	KRRPP, NJMP, KZP, KDP, KKP	Afatmesëm	Krijimi i formateve të raportimit, termave të referencës dhe i orareve të takimeve për NjMP, KZP, KDP, KKP Caktimi i objektivave të projektit dhe i indikatorëve kyç të performancës Caktimi i kërkesave për mbikëqyrjen e menaxhimit të kontratës Krijimi i menaxhimit të rrezikut dhe i raportimit	Praktikat e menaxhimit të projektit Plani i menaxhimit të rrezikut
5	Politikat dhe legjislacioni				
	Rregulloret dhe udhëzimet operacionale	KRRPP	Afatmesëm	Shqyrtimi i politikave operacionale ekzistuese të prokurimit dhe harmonizimi me mjedisin digjital Zhvillimi i rregullave dhe udhëzimeve të reja operacionale sipas nevojës për mjedisin digjital Krijimi i rregulloreve dhe i politikave për nënshkrime elektronike dhe dokumente elektronike	Seksionet
6	Trajnitet për blerësin dhe furnitorin				
	Aftësimi i burimeve njerëzore	Zhvilluesi, KIPA, KRRPP	Afatmesëm në sinkronizim me fazën e fillimit	Zhvilluesi t'i sjellë në grupe zyrtarët e prokurimit përmes strukturave të trajnimeve menjëherë pas fazës së fillimit KRRPP ta aktivizojë strategjinë për furnizuesin	Obligimet e kontratës Seksionet
7	Infrastruktura dhe shërbimet e rrjetit				
	Qendra e të dhënave Faqja e rimëkëmb- jes nga fatkeqësitë Fuqizimi	KRRPP KRRPP MPA	Afatmesëm	Nëse kërkohet, të krijohet një qendër e integruar e të dhënave me harduer, softuer shtesë dhe arkitekturë të re Themelimi i Faqes për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë	Seksionet

	i portës së rrjetit/gate way të qeverisë			(FRF) me dyfishimin e njëjtë të qendrës së të dhënave Sigurimi i shpejtësisë dhe besueshmërisë së portës së rrjetit të qeverisë	
8	Monitorimi dhe vlerësimi				
	Korniza e monitorimit	NJMP, KZP, KDP	Afatshkurtër	Zhvillimi i indikatorëve të pikënisjes Sistemi i marrjes së komenteve nga sektori privat	Seksionet

4.5 Plani vjetor dhe individual i prokurimit

Specialistët e prokurimit kanë për detyrë edhe planifikimin e prokurimit, pasi plani vjetor për secilin subjekt të prokurimit, si dhe planet individuale të prokurimit kërkohet nga ligji. Planifikimi i prokurimit ka mjaft avantazhe, pasi ai mundëson bashkëpunim të frytshëm midis departamenteve të ndryshme dhe me grupet e interesit, informimin për nevojat dhe kërkesat e departamenteve dhe të operatorëve ekonomikë, por edhe ndihmon në programimin e në mënyrë efikase të burimeve buxhetore për vitin pasardhës. Në të kundërt, moskryerja e planifikimit ka pasoja negative në të gjitha këto aspekte.

Plani vjetor lidhet ngushtë me buxhetin e autoritetit kontraktues, ku departamentet duhet të kërkojnë buxhete për personelin, shpenzimet dhe blerjet. Për këtë puna fillon që në muajin shtator të vitit paraardhës, kur merren propozimet e blerjeve, vendosen shifrat fillestare të buxhetit në listën fillestare të miratuar të synimeve. Këto kërkesa të buxhetit i merr dhe i shqyrton departamenti i financës, kurse njësia e prokurimit shqyrton përmbajtjen e blerjeve duke kombinuar kërkesat e departamenteve të ndryshme dhe jep rekomandimet përkatëse. Në fillim të nëntorit buxhetet në fjalë finalizohen dhe në mes të nëntorit organit drejtues të autoritetit kontraktor i kërkohet të miratojë buxhetin. Pas kësaj, njësia e prokurimit dhe grupet e interesit mund të vazhdojnë me planifikimin e hershëm të blerjeve për janarin e vitit të ardhshëm. Moskryerja e planifikimit të prokurimit do të kishte pasoja për grupet e interesit, për departamentin e financës dhe për njësinë e prokurimit, të cilët, në mungesë të programimit, nuk do të kryenin si duhet detyrat dhe funksionet që kanë dhe nuk do t'ia arrinin qëllimit të tyre.

Roli i grupeve të interesit në procesin e planifikimit të prokurimit konsiston në: dhënien e informacionit paraprak në planin vjetor të prokurimit; në shqyrtimin e opsioneve për mallrat, shërbimet dhe punët që kërkohen me prokurim; në bashkëpunimin me grupet e tjera të interesit dhe me specialistët e prokurimit për të kombinuar kërkesat; në zhvillimin e specifikimeve të kërkesës; në përcaktimin e afateve kohore për nevojat e tyre etj.

Planifikimi i prokurimit, gjithashtu, lidh strategjinë e autoritetit kontraktues me aktivitetin e prokurimit dhe me blerjet individuale. Gjatë fazës së planifikimit dhe

përgatitjes për shpalljen e procedurës, është e domosdoshme prania e një specialisti fushe, i cili, përvec të tjerash, përcakton që në fazën e planifikimit nëse punët do të prokurohen me anë të punimeve me matje, në bazë të çmimeve fikse, harton specifikime teknike, që shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve, që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera, që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

Plani i hartuar, pasi miratohet, publikohet për qasje të publikut. Në të jepen të dhënat standarde për prokurimin, përshkrimet e prokurimit, lloji dhe metoda e prokurimit, lloji i buxhetit, kostoja e përlllogaritur, data e planifikuar për shpallje në gazetë, nënshkrimi i kontratës, data e kompletimit dhe të dhëna të tjera të rëndësishme të etapave të ndryshme të ciklit të prokurimit, performanca dhe objektivat e prokurimit.

Hartimi i planit lidhet edhe me SIMF për të vërtetuar buxhetin e caktuar; po ashtu integrohet me SIM, për regjistrimin automatik të të dhënave në lidhje me kohën e shpenzuar, me mospërputhjen midis shpenzimeve të planifikuara dhe atyre aktuale.

Edhe hartimi i *planeve individuale* të prokurimit është pjesë shumë e rëndësishme e aktivitetit të një specialisti prokurimesh, i cili duhet të jetë i ndërgjegjshëm për nevojën e kryerjes së planifikimit të prokurimit dhe për përfitimet që rrjedhin prej tij.

Plani individual i secilit prokurim duhet të jetë në linjë me planin dhe me buxhetin e përgjithshëm të subjektit të prokurimit. Hartimi i mirë i tij është një parakusht për zhvillimin efikas të procedurave të prokurimit, por edhe për kryerjen e monitorimit dhe të auditimit të prokurimeve publike.

Plani parashikon një numër të madh veprimesh të veçanta, aktivitete më të mëdha, si menaxhimi i buxhetit, studimi i fizibilitetit, detajimin e projektit, vlerësimin e ndikimit të tij në mjedis etj. Kjo shërben që të hartohet një dokument sa më i plotë për fillimin e projektit dhe ndihmon në uljen e kostove të prokurimit dhe, si rrjedhim, në shtimin e vlerës së parasë.

Edhe për hartimin e këtij plani është i nevojshëm bashkëpunimi me grupet e interesit, për të dhënë kontributin e tyre në këtë proces. Palët e interesuara luajnë rol të ndjeshëm në planifikim, pasi ndihmojnë në identifikimin e kërkesave që duhet të prokurojnë, në dhënien e informacionit paraprak në planin vjetor të prokurimit, në shqyrtimin e opsioneve për mallrat, shërbimet dhe punët që kërkohen me prokurim, në përcaktimin e afateve kohore për nevojat e tyre, si dhe ndihmojnë në analizat brenda planeve individuale të prokurimit, së bashku me specialistët e prokurimit.

Planifikimi i prokurimit e ka të domosdoshme edhe studimin e tregut të ofertës. Kjo ka të bëjë me mbështetjen e hartimit të planeve dhe strategjive vjetore dhe individuale të prokurimit nëpërmjet njohurive rreth mënyrës sesi funksionojnë tregjet; me qartësimin e fushave ku ekzistojnë pikat e përfitimit dhe mundësitë në treg; me vizualizimin dhe njohjen e tregut nga perspektiva e operatorëve ekonomikë. Njohja e operatorëve ekonomikë me pikat e forta, dhe të dobëta të tregut ndikon edhe te planifikimi, i cili, duke marrë parasysh dhe konkurrencën, që ekziston në treg, parashikon një paketë më të madhe punësh të ngjashme ose bashkëpunimin me

autoritetet kontraktuese për të hartuar një kërkesë më tërheqëse në tregun e ofertës gjatë fazës së planifikimit dhe përgatitjes për shpalljen e procedurës.

Në hartimin e planit individual është nevojshëm edhe një specialist i fushës, për të ndihmuar në studimi i biznesit, për të planifikuar kapitalin dhe buxhetet operative për punët gjatë kohëzgjatjes së parashikuar, kostot e ndërtimit të kapitalit dhe të ardhurat operative të nevojshme për të mirëmbajtur strukturën e përfunduar. Gjatë procesit të planifikimit bëhet edhe studimi i fizibilitetit teknik, që është i nevojshëm për të kontrolluar nëse projekti është i realizueshëm nga ana teknike dhe nëse janë të disponueshme koha, burimet dhe buxhetet.

KAPITULLI V PROKURIMI PUBLIK NË KOSOVË - ARRITJE DHE SFIDA

5.1 Gatishmëria për zbatimin dhe shtrirjen e e-Prokurimit në Kosovë – Sfidat dhe mangësitë

Prokurimi publik në Kosovë ka bërë progres të dukshëm në dekadën e fundit me krijimin e një baze ligjore me kritere të përcaktuara nga BE-ja dhe Banka Botërore, me ndryshimet e herëpashershme të ligjit për prokurimin publik, si dhe me ngritjen e rrjetit të institucioneve përgjegjëse për prokurimin publik dhe për monitorimin e tij. Edhe hapat e bëra për përgatitjen e një stafi me njohuritë e duhura për prokurimin dhe, sidomos, për implementimin e prokurimit elektronik, janë një arritje e madhe në modernizimin e procesit të prokurimit në Kosovë, në rritjen e transparencës, të konkurrencës dhe të efikasitetit të tij.

Rëndësia e prokurimeve publike në Kosovë shihet edhe në aspektin e madhësisë e shpenzimeve krahasuar me buxhetin kombëtar dhe BPV ose madhësisë se blerjeve të Qeverisë. Prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve ishte rreth 9.4 % e BPV, për vitin 2015 ai ishte shpenzimi i dytë më i madh pas pagave dhe mëditjeve (Raporti i Progresit të Komisionit Europian, 2015).

PROKURIMI ELEKTRONIK

Edhe pse diçka ka filluar të bëhet në këtë fushë, finalizimi i kësaj pune mbetet një objektiv. Prokurimi elektronik nuk nënkupton vetëm publikimin e rezultateve të prokurimit, por tërë procesin, ashtu siç parashihet në Ligjin e prokurimit. Të gjitha kërkesat e prokurimit mund të publikohen përmes internetit. Sistemi për menaxhimin e prokurimit mundëson ruajtjen elektronike, si dhe vlerësimin teknik e financiar të ofertave. Paraqitja e këtij procesi në mënyrë transparente përmirëson besimin dhe efikasitetin. Duke u bazuar në të drejtat, ashtu siç parashihet me ligj, sistemi i menaxhimit të procesit i mundëson çdo pale që të përcjellë procesin dhe të ankojë përmes internetit. Zbatimi i prokurimit elektronik ndikon në eliminimin e pengesave të pranishme më parë, duke rritur kështu besimin e të gjitha palëve të përfshira. Qasja do t'u jepet të gjithë personave, nëse rast se ajo u lejohet me ligj, ndërsa në rast të kufizimeve, ata duhet të përdorin identifikimin elektronik (e-Id). Çdo kategori do të ketë kontrollin e veçantë të qasjes, duke përfshirë autoritetin kontraktues, ofertuesit, ankuesit, autorizuesit e njësive buxhetore, auditorët dhe kategoritë e tjera të përcaktuara sipas ligjit

Burimi: Strategjia për qeverisjen elektronike 2009-2015

Nga vëzhgimet dhe analizat e bëra lidhur me ecurinë e implementimit të sistemit të prokurimit publik elektronik në Kosovë rezulton se ka mirëkuptim, predispozicion dhe gatishmëri për ta përqafuar këtë zgjidhje. Si nga strukturat qeveritare, ashtu edhe nga aktorë të tjerë të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit shihet gatishmëria për të vepruar me metodat e përdorimit të teknologjisë informatike, pasi vlerësojnë avantazhet dhe efektet pozitive që ka në praktikë prokurimi elektronik. Po ashtu, duhet thënë se, tashmë, janë krijuar kushtet dhe mundësitë objektive për zbatimin e prokurimit elektronik, si baza ligjore, ashtu edhe rregullimet e nevojshme institucionale. Kosova, gjithashtu, ka një infrastrukturë të mirë të telekomunikimeve dhe një rrjet qeveritar mjaft të mirë.

Një vetëvlerësim për gatishmërinë për zbatimin e prokurimit elektronik në Kosovë kanë bërë katër agjenci, në cilësinë e palëve të interesuara. Vlerësimi është plotësuar me konsultime në një workshop për palët e interesuara dhe rezultatet janë përmbledhur në tabelën 4.

Tabela 4 Rezultatet e vlerësimit të gatishmërisë për zbatimin e prokurimit elektronik në Kosovë

Komponenti kryesor	Vlerësimi 1-4	Komente
Udhëheqja qeveritare	3.5	Aspektet institucionale janë të shëndosha, përkrahja politike duhet të fuqizohet dhe vizioni të artikulohet
Menaxhimi i resurseve njerëzore	2.5	Trajnimi i zyrtarëve dhe i operatorëve ekonomikë, zhvillohet , por ka mungesa të bashkërendimit e të përqendrimit
Planifikimi dhe menaxhimi	3	Planifikimi dhe menaxhimi janë në nivelin e duhur, por ka mungesë të besimi se Departamenti i prokurimit është duke u menaxhuar mirë. Kërkohej reforma e RPB-së për internetin
Politikat	4	Nevojitet zhvillimi i politikave, lidhur me aspektet e internetit, modelit të punës, verifikimit dhe objektivave
Legjislacioni dhe rregulloret	4	Ligji i prokurimit dhe ai i e-nënshkrimit janë në nivelin e duhur, por janë të nevojshme disa amendamente
Infrastruktura dhe shërbimet e internetit	4	Infrastruktura dhe shërbimet e internetit janë në nivelin e duhur
Standardet	2.5	Nuk ekziston një politikë e efektshme lidhur me kornizën qeveritare të ndërveprimit
Integrimi i sektorit privat	4	Kapaciteti i shfrytëzuesve nga sektori privat është në nivelin e duhur, ndërsa kapaciteti i zhvilluesve është pjesërisht i në nivelin e duhur
Sistemet e njoftimit me internet	3	Zhvillimi ekzistues i prokurimit elektronik është i mirë, por ka mungesë të kapacitetit funksional

Burimi: Shtojca 2. (Shih këtë shtojcë edhe për shkallën e vlerësimit).

Rezultatet e paraqitura në këtë tabelë tregojnë se gatishmëria e përgjithshme për zbatimin e prokurimit elektronik në Kosovë është në një nivel të lartë. Megjithatë, del nevoja për disa politikave dhe për njohjen dhe trajtimin e problemeve në vijim:

Lidhur me *udhëheqjen qeveritare* për sigurimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore del se ekziston nivel i ulët i vetëdijesimit për nevojat e trajnimit, ndërsa pronësia e strategjisë së trajnimit ende nuk është e përcaktuar. Në përvojat e shumicës së vendeve, trajnimi është element thelbësor i zbatimit të prokurimit elektronik, si për nivelet e ndryshme të qeverisë, ashtu edhe për sektorin privat. Megjithatë, si sektori publik, ashtu edhe ai privat kanë shkallë të lartë të njohurive të internetit, andaj konsiderohet se kjo nuk do të jetë një problem i madh. Sido që të jetë, ky aspekt mbetet për t'u trajtuar më tej në planin e zbatimit.

Për sa u përket *planifikimit dhe menaxhimit* të prokurimit, këto udhëhiqen përmes legjislacionit konsistent, ku përfshihet pushteti lokal, dokumentet standarde dhe proceset standarde, të cilat vlejnë në përgjithësi. Këto karakteristika do ta bëjnë RPP për prokurim elektronik relativisht një proces të efektshëm. Po ashtu, ekziston përkrahje e gjerë e përmirësimeve të vazhdueshme në procesin e prokurimit elektronik. Nga ana tjetër, ekziston një bindje më e vogël se proceset e prokurimit menaxhohen mirë tek entitetet blerëse, dhe ka analiza të pakta për shpenzimet e qeverisë si tërësi. Prokurimi më shumë shikohet në aspektin e procesit të përputhshmërisë, sesa në atë të menaxhimit të performancës.

Nganjëherë kjo kuptohet si centralizim i prokurimit, por nuk është kështu. Centralizimi përfaqëson një infrastrukturë të unifikuar të informatave të prokurimit e jo centralizim të vetë prokurimit. Entitetet dhe nivelet e qeverisë mund të mbeten plotësisht përgjegjëse dhe të mbajnë nën kontroll se çfarë blejnë dhe kur e blejnë – prokurimi mbetet i decentralizuar, por shfrytëzon infrastrukturën e përbashkët, mu sikurse shfrytëzon infrastrukturën e tjera të përbashkëta të shtetit për tregti, siç janë ligjet e prokurimit dhe sistemet bankare të shtetit. Në disa raste ekzistojnë dispozita për ministrinë apo nivelet e caktuara të qeverisë për të pasur mundësinë e individualizimit të sistemit unik për qëllime të tyre të menaxhimit, pa sakrifikuar aspektet e përbashkëta, por kjo nuk rekomandohet.

5.2 Komponentet e prokurimit publik

Disponueshmëria për përdorimin e prokurimit elektronik mund të përmirësohet përmes identifikimit të komponenteve të sistemit. Lidhur me këtë, theksi vihet në rolin dhe rëndësinë që ka secili komponent. Nëse një komponent është i prirë të dështojë, i tërë sistemi, po ashtu, do të jetë i prirur të dështojë.

Komponentet e prokurimit janë: *qeverisja qeveritare; menaxhimi i burimeve njerëzore; planifikimi dhe menaxhimi; politikat; legjislacioni dhe rregullimi; infrastruktura dhe shërbimet e internetit; standardet; integrimi i sektorit privat; sistemet aktuale të prokurimit elektronik.*

Këto po i paraqesim në tabelat përkatëse, të zbërthyera në nënkomponentet e tyre dhe të shoqëruara me nga një shënim apo koment rreth tyre.

KOMPONENTI 1: QEVERISJA QEVERITARE

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Prokurimi publik në Kosovë aktualisht perceptohet nga media, komuniteti apo bizneset si me mungesë të transparencës dhe/apo integritetit.		XX X		
Prokurimi publik është çështje e konsiderueshme politike në Kosovë	X	X		
Ekziston strategjia e qeverisë për modernizimin e prokurimit edhe për miratimin e prokurimit elektronik				
Reformimi i prokurimit në Kosovë kryesisht udhëhiqet nga një axhendë ndërkombëtare (rregullat e OBT-së, rregullat e BE etj.)	XX			
Reformimi i prokurimit është kryesisht axhendë vendore	XX X			
Qëllimi për të miratuar prokurimin elektronik të qeverisë e ka miratimin e kabinetit/presidentit apo të kryeministrit dhe është shpallur publikisht (luteni të bashkëngjisni ndonjë komunikatë për media)				
Qeveria ka caktuar një ministër për të qenë përgjegjës për prokurim dhe reformim të prokurimit	X			
Ekziston një agjenci kryesore për prokurim, e cila ka nivel të lartë të ekspertizës politike, legjislative, teknike dhe menaxheriale të prokurimit	XX			
Agjencia kryesore e prokurimit apo ministria përgjegjëse ka raporte efektive të punës me autoritetet përgjegjëse për teknologji dhe qeverisje elektronike (aty ku ekzistojnë).	X			

Agjencia përgjegjëse për zbatimin e sistemit të prokurimit elektronik të qeverisë është agjencia kryesore e prokurimit.	X			
Agjencia që e udhëheq zbatimin e prokurimit elektronik të qeverisë ka autoritet të qartë për të udhëhequr dhe mandatuar sistemin mbarëqeveritar	X			
Agjencia kryesore e prokurimit (ku ekziston) ka burime adekuate për t'i kryer funksionet e veta				
Agjencia kryesore ka burime për të ofruar zhvillim, zbatim dhe funksionin të një sistemi të prokurimit elektronik.				
Qeveria është duke e përfshirë një varg të palëve publike dhe private të interesit për të mbështetur menaxhimin dhe/apo modernizimin e prokurimit	X			

Nga rezultatet e mësipërme del se media, komuniteti apo bizneset në Kosovë e perceptojnë prokurimin publik me mungesë të transparencës dhe/apo integritetit. Po ashtu mendohet se reformimi i prokurimit udhëhiqet nga një axhendë ndërkombëtare, por ai është kryesisht axhendë vendore. Po ashtu, mendohet se agjencia kryesore për prokurim, ka nivel të të ekspertizës politike, legjislativë, teknike dhe menaxheriale të prokurimit. Ndërsa rezultatet e dhëna për nënkomponentet e tjera janë në vlera të ulta.

KOMPONENTI 2: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Eksiton një agjenci apo funksion përgjegjës për çështjet e menaxhimit të burimeve njerëzore lidhur me prokurimin			X	
Ka ndërlidhje efektive mes sektorëve publikë dhe privatë në Kosovë lidhur me prokurimin e qeverisë		XX X		
Ekziston programi arsimor dhe trajnues për zyrtarët ekzekutivë, menaxherët dhe stafin për prokurim strategjik dhe operacional	X	X		

Trajnimi në dispozicion është hierarkik – për shembull, trajnimi është në dispozicion për prokurimin e thjeshtë të vlerave të ulëta, për prokurimin më të ndërlikuar për vlera të larta dhe prokurimin e ndërlikuar strategjik.				
Trajnimi për prokurim është i akredituar me standarde ndërkombëtare		X X		
Arsimimi dhe trajnimi lidhur me prokurimin e qeverisë është në dispozicion të furnitorëve			X	
Vargu i ekspertizës që kërkohet për të planifikuar dhe zbatuar një plan strategjik për zbatimin e prokurimit elektronik të qeverisë është në dispozicion në qeveri.				
Janë ndërmarrë veprime për t'i shqyrtuar rolet dhe përgjegjësitë e stafit të prokurimit për të siguruar krijimin e një strukture të qëndrueshme të karrierës në mënyrë që çështjet e modernizimit të mund të trajtohen.		X		
Ekziston një strategji menaxheriale për të ndihmuar modernizimin e prokurimit në Kosovë.		X		

Në shtetet që me sukses e kanë miratuar prokurimin e ndërlikuar elektronik të qeverisë, zakonisht ka pasur përpjekje të konsiderueshme qeveritare për të siguruar arsimimin dhe trajnimin e zyrtarëve ekzekutivë, menaxherëve dhe të punonjësve që kanë përgjegjësi në fushën e prokurimit. Arsimimi dhe trajnimi gjithashtu janë siguruar edhe për furnitorët, meqë nga ata kërkohet që t'i miratojnë ndryshimet e bëra. Tabela në vijim i identifikon nënkomponentët që janë përfshirë.

KOMPONENTI 3: PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Koment
Udhëzimet dhe procedurat e qarta të prokurimit janë të dokumentuara mirë dhe lehtësisht të disponueshme për agjencitë qeveritare dhe furnitorët.	X X			

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Koment
Procedurat dhe udhëzimet e prokurimit zbatohen në mënyrë konsistente nëpër agjenci.	X X			
Agjencitë qeveritare apo një agjenci qendrore e vlerëson fizibilitetin dhe rreziqet e ndërlidhura me projektet madhore të prokurimit.				
Proceset e specializuara të prokurimit janë të zhvilluara për mallra të specializuara, blerje të përgjithshme, mallra të zakonshme dhe/apo asete madhore kapitale.		X X		
Dokumente apo shabllone të standardizuara dhe të thjeshtësuara aktualisht janë në dispozicion për t'i ndihmuar procesit të prokurimit.	X X X			
Kontratat lidhur me ofrimin e shërbimeve dhe me cilësinë e produktit/shërbimit janë të menaxhuara dhe të raportuara mirë.		X X		
Të dhënat e konsoliduara të prokurimit rreth përdorimit, trendëve dhe performancës janë në dispozicion për të ndihmuar buxhetimin dhe vendimmarrjen e qeverisë (p.sh. lloji dhe kosto e konsulentëve që përdoren nga secila agjenci qeveritare).		X X		
Kontrollet menaxhuese për monitorimin e përputhshmërisë, korrektësisë, menaxhimit të rrezikut, efikasitetit dhe performancës së procesit të prokurimit në të gjitha agjencitë qeveritare janë themeluar.		X X		
Reformimi i promovimit për të promovuar efikasitet dhe transparencë e ka mbështetjen dhe përfshirjen e sektorëve kyç publikë, biznesit dhe të palëve me interes nga komuniteti.	X X			

Planifikimi dhe menaxhimi i reformimit të prokurimit duhet të bazohet në një vlerësim të qartë të mjedisit aktual të prokurimit dhe t'i përfshijë palët e interesuara që përfaqësojnë funksionet e qeverisë, grupet e furnitorëve dhe organizatat vëzhguese.

KOMPONENTI 4: POLITIKAT

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Entiteti i politikave të prokurimit ekziston dhe është ndikues në dhënien e rekomandimeve/urdhërimeve për ndryshime të politikave të prokurimit				
Një politikë dhe vizion për prokurimin elektronik është miratuar nga qeveria (luteni ta bashkëngjisni)				
Një objektiv i politikave për prokurimin elektronik kërkon në mënyrë formale më shumë transparencë/integritet të prokurimit	X X X			
Një objektiv i politikave për prokurimin elektronik kërkon në mënyrë formale më shumë efikasitet/vlerë për para	X X X			
Një objektiv i politikave për prokurimin elektronik kërkon në mënyrë formale zhvillim ekonomik	, X X			
Politikat e prokurimit aktualisht kanë objektiva të qarta (luteni t'i paraqisni)		X		
Politikat e prokurimit janë të gatshme për dispozicion dhe mbështeten me programe arsimore dhe këshilla të ekspertëve		X		
Sistemet e prokurimit elektronik konsiderohen të jenë të zhvilluara në mënyrën e duhur si module të veçura që mund të ndërlidhen me sistemin e menaxhimit financiar (lini të zbrazët nëse nuk konsiderohen)				
Sistemet e prokurimit elektronik konsiderohen të jenë të zhvilluara në mënyrë të duhur si module brenda sistemit të menaxhimit financiar (lini zbrazët nëse nuk konsiderohen)				
Politikat e prokurimit janë të ndërlidhura me politikat për afarizëm elektronik, qeverisje elektronike dhe strategji të zhvillimit të industrisë.	X X X			

Zhvillimi i politikave jep një drejtim të rëndësishëm për mjedisin e prokurimit dhe për transformimin e tij. Politikat duhet të përfshijnë çështje si vlera për para, konkurrimi i hapur, menaxhimi i rrezikut, biznesi lokal, zhvillimi ekonomik, performanca e prokurimit publik dhe integriteti e etika. Politikat duhet të hartohen edhe për zhvillimin e sistemeve të prokurimit elektronik dhe të ndërlidhjeve të tyre me sistemet e tjera korporative. Qasja në prokurim e udhëhequr nga politikat e jep një orientim të gjerë lidhur me atë se çfarë rezultatesh duhet të arrijë prokurimi qeveritar pa e specifikuar për së tepërmi mënyrën se si arrihen.

KOMPONENTI 5: LEGJISLACIONI DHE RREGULLIMI

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Legjislacioni specifik për prokurimin ekziston për mjedisin aktual të prokurimit.	X X X			
Legjislacioni specifik është shpallur për mbështetjen e kërkesave të prokurimit elektronik (siç është përdorimi i dokumenteve elektronike).				
Metodat specifike të prokurimit janë specifikuar në ligjin, rregulloret apo udhëzimet me përshkrim adekuat të proceseve të prokurimit.	X X			
Legjislacioni specifik ekziston për kornizat e marrëveshjeve, ankandet e anasjelltë dhe ankandet dhe ua mundëson këtyre funksionimin elektronik.			X	
Një apo më shumë agjenci të pavarura (rregullator) ekzistojnë me kompetenca të qarta dhe të zbatueshme për rregullimin dhe monitorimin e politikave, legjislacionit dhe proceseve të prokurimit.	X X X			
Rregullatori apo rregullatorët kanë burime të mjaftueshme për përmbushjen e rolit të tyre.	X	X		
Ekziston një agjenci qendrore me autoritet për mandatimin e instrumenteve mbarëqeveritare, përfshirë dokumentet standarde të ofertimit, sistemet e prokurimit	X X X			

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
elektronik dhe kornizat e marrëveshjeve (luteni ta bashkëngjisni organogramin)				
Qeveria ia ka dhënë një agjencie përgjegjësinë për caktimin e standardeve për operimin shtetëror dhe ndërkombëtar të funksionit të prokurimit (si kodet e artikujve).			X	
Një lloj monitorimi të llogaridhënies zbatohet ndaj agjencive me përgjegjësi të transferuar për prokurim qeveritar.				

Legjislacioni që e parasheh zhvillimin, drejtimin dhe ndryshimin e politikave pa kërkuar ndryshime madhore në legjislacion ka përparësi në trajtimin e çështjeve evoluese në prokurim.

KOMPONENTI 6: INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET E INTERNETIT

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Blerësit dhe furnitorët mundën me lehtësi t'i qasjen shërbimeve të internetit në qytetet e mëdha	X X X			
Janë themeluar rrjete të internetit (ndoshta përmes kioskave apo qendrave të internetit) që mund të shërbejnë përdoruesve rajonalë.	X X			
Rrjeti në dispozicion është i mjaftueshëm për të ofruar shërbime interneti me cilësi dhe shpejtësi të mjaftueshme për të mbështetur prokurimin elektronik	X X			
Qasja në internet është mjaft e volitshme në krahasim me shtetet fqinje	X X			
Shërbimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit janë në dispozicion të përdoruesve të internetit me kosto dhe vonesa kohore të arsyeshme.	X X			

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Ekspertiza e mjaftueshme është në dispozicion të qeverisë dhe të furnitorëve për të mbështetur dhe mirëmbajtur infrastrukturën dhe softuerin dhe harduerin e tyre. (Luteni të bashkëngjisni profilin e ndonjë sektori lokal të biznesit të teknologjisë informative)	X			
Një qendër nacionale e të dhënave me përputhshmëri adekuate me standardet ndërkombëtare është në dispozicion me mbështetje				
Faqja e rimëkëmbjes pas fatkeqësive në përputhje të duhur me standardet ndërkombëtare është në dispozicion me sistem të duhur të mbështetjes.				
Qeveria e ka përcaktuar platformën e saj teknologjike për sistemet operative, bazën e të dhënave dhe për të gjitha aplikacionet e shërbimeve të qeverisjes elektronike (luteni ta specifikoni nëse kjo është tashmë në dispozicion)		X		
Sistemet softuerike tashmë në dispozicion (financiar, burime njerëzore, pagesa, MIS, etj.) mundësohen në mënyrë adekuate me shërbime të internetit për ndërveprim (luteni t'i paraqisni)	X			

Për t'i mbështetur sistemet e prokurimit elektronik, nevojitet ndërlidhja e arsyeshme, disponueshmëria e shërbimeve të rrjetit të internetit, qasja e përdoruesve dhe besueshmëria e rrjetit. Shërbimet duhet të jenë volitshme për përdoruesit. Shpejtësia dhe cilësia e rrjetit duhet të jetë e mjaftueshme për të inkurajuar rritjen e përdorimit të tij. Tregu i qëndrueshëm i harduerit dhe softuerit dhe ekspertiza e mjaftueshme për të mbështetur dhe mirëmbajtur infrastrukturën janë përparësi.

KOMPONENTI 7: STANDARDET

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Qeveria ka caktuar një agjenci me përgjegjësi dhe autoritet për zhvillimin apo mandatin e standardeve teknike.				
Qeveria bashkëpunon me sektorin privat dhe/apo organet e standardeve për caktimin e standardeve.				
Legjislacioni ekzistues është neutral ndaj teknologjisë në vend se të jetë i bazuar në teknologji				
Qeveria e ka mbështetur aplikimin e standardeve të hapura				
Qeveria është duke bashkëpunuar me partnerët e vet ndërkombëtarë tregtarë për arritjen e ndërveprimit				
Standardet e përgjithshme të menaxhimit dhe të procesit janë duke u zbatuar për prokurim (p.sh. Kodi standard i OKB-së për produkte dhe shërbime, CPV apo ndonjë standard tjetër).	X X			
Janë krijuar standardet lidhur me sistemet e prokurimit (sipas rrethanave).				
Korniza qeveritare për ndërveprim tani më ekziston dhe zbatohet në aplikacionet e qeverisë				

Krijimi i standardeve për mbështetjen e shërbimit elektronik është fushë e ndërlikuar dhe zhvilluese. Është e rëndësishme që ekzekutivët dhe menaxherët të kenë mundësi të vlerësojnë dhe të angazhohen lidhur me këto çështje në rast se dëshirojmë menaxhimin e rrezeve të qeverisë. Disa shembuj të zbatimit të standardeve janë (i) standardet e tregut të prokurimit për regjistrat dhe katalogët e furnitorëve, rrjetet e tregut dhe komunitet; (ii) Standardet sistematike të cilësive për besueshmëri, siguri, transportueshmëri, komunikueshmëri dhe menaxhim dhe (iii) Standardet e procesit të prokurimit për dokumentim, kontraktim ligjor, interpretim të legjislacionit rrjedhës së procesit dhe koreografi.

KOMPONENTI 8: INTEGRIMI I SEKTORIT PRIVAT

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Ka nivel të lartë të konsultimeve me biznesin për çështje të prokurimit.		X X		
Ka shoqata të industrisë/biznesit që kanë komunikim të rregullt me qeverinë (cekni ato)		X		
Bizneset /furnitorët nuk janë kundër zhvillimit të biznesit përmes internetit.		X		
Ka shoqatë të industrisë/biznesit të teknologjisë që ka komunikim të rregullt me qeverinë (cekni)				
Informatat dhe këshillat për politikë, rregullat dhe procesin e prokurimit janë falas në dispozicion të sektorit privat.	X X X			
Furnitorëve u jepen informata rreth ofertave të pasuksesshme.	X X X			
Janë themeluar mekanizma të pavarur për ankesa dhe zgjidhje të kontesteve.	X X X			
Kostot për të marrë pjesë në prokurime të qeverisë janë të pranueshme për bizneset e vogla.	X X			
Qeveria është duke ofruar strategji për t'i ndihmuar bizneset për zhvillimin e katalogëve dhe qasjes në infrastrukturën dhe sistemet e saj.				
Disa entitete private tani më kanë përvojë me tregjet ndërkombëtare apo vendore që zhvillohen përmes internetit.	X	X		

Pjesëmarrja e sektorit privat nuk duhet të konsiderohet si e garantuar. Integrimi i sektorit privat mund të arrihet në disa mënyra të ndryshme. Tabela në vijim i identifikon nënkompomentët e përfshirë.

**KOMPONENTI 9: SISTEMET (SISTEMET AKTUALE
TË PROKURIMIT ELEKTRONIK TË QEVERISË – NËSE KA)**

NËNKOMPONENTET	TË GJETURAT			
Niveli në të cilin	o		o	Komente
Sistemi është i bazuar në internet dhe është sistem unik për tërë qeverinë.	X X			
Informatat rreth të gjitha mundësive të prokurimit shpallen në një faqe të vetme të internetit.	X X X			
Trajtimi i mundësive të prokurimit është e domosdoshme për entitet qeveritare	X X X			
Asnjë harduer apo softuer i patentuar nuk kërkohet nga furnitorët për përdorimin e sistemit përveç shfletuesit të internetit dhe qasjes në internet.				
Blerësit dhe furnitorët mund të regjistrohen për biznes përmes internetit.				
Regjistrat e blerësve dhe të furnitorëve janë të lidhur me sistemin.				
Sistemi ka makinë kërkimi/search engine për t'i ndihmuar përdoruesit në gjetjen e informatave.	X X X			
Legjislacioni, politikat dhe udhëzimet e prokurimit, si dhe informatat për përdorimin e sistemit mund të gjenden në internet.	X X			
Ka qasje të hapur në të gjitha dokumentet ofertuese dhe në dokumentet e proceseve të tjera.				
Shkarkimi elektronik e dokumenteve ofertuese është në dispozicion.			X	
Bartja elektronike e dokumenteve propozuese të furnitorit është në dispozicion			X	
Sistemi e mbron sigurinë dhe privatësinë e informatave.				
Standardet e përgjithshme të ndërveprimit dhe të prokurimit zbatohen në të gjitha sistemet.				

Zhvillimet e reja kanë nevojë që t'i njohin iniciativat ekzistuese për themelimin e sistemeve të prokurimit elektronik. Këto mund por edhe mund të mos jenë të lidhura me një strategji të përgjithshme për prokurimin elektronik të qeverisë. Megjithatë, nënkomponentet e paraqitura do të mund të përdoren si udhëzim për të parë sesi mund të integrohen këto sisteme në një strategji të përgjithshme të prokurimit elektronik të qeverisë.

5.3 Infrastruktura teknologjike e sistemit të e-Prokurimit

Kosova ka infrastrukturën e duhur teknologjike për prokurimin elektronik dhe shërbimin e internetit, që mbulon pothuajse të gjitha zonat e vendit dhe pushtetin vendor. Edhe rrjeti qeveritar është i pajisur mirë me kapacitete të caktuara të ruajtjes dhe të nxjerrjes së informatave. Po ashtu, janë në vazhdim e sipër investime të mëtejme në qendrën e të dhënave. Ministria e Administratës Publike ofron udhëzime lidhur me standardet e ndërveprueshmërisë dhe me menaxhimin e rrezikut në fushën e zhvillimit të aplikacioneve. Qendra ekzistuese e të dhënave duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme për prokurimin elektronik. Kjo vlerësohet përmes specifikimeve të sistemit, të dhëna në kuadër të këtij projekti. Në shumë vende prokurimi elektronik funksionon me mbulueshmëri dhe shpejtësi të ulët të internetit. Aplikacionet janë të parapara të funksionojnë edhe me telefona mobilë apo edhe në internet-kafe.

Elementet e infrastrukturës elektronike zbërthehen në komponente, si:

Një apo më shumë *servera*, ku përpunohen dhe ruhen shumica e të dhënave;
Rrjeti, i cili mundëson komunikimin mes klientit dhe serverit.

Harduer, softuer, qendra e të dhënave, qendrën për rimëkëmbje në rast katastrofe procese, procedura etj., për të garantuar sigurinë e tyre dhe disponueshmërinë e pandërprerë të sistemit.

Hardueri përfshin:

- ✚ Njësinë qendrore të përpunimit;
- ✚ Pajisjet për ruajtje;
- ✚ Pajisjet hyrëse (tastierë, portet serike, mausin etj.);
- ✚ Pajisjet dalëse (monitorë, printerë etj.);
- ✚ Kabllot

Softueri

Operon në sistem dhe përbëhet nga:

Firmware, që gjendet në harduer (BIOS) dhe mundëson komunikimin me sistemin operativ;

Sistemet operative Windows, Linux etj;

Programet, që përdoren nga administratorët apo personeli i mirëmbajtjes për kryerjen e kontrolleve dhe trajtimin e të dhënave;

Aplikacionet që kryejnë detyra apo operacione specifike varësisht nga përdoruesi;

Programe Middleware, që mbështesin komunikimin apo këmbimin e të dhënave.

Për operimin e sistemit nevojiten rryma.

Ai përfshin disa procese, si: fillimi i sistemit; menaxhimi dhe operimi i rrjetit; monitorimi i sistemit; ruajtja dhe arkivimi; menaxhimi i përdoruesit, siguria dhe mbyllja e sistemit.

3.5 Hardwarei dhe software-i

Paralelisht me përmirësimin e teknologjisë dhe zgjerimin e qeverisjes elektronike duhet të ketë qasje për çështjet e harduerit dhe të softuerit përmes ndryshimeve të nevojshme të ligjeve dhe investimit në teknologjitë e reja të harduerit dhe të softuerit.

Platformat ekzistuese do të përmirësohen, zgjerohen, kapaciteti i harduerit do të shtohet dhe platformat e reja do të zbatohen me qëllim të arritjes së një qeverisjeje elektronike të suksesshme.

Softueri ka Arkitekturën e Orientuar drejt Shërbimit (AOSH) dhe shërbimet e rrjetit të internetit (i mbështetur nga protokollet siç janë XML, SOAP, WSDL, WDDX, dhe UDDI); Web 2.0 me qëllim ofrimin e ndërveprueshmërisë dhe përkrahjes.

Teknologjia që do të përdoret në të ardhmen kryesisht do të përqendrohet në hapësirën kibernetike.

Gjithashtu, do të bëhen përpjekje për marrjen e licensave të softuerit; do të bëhen investime të nevojshme dhe do të zbatohen aplikacionet, me qëllim krijimin e një sistemi funksional të qeverisjes elektronike.

Karakteristike për këtë është shfrytëzimi i përbashkët i adresave të punës mes zyrtarëve në faqet e internetit, siç janë: hotmail/gmail/yahoo. MAP 'inkurajon' zhvillimin e aplikacioneve dhe përputhjen e tyre me Arkitekturën e Orientuar në Shërbime (AOSH), që çdo entitet të ketë pronësinë ndaj kodit.

Qendra e të dhënave

Qendra e të dhënave ofron sigurinë e tyre, besueshmërinë, shërbimin dhe menaxhimin e rrezikut. Ajo ka një rrjet të dedikuar, servera të aplikacionit dhe të bazës së të dhënave, si dhe servera të tjerë mbështetës (siç është serveri për ruajtjen e regjistrave, kontrollorët e domenit dhe serveri për shënimin e kohës). Për kërkesat e disponueshmërisë së lartë të sistemit, serverat përdoren në çift dhe konfigurohen për mbështetje në rast dështimi. Mjaftueshmëria e lidhjes së internetit është shumë e dëshirueshme për disponueshmëri të pandërprerë të sistemit të prokurimit elektronik.

Faqja për Rimëkëmbje

Faqja për Rimëkëmbje në rast Rreziku (FRRr) përfshin lidhje të pandërprerë të internetit dhe furnizim shtesë me energji elektrike. Në rast të fatkeqësive, kryhet procesi i rimëkëmbjes, që është reagim ndaj fatkeqësisë së shpallur. Kjo nënkupton restaurimin apo rimarrjen e një aplikacioni apo sistemi të tërë dhe kthimi i tij në normalitet. Procesi i rimëkëmbjes, po bëhet i zakonshëm në entitete të ndryshme, pasi pajisjet, sistemet dhe rrjetet po bëhen më të ndërlikuara, pësojnë çrregullime. Kjo situatë dikton që duhen parashikuar dhe miratuar planet për rimëkëmbje, që të sigurohet vazhdimësia e punës.

Platforma e prokurimit elektronik mund të qëndrojë më vete apo të bashkëvendoset në mjedisin pranues të një qendre ekzistuese të të dhënave, me harduer, softuer, brez frekuencor adekuat të lidhjeve të internetit, me proces të menaxhimit dhe aftësi menaxheriale shtesë. Sistemi duhet të ketë mjaft mundësi për sigurimin e ruajtjes/mbështetjes shtesë në çdo kohë. Krijimi i një qendre mbështetëse për prokurim elektronik është i dobishëm dhe i nevojshëm.

Lidhja e internetit

Brez frekuencor i internetit duhet të jetë adekuat, si dhe i qasshëm 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë, për t'u siguruar qasje përdoruesve në sistemin e prokurimit elektronik. Në përgjithësi, bizneset dhe qeveria kanë qasje të mirë në shërbimet e

internetit. Por kujdes duhet treguar për komunat, në të cilat konstatohen ndërprerje të lidhjeve të internetit, shpejtësi e vogël e tij etj.

5.4 Performanca dhe përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik

Një sistem përmes të cilit mund të trajtohet dhe të reagohet shpejt ndaj çfarëdo kërkesë të përdoruesit, jo vetëm që mund t'i përshpejtojë aktivitetet e prokurimit elektronik, por edhe mund t'u ndihmojë përdoruesve kuptim më të mirë të funksioneve të ndryshme që ofron sistemi. Zakonisht, mund të ketë aktivitet që pashmangshmërisht mund të kërkojnë më shumë kohë (p.sh. shkarkimi i dokumenteve). Në raste të tilla, zbatuesit e sistemit duhet të sigurohen që përdoruesit të jenë të informuar rreth statusit të kërkesave të tyre, duke mënjeluar, kështu, anulimin e aktiviteteve nga përdoruesit apo pasiguritë e statusit të veprimeve të tyre.

Kushtet e performancës për prokurim elektronik varen nga numri i prituri i përdoruesve dhe i ofertave. Zbatuesit e sistemit duhet të planifikojnë shkallëshmërinë e softuerit/harduerit, si dhe të krijojnë sisteme, përmes së cilave mund të arrihen objektivat e performancës, të caktuara paraprakisht.

Koha e reagimit për testimin e performancës së prokurimit elektronik duhet të matet në një bazë të dhënash, e cila ka sasi të konsiderueshme të dhënash, përmes simulimit të performancës në kushte reale. Ndërsa shfrytëzimi real i sistemit duhet të simulohet, duke përfshirë bartjet dhe shkarkimet e të dhënave mbështetëse.

Për të përcaktuar nëse kërkesat institucionale janë përmbushur dhe janë të vlefshme, është e rëndësishme që të kryhet testimi i duhur i sistemit të implementuar, për t'u siguruar se i plotëson kërkesat e përdoruesit. Përdorimi i sistemit reduktohet, në qoftë se përfitimet e pritura nuk realizohen.

Vlerësimi i performancës së sistemit i shërben shumë blerësit, i cili, edhe me ndihmën e ofertuesit kryen disa teste të sistemit dhe të nënsistemeve për të përcaktuar nëse i përmbushin të gjitha kërkesat e mandatuara për pranim operacional.

- Testimi i njësive - vërteton se secili modul individual i sistemit të e-Prokurimit është duke funksionuar siç duhet;

- Testimi i funksional - vërteton se kërkesat e detyrueshme funksionale të sistemit të ofruar funksionojnë si duhet. Është e nevojshme që sistemi i ofruar të përputhet me specifikimet.

- Testimi i integritetit - vërteton se pjesët e kombinuara ose modulet e sistemit të e-Prokurimit janë duke funksionuar si duhet

- Testimi i vëllimit - vërteton se çdo vlerë që mund të rritet me kalimin e kohës, mund të akomodohet nga programi dhe nuk do të bëjë që sistemi të ndalojë punën ose në ndonjë mënyrë të degradojë operacionin

- Testimi i performancës - vërteton se sistemi i plotë operon në përputhje me kërkesat e biznesit;

Performanca e sistemit shihet edhe përmes kohës mesatare të dështimeve të pjesëve të ndryshme të sistemit, thënë ndryshe nga shkalla e disponueshmërisë. Rastet e defekteve varen nga shpeshtësia e ndodhjes së veprimeve të papritura. Prandaj del nevoja e matjes së kohës mesatare të dështimeve, e cila ndihmon për të identifikuar

se sa gjatë do të operojë sistemi në vite, sa kohë duhet për riparim, për kryerjen e mirëmbajtjes etj., pra, sa është disponueshmëria e sistemit, e cila është një tregues shumë i rëndësishme i sigurtisë dhe për operimin e pandërprerë të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik.

Ajo matet në mënyrë sasiore dhe në intervale kohore të rregullta. Një llogaritje indikative për matjen sasiore të disponueshmërisë është:

Sasia e orëve në një muaj që sistemi duhet të jetë i disponueshëm:

24 orë në ditë x 7 ditë x 4.33 javë në muaj (mesatarisht) = 720 orë/muaj.

Orët në muaj që sistemi ka qenë jashtë funksionit: 5 orë, për shkak të mirëmbajtjes riparuese (p.sh. rregullimi i defektit të softuerit), 3 orë, për shkak të mirëmbajtjes përsosëse (p.sh. përmirësimi i harduerit), 1 orë, për shkak të dështimit të hard diskut, gjithsej 9 orë të padisponueshmërisë.

Disponueshmëria neto: $((720 - 9)/720) * 100\% = 98.75\%$

Disponueshmëria e lartë: Nga 9 orë ndërprerje, 3 orë ishin për shkak të veprimtarive të mirëmbajtjes dhe vetëm 6 orë (5+1) ishin për shkak të defekteve. Prandaj, disponueshmëria e lartë është $((720-6)/720)*100\% = 99.16\%$. Disponueshmëria e klasës funksionale shpesh është pesë nëntëshe – 99.999%.

Për matjen e performancës së sistemit, zakonisht, përdoren këto përkufizime:

Kërkesë e thjeshtë: kërkesë për vlerësimin e një table të vetme të bazës së të dhënave apo të një kombinimi prej dy tabelave;

Kërkesë e ndërlikuar: kombinim i tri apo më shumë tabelave të bazës së të dhënave;

Raport: raport i gatshëm për t'u shtypur, i prodhuar nga gjenerimi PDF në server, lidhja e mjetit të raportuar apo e ndonjë teknologjie tjetër;

Menaxhimi i dokumentit: bartja, shkarkimi dhe hapja e dokumentit në bibliotekën e dokumenteve të sistemit në vendin e punës së klientit apo nga ajo;

Përdorues aktiv: përdoruesi i aplikacionit, që, në mënyrë konstante, kryen operacione të zakonshme;

Koha e reagimit: periudha kohore nga momenti kur përdoruesi inicon një veprim (p.sh. duke shtypur mbi ndonjë buton apo lidhje/link) deri në momentin kur faqja e internetit me informatat e kërkuara apo porosia për konfirmim e azhurnim zhbartet plotësisht dhe shfaqet në ekranin e përdoruesit. Kohët e reagimit mund të preken nga gjendja latente e internetit; ndaj koha e reagimit, zakonisht, testohet në mjedisin e rrjetit të zonës lokale (LAN).

Disa shembuj të synimeve të performancës mund të jenë:

Së paku 50 përdorues aktivë të njëkohshëm, me kohë maksimale të reagimit;

Deri në 200 përdorues aktivë të njëkohshëm me 10% ngritje të kohës maksimale të reagimit;

Koha maksimale e reagimit që kthen deri në 200 rreshta të rezultateve është X. Për çdo 100 rezultate shtesë, koha maksimale e reagimit mund të ngritet për deri në X sekonda.

Kohët e reagimit për testimin e performancës të një prokurimi elektronik duhet të matet në një bazë të dhënash, e cila, paraprakisht, ka ngarkuar një sasi të konsiderueshme të të dhënave, duke simuluar performacën e sistemit në kushte reale.

Përveç kësaj, përdorimi i vërtetë i sistemit do të duhet të simulohet duke i përfshirë ngarkimet dhe shkarkimet e njërësive të të dhënave.

Qasjet që ulin rreziqet e ndërprerjes së sistemit janë të ndërlidhura me komponentet kritike të sistemit. Këto rreziqe evitohen nga:

- ✚ Ulja e shpeshtësisë së mosfunksionimit të sistemit përmes kërimit të mënyrave për parandalimin e ndërprerjes së disa komponentëve kritikë;

- ✚ Minimizimi i kohëzgjatjes së mosfunksionimit të sistemit përmes përpjekjeve për parandalimin e ndërprerjes së komponentëve kritikë dhe uljes së numrit të komponentëve kritikë që mund të preken nga ndonjë ndërprerje;

- ✚ Ulja e numrit të pjesëve të sistemit që kanë mundësi të preken nga ndonjë ndërprerje.

Menaxhimi i defekteve dhe siguria e sistemit janë më shumë se çështje teknike. Sistemet dhe menaxhimi i prokurimit elektronik duhet të administrohen në kuadër të një kornize të duhur të qeverisjes me qëllim krijimin e sigurisë. Ky proces nuk kërkon vetëm ekzistimin e instrumenteve të sigurisë (mburojat/firewalls, kriptimi/encryption, mbylljet kohore/time locks), por edhe sigurinë e menaxhimit të sistemit. Me këtë rast zbatohen standardet dhe metodologjitë ndërkombëtare të auditimit të rrezikut IS, siç janë ato që janë publikuar nga Shoqata për auditimin dhe kontrollin e sistemeve të informimit (ISACA), të cilat ndërlidhen me konceptet dhe qasjet e përgjithshme të organizatës për menaxhimin e rrezikut, siç janë COSO ERM, ARMS dhe ISO 31000. Sistemi duhet të auditohet rregullisht në bazë të këtyre standardeve ndërkombëtare. Në rastet kur sistemet ofrohen nga ndonjë burim i jashtëm, për shembull, shërbimi Cloud, atëherë ngrihen çështjet e transparencës së kontroleve – kushteve në Marrëveshjen për Nivelin e Shërbimit (MNSH), (ISACA,2011) të cilat janë kryesoret për menaxhimin e rreziqeve nga ofruesit e jashtëm dhe duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e rrezikut. Çështjet e tjera kanë të bëjnë me përkrahjen, besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e softuerit dhe harduerit.

Por përveç sigurimit të sistemeve sa më të besueshme, nevojiten edhe mekanizma për menaxhimin e çrregullimeve të mundshme të sistemit përmes planeve për rimëkëmbjen e tij. Këto duhen përfshirë në planin e menaxhimit të rrezikut, që trajton parimet komerciale të vërtetimeve, të autorizimeve, të besueshmërisë, të integritetit së bashku me çështjen e mbrojtjes nga viruset dhe nga kërcënimet e tjera ndaj sigurisë.

5.5 Metodat e prokurimit

Teknologjia elektronike i hap rrugë zbatimit efikas të metodave të ndryshme të prokurimit, siç janë ankandet elektronike, tregjet elektronike dhe marrëveshjet kornizë elektronike. Përdorimi i këtyre metodave lehtësohet me futjen e kartelave elektronike efikase për blerje, me qasjen efikase dhe me kosto të ulët në informatat menaxheriale në prokurimin elektronik, si dhe me fuqizimin e kontrollit, mbikëqyrjes, konkurrimit, efikasitetit, të kapaciteteve planifikuese etj.

Në figurën 3 paraqiten nga aspekti i ‘analizës së shpenzimeve’ aplikacionet e zakonshme të prokurimit, lidhur ngushtë me metodat që përdoren në prokurimin elektronik. Kuadrati i parë (mallrat e thjeshta me vlerë të ulët) mund të përkrahen përmes blerjes me katalogë elektronikë, dhe përmes përdorimit të marrëveshjeve kornizë, gjë e cila ndihmon në konstruktimin e performancës së furnitorit. Në këtë rast, prokurimi i thjeshtë dhe me vlerë të ulët (siç është letra për fotokopjim) specifikohet në katalog, ndërsa çmimet e furnitorit dhe disponueshmëria shihen në internet dhe vlera më e mirë i paraqitet blerësit.




Figura 3 Aplikacionet e prokurimit elektronik

Kuadrati i dytë (vlera e thjeshtë, e lartë) mund të përkrahet përmes ankandeve elektronike të anasjelltë dhe, si alternativë, mund të përdoren edhe marrëveshjet kornizë, varësisht nga natyra e tregjeve, nga niveli i konkurrencës dhe nga koha e qarkullimit e kërkuar nga blerësit.

Kuadrati i katërt, jep funksionalitetin e prokurimit elektronik, i cili kontribuon në mënyrë domethënëse në bashkëpunimin parakontraktual dhe në menaxhimin e kontratave.

5.5.1 Menaxhimi i marrëveshjes kornizë

Dy shtyllat e prokurimit publik elektronik në vendet e praktikave më të mira janë tenderimi elektronik dhe të gjitha llojet e marrëveshjeve elektronike kornizë. Metodot e tjera gjithashtu mund të përkrahen, por këto dy metoda duhet të përfshijnë pjesën më të madhe të transaksioneve.

Marrëveshjet kornizë elektronike janë metoda më efikase për të qasur dhe drejtuar sa të jetë e mundur decentralizimin e prokurimit. Në parim, këto marrëveshje janë më të preferueshme, në krahasim me ankandet, ku blerësi jep çmimin.

Marrëveshjet kornizës përdoren me efikasitet në shumë shtete, duke u përqendruar në ekonomizimet e procesit dhe për të fituar më shumë vlerë nga çmimet më të ulëta.

Marrëveshjet kornizë aplikohen në çdo fushë të prokurimit – për mallrat e përdorimit të zakonshëm; për shërbimet, përfshirë konsulencat, mirëmbajtjen dhe punësimin. Marrëveshjet kornizë për punët e mëdha dhe të vogla janë të parapara shprehimisht në Direktivat e Komisionit Europian (KE) dhe janë rregulluar nga Zyra e Mbretërisë së Bashkuar për çështjet komerciale qeveritare (OGC, 2008). Zakonisht, marrëveshjet kornizë gjenden në internet dhe mbulojnë shumicën e prokurimit qeveritar të thjeshtë dhe me vlera të ulëta.

Agjencitë qeveritare shpesh ballafaqohen me vështirësi të prokurimit, të cilat nuk janë plotësisht të identifikuar në kuadër të rregulloreve apo udhëzimeve të prokurimit. Për shembull, disa kontrata duhet të vlejnë disa vite, ndërsa buxhetet janë vjetore, shpesh ka mungesë kronike të punonjësve të trajnuar, dorëzimi i mallrave, punës a shërbimeve shpesh nuk është i parashikueshëm, etj. Planifikimi më i mirë i prokurimit është vetëm zgjidhje e pjesshme për këto situata që shfaqen në jetën e përditshme.

Marrëveshjet kornizës janë posaçërisht të dobishme në shtetet, siç janë: SHBA, Britania, Portugalia, Singapori dhe Australia. Këto instrumente janë të zakonshme edhe për organizata e sektorit privat dhe OJQ-të.

Objektivat e marrëveshjeve kornizë janë trajtimi i secilës prej këtyre çështjeve, por fokusi dallon në shtete të ndryshme. Në Europë dhe në Amerikën e Jugut, marrëveshjet kornizë, në mes të tjerash, hartohen për të fituar më shumë vlerë për para nga çmimet më të ulëta që rrjedhin nga efektet e ekonomisë së shkallës që rrjedhin nga blerja e grumbulluar. Në Azinë jugore renditja e kontratave në shërbimet shëndetësore gjithashtu nxiten nga akumulimi, por shpesh më shumë janë të përqendruara në ekonomizimet e procesit dhe në kufizimet e kapaciteteve, ku nganjëherë kanë rezultuar me çmime më të larta.

Përparësitë e metodës së marrëveshjeve kornizë janë të mëdha, sidomos kur ka porosi të shpeshta, duke u bazuar në specifikacionet e njëjta apo të ngjashme; kur furnizimi kërkohet për një periudhë më të gjatë. Nën këto marrëveshje mundësohen përcjellja e kontraktorëve, furnitorëve, përcjellja e bilancit të furnizimeve apo e dërgesave nga secili furnitor/kontraktor. Ajo bën të mundur përfshirjen e kontraktorëve/furnitorëve të rinj, përmes procesit të rregullt, duke u dhënë mundësinë lojtarëve të ri në treg dhe për të mbajtur të papenguara furnizimet.

Sistemi i siguron menaxherit të kontratës tabelën e aparaturave që bëjnë shqyrtimin krahasues të statusit të marrëveshjes dhe të furnizimeve. Gjithashtu, ai lidhet me modulën e pagesave për të parë statusin e secilës marrëveshje kornizë sipas kushteve të pagesës, vlefshmërisë, shpërndarjes/furnizimit, sipas furnitorit, lokacionit/rajonit dhe artikullit.

Zhvillimi dhe menaxhimi i marrëveshjeve kornizë duhet të jetë themeli i roleve të reja të CPA. Përmes këtyre marrëveshjeve kontrollohen shumica e transaksioneve të prokurimit në qeveri. KRRPP-ja duhet ta bëjë të obligueshëm përdorimin e tyre, sa herë që ato janë në dispozicion.

Menaxhimi i të gjitha marrëveshjeve kornizë të qeverisë kërkon monitorim dhe raportim të standardizuar, në format analitik, lidhur me shpenzimet; departamentet japin informata për zhvillimin strategjik të prokurimit; për shqyrtimin e efektshmërisë dhe përputhshmërisë së programit; të shpenzimeve, kursimeve potenciale dhe të niveleve të tregtisë ndërkufitare.

Auditimi i aktivitetit të prokurimit kërkon qasje me kohë në informata nga transaksionet e shumta të vlerave të ulëta dhe të shpërndara gjerësisht. Qasja në të dhënat e sakta dhe gjithëpërfshirëse të shpenzimeve ofron informata lidhur me trendet e shpenzimeve, të inventarizimit, të performancës dhe të përputhshmërisë. Këto informata mund të ndihmojnë me identifikimin e mundësive të efikasitetit dhe të tregut.

Theksojmë këtu se LPP i Kosovës, aktualisht, pengon ndryshimet e kontratës, gjë që ka krijuar mendimin se ai pengon edhe ndryshimet e marrëveshjeve kornizë. Por këto të fundit nuk janë kontrata, ndaj edhe mund të ndryshohen. Gjithashtu, gjykojmë se duhet lejuar ndërprerja e këtij lloji marrëveshjeje në rastet kur agjencitë blerëse dhe furnitorë/kontraktorë janë në procesin e ndërprerjes.

Probleme që kërkojnë zgjidhje këtu janë disa mangësi. Për shembull, nuk mund të parashikohen vëllimi i kërkuar apo datat e dërgesës apo të ofrimit. Nuk ka siguri buxhetore dhe njësitë e pavarura të blerjes brenda një ministrie apo mes ministrive të ndryshme, mund të dublifikojnë përpjekjet e njëra-tjetrës dhe blejnë mallra, shërbime apo punë të njëjta. Grumbullimi i kërkesës nga njësitë e blerjes mund të rezultojë me zbritje të theksuara çmimesh, në bazë të sasisë dhe njësitë e vogla blerëse nuk kanë kapacitete për rregullimin dhe menaxhimin e kontratave të tyre. Rastet e krizës (siç janë katastrofat natyrore) nuk japin kohën e nevojshme për realizimin e procesit të rregullt. Po ashtu, asnjë furnitor i vetëm nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat, ndaj dhe kërkohet një zgjedhje e mirë e furnitorëve për të minimizuar rrezikun e mospasjes së sasive të nevojshme për furnizim.

Probleme të tilla obligojnë strukturat përgjegjëse që të marrin masat e duhura që në përgatitjen e procesit, për t'i minimizuar sa më shumë ato.

5.5.2 Ankandi elektronik dhe ankandi i anasjelltë

Metoda e ankandëve elektronike, ku shitësi jep çmimin, përdoret për prokurimin e mallrave me specifikime të thjeshta dhe të mirëpërcaktuara, për të cilat nuk janë të rëndësishme konsideratat e tjera, përveç çmimit. Funkcionaliteti i ankandit përdoret edhe për shitjen e aseteve apo të tepricës nga entitete qeveritare ose për dhënien e licensave a lejeve përmes internetit dhe në kohë reale. Ky modul lehtëson grumbullimin e aseteve për heqje.

Edhe në ankandet elektronike të anasjellta konkurrenca për çmime bëhet në internet, në mënyrë dinamike. Ndërmarrjet e sektorit publik, që blejnë sasi të mëdha mallrash apo shërbimesh të standardizuara kanë më shumë prirje jo vetëm për marrëveshjet kornizë, por edhe për ankande elektronike dhe ankande elektronike të

anasjellta. Këto të fundit nuk dallojnë nga proceset e tjera të negocimit, përveç faktit që, përmes teknologjisë, mund të sigurojnë neutralitetin dhe drejtësinë.

Duhet thënë se krijimi i pakove për ankand lehtësohet shumë nga sistemi i prokurimit elektronik. Informatat e ankandit, zakonisht, përfshijnë numrin e pjesës (lot), sasinë, çmimin fillestar, rregullat e ankandit dhe periudhën e ankandit. Sistemi krijon mundësinë për të ftuar ofertuesit dhe ofertat në ankand; lejon ofertimin e autorizuar, nëse dokumenti i ankandit e ka këtë opsion. Gjithashtu, përmes përgatitjes së artikujve të ankandit, bëhet i mundur importimi dhe plotësimi i bazës së të dhënave të ankandit.

Ankandi elektronik zhvillohet në kohë reale. Si administruesi i ankandit, edhe ofertuesit pjesëmarrës njoftohen për kohën e mbetur për mbylljen e ankandit deri në sekondën e fundit.

Theksojmë se kjo metodë, në të shumtën e rasteve nuk është e përshtatshme për prokurime të mëdha strategjike apo teknike, as për prokurimet e vogla të përditshme dhe në tregjet ku rreziku i marrëveshjeve paraprake mes furnitorëve është i madh, për shkak të konkurrencës së pamjaftueshme. Por, zakonisht, qeveritë nuk e pranojnë këtë konstatim.

Nga ana tjetër, edhe në këtë metodë, ashtu si në metodat e tjera, ekziston dobësia ndaj marrëveshjeve paraprake mes furnitorëve. Kushti kryesor edhe në përdorimin e kësaj metode është që të ketë konkurrencë të mirëfilltë në treg.

5.6 Ndikimi i prokurimit elektronik dhe përfitimet prej tij

Sipas planit udhëzues, qëllimi kryesor i sistemit të prokurimit elektronik, është që ai të ndikojë pozitivisht dhe fuqimisht nën drejtime të tilla, si:

- + Rritja e aftësive vendimmarrëse të zyrtarëve të prokurimit, duke siguruar informacion kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës të prokurimit;
- + Përmirësimi i transparencës në procedurat dhe në praktikat e prokurimit;
- + Përmirësimi i planifikimit financiar dhe buxhetimit;
- + Efikasitet në të gjithë procesin e prokurimit dhe minimizimi i kohës së ciklit të prokurimit;
- + Nxitja dhe inkurajimi i pjesëmarrjes dhe promovimi i konkurrencës ndërmjet furnizuesve;
- + Shfrytëzimi i ekonomisë së shkallës nëpërmjet grumbullimit të kërkesës dhe maksimizimi i vlerës së parasë në prokurimin qeveritar;
- + Rritja e besimit të bizneseve dhe të qytetarëve në procesin e prokurimit qeveritar dhe në përdorimin e fondeve publike;
- + Optimizimi i niveleve të inventarit përmes adoptimit të praktikave efikase të prokurimit;
- + Sigurimi i konfidencialitetit, integritetit dhe vërtetësisë së të gjitha transaksioneve dhe të dhënave ndërmjet entiteteve të prokurimit dhe furnizuesve;

✚ Përmirësimi i niveleve të shërbimit për të gjitha palët e përfshira në prokurimin qeveritar etj.

Përvoja ndërkombëtare, por edhe përvoja e deritanishme në Kosovë kanë dëshmuar se me prokurimin elektronik këto synime bëhen realitet dhe ky impakt pozitiv i këtij sistemi është një argument më shumë për domosdoshmërinë e implementimit sa më të gjerë në Kosovë.

Nga vëzhgimet e bëra, rezulton se në sajë të sistemit elektronik është rritur efektiviteti i procedurave të prokurimit, vonesat janë reduktuar në minimum, ndërsa procedurat kryhen në një kohë të shkurtër. Krahasuar me procedurat e prokurimit në letër, komunikimi midis AK-ve dhe OE-ve është shumë më i shpejtë. Konkurrenca e ndershme në procedurat e prokurimit është tashmë e rritur dukshëm edhe ngaqë ofertuesit e mundshëm nuk e njohin njëri-tjetrin paraprakisht, sepse pjesëmarrja në një procedurë të caktuar është anonime deri në ditën e hapjes së ofertave. OE-të nuk kanë asnjë mënyrë për të gjetur, nëpërmjet kanaleve zyrtare, informacion në lidhje me ofertuesit e tjerë të mundshëm. Në të njëjtën kohë, anëtarët e Komisioneve të Verifikimit të Ofertave shprehen se ndërhyrjet jozyrtare dhe influencat informale nga ofertuesit potencialë nuk përbëjnë më shqetësim për ta, pasi deri para ditës së hapjes së zarfeve, askush nuk ka informacion për ofertat që janë paraqitur. Sistemi i Prokurimit Elektronik nuk lë vend për përjashtime apo lëshime në këtë drejtim.

Përfitime të ndjeshme nga prokurimit elektronik janë rritja e transparencës dhe e efikasitetit; koha më e shkurtër e procesit të prokurimit; qasje më e mirë në mundësitë për prokurim përmes një portali të vetëm shtetëror; paksimi i gabimeve gjatë procesit dhe në dokumentacionin e blerësve; më shumë qasje në treg; kursimet e fondeve publike dhe ulje e kostove të prokurimit.

Shumë përparësi të tjera përforcojnë argumentet në favor të prokurimit elektronik. Të tilla janë ekonomizimi i transaksioneve, standardizimi i praktikave të prokurimit dhe zvogëlimet e çmimeve; automatizimi i shumë proceseve të prokurimit, përfshi përzgjedhjen e furnitorëve për disa lloje prokurimi, shtimi i mundësive për përdorimin e metodologjive të reja ekonomizuese të prokurimit, përmes të cilave mund të rriten qasja në treg dhe konkurrenca, si dhe të decentralizohet një pjesë e madhe e prokurimit deri te pika e ofrimit të shërbimit në qeveri (siç janë shkollat etj.). Automatizimi i ciklit prej porosisë deri te pagesa ka rezultuar në ulje të përpunimit manual të detyrave procedurale që janë të prira për gabime, duke i lejuar stafit që të përqendrohet në aktivitete më produktive.

Prej përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik ka edhe shumë përfitime ekonomike dhe financiare. Këtu ndihmon shumë interneti, i cili mundëson realizimin dhe zhvillimin e programit të e-Prokurimit. Vështuar në planin financiar, përdorimi i prokurimit elektronik të rezulton me kurse domethënëse, përmes ofrimit të dukshmërisë më të lartë dhe lehtësisë së qasjes në tregun qeveritar. OECD parashikonte që si rezultat i zbatimit të kornizës së prokurimit elektronik kursimet të arrijnë 5-8% të vlerës së prokurimit (www.oecd.org). Kur kjo kombinohet me informatat bashkërenduese dhe menaxheriale të prokurimit dhe me kontrollin që lehtësohet nga prokurimi elektronik, kostot janë raportuar të bien mes 5% dhe 20%. Duke pasur parasysh madhësinë e vlerave në procesin e prokurimeve publike,

vlerësimet e kursimeve janë shumë të mëdha në krahasim me koston e zbatimit të prokurimit elektronik.

Në shifra, raportohen këto përparësi:

- ✚ Ulje prej 80% e vlerës së inventarit;
- ✚ Ulje në blerjet pa kontratë me furnitorë – përmirësim prej 30% në përputhshmëri;
- ✚ Ulje të gabimeve për shkak të eliminimit të proceseve manuale;
- ✚ Ulje prej 90% e proceseve prej blerjes në pagesë;
- ✚ Ulje deri në 80% të kohës së ciklit të prokurimit;

Potenciali i prokurimit elektronik sjell raporte të përmirësuara me furnitorët, të cilët përfitojnë nga kostot më të ulëta të transaksioneve dhe kanë pasur efikasitet; përmirësimin e kapaciteteve analitike dhe të kontrollit të menaxhimit, fuqizimin e qeverisjes së prokurimit përmes shtimit të transparencës dhe qasjes në informatat menaxheriale dhe të auditimit.

Shumë prej përfitimeve të prokurimit elektronik janë baras të vlefshme, si për qeverinë, ashtu edhe për sektorin e biznesit. Rritje të efikasitetit kanë institucionet publike, po ashtu edhe sektori privat, i cili nga vlera e prokurimit elektronik përfiton qasje në treg, lehtësi për të ofertuar, transferta të dokumenteve, transaksione, marrjen e informatat rreth tregut etj.

Ndërmarrjet e sektorit publik e kanë përmirësuar performancën e tyre si rezultat i iniciativave të prokurimit elektronik me kosto më të ulëta të transaksioneve, shpenzime më të ulëta për blerje pa kontratë me furnitorë dhe kohë më të shkurtra për ciklin e transaksioneve. Nëpërmjet prokurimit elektronik përdoruesit kryejnë me lehtësi të gjitha fazat e procesit të prokurimit, përfshirë regjistrimin e centralizuar të operatorëve ekonomikë, të autoriteteve kontraktuese; tenderimin elektronik (nga planifikimi i prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës); marrëveshjet elektronike kornizë; ankandet elektronike; ankandet e kthyeshme elektronike; sistemin e menaxhimit të kontratës; përdorimin dhe ndihmesën e aplikacionit, sigurinë e sistemit etj.

Falë këtyre avantazheve dhe mundësive për përfitime nga sistemi i prokurimit elektronik, është rritur numri i autoriteteve kontraktuese edhe ai i operatorëve të ndryshëm ekonomikë që përfshihen në tendera. Po ashtu, është rritur shkalla e përdorimit të këtij sistemi. Kjo ndodh sepse tashmë ka një perceptim të shëndoshë lidhur me këtë sistem dhe sepse përfitimet e tij janë të prekshme.

Si përfundim mund të thuhet se është e qartë se argumentimi në favor të prokurimit elektronik duhet të përfshijë një varg aspektesh cilësore dhe sasiore. Tabela në vijim paraqet disa nga përfitimet në Kosovë. Ajo përmban tregues të faktorëve të cilësisë dhe disa përllogaritje sasiore.

Tabela 5 Vlerësimi përmbledhës i ndikimit të prokurimit elektronik në Kosovë

r.	Faktori	Ndikimi i prokurimit elektronik	Palët direkte të interesuara	Indikatorët për Kosovën
	Çmimet	Ulje prej 5-8% në tregjet konkurruese	Të gjitha entitetet publike	Parallogaritet 1% për rreth 12 milionë euro /vit
	Efikasitet i transaksioneve	Ulje prej 65% për prokurim të thjeshtë	OE, entitetet publike, qytetarët	Parallogaritet 10% në 0.6 milionë euro/vit
	Periudha e ciklit të prokurimit	Ulje prej 25-75% për prokurimin e ndërlikuar Ulje prej 80-95% për prokurimin e thjeshtë	Komuniteti	1 muaj më pak në kohëzgjatjen e ciklit për buxhetin e infrastrukturës të parallogaritur për 10 milionë euro NPV
	Përputhshmëria	Për blerjet pa kontratë me furnitorë 30%	Departamentet, KRRPP, OE	
	Kontrolli i delegimit/decentralizimit	Deri në 100% prokurim i thjeshtë	Departamentet, OE	
	Transparenca/praktikat e paligjshme	Është raportuar për zbritje domethënëse	KRRPP, ZAGj, OR, departamentet	Ngjashëm me pikët 1 & 2 më lart
	Bashkërendimi i shpenzimeve, blerjet pa kontratë	Rritje prej 30%	Buxhetet, OE	Ngjashëm me pikën 3 më lart
	Kapaciteti i auditimit	100% për disa pjesë të ciklit të prokurimit	Auditori, KRRPP	Si për pikën 6 më lart
	Zhvillimi i NVM/ biznesit	Mundësimi i biznesit online 25%	OE-të	Teknologjia në Austriali vlerësohet të jetë deri në 60% e rritjes së GDP-së
0	Vlera e inventarizimit	Ulje prej 70%	Buxhetet, departamentet	
1	Kërkesat për trajnime	Ulje për funksione të përgjithshme	Departamentet, KRRPP	

5.7 Sfidat e përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë

Avancimi i sistemit të prokurimit publik i vendosur në Programin e Qeverisë 2014-2018, në Strategjinë Kombëtare Zhvillimore dhe në Planin e reformave Ekonomike, gjendet para sfidash të shumta, pasi është i lidhur edhe me obligimin që dikton procesi i integritetit europian përmes MSA-së dhe, njëkohësisht, sepse është nën mbikëqyrjen dhe para vlerësimit që bëhet çdo vit përmes raporteve të Progresit të KE-së dhe atyre të OECD/SIGMA.

Këto paraqiten në disa fusha dhe aspekte. Së pari, do të thoshim se një angazhim të madh kërkon përmirësimet dhe ndërhrjet në kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës për përparimin e sistemit të prokurimit publik. Siç është theksuar edhe më parë në studim, vëmendje të veçantë kërkon plotësimi dhe përmirësimi i ligjeve dhe rregullave për zbatimin e prokurimit elektronik. Hartimi i akteve nënligjore dhe i rregullave lidhur me pajisjet e dorëzimit elektronik, me pranimin e tenderave, si dhe mepajisjet për pranimin elektronik të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e BE-së.

Nevojën e intensifikimit të punës e dikton zbatimi me rigorozitet i Ligjit të Prokurimit Publik, në radhë të parë, lidhur me respektimin e kriterëve bazë të prokurimit, si rritja e transparencës, e konkurrencës, e llogaridhënies. Përballja me perceptimin e përgjithshëm të aktorëve të prokurimit publik, të mediave e të publikut se sistemi i prokurimit është i cenuar nga korrupsioni i lartë kërkon impenjimin e të gjitha strukturave përgjegjëse të prokurimit publik për gjetjen e rrugëve dhe marrjen e masave për të parandaluar dhe luftuar shfaqjet korruptive në tendera, abuzimet dhe shpërdorimet e fondeve publike etj. Një rol të madh luan këtu integriteti dhe profesionalizimi i stafit përgjegjës për menaxhimin e sistemit dhe sidomos i zyrtarëve të prokurimit.

Në praktikë hasen problematika të ndryshme në procesin e prokurimit, duke filluar nga planifikimi e deri te realizimi i projekteve. Si të tilla veçojmë rastet kur prokurohen mallra, shërbime dhe projekte kapitale të cilësisë jo të duhur dhe me kosto më të lartë; mungesa e ekspertizës në planifikimin dhe kryerjen e procedurave të tenderimit, sidomos në autoritetet kontraktuese të vogla; zyrtarëve të prokurimit; përdorimit i praktikave moderne të prokurimit, si marrëveshjet kornizë dhe prokurimet qendrore, të cilat rrisin vlerën e parave, por kapacitetet për menaxhimin dhe zbatimin të sistemit nuk janë të përgatitur si duhet. Duhet thënë se në Kosovë ende prokurimi publik nuk është tërësisht në nivelin e standardeve europiane dhe se ka shfaqje të korrupsionit. Ndaj dhe sfidat në këtë fushë janë të mëdha.

Në rend të ditës mbeten forcimi i kontrolleve të punës që bëhet për trajnimin në fushën e prokurimit publik të zyrtarëve të prokurimit, të stafit menaxhues, ekspertëve që përgatisin specifikimet teknike, audituesit e përgjithshëm dhe ata të brendshëm etj. Ndershmëria dhe integriteti i zyrtarëve të prokurimit në mjaft raste lënë për të dëshiruar.

Praktika e deritanishme ka nxjerrë nevojën që të rritet cilësia në planifikimet e prokurimit, në specifikimin e secilit aktivitet, si dhe të harmonizohen kërkesat e çdo prokurimi me mundësitë e buxhetit, me qëllim sigurimin e fondeve.

Mbajtja e regjistrave të prokurimit në aspektin menaxhimit të kontratës kërkon një monitorim rigoroz dhe intensiv nga ana e KRRPP-së, pasi mjaft autoritete kontraktuese nuk e bëjnë këtë siç kërkohet në ligj. Evidencat mbi aktivitetet e prokurimit shpeshherë nuk janë të plota dhe nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për mënyrën sesi është implementuar aktiviteti i prokurimit.

Impenjim të madh të të gjithë aktorëve kërkon edhe problemi i mungesës së efektivitetit të punëve që kryhen gjatë implementimit të plotë të kontratës e deri në përfundimin e saj. Veçanërisht përdorimi i kontratave kornizë kërkon vëmendje të madhe, në radhë të parë për respektimin me rigorozitet të kërkesave ligjore, pasi në praktikë vërehen mjaft shkelje dhe parregullsi, sidomos në përgatitjen e njoftimeve dhe të raporteve për kontrata, për dhënie kontrate apo për kontratat e nënshkruara. Këtu mungon profesionalizmi dhe ngaqë nuk jepen të gjitha të dhënat e nevojshme, u lihet vend abuzimeve. Për të dëshiruar lë edhe puna që bëhet nga strukturat përkatëse për menaxhimin dhe implementimit të kontratave. Janë konstatuar shpesh shkelje ose moszbatim në nivelin e duhur të kërkesave të ligjit lidhur me të dhënat e procesit, me pagesat dhe me aspekte të tjera.

Qeveria, KRRPP dhe sidomos institucionet e auditimit duhet të bëjnë hapa konkretë për eliminimin e këtyre dhe për të realizuar detyrat ligjore, për të arritur objektivat e Strategjisë Kombëtare të Prokurimit publik dhe për progresin e këtij sistemi në Kosovë.

Agjencitë përgjegjëse të prokurimit duhet të ushtrojnë me më shumë efektivitet autoritetin ndhe kompetencat e tyre për ta udhëhequr, administruar dhe zhvilluar më gjerësisht sistemin e prokurimit elektronik. Shmangia e komunikimit tradicional shkresor midis tyre dhe autoriteteve kontraktore, shtimi i përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik, rritja e efikasitetit të procedurave, shkurtimi i kohës së kryerjes së tyre janë disa sfida që duhet të përballojnë institucionet e prokurimit publik.

Ka ardhur koha që të ndërtohet arkiva elektronike në sistem, me qëllim që të lehtësohet puna e përdoruesve të sistemit, të prokurimit elektronik, puna e audituesve, si dhe të përmirësohet ndëreveprimi i autoriteteve në sistem.

I nevojshëm është edhe botimi elektronikisht në faqen e internetit të AQP-së i të gjithë informacionit që ka të bëjë me një procedurë prokurimi, duke filluar me dokumentet e tenderit dhe më tej të gjitha njoftimet që kanë lidhje me ecurinë e një procedure prokurimi. nga njoftimi i kontratës deri në botimin e njoftimit për kontratën e nënshkruar.

Hartimi i udhëzimeve përkatëse, për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, në lidhje me çdo funksionalitet të ri të krijuar në sistem si dhe trajnimin e Autoriteteve Kontraktore dhe institucioneve audituese, mbi zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik janë detyra kryerja e të cilave ka të bëjë me efikasitetin e sitemit elektronik të prokurimit. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike që merren me procedura prokurimi, përmirësimi i faqeve zyrtare të internetit në to, duke i bërë ato ndëraktive, trajtimi elektronik i ankesave, shtimi i numrit të shërbimeve në mënyrë elektronike etj., do ta bëjnë më efikas procesin e prokurimit, do të sjellin rritja e transparencës, aksesin e bizneseve në informacionin e mbajtur nga

qeveria, që është një kusht thelbësor për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, si dhe për mbrojtjen e interesave të tyre private.

5.8 Rreziqet që duhen menaxhuar në fushën e prokurimit

Përmirësimi i procesit të prokurimit elektronik është përballur dhe përballët çdo ditë edhe me nevojën e parandalimit dhe të evitimit të rreziqeve në sistemin e prokurimit. Rreziku mund të jetë teknologjik, rrezik i tregut, rrezik organizativ dhe social, por edhe rrezik financiar. Të gjithë këta, nëse ndodhin, sjellin jo vetëm dështimin e procesit, por edhe pasoja financiare, shoqërore, edhe organizative.

Meqë këto rreziqe nuk mund të parashikohen qysh më parë, kërkohet rritja në maksimum e cilësisë së menaxhimit të sistemit, me synim që të kapet në kohë kërcënimi apo mundësia për ta krijuar rrezikun. Duhet një strategji e qartë për hapat që duhen bërë për ngushtimin e hapësirave që lejojnë të ndodhë rreziku. Gjithashtu, duhet planëzuar skema sesi duhet vepruar konkretisht në rast rreziku.

Rreziqe të tjera lidhen me vlerësimin e nevojave apo me rritjen e pagesave për të shpërdoruar fondet publike; me planifikimin dhe me përlllogaritjen e kostove të projektit, duke i mbivlerësuar ose dhe nënvlerësuar ato, me qëllim për të përvetësuar paratë; me deformimin e rezultatit të zgjedhjes së fituesit; me shpërdorimet gjatë përgatitjes së dokumenteve. Shpesh ato përgatiten jo nga konkurruesi, por nga vendimmarrësi, duke kopjuar dokumente të gatshme, teknika këto, që bëjnë të mundur përfitim të paligjshëm të parave. Po ashtu, rreziku vjen edhe në rastet kur, për hartimin e gjithë dokumenteve për konkurrim punësohet një kompani private, e cila fut të dhëna sipas porosisë së vendimmarrësit dhe ky, bashkë me miqtë e tij ndërmjetës, duke u fshehur pas firmës private, marrin ryshfete të majme pa u zbuluar.

Kërcënime përbëjnë edhe pagesat “legale”, që vendimmarrësi gjithmonë “e rregullon” që t’i paguhen atij, duke bërë mbifaturime apo veprime të tjera, si përgatitja e specifikimeve të projektit në mënyrë të tillë që të justifikohet ndryshimi më pas i sasisë së fondeve. Këto veprime kryhen në forma aq të sofistikuar, sa e bëjnë të pamundur zbulimin e rrezikut për sa kohë zgjat kontrata.

Një grup tjetër rreziqesh, që duhen zbuluar dhe parandaluar janë specifikimet jostandarde, “gabimet” në specifikimin e sasisë apo cilësisë, sidomos në projektet e ndërtimit të rrugëve, “mosveprimet” ose, thënë ndryshe, fshirja e gjobave, që u sjellin firmave të bizneseve favore, të cilat shoqërohen me shpërblime korruptive të zyrtarëve të prokurimit.

Risqe nga më të ndryshmet shfaqen edhe në njoftimet për tendera. Procedurat për këtë mund të keqpërdoren nga vendimmarrësit, duke dëmtuar transparencën e prokurimit dhe duke u hapur rrugë abuzimeve që përfshijnë grupet blerëse të cilat bashkëpunojnë me menaxherët e prokurimit për të lëshuar një thirrje të detyrueshme për tender thjesht duke zgjedhur nga një katalog mallrat për blerje, me çmime të ulëta. Në këtë mënyrë atakrijojnë terren që të përfitojnë ryshfet nga grupi blerës. Edhe abuzimet me thirrjet e hapura për tender, me publicitet të pamjaftueshëm ose pa u

publikuar fare, qoftë në nivel lokal, qoftë edhe në ato kombëtar dhe ndërkombëtar, përbëjnë gjithashtu rrezik. Kështu, ndodh që për tenderin vihen në dijeni vetëm pak firma të favorizuara që mund t'i përgjigjen njoftimit për tender, kundrejt dhënies së rryshfetit.

Përmendim këtu edhe rreziqet nga caktimi i kriterëve subjektive të përzgjedhjes; nga afatet jorealiste që caktohen; nga vënia e disa kushteve të përealizueshme për marrjen e dokumenteve të tenderit, nga rrjedhjet e informacionit, nga hartimi paraprak i një liste të kandidatëve fitues. Po ashtu janë shumë të dëmshme edhe pasojat që vijnë nga marrëveshja që mund të bëjnë midis tyre firmat konkurruese, për t'i ndarë së bashku kontratat, si dhe nga “komplotet” që mund të bëjnë vetë konkurrentët, duke caktuar çmime shumë të larta të kontratave, me qëllim që t'ia lënë vendin e fituesit një firme të caktuar, kundrejt kompensimeve që mund të marrin në formë kontratash ose ndonjë fature.

Edhe manipulimi i tregut të stokut në rastin e kontratave të mëdha; procedurat e negociuara, kur ftohen për të negociuar vetëm furnizuesit e zgjedhur, përmbajnë rreziqe për prishjen e procesit të prokurimit. Flagrante është edhe tenika e zakonshme e ndarjes së kontratave, pa zbatuar procedurat e prokurimit, si dhe shumë teknika të tjera, që lejojnë mashtrime dhe abuzime, shpërdorim të fondeve publike dhe korrupsion.

Të gjitha këto sfida dhe rreziqe që shfaqen në procesin e prokurimit dhe të tenderimit obligojnë edhe më shumë agjencitë përgjegjëse të prokurimit të përqendrohen për rritjen e transparencës në veprimtarinë shtetërore në tendera dhe për përmirësimin e aksesit të bizneseve dhe të qytetarëve në informacion. Theksi duhet vënë në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore me transparencë dhe sidomos në sigurimin dhe përdorimin e teknologjisë elektronike nga institucionet publike, duke përmirësuar faqet zyrtare të internetit të lidhur me prokurimet, duke rritur sasinë dhe cilësinë e shërbimeve që jepen në mënyrë elektronike.

Po ashtu, kërkohet një punë më e madhe në riinxhinierimin e sistemit elektronik të prokurimit, me qëllim përmirësimin e tij dhe shtimin e funksionaliteteve për ta bërë sa më të aksesueshëm dhe lehtësisht të përdorshëm nga autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë apo përdorues të tjerë; në monitorimin e procedurave të prokurimit publik, me qëllim evidencimin e problemeve të hasura dhe të mangësive të autoriteteve kontraktore, sa i takon zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe parashikimin e masave të nevojshme për adresimin e tyre; në ngritjen e kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në vend.

5.9 Korrupsioni në prokurimin publik dhe lufta kundër tij

Një nga sfidat e mëdha të prokurimit publik në Kosovë është dukuria e korrupsionit dhe niveli i tij. Dihet që prokurimi publik është proces nëpërmjet të cilit

qeveria dhe institucionet publike shpenzojnë shumë fonde për të blerë produkte, shërbime dhe të kryejnë punë publike. Rëndësia ekonomike e prokurimit publik është e konsiderueshme. Shumë autoritete kontraktuese menaxhojnë buxhetet e prokurimit të madhësive të ndryshme, duke harxhuar fonde publike në masë të madhe. Por, për shkak të korrupsionit, ato nuk shpenzohen në mënyrë efikase, shpërdorohen dhe u shkaktojnë një kosto të konsiderueshme buxhetit të shtetit dhe publikut taksapagues. Korrupsioni gjeneron humbje të fondeve publike, pasoja të menjëhershme monetare për buxhetin kombëtar dhe lokal.

Korrupsioni në vetvete është një temë e gjerë, pasi ai mund të ndodhë në nivele të ndryshme të qeverisjes, mund të përfshijë një sërë sektorësh dhe aktorësh, pra, edhe prokurimin publik, dhe merr forma nga më të ndryshmet. Si një fenomen i gjerë dhe kryesisht i fshehur, në shumicën e rasteve ai nuk ka viktima të dukshme, pasi palët e përfshira për të fituar në mënyrë të paligjshme veprojnë në mënyrë diskrete, në heshtje. Kjo e bën të vështirë gjetjen dhe luftimin e rasteve të korrupsionit.

Edhe në prokurimet publike korrupsioni është, në fakt, abuzim i pushtetit për përfitime private. Pra, ka të bëjë direkt me sjelljen e njerëzve. Në këtë fushë shpërdorimi i pushtetit mund të çojë në një marrëdhënie midis një ose më shumë ofertuesve dhe zyrtarit të prokurimit, marrëdhënie kjo që materializohet në konflikt interesi, në ryshfet ose në dëmtim. Formë tjetër e shpërdorimit të pushtetit për përfitime private në prokurimin publik janë edhe marrëdhëniet e fshehta midis ofertuesve, kuptohet, edhe me përfshirjen e ndonjë zyrtari të korruptuar, që bashkëpunon me ta për manipulimin e ofertave etj. Këto forma të korrupsionit shkaktojnë humbje ekonomike.

Korrupsioni në prokurim mund të bëhet, si në sektorin publik, edhe në sektorin privat. Ai ndeshet si korrupsion aktiv dhe korrupsion pasiv. Veprimi i qëllimshëm i kujtdo që premton, ofron ose jep, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, një avantazh të çfarëdo lloji për një person, për vete ose për një palë të tretë, gjatë veprimtarisë afariste të atij personi, me qëllim që ky të kryejë ose të mos kryejë një veprim, në shkelje të detyrave të tij, përbën korrupsion aktiv. Ndërsa veprimi i qëllimshëm i një personi, i cili në veprimtarinë e tij, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, kërkon ose merr ndonjë avantazh të çfarëdo lloji, ose pranon premtimin e një avantazhi të tillë, për vete ose për një palë të tretë, që ai të kryejë ose të mos kryejë një veprim, duke shkelur detyrat e tij, përbën korrupsion pasiv.

Korrupsioni konsiderohet një formë mashtrimi dhe realizohet me ryshfetin, me manipulimin e ofertave, me konfliktin e interesit dhe me përvetësimin.

Si kudo, edhe në Kosovë, përfitimi i paligjshëm nga korrupsioni, në shumicën e rasteve merr formën e ryshfeteve për një zyrtar të korruptuar publik, për miqtë ose të afërmit e tij, për një kompani ose organizatë tjetër.

Mashtrimi korruptiv është shkelje e ligjit, e një dispozite, nga një operator ekonomik, që ka ose do të kishte efektin e dëmtimit të interesave ekonomiko-financiare, pra, një parregullsi e kryer me dashje në prokurim a tenderim, me qëllim fitimi të paligjshëm, ndaj dhe përbën vepër penale. Të tilla janë *ndërhyrjet në ofertat*. Këto bëhen në disa mënyra: zvogëlimi i ofertës nga disa ofertues; ofertimi plotësues, i quajtur edhe si "ofertim i mbuluar", kur disa ofertues ofrojnë një shumë më të lartë

ose kushte që ata e dinë se janë të papranueshme; ofertuesit bien dakord të ndajnë konsumatorët ose zonat gjeografike; *Lowballing*, dorëzimi i ofertës më të ulët, që, me miratimin e zyrtarit publik, kontrata do të ndryshohet që të rritet çmimi i saj; kontraktimi i ofertës së nënkontratës, kur disa nga ofertuesit bien dakord të mos dorëzojnë oferta ose të paraqesin oferta të mbuluara, që nuk kanë si synim të jenë të suksesshme, me kusht që disa pjesë të kontratës së ofertuesit të suksesshëm të nënkontraktohen me to; ndarja e gabuar e shumave të kontratës; urgjenca e rreme; keqpërdorimi i procedurave të prokurimit publik të përshpejtuar pa justifikim adekuat; reduktimi i konkurrencës; reduktime të çuditshme të çmimeve; tenderat anormalisht të ulëta etj.

Siç e theksuam më sipër, në prokurimin publik korrupsioni merr edhe formën e konfliktit të interesit midis detyrimit publik dhe interesave private të një zyrtari publik, të cilat mund të ndikojnë te kryerja e detyrave dhe e përgjegjësisë së tij zyrtare. Një konflikt interesi mund të jetë i tanishëm ose ka ekzistuar në të kaluarën dhe interesi privat ka rrezikuar kryerjen e duhur të detyrave të një zyrtari publik.

Ndodh që korrupsioni në prokurimin publik të jetë pasojë e performancës jooptimale të prokurimit dhe tenderimit, për shkak të vendimeve jo të drejta, Këto sjellin kosto materiale dhe humbje të vlerave monetare dhe shkaktojnë disa pasoja. Kështu kemi: *joefektivitetin*, kur projekti nuk arrin objektivat e tij, ngaqë prokurimi i punëve, i mallrave ose i shërbimeve gjeneron më pak vlerë publike. Po ashtu shkaktohet *joefikasitet*, kur rezultatet e një projekti nuk janë në përputhje me inputet, kur mallrat, shërbimet dhe punët bëhen me çmime më të larta se ofertat konkurruese që ofrojnë cilësi të ngjashme ose më të lartë, ose kur prokurimi kryhet me çmime të ngjashme, por me cilësi më të ulët se ofertat konkurruese.

Në Kosovë ka një perceptim të përgjithshëm se në prokurimin publik ka shumë korrupsion. Pa hyrë në detaje, mund të themi se ky konstatim qëndron, është shprehur edhe në raportet vjetore etj. Që këtej, del nevoja e forcimit të luftës kundër korrupsionit në prokurimet publike. Organizmi i kësaj lufte duhet të përqendrohet, në radhë të parë, në punën për identifikimin dhe reduktimin e shfaqjeve të korrupsionit në prokurimet publike, që përfshijnë fondet publike. Strukturat përkatëse duhet të krijojnë një tablo të qartë për llojet dhe nivelet e korrupsionit në fushën e prokurimit dhe të tenderimit, si dhe të ndërtojnë një program-kornizë për luftimin e mashtrimeve dhe të veprimeve korruptive në tendera, të cilat prekin interesat financiare dhe sjellin humbjen dhe shpërdorimin e parave publike.

Në këto kushte, programi i modernizimit të prokurimit publik, përmes aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik duhet të përfshijë edhe antikorrupsionin, metodologjinë për zbulimin e rasteve të korrupsionit dhe për matjen e niveleve të tij. Theksi duhet vënë te përmirësimi i aplikimit të rregullave dhe të praktikave të prokurimit publik dhe, njëkohësisht, te thellimi i luftës antimashttrim dhe antikorrupsion, për identifikimin dhe goditjen e rasteve të korrupsionit.

Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i korrupsionit në prokurimin publik në Kosovë kryhen në mënyrë të fragmentuar, pa një program dhe një qasje të integruar. Praktikrat e monitorimit dhe të kontrollimit të prokurimit publik nuk janë plotësisht

efikase për të parandaluar ose zbuluar veprimet korruptive. Auditimet publike përqendrohen, zakonisht, në parregullsitë në procesin e prokurimit publik, por jo në kryerjen e projekteve për të cilat prokurimet, mallrat ose punët janë siguruar. Nga ana tjetër, kur dyshohet për mashtrim dhe korrupsion, rastet transferohen në organet hetimore dhe nuk janë më kompetencë e autoriteteve të auditimit. Këtu ndikon edhe fakti që organet hetuese mbulojnë të gjitha rastet e korrupsionit në të gjitha fushat dhe korrupsioni në prokurimin publik është vetëm një aspekt i detyrës së tyre, pra, nuk është një prioritet. Ky zhvillim i fragmentuar i luftës kundër korrupsionit në prokurimin publik nuk u shërben parandalimit, zbulimit dhe hetimit efikas të korrupsionit në këtë fushë. Mendojmë se ka ardhur koha që hetimi i rasteve të korrupsionit të dyshuar në prokurimin publik të marrë përparësi, për vetë peshën e madhe që ato kanë në ekonomi dhe në raport me veprat e tjera kriminale (financiare).

Lidhur me këtë kërkohet ndjekja dhe zbatimi i një metodologjie gjithëpërfshirëse për vlerësimin e rasteve dhe të kostove të korrupsionit në prokurimin publik, që antikorrupsioni të mos mbetet te zbulimi i rasteve të veçanta dhe të izoluara, por të kombinojë fuqinë zbuluese në nivel mikro dhe makro.

Politika e menaxhimit të korrupsionit presupozon një bazë të fortë ligjore, institucionale dhe teknike për të mbrojtur prokurimin publik nga ky fenomen gërryes; një politikë ose program antikorrupsion me objektiva të qartë, që të fokusojnë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në luftën kundër korrupsionit në prokurimet publike; kodet etike të sjelljes, të inkuorpuara në legjislacionin e shërbimit civil, duke pasur në shënjestër jo vetëm zyrtarët qeveritarë dhe nëpunësit e administratës, por edhe kontraktorët, nënkontraktuesit dhe të tjerë të përfshirë në ekzekutimin e kontratës.

Politika e menaxhimit të korrupsionit përcakton edhe teknikat e zbulimit dhe të hetimit të korrupsionit. Si të tilla përmendim:

Auditimet dhe vlerësimet e pavarura, të kryera sipas standardeve të caktuara, të nivelit të kualifikimit për nëpunësit civilë dhe zyrtarët e përfshirë në prokurim, të performancës së përmbajtjes së projekteve, si në fazën e përgatitjes, ashtu edhe të implementimit, duke u përqendruar në rastet me probabilitet të lartë korrupsioni.

Analiza e të dhënave të prokurimit publik për të vlerësuar probabilitetin e korrupsionit, për të zbuluar parregullsi, mashtrime dhe korrupsionin e mundshëm, evazionin fiskal etj.

Transparenca optimale në të gjithë procesin e prokurimit publik, disponueshmëria maksimale e informatave lehtësisht të përdorshme nga të interesuarit dhe nga publiku;

Zhvillimi dhe përdorimi i mjeteve dhe metodave adekuate të vlerësimit për të pranuar dhe sinjalizuar praninë e korrupsionit në proceset e prokurimit publik.

Analiza e tregut, që duhet të bëjnë autoritetet kontraktuese për të mbledhur informacionin e duhur, me qëllim që prokurimet të jenë të bazuara në treg dhe që shërbimet të merren në mënyrën më efektive.

Shqyrtimi i duhur i kontraktorëve dhe i përfituesve.

Zbatimi adekuat i detyrimit për t'u mbështetur në Direktivën e BE-së për prokurimin.

Shqyrtimi para punësimit dhe gjatë punës i të gjithë zyrtarëve të prokurimit publik, vlerësimi se sa të specializuar dhe të trajnuar janë, ç’nivel ekspertize, njohurish dhe inteligjence kanë.

Një sistem zyrtar i deklarimit financiar/deklarimit të pasurive, që rregullon se kush duhet të deklarojë, llojin e informacionit që kërkohet, frekuencën e deklaratave dhe qasjen publike në informacionin e dhënë.

Vëmendje kërkon edhe fakti që strukturat antikorrupsion, përqendrohen më shumë në hetimin dhe jo në parandalimin dhe zbulimin e rasteve të korrupsionit në prokurimin publik. Pozitive është se luftën kundër korrupsionit e ndihmojnë edhe OJQ-të, mediat dhe qytetarët, të cilët, duke denoncuar sjelljet, korruptive i vënë vendimmarrësit nën presion për të siguruar transparencë dhe për të forcuar dhe koordinuar agjendat antikorrupsion.

Në reduktimin e korrupsionit ndikon edhe një sistem i shëndoshë i prokurimit publik, që bazohet në rregulla dhe sidomos sistemi i prokurimit elektronik, i cili inkurajon konkurrencën në ofertimin për kontratat e qeverisë dhe të institucioneve të saj, nxit transparencën, forcon llogaridhënien, shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin. Platforma e prokurimit elektronik duhet të përmbajë edhe një modul të dizajnuar për zbulimin e korrupsionit.

Nga ana tjetër, një sistem gjyqësor i pavarur luan një rol të madh në hetimin dhe luftimin e korrupsionit. Por, duhet thënë se gjyqësori nuk e ka prioritet hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit në prokurimin publik. Po ashtu, kërkohet një punë më e studiuar dhe bashkëpunim me publikun, për ndërgjegjësimin e tij lidhur me rreziqet dhe luftën kundër korrupsionit në prokurimin publik dhe për shtimin e denoncimeve në këtë fushë. Institucionet e ngarkuara me ligj për zhvillimin e prokurimit publik, kanë gjithashtu një front të gjerë pune për edhe për kualifikimin profesional të zyrtarëve të prokurimit, por edhe për rritjen e integritetit dhe të ndershmërisë së tyre në punë, me qëllim luftimin dhe parandalimit e korrupsionit.

KAPITULLI VI SISTEMI I PROKURIMIT ELEKTRONIK – PROBLEME TË FUNKSIONIMIT TË TIJ

6.1 Funksionimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe përdorimi i tij

Në Kosovë institucionet, bizneset, administrata kanë, tashmë, kapacitete dhe pajisje të nevojshme për të kryer procedurat e prokurimit përmes internetit. Aktorët që përfshihen në prokurime elektronike janë pajisur me infrastrukturën e teknologjisë së avancuar, me pajisjet e duhura elektronike që bëjnë të mundur funksionimin e Sistemit Elektronik të Prokurimit. Nga vëzhgimet që kemi bërë lidhur me kapacitetin dhe parametrat e kompjuterave dhe pajisjeve që përdoren për të ndërvepruar me SPE-në, del se autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë e konsiderojnë këtë sistem efikas dhe se shumica e tyre e shfrytëzojnë si burim kryesor të informacionit dhe të dokumenteve për prokurimet. Sistemi elektronik i njoftimit të prokurimeve është profesional dhe kërkohet të shfrytëzohet nga shumica e entiteteve të interesuara.

Por, duke marrë në konsideratë vështirësitë, shihet që në disa komuna dhe autoritete të tjera kontraktore lokale ka ende mungesa në këtë fushë dhe nuk i kanë plotësuar të gjitha nevojat për pajisje teknologjike për përdorimin e SPE-së. Në këto rrethana, disa autoritete kontraktuese kanë krijuar salla me pajisjet e nevojshme, si kompjutera dhe lidhje interneti, që mund t'i shfrytëzojnë specialistët e prokurimit dhe anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave (KVO) për të përdorur SPE-në. Kjo e ka zbutur disi problemin dhe ka mundësuar që anëtarët e KVO-ve, me ndihmën e specialistëve të njësive të prokurimit, jo vetëm përdorin sistemin elektronik, por edhe kontaktojnë me zyrtarët për të diskutuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Përdoruesit e sistemit ndërveprojnë në mënyrë të rrjedhshme, të sigurt dhe efikase. Përdoruesit mund të jenë: Entitetet e prokurimit në qeveri dhe të punësuarit e tyre; Furnitorët ekzistues dhe furnitorët e mundshëm; Komuniteti në përgjithësi; Bankat; Agjencitë e certifikimit (nëse përdoren); Audituesit; Agjencitë shumëpalëshe zhvillimore. Këto entitete, përmes përdorimit të SPE-së njohin dhe përdorin programet kompjuterike të punimit me dokumente të formateve të ndryshme, bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin me lehtësi të dokumenteve dhe kryejnë veprimet e tjera të procesit të prokurimit elektronik etj. Pothuajse të gjitha autoritetet kontraktuese kanë lidhje ADSL në internet, madje, dhe nga dy linja ADSL, me shpejtësi normale, për t'u siguruar që të kenë lidhje të vazhdueshme interneti.

Punonjësit e angazhuar me prokurimin elektronik e shohin praktikisht se falë këtij sistemi

po rritet numri i procedurave të prokurimit, në krahasim me sistemin e prokurimit në letër. Gjithashtu, është zvogëluar numri i kontakteve personale të drejtpërdrejta të zyrtarëve të operatorëve ekonomikë me ata të autoriteteve kontraktuese. Bizneset komunikojnë përmes SPE-së me specialistët përkatës të prokurimit në autoritetet kontraktuese ku kanë paraqitur oferta. Megjithatë, ka edhe operatorë ekonomikë që mbështeten ende në kontakte personale me AK-të.

Edhe marrja e informacionit në çdo fazë të procedurës së prokurimit tani bëhet kryesisht nëpërmjet SPE-së. Buletini i Prokurimeve të AQP-së konsiderohet dhe po përdoret si një burim i mirë informacioni për gjetjen e njoftimeve të tenderave.

Aplikimi i SPE-së ka çuar në rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit, pasi ky sistem e bën të pamundur ndryshimin dhe deformimin e dokumenteve të ofertës, siç mund të ndodhte me procedurën në letër. Duke qenë në sistem dokumentet e ofertës, gabimet në to nuk mund të falen apo të tolerohen. Nëpërmjet sistemit elektronik të gjitha autoritetet kontraktuese, pa përjashtim, janë të ekspozuara ndaj kontrollit dhe mbikëqyrjes. Edhe operatorët ekonomikë, të vetëdijshëm se sistemi elektronik nuk të fal, ndjekin rregullat e përcaktuara të procedurave të tenderit dhe nuk abuzojnë me dokumentet e ofertës, pasi nuk mund t'i falsifikojnë ato, nuk mund të paraqesin dokumentin e gabuar dhe as t'i deformojnë e t'i keqinterpretojnë. Anëtarët e KVO-ve nuk kanë më motiv për të bërë lëshime në këtë drejtim, sepse, edhe sikur ta bëjnë këtë gjë, sistemi ruan vlerësimin e bërë dhe ata mund të ndëshkohen.

Dorëzimi i ofertave nëpërmjet SPE-së i jep fund situatës kur operatorët ekonomikë përplaseshin me njëri-tjetrin në zyrën e autoritetit kontraktues të gjithë në të njëjtën kohë, për të paraqitur e dorëzuar ofertat. Me vënien në funksionim të SPE-së, rritet profesionalizmi i zyrtarëve në kryerjen e procedurave të prokurimit, përmirësohet reputacioni i institucioneve publike dhe specialistët e prokurimit nuk kanë më frikë nga kontrollët dhe nga auditimi, sepse të gjitha ofertat dhe dokumentet e tenderit ruhen në sistem dhe nuk mund të manipulohen nga ndonjë përdorues tjetër. SPE ndikon që përdoruesit e sistemit elektronik të jenë seriozë në punë dhe më të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave të tyre deri në përfundimin e procedurës së prokurimit.

Sistemi i prokurimit elektronik po pakson gabimet e operatorëve ekonomikë dhe po rrit nivelin e konkurrencës së efektshme edhe për bizneset shumë të vogla. Me fitimin e përvojës, tani OE-të kanë fituar siguri në përdorimin e sistemit dhe për shumicën e procedurave dhe të dokumenteve në formatin e kërkuar.

Sektori privat në Kosovë është përshtatur mirë me tregtinë elektronike, përfshirë këtu edhe punët bankare përmes internetit. Megjithatë, pjesëmarrja e sektorit privat në tregjet që janë relevante për prokurimin elektronik, nuk mund të merret gjithmonë si e garantuar, pasi operatorët ekonomikë privatë janë skeptikë për të investuar në një 'ide të mirë', por e mirëpresin një rast të besueshëm biznesi që ofron kosto më të ulëta apo mundësi më shumë të prekshme e transparencë. Përvoja në BE dhe gjetiu tregon se mënyra më efektive për promovimin e aktivizimit të biznesit është përmes ofertimit të vlerës së menjëhershme. Strategjia për aktivizimin e biznesit do t'i trajtojë furnitorët ekzistues të kontraktuar dhe furnitorët e pakontraktuar; anëtarët e shoqatës së biznesit; kostot; furnitorin – ndërveprimin e furnitorëve; shërbimet e kioshave dhe kafenetë e internetit. Është sugjeruar se ka nevojë për trajnime të sektorit të biznesit për fushën e prokurimit elektronik, por nuk pritet që kjo të jetë prioritet. Tenderimi elektronik kuptohet lehtë nga bizneset, me pak apo aspak kosto, dhe përbën themelin mbi të cilin mund të ndërtohen shërbime elektronike të vlerës më të lartë.

Veçanërisht shërbimet mobile kanë qenë tërheqëse për bizneset. Mirë mund të punohet edhe me industrinë e shërbimeve, e cila i mbështet aplikacionet e biznesit.

Konsiderohet që sistemi i prokurimit elektronik zvogëlon gabimet e Operatorëve Ekonomikë (OE) dhe rrit nivelin e konkurrencës së efektshme. Kjo vlen për të gjitha bizneset, pos atyre shumë të vogla. Në përgjithësi, duket se ka gjasa që kjo nismë do të ketë përkrahje të madhe nga shumica e palëve në sektorin e biznesit. E vetmja rezervë mund të jetë fakti se mund të ketë rezistencë që rrjedh nga besueshmëria e sistemit nga aspekti i sigurisë.

Tashmë, ekziston një sistem i njoftimit të prokurimeve përmes internetit, i cili është pranuar mirë dhe është profesional, të cilin e administron KRRPP-ja dhe i cili kërkohet të shfrytëzohet nga të gjitha entitetet, madje, edhe nga bizneset. Ka dëshmi që vërtetojnë se OE-të e konsiderojnë këtë faqe si efikase dhe të efektshme, si dhe shumica e tyre e shfrytëzojnë si burim kryesor të informatës dhe të dokumenteve lidhur me prokurimet qeveritare. Kjo faqe më së shumti përdoret në G2C nga të gjitha aplikacionet e tjera të qeverisjes elektronike. Megjithatë, ky instrument nuk ka kapacitete për zgjerimin funksional.

Gjithashtu, theksojmë se prokurimi përmes faqes qendrore të internetit, automatikisht mundëson kontrollin e politikave për të siguruar që proceset e blerjes të jenë në përputhje me politikat e qeverisë. KRRPP-ja duhet të ketë në arkitekturën e prokurimit elektronik Instrumentin e përputhshmërisë së politikave.

Por në praktikë konstatohet se ende ka zyrtarë të prokurimit të AK-ve dhe anëtarë të KVO-ve që nuk i kanë të gjitha njohuritë dhe përvojën e nevojshme për përdorimin e SPE-së. Ata kanë nevojë për ndihmë teknike. Këtë mund ta marrin nga njësia e prokurimit e AK-së, tek e cila dërgojnë oferta ose nga specialistë.

Në përdorimin e SPE-së ka mjaft vështirësi dhe probleme. Disa entitete publike në Kosovë konsiderojnë se rrjeti është i integruar dobët në praktikat qeveritare të menaxhimit, se nuk ka një kornizë të artikuluar mirë të ndërveprueshmërisë, nuk ka standarde të qarta për zhvillimin e sistemeve etj. Shembull për këtë është shfrytëzimi i përbashkët i adresave të punës mes zyrtarëve qeveritarë në faqet e internetit dhe strategjia ekzistuese e qeverisjes elektronike nuk jep udhëzime të qarta për këtë çështje të rëndësishme. Probleme ka edhe lidhur me kapacitetin e TI-së në shumë entitete, ku janë konstatuar shpejtësi e ulët dhe ndërprerje e internetit.

Ka pasur raste që faqja e SPE-së nuk funksionon mirë, duke shkaktuar ndërprerjen e ngarkimit të dokumenteve të prokurimit ose të procesit të publikimit të njoftimit për procedurën e prokurimit, fshirjen e dokumenteve të prokurimit, duke bërë që procedurat të rinisin nga e para dhe dokumentet e nevojshme të ngarkoheshin sërish nën drejtimin AQP-së. Disa OE dyshojnë se operatorët qeveritarë mund të çkyçin nivelet e sigurisë, për të pasur qasje jo të duhur në dokumentet e ofertimit. Probleme dalin edhe kur AK-të humbin fjalëkalimin e llogarisë së tyre në SPE, por, specialistët e AQP-në së janë të gatshëm të ofrojnë një ndihmë.

AQP-ja ndryshoi formatin për procedurat e prokurimit me lote dhe shtoi atë në SPE, pa ofruar trajnim paraprak ose sqarime për AK-të. Kjo çoi në shumë probleme teknike që hasën AK-të ndërsa përpiqeshin për të realizuar një procedurë me lote përmes SPE-së. Pati raste kur AK-të nuk mundën t'i ngarkonin DST-të në SPE dhe u

detyruan të dërgonin një CD me DST-të tek AQP-ja, në mënyrë që kjo t'i ngarkonte vetë këto dokumente.

Një shqetësim i përmendur nga AK-të është se ata janë nën kontroll të fortë nga specialistët e auditit, që u kërkojnë të printojnë çdo dokument elektronik për ta. Printimi rrit disa herë, në mënyrë të panevojshme, kostot e procedurave të prokurimit. Megjithatë, ligji i prokurimit nuk u kërkon AK-ve t'i printojnë të gjitha dokumentet e ofertave dhe të arkivojnë në letër dokumente, që mund të jenë më vonë subjekt i kontrolleve të brendshme ose të jashtme.

Një konkluzion i studimit doktorat është se ka mangësi në organizimin institucional për implementimin e projektit të prokurimit elektronik, qeverisja e sistemeve të informacionit në kuadrin e prokurimit publik shpeshherë çalon dhe nuk është efektive. Për rrjedhojë, rriten kostoja dhe vonesat në zbatimin e projektit.

Siç ka dalë nga hulumtimi, edhe për shkak të mungesës së Infrastrukturës së Çelësave Publikë (*Public Key Infrastructure-KPI*) funksionimi i e-Prokurimit bëhet joefikas. Me mangësi të shumta ka rezultuar edhe ndërveprimi, pasi nuk bëhet sa duhet për shkëmbimin e informacioneve midis sistemit të e-Prokurimit me shërbimet tjera të e-Qeverisë, për të vërtetuar dhe proceduar të dhënat dhe për të shmangur dyfishimin e tyre.

Edhe transferimi i njohurive të përdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik përmes trajnimeve nuk realizohet në masën e duhur.

6.2 Kushtet për funksionimin e SPE

Sistemi i prokurimit elektronik është ndërtuar duke përdorur dizajnë të mirë softuerikë dhe teknika zhvillimore, që cilat mundësojnë që prokurimet e qeverisë të jenë të ndërlidhura ngushtë me praktikën e sektorit privat. Këto teknika, përgjithësisht, nuk i japin të gjitha efektet pozitive plota që ka zbatimi i prokurimit elektronik, si dhe mund të mos mospërputhen me politikat e qeverisjes elektronike, me qasjen dhe me përfshirjen e të interesuarve. Prokurimi elektronik ka funksione të ndryshme, të pavarura si koncepte, dhe ato duhet t'i përshtaten mirë procesit të menaxhimit të prokurimit nga qeveria.

Sistemi i prokurimit elektronik bazohet në internet dhe duhet të përfshijë tërë ciklin e prokurimit, si dhe të regjistrojë të gjitha aktivitetet e prokurimit. Qëllimi është mirëmbajtja e një sistemi efikas dhe të përditësuar të prokurimit për të gjitha agjencitë publike të Kosovës dhe t'u ofrojë mundësinë e tenderimit të gjithë ofertuesve të mundshëm vendorë e ndërkombëtarë.

Arkitektura e prokurimit elektronik duhet t'u ofrojë blerësve, furnitorëve dhe qytetarëve në përgjithësi qasje të sigurt në sistemin dhe në shërbimet e prokurimit. Sistemi duhet të ndërveprojë me bazat e tjera të të dhënave në qeveri, siç janë regjistrat e biznesit, SMIF-ja, resurset njerëzore/sistemi i listës së pagave dhe sistemet e tjera jashtë qeverisë, siç janë bankat.

Pasi interneti është mekanizmi kryesor i qasjes për shërbimet dhe sistemet e prokurimit elektronik, shfrytëzuesit nga sektori publik do të kërkojnë të kenë qasje në

intranetin e sigurt të qeverisë, për të qenë në gjendje të marrin pjesë në prokurim elektronik. Cilësia e shërbimit të internetit duhet të jetë e lartë.

Aspektet e zbatimit të prokurimit elektronik përfshijnë:

A do të përkrahë, fuqizojë dhe a do t'i ofrojë resurse qeveria agjencisë udhëheqëse për të realizuar prokurimin elektronik? Ky aspekt duhet të shqyrtohet në kuptimin e rregullimeve institucionale për prokurim në qeveri.

Çfarë ekspertize apo zhvillimi profesional nevojitet, nga do të vijnë këto dhe si do të mbahen?

A nënkupton prokurimi elektronik centralizmin e prokurimit?

A i përket prokurimi elektronik Sistemit informativ për menaxhim financiar?

A duhet që sistemi i prokurimit elektronik të blihet i gatshëm”?

Sa do të kushtojë instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit dhe a mund të arsyetohen këto shpenzime?

A duhet të ekzistojë sistemi i bazuar në letër paralelisht me sistemin e prokurimit elektronik?

A duhet që sistemi i prokurimit elektronik të ndërveprojë me sistemin tatimor dhe me sistemet e tjera të ngjashme të qeverisë?

Kush duhet të organizojë trajnimin për prokurim elektronik, dhe çka përfshihet në të?

A ka nevojë të miratohet legjislacioni i ri?

Cilat janë rreziqet e sigurisë?

Shumica e këtyre çështjeve kanë të bëjnë me menaxhimin e zakonshëm të punës, të cilat nuk kërkojnë ekspertizë teknike për nxjerrjen e vendimeve të duhura rreth politikave.

Blloqet kryesore funksionale të sistemit, në bazë të marrëdhënieve logjike, janë: Portali i prokurimit, Regjistri i furnitorëve, Regjistri i blerësve, Sistemi i ofertimit elektronik, Blerja, elektronike, Sistemi i pagesave elektronike, Sistemi i informatave për menaxhimin e prokurimit dhe Sistemi i menaxhimit të rrjedhës së punës.

6.2.1 Portali i prokurimit

Portali qendror funksionon si vendi për marrjen e informatave të nevojshme për të gjitha prokurimet publike, përfshirë edhe ato nga pushteti lokal. Të gjitha shpalljet dhe publikimet për prokurim në mbarë vendin gjenden aty, kështu që furnizuesit nuk kanë nevojë të kërkojnë faqe të ndryshme të internetit të departamenteve apo ministrive për të parë se çfarë mundësish janë në dispozicion.

Portali ofron udhëzues vizual për agjencitë e prokurimit, për kontraktuesit, furnitorët, konsulentët, bankat etj. Në të ka njoftime, statistika të prokurimit për informim të publikut, lista, lajmet mbi përjashtimet, ka formularë dhe dokumente, si legjislacionin, politikat, udhëzuesit etj. Ai krijon mundësi për realizimin e transaksioneve, në bazë të standardeve të vendit, të cilat duhet të jenë në dispozicion për shfrytëzim nga të gjitha ministrinë.

Funksionimi i portalit përfshin:

- + Informatat bazë, siç janë ligjet e prokurimit;
- + Politikat e prokurimit;
- + Regjistrimin e furnitorëve;
- + Listën e të gjitha mundësive aktuale të ofertimit;
- + Dhënien e kontratave, duke përfshirë informatat e arkivuara;
- + Njoftimet e hershme për ftesat e ofertimeve;
- + Planifikimin vjetor të prokurimit nga departamentet;
- + Mundësitë për përcjelljen e ofertës;
- + Dërgimin e ofertës dhe shkarkimin e dokumenteve;
- + Mundësitë për kërkim inteligjent për furnitorët e ndërlidhur me shërbimet mobile.

Në thelb, portali është kutia postare e prokurimeve të qeverisë. Megjithatë, pjesa më e madhe e aktiviteteve të prokurimit nuk trajtohen nga portali i prokurimit elektronik – posaçërisht monitorimi dhe raportimi i rëndësishëm i informatave për menaxhim dhe përputhje me procedurat. Portali duhet të lidhet në modulën e menaxhimit të mbarëvajtjes së punës dhe me aspektet e tjera të SMIP-it.

6.2.2 Regjistrimi

Regjistrimi në sistem bazohet në fjalëkalimin e mbrojtur dhe vetëm një vlerë e përzier (*hash value*) e fjalëkalimit ruhet në bazën e të dhënave. Regjistrimi online përmes hyrjes së vetme bëhet për të gjitha subjektet e prokurimit, për kompanitë, kompanitë me angazhime të përbashkëta dhe individët.

Sistemi i prokurimit elektronik mbështet metodat standarde për regjistrimin dhe verifikimin e përdoruesit. Për këtë regjistrim ka dy opsione: identifikimi dhe fjalëkalimi i përdoruesit; dhe certifikatat për nënshkrime digjitale. Regjistrimi i përdoruesit i bazuar në identifikim dhe në fjalëkalim është qasja kryesore në shumicën e vendeve.

6.2.2.1 Regjistrimi i furnitorëve dhe i blerësve

Në këto module ruhen profilet e furnitorëve, të kontraktorëve, të konsulentëve, si dhe të entiteteve të prokurimit, por edhe të zyrtarëve të tyre, përfshirë edhe të drejtat në qasje në sistemet e prokurimit dhe në informatat e vërtetësisë. Kërkesa për regjistrimin e subjekteve të prokurimit duhet të aprovohet nga KRRPP. Vërtetimi/autenticiteti bëhet përmes opsionit të përzierjes (*hash option*), CAPTCHA apo ndonjë opsioni tjetër të vërtetimit, të miratuar nga qeveria. Regjistrimi i furnitorëve përmes internetit është parakusht për pjesëmarrjen në prokurimet qeveritare përmes sistemit të prokurimit elektronik.

Për fushën prokurimit elektronik, identifikimi dhe fjalëkalimi i përdoruesit mund të jenë të besueshme, siç mund të jetë çdo metodë tjetër, duke përfshirë PKI. I vetmi dallim është se kodet e qasjes ndërlidhen me entitetin apo me individin. Në rastin e regjistrimit të përdoruesve përmes internetit, ky verifikim, zakonisht, nuk

bëhet në këtë fazë, por në fazën e kujdesit të veçantë, si, p.sh., në rastin e kontraktimeve nga qeveria.

Opsioni i dytë, janë certifikatat digjitale, të cilat i lëshon entiteti që menaxhon sistemin e prokurimit elektronik përmes internetit në momentin e regjistrimit. Edhe këto certifikata, ashtu si edhe identifikimi dhe regjistrimi i përdoruesve për prokurim elektronik, janë të cenueshme, pra, mund të vidhen.

Procesi i krijimit të identifikimit, duke përfshirë parashtrimin e informatave të tjera të besueshmërisë për qëllime të regjistrimit dhe të vërtetimit, duhet të kryhet përmes lidhjes së sigurt SSL. Gjithashtu, duhen trajtuar edhe kushtet për transferimin dhe ruajtjen e sigurt të të dhënave, si dhe për integritetin e tyre.

6.2.2.2 Regjistrimi i zyrtarit të prokurimit

Çdo zyrtar i përfshirë në procesin e prokurimit elektronik duhet të jetë i regjistruar online, përmes subjektit të prokurimit. Për të bëhet regjistrimi online i të dhënave të detajuara personale, i identifikuesit të listës së pagave, i informatave mbi departamentin/sektorin, i informatave mbi përgjegjësinë dhe i informatave të detajuara kontaktuese të përdoruesit. Subjektet e prokurimit dhe përdoruesit duhet të bëjnë dallimin midis tyre dhe lidhjen e tyre me nivelin qendror të qeverisë apo me autoritetet lokale.

Regjistrimi përmban nivelin e akreditimit (ku është në dispozicion), duke mos lejuar regjistrimin e paautorizuar.

6.2.2.3 Regjistrimi i komisioneve

Regjistrimi i komisionit të vlerësimit bëhet online nga ana e AQP-së, nga autoritetet lokale dhe nga subjektet e prokurimit, që kanë edhe autoritetin për formimin e komisioneve sipas ligjit të prokurimit. Gjatë regjistrimit online secili anëtar i komisionit duhet të nënshkruajë kodin e konfidencialitetit dhe kodin e etikës. Regjistrimi përfshin edhe të dhënat mbi emrat/identifikuesit e individëve në komision, mbi departamentin, rolin, pozitën; si dhe identifikimin e komisionit me kushtet me të cilat aplikohet kontrata. Secili anëtar komisioni duhet të jetë subjekt i nominimit nga autoriteti më i lartë i regjistruar. Nominimi duhet të regjistrohet në mënyrë automatike për auditim.

6.2.2.4 Regjistrimi i kompanive

Fushëveprimi i projektit përfshin zhvillimin e moduleve kyçe për regjistrimin e centralizuar të operatorëve ekonomikë, të autoriteteve kontraktuese, të kompanive, përfshirë edhe kompanitë e përbashkëta. Kategoria e kompanisë bën regjistrimin e të dhënave, si certifikatën e identitetit të saj; deklaratën mbi veprimtarinë; historikun; të dhënat mbi taksat, të dhënat e kontaktit; zyrtarët kryesorë; fushat e interesit (mallrat, shërbimet apo punët e TI etj.); kriteret, si industria, statusi i NVM-së, kodi i lokacionit, të dhënat/listat kontrolluese të hapjes së tenderave, leximet nga hapja e tenderave.

Kompania duhet, gjithashtu, të përditësojë online profilin e saj të regjistrimit në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së regjistrimit të saj.

Regjistrimet përcillen automatikisht në baza vjetore për veprimet e vazhdimet (ripërtëritjes) dhe përfundimit, si edhe njoftimet për përdoruesit e regjistruar për ripërtëritje me lidhje automatike dhe me kanale të prirura për njoftime.

Procedura e prokurimit për menaxhimin e përjashtimit ndërmerret nga KRPP-ja përmes faqes qendrore, me një regjistër të vetëm, i cili integron informatën mbi anulimin/refuzimin, në mënyrë që të sigurohet që kontraktorët/furnitorët/konsulentët të mos ndërmarrin veprimtari të mëtejshme të prokurimit me qeverinë. KRPP-ja aprovon/refuzon aplikacionet për regjistrim, duke u bazuar në sistemin e procesit të punës dhe në rregullat afariste.

Çregjistrimin e bën automatikisht një autoritet më i lartë.

6.2.3 Sistemi i ofertimit elektronik

Ofertimi elektronik apo tenderimi elektronik përfshin disa procese: bashkimin e kërkesës, përgatitjen e planit të prokurimit, publikimin dhe shpalljet elektronike, verifikimin e dokumenteve (miratimin), ftesat për tendera, REOI-të, RFP-të dhe metodat e tjera të prokurimit, shkarkimin e dokumenteve të tenderit, parashtrimin e ofertave, hapjen e ofertave dhe publikimin e dhënies së kontratës). Të gjitha këto realizohen në mënyrë elektronike. Kontraktorët mund t'i parashtrojnë ofertat e tyre në mënyrë elektronike që nga zyra dhe në mënyrë anonime. Gjithashtu, hapja e tenderit, marrja e vendimeve dhe dhënia e kontratave në rrugë elektronike realizohen përmes modulit të tenderimit elektronik.

Krijimi i procedurave të ofertimit elektronik, zakonisht, bëhet gradualisht, në disa faza, por, nëse e mundësojnë reformat e menaxhimit të dokumenteve, protokollet e sigurisë dhe interfejsët e teknologjisë së departamentit, këto faza mund të shkrihen me njëra-tjetrën. Nga aspekti teknik, elementi më i vështirë i ofertimit elektronik është problemi i sigurisë i parashtrimit të ofertave përmes internetit.

Dhënia e informatave në faqen qendrore të internetit lidhur me proceset ofertimit elektronik krijon dinamikë në përdorimin e kësaj faqeje të internetit nga agjencitë qeveritare dhe furnitorët.

Operacionet dhe cilësia e shërbimit të ofertimit elektronik duhet të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara nga Banka Botërore për zbatimin e sistemeve të prokurimit elektronik për huatë, grantet apo kreditë që ajo ofron. Këto standarde nuk janë të vështira për t'u arritur dhe përfshihen në planin e zbatimit.

Në sistemin e ofertimit elektronik duhet të ketë niveli të lartë të besueshmërisë së komponentëve të tij. E theksojmë këtë, sepse gjatë procesit ka edhe momente kritike, siç është faza e mbylljes së dorëzimit të ofertave nga ofertuesit (faza e e-ofertimit). Në rastin e ankandëve elektronike të anasjelltë, shumica e ofertave mund të vijnë gjatë minutave të fundit. Para përfundimit të ofertimit elektronik, nga furnitorët kërkohet që t'i qasen sistemit për dorëzimin e ofertave. Megjithatë, zakonisht, ndodh që furnitorët t'i dorëzojnë ofertat e tyre afër fundit të afatit për

dorëzimin e ofertave. Përveç kësaj, varësisht nga një njoftim specifik, oferta mund të përbëhet prej disa dosjeve, kur nuk ka më kohë. Kjo situatë mund të rezultojë me nevojën e transferimit nga mjedisi i TI-së së furnitorit te prokurimi elektronik i një sasive të madhe të dhënash, me disa megabajt, të cilat duhet të ruhen në servera të sigurt dhe të përshtatshëm.

Në situata të tilla periudha mbyllëse e ofertimit elektronik për secilin njoftim edhe mund të shkaktojë dështime, për shkak të problemeve me kapacitetet voluminoze të të dhënave. Po ashtu, prokurimi elektronik mund të dëmtohet nga ngjarje penguese, si defektet e lidhjes së internetit, sulmet dashakeqe, ndërprerja e energjisë, prishja e softuerit/harduerit etj.

Problematika të tilla obligojnë zbatuesit e sistemit që të marrin masa për të siguruar që sistemet e tyre të mund t'i kapërcejnë këto dukuri dhe për këtë duhet të përgatiten plane për trajtimin e rasteve të dështimeve kritike, duke parashikuar masa konkrete dhe planet për rimëkëmbje nga defektet dhe për vazhdimin e punës normalisht.

Sistemet e prokurimit elektronik duhet të projektohen për t'i përballuar ngarkesat tejet të mëdha të transaksioneve. Efikasiteti me të cilin kjo mund të arrihet në aspektin e kostos, kohës, cilësisë, etj. e përcakton shkallëzueshmërinë e sistemit. Shkallëzueshmëria e mirë e sistemit mund të arrihet përmes arkitekturës efektive të softuerit dhe/apo komponentëve të duhura të harduerit, të cilët duhet të jenë në gjendje që automatikisht të krijojnë mundësi për rifillimin menjëherë të punës.

6.2.4 Blerja elektronike

Blerja elektronike është elementi më i rëndësishëm për sa i përket ekonomizimit. Ajo është më e rëndësishme se ofertimi elektronik, kur kemi të bëjmë me biznese të vogla. Blerjet e mallrave, punëve dhe shërbimeve të konsulencës, me vlerë të ulët, në sasi të mëdha dhe që përdoren, zakonisht, përmes kuotimeve të drejtpërdrejta në tregun e hapur apo nga furnitorët e parakualifikuar, si dhe pagesa e blerjes përbëjnë aktivitete të prokurimit elektronik. Ky sistem i mundëson zyrtarit që bën blerjen të identifikojë një mall, shërbim apo punë në katalogun në internet, të lëshojë urdhërblerjen drejtpërdrejt apo të kërkojë kuotime nga tregu, duke e pasuar automatikisht me urdhërblerjen.

Kryerja e blerjes elektronike është relativisht komplekse, pasi duhen integruar rrjedha e punëve dhe transaksionet, si dhe të menaxhohen lloje të ndryshme blerjesh dhe informacionesh, përfshi edhe punët bankare për shumë blerës dhe shumë shitës. Blerja elektronike kërkon përfshirje më të madhe të furnitorëve në punën me katalogët në internet. Përmes saj lehtësohet blerja dhe zvogëlohen shpenzimet e transaksionit, gjë pa të cilën shumë marrëveshje kornizë nuk do të mund të zbatoheshin.

Kjo metodë përdoret për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve me vlerë të ulët, për të cilat ofertimet dhe ankandet nuk janë të nevojshme. Për blerje të tilla përdoret lista e burimeve të furnizimit. Ky nivel i blerjes përbën pjesën më të madhe të transaksioneve.

Si kapacitete funksionale të sistemit të blerjes elektronike, që janë të përshtatshme për prokurimin elektronik, specifikojmë: funksionalitetin e shumicës drejt shumicës (shumë blerës për shumë shitës); blerësit dhe shitësit e decentralizuar; integrimin me rrjedhën e punës/SMIP; kërkimin e furnitorëve përmes emërimit, kategorisë, kodit të vendit dhe kontratës; përzgjedhjen gjithëpërfshirëse (100%) të kuotimit me standarde sipas çmimeve minimale; krijimin dhe dhënien e të gjitha kërkesave të prokurimit për informim dhe kuotim; krijimin e kërkesave për blerje; krijimin e urdhërblërjeve dhe rrjedhën e punës së miratuesit opsional; krijimi i raporteve të pranimit (plotësimit); mundësia për përshtatjen e "politikave të blerjes"; menaxhimi i të dhënave të blerësit; menaxhimi i të dhënave të furnitorit; mundësia për regjistrim të njehershëm; integrimi/interfejsi i SMIF-it; raportimi për të gjitha aktivitetet e tregut; integrimi i pagesave; menaxhimi, regjistrimi dhe raportimi i rrjedhës së punës së zinxhirit furnizues.

Pasi të jetë aprovuar kërkesa nga autoriteti i duhur, bëhet krijimi automatik i urdhërblërjes. Sistemi e lidh numrin e urdhërblërjes me numrin e kërkesës, për të mundësuar përcjelljen. Po ashtu, sistemi plotëson vetë urdhërblërjen me detajet e departamentit dhe të ngarkesës.

Blerësi/departamenti i blerjes i lëshon urdhërblërjet në mënyrë selektive. Programimi i urdhërblërjeve është i konfigurueshëm dhe lejon mënyrat vijuese të lëshimit të urdhërblërjes për furnitorët.

Sistemi i blerjes elektronike funksionon kështu: Kur mallrat ose shërbimet specifike duhet të blihen, sistemi në mënyrë automatike kërkon kuotimet apo lëshon urdhërblërjen (varësisht prej marrëveshjes kornizë) dhe përzgjedh ofertën më të ulët, brenda rregullave të blerjes, të cila mund të jenë specifike për zonën apo lokalitetin. Pas miratimit nga blerësi, malli apo shërbimi i përzgjedhur porositet drejtpërdrejt përmes internetit nga furnitori dhe mjetet e nevojshme për pagesë ndahen automatikisht brenda SIMF-it. Pasi të jetë dërguar porosia, personi i autorizuar që pranon dërgesën fut pranimin në sistem. Çfarëdo ndërhyrjeje subjektive nga operatori eliminohet përmes rregullave të punës. Më pas sistemi përpunon automatikisht urdhërpagesën për furnitorin, kërkon pagesën, kërkon autorizimin e çekut, përditëson llogaritë, trajton çdo çështje tatimore, regjistron përditësimet e inventarizimit dhe informatat në bazën e të dhënave dhe i përcjell ato automatikisht, për përdorim në procesin e auditimit dhe të mbikëqyrjes qeveritare dhe publike.

6.2.5 Sistemi i pagesave elektronike

Sistemi i prokurimit elektronik përfshin metodat e pagesave përmes internetit. Idealisht, në procesin e prokurimit trajtohen në mënyrë elektronike të gjitha pagesat, pagesat e furnitorëve për qeverinë dhe pagesat e kontratave nga qeveria për furnitorët. Këto pagesa mund të përpunohen manualisht, por kjo mënyrë është joefikase. Me zbatimin e plotë të kryerjes së pagesave në rrugë elektronike, procesi i përpunimit të pagesave lehtësohet shumë, por modernizohet edhe pranimi i tarifave për blerjen e dokumenteve të ofertimit të tarifave për regjistrim etj.

Në mënyrë elektronike kryhen edhe pagesat për kontraktorët për ofrimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve; pranimi dhe menaxhimi i garancisë bankare për performancën elektronike; tarifat e tjera për shërbimet e vlerës së shtuar nga portali i prokurimit elektronik.

Këtë proces e lehtëson shumë edhe përdorimi i kartave elektronike të debisë apo të kredisë, hapja e një xhirollogarie qendrore në bankën kryesore për përpunimin elektronik të regjistrimit, të faturave për tarifat e transaksionit, të fletobligacioneve e të kthimeve të tyre. Nga banka e përzgjedhur mund të kërkohej që të integrojnë zgjidhjet e saj për pagesat elektronike me sistemin e prokurimit elektronik.

Aranzimet e pagesave elektronike janë disa. Në sistemin e prokurimit elektronik mund të kërkohej pagesat elektronike për: pagesën për dokumentacionin e tenderit; për sigurinë e tenderit; për sigurinë e performancës; për pagesën e kontraktorit; për abonimin për shërbimin e vlerës së shtuar të prokurimit elektronik – njoftimeve mobile, shërbimet e rrjetit, hapësirë shtesë për ruajtje të dokumenteve etj.

Duhet të ekzistojë një dispozitë për kontraktorë për bartjen e këtyre fondeve përmes një numri instrumentesh bankare të miratuara dhe të specifikuara, siç janë:

- ✚ Kartela e kreditit/kartela e blerjes/kartela e debitit;
- ✚ Punët bankare përmes internetit;
- ✚ Transferimi Elektronik i Fondeve (TEF);
- ✚ Me para në dorë.

Dizajni i sistemit të pagesave elektronike siguron që nga shitësit të mos kërkohej të hapin xhirollogari në bankë, ata mund t'i bëjnë pagesat në cilëndo bankë ku e kanë llogarinë e hapur. Po ashtu, mund të përdoren edhe metoda të tjera, me kusht që kërkesat vijuese të plotësohen pa ndërhyrje manuale.

Vërtetimi i pranimi të pagesës: numri unik dhe i pakthyeshëm i referencës krijohet si vërtetim për pranimin e pagesës së bërë nga kontraktuesit.

Përmes procesit të barazimit barazohet pagesa e pranuar në xhirollogarinë qendrore grumbulluese me kërkesën për shërbimin e caktuar, për të cilin është bërë pagesa (duke përdorur numrin e referencës për kërkesën e shërbimit).

Gjithashtu, përmes sistemit të prokurimit elektronik duhet të jemi në gjendje të vërtetojmë pranimin e pagesave brenda afatit të arsyeshëm kohor (më së shumti dy ditë pune).

Një parakusht për pagesën elektronike të kontratave është ndërveprueshmëria mes sistemit financiar dhe sistemit të prokurimit elektronik. Sistemi i krijon fatura subjektit të prokurimit. Ofertuesi duhet shton/heq rreshta në faturë dhe shkruan formulat bazike, si SHUMA (SUM), % etj. Ai kalkulon në mënyrë automatike datën kur duhet bërë pagesa, bazuar në kushtet e kontraktuara, përveçse kur anashkalohen në mënyrë manuale. Ofertuesi duhet t'i ruajë faturat si draft dhe të programojë dërgimin automatik/manual të tyre te subjekti i prokurimit.

Sistemi mund të përcjellë dhe të mirëmbajë llogarinë e progresit të pagesave dhe të paradhënies së ofertuesit. Ai mundëson shlyerjen/rregullimin e pagesës në tri mënyra: me faturë, urdhërblerje, me vërtetim për pranimin e mallrave, si edhe delegimin e rregullimit të përgjegjësisë së pagesës departamentit të centralizuar.

Gjithashtu, sistemi bën integrimin me pagesën online, të siguruar nga palët e treat, me qëllim zgjidhjen e pagesës.

I tërë procesi i pagesës elektronike ndërlidhet me orarin e punës, me kushtet e pagesës, me modulën e pagesës dhe me regjistrin e autoritetit.

Në mungesë të porteve për pagesa përmes internetit, mund të zbatohen opsione të tjera të mundshme për sistem të sigurt të pagesave. Opsioni i preferuar është mekanizmi Automated Clearing House/kliringu i automatizuar.

Moduli ndihmues

Moduli ndihmues ofron për tërë sistemin e prokurimit këshilla konsistente, me grafika lehtë të përdorueshme, me shfletim të faqes së internetit, prezantim të përmbajtjes, lokalizim dhe ndihmesë e bazuar në kontekst. Po ashtu duhet të ofrojë doracak për përdorues, videoincizime dhe pyetjet më të shpeshta me qëllim të përkrahjes së shfrytëzuesve për përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik në mënyrë të efektshme. Funksionimi i modulit ndihmues më tej është trajtuar më poshtë.

6.2.6 Katalogët elektronikë

Katalogët janë një standard bazë për prokurimin elektronik. Procesi fillon nga publikimi i artikujve përmes internetit nga furnitorët, vazhdon me përzgjedhjen elektronike, me porosinë, pranimin dhe pagesat nga entiteti blerës.

Një katalog i marrëveshjes kornizë përmban emërtimin e artikullit, kodin dhe përshkrimin e tij, masën matëse, emërtimin e furnitorit, numrin e pjesës së furnitorit (nëse ka) etj. Ky lloj katalogu lejon çmime të ndryshme, duke specifikuar tarifat e spedicionit (nga aspekti i zonës), tatimet, zbritjet për shfrytëzuesit specifikë etj. në lokacione të ndryshme etj.

Katalogët për prokurim elektronik përfshijnë edhe kodet e klasifikimit dhe të identifikimit. Kodet e klasifikimit kërkohen për të lejuar futjen e të dhënave në formularin përgjithësues për raportim dhe analizë. Për shembull, raporti financiar mund të paraqesë shpenzimet e prokurimit për disa kategori të gjëra artikujsh, si TI-ja, automjetet etj. Në ta janë përmbledhur dhe të analizuar me hollësi mijëra artikuj. Në prokurimin me letra, kodet e klasifikimit janë më pak të rëndësishme, thjesht sepse ka pak mundësi për t'iu qasur të dhënave, për t'i mbledhur dhe analizuar ato kur janë në formatin në letër, në zyra dhe dosje të shumta. Dallimet mes kodeve identifikuese dhe klasifikuese paraqiten në figurën 4.



Figura 4 Kodet klasifikuese dhe kodet identifikuese

Katalogu ndërtohet gjatë çdo prokurimi të ri. Në të bëhet regjistrimi për çdo artikull, që përshkruhet me fjalë dhe me fotografinë. Kodi klasifikues është ndërkombëtar, që funksionon në BE, dhe quhet Fjalori i Përbashkët i Prokurimit (FBP). Përmes këtij fjalori promovohet konsistenca ndërkombëtare për lehtësimin e shitblerjes. Ai përputhet me shumicën e kodeve doganore.

Skema e klasifikimit duhet të bëjë ndarjen mes punëve, mallrave apo shërbimeve të blera. Kjo skemë klasifikon produktet e identifikuara në format hierarkike, për të mundësuar analizën ‘nga lart-poshtë’ dhe nga ‘nga poshtë-lart’.

Përmes fjalëve kyçe, numrave dhe sistemeve standarde të klasifikimit, katalogët mundësojnë kërkimin e lehtë, përcjelljen e urdhërblërjeve dhe të kërkesave për informim, blerjen përmes kartave të kreditit dhe mundësi të tjera.

Zbatimi i kodit të përbashkët të klasifikimit ka shumë përparësi. Ai lehtëson bashkimin e kërkesës për blerje elektronike (prokurimi i grumbulluar, kontrata kornizë) dhe prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të tjera; automatizon grumbullimin dhe analizën e të dhënave për shpenzime, me qëllim buxhetimin dhe planifikimin; rrit transparencën dhe monitorimin e raportimin e performancës; mundëson kuotimet e automatizuara të çmimeve për blerje; unifikon sistemet e menaxhimit financiar dhe raportimin e prokurimit etj.

Katalogët elektronikë kërkojnë administrim të kujdesshëm. Ato duhen regjistruar dhe përditësuar vazhdimisht. Përmbajtja e tyre duhet të kontrollohet në përputhje me kushtet e një marrëveshjeje individuale ndërmjet departamentit dhe furnitorëve të tij dhe të pasurohet herë pas here. Vëmendje kërkon edhe redaktimi dhe publikimi i tyre, duke adoptuar në to edhe Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit.

6.3 Fushëveprimi i prokurimit elektronik

Sistemi i prokurimit elektronik duhet të kuptohet si një platformë bashkëpunuese qeveritare e prokurimit. Përdoruesit e drejtpërdrejtë të sistemit mund të jenë, siç e kemi thënë më sipër, entitetet e prokurimit, KRRPP-ja, AQP-ja, operatorët ekonomikë, ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe qytetarët në përgjithësi. Të gjitha palët e interesuara në procesin e prokurimit do të kenë qasjen e duhur, duke përdorur emrin e tyre të sigurt të përdoruesit dhe kodet e qasjes, si dhe do të kenë tavolina punuese private dhe të sigurt.

Standardet e veprimit të sistemit të prokurimit elektronik, gjatë dekadës së fundit kanë evoluar dhe kanë avancuar. Karakteristikë kryesore e tyre është integrimi dhe ndërveprimi mes sistemeve të brendshme dhe të jashtme të zyrave për këmbimin shumëpalësh të informatave të prokurimit mes entiteteve qeveritare dhe shumë blerësve e furnitorëve. Theksi vihet në çështjet teknike të tilla, si: siguria e informatave, ndërveprueshmëria dhe besueshmëria, shkalla dhe disponueshmëria, të cilat janë të rëndësishme që sistemi i prokurimit elektronik t'i plotësojë vëllimet më të mëdha të transaksioneve.

Platforma e prokurimit elektronik përfshin: regjistrimin e prokurimit; panelin (BAM); tenderimin elektronik; ankesat elektronike; prokurimin e centralizuar; marrëveshjet kornizë; kontratat elektronike; ankandet elektronike; ankandet e kthyer; auditimet; e-PMIS; kuotimin elektronik; Ueb-shërbimet (regjistri i taksave, ID elektronik etj.).

Siç e kemi përmendur, tashmë, në Kosovë ekzistojnë rregullime të kënaqshme institucionale për zbatimin e prokurimit elektronik. Po ashtu, në nivel të kënaqshëm është edhe legjislacioni i prokurimit dhe legjislacioni i tregtisë elektronike, përveç disa ndryshimeve, për të cilat janë paraqitur në këtë studim disa propozime dhe rekomandime.

Praktikat ndërkombëtare lidhur me zbatimin e prokurimit elektronik dukshëm ndryshojnë. Disa qeveri kontraktojnë ofrues vendorë të shërbimeve apo edhe të jashtëm, në mënyrë që ata të merren me të gjitha aspektet e prokurimit elektronik, ku qeveria vetëm jep të dhëna. Disa qeveri të tjera mbajnë pronësinë dhe posedimin e sistemit të tyre të prokurimit elektronik dhe kontraktojnë menaxhmentin; të tjerat mbajnë pronësinë dhe operacionet. Të gjitha këto mundësi janë teknikisht të mundshme, por këto çështje shkojnë përtej aspekteve teknike. Kjo, në fakt, shpesh është çështje e politikave të shtetit. Brenda BE-së, autoritetet kontraktuese kanë qenë të ngadalshme në shfrytëzimin e kësaj teknologjie dhe kjo ngadalësi u është atribuar kostove të riorganizimit të sistemeve të brendshme dhe të vetëdijesimit rreth përparësive. Shumë autoritete kontraktuese dhe furnizues kanë zbatuar qasjen “të presim dhe të shohim se ç’do të bëhet”. Përveç rreziqeve të ndërlidhura me teknologjinë, ata shqetësosheshin edhe për rreziqet e ndërlidhura me integrimin e këtyre teknologjive me sistemet ekzistuese të informimit, me modelin e punës që këto teknologji ua imponojnë marrëdhënieve të autoriteteve furnitore-kontraktuale dhe mekanizmave të sigurisë e të kontrollit, që nevojiten për të siguruar shfrytëzimin e tyre të duhur.

Qeveria e Kosovës ka preferuar t'i mbajë këto kapacitete plotësisht, megjithatë, këto çështje nuk janë të thjeshta. Ato përfshijnë edhe zhvillimin e sektorit vendor të TI-së dhe të kapaciteteve të qeverisë për të shfrytëzuar ekspertizën e TI-së nga punonjësit qeveritar. Nga ana tjetër, ekzistojnë çështje të sigurisë, të bërjes së konsumatorit të varur nga produktet apo shërbimet, të zhvillimit të aftësive, të udhëheqjes politike dhe të rrezikut politik. Duhet një strategji e prokurimit që të pasqyrojë edhe kufizimet, përfshirë çështjet e kapaciteteve, të legjislacionit, të ndërveprueshmërisë së sistemit, të modelit të punës dhe të kornizës së qeverisjes për prokurim.

Fushëveprimi i sistemi të e-Prokurimit përfshin edhe shkëmbimin me TI-të informacioneve të rëndësishme, për të vërtetuar dhe procesuar të dhënat në mënyrë efektive. Tri institucionet kryesore me të cilat sistemi shkëmben të dhëna janë:

a) Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) - për të verifikuar të dhënat e subjekteve, si dhe detyrimet e tyre tatimore. Duke përdorur numrin fiskal ajo kontrollon ekzistencën e subjektit, merr të dhënat bazë dhe kontrollon nëse subjekti ka paguar të gjitha taksat.

b) Thesari i Kosovës - për të verifikuar informatat financiare dhe buxhetore lidhur me entitetet dhe detyrimet e tyre për autoritetin kontraktues ose ndonjë subjekt tjetër. Ky i fundit kontrollon pagesat për faturat që janë dërguar nga furnizuesi, si dhe verifikon nëse kodi UNIREF është përdorur saktë gjatë pagesës së depozituar për ankesë nga një operator ekonomik.

c) Autoriteti kontraktues pranon faturat dhe menaxhon pagesat e Thesarit përmes softuerit për menaxhim financiar "Sistemi FreeBalance" dhe kërkesës së duhur për uebshërbime.

d) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - për të verifikuar dhe vërtetuar certifikatat në e-ID karta.

Sistemi i e-Prokurimit ndërvepron edhe me sistemet e jashtme për verifikim, merr informacionet në lidhje me regjistrimin e biznesit, taksat dhe pagesën e TVSH-së, informacionin e përditshëm për këmbim valutash dhe e-Katalogun.

Në disa raste sistemi i prokurimit elektronik ofrohet 'falas', me kusht që pranuesi të paguajë përshtatjet e nevojshme, në mënyrë që sistemi t'i përshtatet politikave, proceseve dhe gjuhës. Kjo përshtatje bëhet nga ofruesi i sistemit sipas tarifave të. Zakonisht, kostoja në këtë rast është më e madhe sesa në rastin nëse qeveria pranuese të kishte krijuar sistemin e vet që nga fillimi.

Po ashtu, në fushëveprimin e e-Prokurimit ekziston edhe modeli i Partneriteteve Publike – Private (PPP), i cili është përdorur në disa raste. Një mundësi tjetër është modeli "Krijo, Mbaje në Pronësi dhe Bart" (Build Own Operate and Transfer (BOOT) ose "Krijo, Puno dhe Bart" (Build, Operate and Transfer (BOT). Këto qasje shërbejnë për krijimin e sistemeve të përshtatura për qeverinë dhe për funksionimin e tyre dhe, njëkohësisht, për zhvillimin e shkathtësive vendore.

Ndërveprimin me aplikacionet kompjuterike në nivel vendi, rajoni, madje, edhe ndërkombëtar e lehtësojnë politikat e TIK-ut lidhur me sistemin e prokurimit elektronik, të cilat parashikojnë që investimet të jenë të nivelit të gjerë, të zhvillohen

përmes internetit, duke përdorur standarde të hapura dhe arkitekturë të hapur. Në rastet kur kërkohet ndërveprimi mes platformave, realizohet komunikimi sikron dhe asinkron (këmbimi i porosive) me sistemin e prokurimit elektronik dhe me aplikacionet e departamentit. Sistemi i prokurimit elektronik përdor protokolle për zhvillimin e sistemeve për komunikim, që janë të hapura dhe me standardet e duhura.

Rëndësia të madhe ka edhe ndërveprueshmëria teknike në sistemin e prokurimit elektronik. Kjo bën të mundur që prokurimi elektronik të ketë ndërlidhje të duhura dhe të hapura për ndërveprimin mes sistemeve të ndryshme operationale, si dhe me sistemet dhe aplikacionet që janë nën zhvillim e sipër. Prokurimi elektronik mund të realizohet në atë mënyrë që mundëson ndërveprueshmërinë me sistemet ekzistuese të trashëguara, ku mundësohet edhe ripërdorimi i sistemeve ekzistuese dhe minimizimi i kostove.

Për trajtimin e kushteve të ndërveprueshmërisë, prokurimi elektronik duhet t'i zbatojë strategjitë vijuese:

Arkitektura e Orientuar drejt Shërbimit (AOSH): AOSH-ja ka të bëjë me ndërtimin e pavarur të shërbimeve, të cilat mund të kombinohen në procese domethënëse të nivelit më të lartë të punës në kuadër të kontekstit të një sistemi aplikacionesh, siç është prokurimi elektronik.

AOSH i përmban aspekte të ndryshme të aplikacionit:

Detajet ("copëzat") dhe llojet e shërbimeve (copëzimi nënkupton madhësinë dhe shkallën e funksionalitetit në një ndërveprim të caktuar); mënyrën e ndërtimit të shërbimit; mënyrën e kombinimit të shërbimit; mënyrën e komunikimit të shërbimit në nivelin teknik; mënyrën e ndërveprimit të shërbimit në nivel semantik.

Me aplikimin e AOSH-së në dizajnimin e komponentëve themelore, zbatuesit e sistemit të prokurimit elektronik sigurojnë përmirësimin domethënës të fleksibilitetit të sistemit, duke i ripërdorur njëkohësisht komponentët e biznesit. Ky aspekt duhet të jetë pjesë e fazës së dizajnit të sistemit të prokurimit elektronik. Sistemi i prokurimit elektronik duhet të dizajnohet në një mënyrë që kapacitetet e ardhshme të ndërveprueshmërisë të përmirësohen përmes miratimit të standardeve të duhura.

Në raste nevojë për ndërveprim mes platformave duhet të përdoren edhe protokollat e hapura ndërkombëtare të bazuara në XML (SOAP dhe XML-RPC): Protokollat e komunikimit të bazuara në XML Për më tepër, SOAP dhe XML-RPC janë komponente standarde të pothuajse çdo mjedisi dhe përbëjnë dy protokolle që mundësojnë komunikimin në distancë mes platformave në mënyrë të standardizuar dhe të përshtatshme.

Kapacitetet e ndërveprimit dhe të integritetit varen nga korniza specifike zhvillimore e cila përdoret: varësisht nga korniza zhvillimore e përdorur. Një nga opsionet e popullarizuara është përdorimi i J2EE. Arkitektura e ndërlidhësit J2EE (JCA) për kornizën J2EE, si shembull, mund të ndihmojë në krijimin e mjedisit për ndërveprim të sigurt të sistemit. JCA përkufizon dhe mundëson mënyrën standarde për lidhjen e aplikacioneve J2EE me sistemet heterogjene të informatave të ndërmarrjeve (EIS). EIS përbëhet prej sistemeve të planifikimit të burimeve të ndërmarrjes (ERP), sistemeve të bazës së të dhënave dhe aplikacioneve të ndryshme ekzistuese. Për më tepër, JCA ofron një numër mekanizmash të shkallëzuar, të sigurt

dhe të transaksioneve për të mundësuar lidhjen me EIS, ku kemi treg mjaft domethënës të përshtatësve JCA për të thjeshtësuar integrimin e aplikacioneve të ndërmarrjes.

Gjatë kalimit në prokurimin elektronik, procedurat tradicionale të bazuara në letër mund të funksionojnë paralelisht. Por rekomandohet që kjo të zgjatë vetëm për një periudhë shumë të kufizuar. Sistemet paralele e ngadalësojnë zbatimin e plotë të prokurimit elektronik dhe shtojnë ndërlikueshmëri administrative, si dhe e ulin sigurinë. Orari i caktuar në faza i këtyre zhvillimeve paraqitet në tabelën 6. Fazat e zbatimit janë udhëzim e jo përshkrim dhe duhet të udhëhiqen nga KDP-ja.

Tabela 6 Orari i sistemit të prokurimit elektronik

E-Procurement Implementation						Timelines											
No.	Project Task					Year 1				Year 2				Year 3			
						Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
A	PPRC to finalise strategy					■											
B	Cabinet endorsement					■											
C	Establishment of Institutional Structures					■											
	Project Steering Committee					■											
	Project Implementation Committee					■											
	PMU with Programme Director					■											
	Decision on Business Model including revenue options					■	■	■									
D	e-Procurement in Pilot Entities					■	■	■	■								
	Identification of pilot entities					■											
	Formation of task teams in pilot entities					■											
E	PPRC, PMA					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	Specification of core technical standards for the e-procurement system					■											
	Formulation of Common item code classification standards - CPV					■											
	Adoption and online conversion of an existing Framework Contracts					■	■	■	■	■	■	■	■				
	Demand aggregation policies in select categories					■	■	■	■	■	■	■	■				
	Development of buyer delegations register standards					■	■	■	■	■	■	■	■				
	Specification of supplier pre-qualification processes					■	■	■	■	■	■	■	■				
F	Pilot entities					■	■	■	■								
	Business Process Re-engineering of processes					■	■	■	■								
	Development of buyer delegations					■	■	■	■								
G	PPRC					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	Formulation of policies to enable and promote e-procurement					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
H	PPRC					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	Drafting / Enactment e-signatures and e-documents rules					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
I	Design, develop and launch e-procurement service					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	1 Specify functional requirements					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	2 Specify technical requirements					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	3 Select development partner and national counterpart					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	4 Develop the Procurement Portal					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	5 Launch the Procurement Portal					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	6 Develop the e-tendering module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	7 Pilot implementation of e-tendering module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	8 Roll-out of e-tendering module at national level					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	9 Develop the e-quoting and framework agreement module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	10 Pilot implementation of e-quoting					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	11 Roll-out of e-quoting					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	12 Design and develop the vendor registration module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	13 Design and develop the vendor classification process					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	14 Pilot the vendor management module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	15 Roll out the vendor management module at the national level					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	16 Design and develop the e-purchasing module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	17 Pilot the e-purchasing module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	18 Roll out the e-purchasing module at the national level					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	19 Design and develop the e-contract management module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	20 Pilot the e-contract management module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	21 Roll out the e-contract management module at the national level					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	22 Integrate the e-payments module					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
J	Hardware and Infrastructure					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	Follow open standards and open architecture for GIF					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
K	Private Sector integration capacity and awareness					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■

6.3.1 Ndhimesa e internetit

Në funksionimin efikas të sistemit luan rol të veçantë ndihmesa që interneti u ofron në çdo kohë përdoruesve që realizojnë aktivitete në sistem. Përmes internetit, përdoruesi ndihmohet për të njohur dhe për të kuptuar funksionalitetet e shërbimeve që ofron sistemi. Ai gjen aty doracakët, magjistarët (wizards), kalimet (walkthroughs) dhe demonstruesit, që janë një ndihmë e madhe për të gjitha kategoritë e përdoruesve. Dokumentet ndihmëse në internet, fjalorthët, këshillat dhe pyetjet e parashtruara ndihmojnë për të pasur qasje të shpejtë dhe të lehtë në përkufizimet e qarta për të gjitha fushat e përdorura (çfarë përfaqësojnë, çfarë masin etj). Udhëzuesit për përdorues mund të shpjegojnë në hollësi GUI e prokurimit elektronik, për shembull, duke përdorur *screen-shots* dhe përshkrimet tekstuale, ku gjenden përgjigje për pyetjet që parashtrojnë shpesh përdoruesit.

Një proces i suksesshëm i e-Prokurimit varet shumë nga saktësia e të dhënave që përdoruesit fusin në sistem përmes formularëve të plotësuar në internet. Vlefshmëria e tyre mund të kontrollohet, si nga ana e serverit, ashtu edhe nga klienti. Përmes serverit verifikohet vlefshmëria e të dhënave të ofruara nga përdoruesi, kur përdoruesit i qasen prapë të njëjtët formularë me porosi përshkruese të paralajmërimit për fushat që janë plotësuar gabimisht. Nga klienti verifikohet vlefshmëria e të

dhënave të ofruara nga përdoruesi duke përdor logjikën e punës për t'i gjetur dhe për t'ia shpjeguar përdoruesit gabimet.

Përdoruesit që kryejnë aktivitete “domethënëse” (krijimi i thirrjes, paraqitja e ofertës etj.) informohen duke përdorur nga interneti faqet informuese/konfirmuese dhe mekanizmat të lajmërimit të automatizuar.

Mundësitë e ndihmës përmes internetit mund të vihen në dispozicion në të gjitha gjuhët që njeh sistemi.

Por, kuptohet, shfrytëzimi i internetit ka edhe kufizimet e veta, në aspektet e kapaciteteve, të legjislacionit, të ndërveprueshmërisë së sistemit, të modelit të punës dhe të kornizës së qeverisjes për prokurim. Kjo lidhet me kostot e riorganizimit të sistemeve të brendshme dhe me vetëdijesimin rreth përparësive.




Figura 5. Kushtet për zhvillimin e prokurimit elektronik

Në figurën e mësipërme jepen modelin institucional, legjislativ, funksional i strategjisë së implementimit të e-Prokurimit, teknologjia dhe standardet, modelet e biznesit funksionaliteti dhe metodat sistemit, por edhe çështje të politikave dhe kapaciteteve në nivel shteti, njësia për menaxhimin e projektit etj.

6.4 Infrastruktura Kryesore Publike (Nënshkrimet digjitale)

Infrastruktura Kryesore Publike (IKP) përbëhet nga një sërë rregulloresh për shërbimet e teknologjisë, lidhur me nënshkrimet digjitale. Përdorimi i nënshkrimeve digjitale është pjesë e një koncepti më të gjerë të sistemit elektronik të prokurimit. Në kuptimin e ngushtë matematikor nënshkrimet digjitale janë të vështira për t'u falsifikuar, megjithatë, edhe ato mund të komprometohen përmes mënyrave të menaxhimit dhe atyre teknologjike apo përmes vjedhjes fizike të identitetit të përdoruesit të sistemit.

Raste të tilla komprometimi vijnë për shkak të dobësive të IKP-së, të cilat janë: vjedhja e identitetit, përdorimi i identitetit të rremë, pasiguria e serverit verifikues, mungesa e garancisë; vështirësitë në menaxhimin e IKP-së; mungesa e menaxhimit të rrezikut; mungesa e mënyrës për caktimin e përgjegjësisë apo kur një furnitor huazon certifikata, në mënyrë që të ofertojë në emër të disa furnitorëve të ndryshëm etj.

Duke pasur parasysh këto, është e domosdoshme që hartimi i rregulloreve për nënshkrimet elektronike në e-Prokurim të shqyrtohet me kujdes. Shpesh këto rregullore hartohen sipas mënyrës 'tradicionale' të nënshkrimeve të vërtetuara digjitale, duke u bazuar në supozimin joekzistent se IKP-ja është standard. Pjesa dërmuese e biznesit elektronik sot bëhet pa nënshkrimet digjitale të klientëve, përfshi edhe industrinë bankare.

BE-ja nuk i konsideron të obligueshme nënshkrimet e vërtetuara digjitale, por vetëm i lejon ato, madje, është rekomanduar që edhe ky qëndrim të rishikohet, pasi nënshkrimet elektronike mund të jenë një pengesë e panevojshme për hyrje në sistemin e prokurimit elektronik, veçanërisht në rastet kur nuk ka njohje të ndërsjellë. Ndaj axhenda digjitale e Europës parashikon rishikimin e legjislacionit për nënshkrimet elektronike dhe përsheptimin e punëve në fushën e identifikimit elektronik.

Shumë vende vazhdojnë të përdorin sistemin e prokurimit elektronik pa obliguar përdorimin e nënshkrimeve të vërtetuara digjitale, ku përfshihen Australia, Singapori, MB dhe SHBA. UNCITRAL tani ka ndryshuar Ligjin e tij model për të hequr çfarëdo kushti të nënkuptuar për IKP. Disa vende që më parë kishin miratuar IKP-në tanimë e kanë braktisur atë (Singapori, Australia, Argjentina...). Një punë mjaft e madhe është duke u bërë edhe lidhur me zbatimin e aspekteve biometrike në internet, për shembull në kornizën MERCOSUR në Amerikën Latine. (KORNIZA IBERO-AMERIKANE E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK, korrik 2011).

6.5 Sistemet e Menaxhimit të Prokurimit

6.5.1 Sistemi i Menaxhimit Informativ të Prokurimit (SMIP)

Pronësia e informatave, përpunimi dhe zhvillimi i tyre është një çështje që ka rëndësi politike, administrative dhe në politikëbërje. Si e tillë duhet të trajtohet ajo dhe jo nga ekspertët e teknologjisë, sepse shkon përtej aspekteve teknike. Ajo ka të

bëjë me thelbin e kontrollit dhe me pronësinë e informatave të qeverisë, me sigurinë e tyre, me identifikimin e sistemit nga përdoruesit.

Pronar i sistemit të informacionit është KRPP. SMIP përfshin të gjitha informatat që lidhen me tërë procesin e prokurimit publik, me rrjedhën e punëve, me lejet/autorizimet, me kontratat dhe planifikimin e tyre, me blerjet dhe pagesat, si dhe me të gjitha ndërveprimet mes palëve të interesuara në prokurim. Gjithashtu, SMIP trajton bartjet e informatave në cilëndo pjesë dhe fazë të procesit të prokurimit. Në funksionet e tij bën pjesë edhe siguria e informacionit nëpër institucione entitete të ndryshme që përfshihen në procesin e prokurimit.

Sistemi ka kapacitete të regjistrojë dhe të publikojë variacionet e kontratave për çmimin fitues, sipas artikullit apo sasisë së blerë, grumbullon informata që mund të përdoren për matjen e performancës së entiteteve në prokurimin publik; përmban regjistrat e rëndësishëm të informatave të sistemit të prokurimit elektronik, që paraqiten në figurën 6. Teknologjia i ul kostot marginale të informatave menaxheriale dhe të auditimit nga një nivel i lartë në pothuajse zero. Prokurimi elektronik po ashtu ofron informata më domethënëse dhe me kohë rreth prokurimit, të cilat krijojnë potencialin për analiza të rregullta dhe raportime për shumë palë të interesit. Ky aspekt i informatave nuk mund të pritët të funksionojë në mënyrë efektive në mjedisin e prokurimit me bazë letrat.

Është me rëndësi të thuhet se SMIP, me pasurinë e informacionit që trajton dhe menaxhon, është thelbësor për analizat gjithëpërfshirëse të shpenzimeve, të cilat duhet të bëhen çdo tre muaj apo, së paku, një herë në vit, në departamente, në ministri apo në qeveri, përmes të cilave shqyrtohet se ç'është blerë, kush janë blerësit dhe vlerat, vëllimet dhe trendet e transaksioneve etj. Nëpërmjet kësaj analize krijohet baza për argumente në favor të prokurimit elektronik dhe mund të krijohen indikatorët kryesorë të performancës së këtij sistemi.

Këto funksione dhe kapacitete e bëjnë zhvillimin e SMIP një pikë kryesore të agjendës së prokurimit elektronik, me të gjitha dokumentet e standardizuara dhe me udhëzues dhe politika për realizimin e aktiviteteve të menaxhimit të brendshëm të departamenteve. Gjithashtu, ai mundëson ndërveprimin me procesin e mbarëvajtjes së punëve, të krijimit dhe menaxhimit të kontratës, përfshirë edhe raportimin.

Edhe pse zbatohet arkitektura konsistente, disa aspekte të funksionimit të SMIP-së kanë nevojë të përshtaten prej departamentit në departament. Funksionimi dhe konsolidimi i SMIP lidhet ngushtë me sistemet e menaxhimit të prokurimit në çdo agjenci.

Këto dhe kushtet e tjera paraqiten në figurën 6, ku ilustrohen udhëzimet dhe fushëveprimi i moduleve të SMIP.

Punët që po bëhen për konsolidimin e SMIP-së janë ngushtë të lidhura me sistemet e menaxhimit për prokurim në çdo agjenci. Në kuadër të sistemit të prokurimit elektronik duhet të zhvillohet një proces i standardizuar dhe me cilësi të garantuar i mbarëvajtjes së punës. Gjithashtu, duhet të shfrytëzohet mundësia për shfrytëzimin e konsolidimit të SMIP-së për të shqyrtuar rregullat aktuale dhe proceset e menaxhimit me qëllim të identifikimit të atyre që mund të futen në rrjedhat e duhura, të modifikimit apo të braktisjes. Përmes integritetit të sistemeve për menaxhimin e

inventarizimit me SMIP, mund të arrihen zvogëlimet e mëtejme të shpenzimeve të prokurimit.

Futja në SMIP, e të dhënave kryesore të inventarizimit dhe e të dhënave për artikujt e vjetruar, paraqitja e udhëzimeve në fushën e politikës së prokurimit lidhur me nivelet minimale të inventarizimit për situata emergjente, menaxhimi i inventarizimit, heqja e artikujve të vjetruar përmes shitjes në ankande elektronike, etj, do të mund të çonin në përfitime domethënëse. Kështu, për shembull, derisa inventarizimi mund të jetë i decentralizuar, kjo nuk do të thotë se menaxhimi i tij nuk duhet të bashkërendohet – duhet të ketë hapësirë për identifikimin e tepriceve të stoqeve në një pjesë të qeverisë para se të bëhet riporositja në pjesën tjetër të qeverisë së njëjtë.




Figura 6 Regjistri i informatave dhe SMIP

6.5.2 Interfejsi SIMF dhe Interfejsi Grafik i Përdoruesit (IGP)

Në figurën 6 paraqitet edhe interfejsi me Sistemin Informativ për Menaxhim Financiar (SIMF). Kjo flet për ndërveprimi i sistemit të prokurimit elektronik me sistemet e tjera të menaxhimit, gjë që është pjesë e rëndësishme e përfitimeve të plota nga teknologjia.

Mes aktivitetëve të prokurimit dhe menaxhimit e planifikimit të buxhetit ekzistojnë marrëdhënie të ngushta, përfshirë edhe aspektet e pagesave, caktimin paraprak të orareve dhe të zotimeve të kontratave, inventarizimin dhe vlerësimin e performancës dhe raportimin. Këmbimi efikas i informatave nuk duhet të pengohet nga dallimet në platforma dhe standarde mes entiteteve kryesore qeveritare. Kjo çështje shtrton nevojën e krijimit të GIF-së mbarëqeveritare.

SMIP dhe SIMF janë sisteme të ndara, ndaj një interfejs efikas mes tyre është mjaft i rëndësishëm. SMIP duhet të jetë i qasshëm përmes këmbimit dykahësh të të dhënave mes blerësve dhe shumë shitësve, ku përfshihen aspekte dhe autorizime të shumta operationale për prokurim, që mund të ndryshohen çdo ditë. Për realizimin e këtyre dhe të funksioneve të tjera të menaxhimit ndihmon futja e sistemit SIMF, i cili është një proces mjaft efikas, por i shtrenjtë dhe i vështirë.

Aplikacioni (IGP)

Zyrtarët e prokurimit përdorin aplikacionin *Interfejsi Grafik i Përdoruesit* vetëm në rastin e hartimit të njoftimit për ftesën e ofertimit apo në rastin e menaxhimit të ofertave ekzistuese. Ai mund të përdoret disa herë gjatë vitit, varësisht nga madhësia dhe lloji i departamentit dhe nga shpeshtësia e blerjeve. Furnitorët e përdorin vetëm kur marrin pjesë në ofertimin e caktuar, gjë që ndodh shumë rrallë.

Interfejsi i përdoruesit të sistemit të prokurimit elektronik duhet të jetë intuitiv dhe operacional në të gjithë shfletuesit e popullarizuar të internetit, ndërsa parakushtet teknike për qasshmëri nuk duhet të kenë kufizime të mëdha për përdoruesit. Funksionalitetet, që sistemi u ofron përdoruesve, duhet të jenë vetëshpjeguese, me qëllim që përdoruesit të ndihmohen për të kuptuar hapat që duhen bërë për t'i shfrytëzuar sa më mirë ato.

Interfejsi grafik i përdoruesit siguron ndërveprueshmëri. Teknologjia e përdorur për zbatimin e tij lidhur me nevojat e prokurimit elektronik zgjidhet kryesisht duke u bazuar në nivelin e qasshmërisë. Tani kanë dalë teknika të sofistikuara të zbatimit të IGP-së, që u mundësojnë zhvilluesve të sistemit ta zbatojnë këtë aplikacion me lehtësi dhe në mënyrë efikase. Megjithatë, jo të gjitha teknologjitë kanë standarde të përcaktuara dhe mund të mos përkrahen njëllë nga shfletuesit e internetit. Kjo redukton në mënyrë të dukshme nivelin e qasshmërisë. Ndaj, rekomandohet që IGP-ja në prokurimet elektronike të bazohet në teknologji të pranuar gjerësisht. Për shembull, të gjithë shfletuesit e internetit përkrahen standardin HTML 4.01. Rrjedhimisht, IGP-ja e prokurimit elektronik duhet ndërtuar në këtë standard.

Përdoruesit duhet të kenë edhe opsionin e zgjedhjes së gjuhës së tyre të parapëlqyer për Interfejsin Grafik të Përdoruesit (IGP) nga gjuhët e instaluar në sistem, si dhe të kenë mundësinë e kalimit prej një gjuhe në tjetrën. Fontet e përdorura

në aplikacion përmbajnë të gjitha simbolet grafike për të gjitha gjuhët zyrtare të shtetit.

6.5.3 Sistemi i menaxhimit të rrjedhës së punëve

Sistemi për menaxhimin e punëve, në thelb, përmban motorin dhe rregullat e rrjedhës së punëve, që gjenden në regjistrin e autoritetit. Të gjitha modulet e entiteteve të prokurimit kanë lidhje inteligjente me këtë motor.

Moduli i automatizimit të rrjedhës së punëve merret me rrjedhën e dokumenteve të përgatitjes së tenderit apo të kontratës. Personeli i autorizuar e përdor këtë modul për bartjen e dokumenteve të tenderit dhe të dokumenteve të tjera, përmes proceseve të miratimit të dokumenteve në çdo entitet të prokurimit, së bashku me komente apo ndryshime. Të gjitha aktivitetet në rrjedhën e punëve ruhen në regjistrin e auditimit.

Rrjedha e punës bazohet në regjistrin e autorizimeve, ku ruhen lejet e përdoruesve për realizimin e aktiviteteve të autorizuara të prokurimit. Nëse përdoruesi nuk ka autorizim për realizimin e aktivitetit, motori i rrjedhës së punës automatikisht ia referon aktivitetin autoritetit më të lartë. Menaxhmenti vlerëson statusin e procesit të punës të ngjarjeve në vazhdim, kur kjo kërkohet nga palët e interesuara (ofertuesit, subjektet e prokurimit, autoritetet kontraktuese, auditorët etj.) përmes rolit dhe autoritetit të përshtatshëm.

Në rrjedhën e punës përfshihen: Regjistrimi; Vlerësimi i tenderit; Dhënia e tenderit; Bërja e pagesës; Mbyllja e tenderit; Dorëzimi i tenderit; Ndryshimet në tender; Testimi i pranueshmërisë; Certifikata e kompletimit; Ndryshimi i adresës.

Sipas nevojës, moduli i proceseve të punës sjell proceset e nevojshme dhe datat; siguron që hapat apo procedurat të mos harrohen dhe përcjell veprimtaritë e vonuara për auditim dhe shqyrtim. Procesi i punës integrohet me regjistrimet e auditimit dhe SIM, që të mundësojë një raportim dhe analizë gjithëpërfshirëse të veprimtarive. Tabelimi i tërthortë i ndonjë faktori me ndonjë kombinim tjetër duhet të jetë në dispozicion të subjekteve të autorizuara.

6.5.4 Moduli për menaxhimin e kontratave elektronike

Ky modul ka të bëjë me menaxhimin dhe monitorimin e kontratës së projektit, të progresit të kontratës; të performancës së kontratës; të pagesave të saj; të ndryshimit dhe kompletimit të kontratës; si dhe të vlerësimeve përfundimtare. Po ashtu, ai grumbullon informata dhe paraqet renditjen e kontraktuesve, përjashtimet, heqja nga lista, menaxhimi i kontesteve dhe funksionalitete të tjera gjithashtu mund të ndërliken.

Përmes tij përgatiten dokumentet standarde të njoftimit për aprovim, për shprehjen e interesit, kërkesën për propozime, kërkesën për tenderim, kuotim etj. Po ashtu, sigurohet regjistri i njoftimeve për dhënie të kontratës (dhënie të tenderit, listën

e shkurtër të shprehjes së interesit, dhënien e kontratës për shërbime etj.), me numrin e referencës, emrin e tenderit, datën e shpalljes, datën e fundit për dorëzim dhe njoftimin për dhënie të kontratës, subjektin e prokurimit që bën shpalljen etj. Gjithashtu, lejon njoftimet e kërimit të tenderit online në mënyra të ndryshme, duke përfshirë numrin e tenderit, përshkrimin gjenerik, lokacionin, autoritetin lokal, subjektin e prokurimit, publikimin, natyrën dhe kategorinë e punës etj.

Kërkesa për tenderim publikohet në sistem drejtpërdrejt nga ana e subjekteve të prokurimit, në datën dhe orën e caktuar (pas verifikimit nga ana e KRPP-së). Nëse është e nevojshme, u dërgon alarmet automatike palëve të regjistruara të interesuara në lidhje me ftesën për tender të ri, dhe për korrigjime. Kur bëhet shpallja e njoftimit për dhënien e kontratës, duhet të specifikohet në mënyrë të qartë afati për dorëzimin e sigurisë së performancës dhe të bëhet nënshkrimi i kontratës.

Projektkontrata shpërndahet së bashku me njoftimin për dhënie të kontratës dhe me kërkesën për nënshkrimin e saj. Pasi publikohen lajmërimet në gazetë për ftesën për tenderim, të gjithë tenderuesit e regjistruar sipas asaj kategorie të veçantë duhet të pranojnë në mënyrë automatike njoftimin në postën e tyre elektronike apo përmes SMS porosisë, duke u bazuar në preferencën që kanë zgjedhur për të pranuar autoalarme.

Modeli “Njoftimi për dhënie të tenderit” për lloje të ndryshme prokurimi duhet të jetë në dispozicion në bibliotekën e modelit standard. Moduli ndërlidhet me SIM për llogaritjen e ditëve ndërmjet publikimit të njoftimit të tenderit dhe lëshimit të njoftimit për dhënie të tenderit me qëllim të përmirësimit të kohës së përpunimit në të ardhmen. Gjithashtu, lidhet me modulën e procesit të punës për ciklin e përgatitjes së reklamimit, si dhe me planin vjetor dhe planin individual të prokurimit.

Në mënyrë automatike, ai lejon ose nuk lejon veprimet e përdoruesit, të cilat korrespondojnë me orarin e tenderit të specifikuar në sistem. Ai nuk lejon shkarkimin e formularit të tenderit pas datës së fundit të specifikuar të prokurimit të dokumenteve të tenderit; nuk lejon shikimin e tenderit nga asnjëri prej personelit para datës dhe orës së hapjes së tenderit; lehtëson mënyrën e përcjelljes së tenderave, duke përdorur numër unik të tenderit.

Moduli për menaxhimin e kontratave është nënsistem i sistemit për menaxhimin e rrjedhës së punës. Në të drejtohen në mënyrë elektronike proceset prej lëshimit të urdhrit të punës apo kontratës dhe ato gjatë kryerjes së punës. Me modulën për menaxhimin e kontratave, agjencia qeveritare mirëmban dhe mbikëqyr punët, mallrat dhe shërbimet e ofruara, variacionet e kontratës. Në momentin e realizimit të një pjese të kontratës, bëhet pagesa për furnitorin.

Gjatë afatit të kontratës sistemi bën përditësime automatike dhe përmirësime, që rrisin cilësinë dhe nxisin verifikimet e dërgesave, transfertat bankare, ricaktim të orarit etj.

Përmes sistemit menaxhohet edhe procesi i zgjatjes së kontratës. Shumë kontrata parashohin mundësinë e zgjatjes së tyre për periudha të tjera. Gjithashtu, ofrohet raporti i paralajmërimit të hershëm për kontratat, të cilave po u skadon afati. Për të treguar zgjatjen e kontratave, bëhet një raport i automatizuar. Megjithatë,

theksojmë se legjislacioni ekzistues nuk parasheh zgjatjen e kontratave, por rekomandohet që kjo të ndryshojë.

Moduli menaxhon edhe anulimin e kontratave. Për këtë proces mbahet evidenca, për shqyrtimin e procedurave të mundshme juridike në të ardhmen.

Sistemi ka edhe kapacitetet për lehtësimin e bashkimit të kërkesës, me qëllim marrjen e çmimeve më të leverdisshme. Përmes integritit të sistemeve për menaxhimin e inventarizimit me SIMP-në, mund të arrihet ulja e shpenzimeve të prokurimit.

Agjencitë qeveritare shpesh ballafaqohen me vështirësi të prokurimit, të cilat nuk janë plotësisht të identifikuar në kuadër të rregulloreve apo udhëzimeve të prokurimit. Për shembull, disa kontrata duhet të vlejnë disa vite, ndërsa buxhetet janë vjetore, shpesh ka mungesë kronike të punonjësve të trajnuar, dorëzimi i mallrave, punës a shërbimeve shpesh nuk është i parashikueshëm, etj. Planifikimi më i mirë i prokurimit është vetëm zgjidhje e pjesshme për këto situata që shfaqen në jetën e përditshme.

6.5.5 Menaxhimi i profilit të përdoruesit dhe siguria e tij

Menaxhimi i profileve të përdoruesve ngërthen në vete ruajtjen e sigurt të të dhënave personale të përdoruesit, ndërsa autorizimi identifikon rolet e ndryshme që përdoruesi mund të marrë brenda sistemit të prokurimit elektronik. Nivelet e autorizimit janë të përkufizuara në nivel të sistemit dhe në nivelin e procesit specifik, të bazuar në rrjedhën e punës. Të gjitha aktivitetet e rrjedhës së punës duhet të ruhen në një regjistër të auditimit. Aktivitetet e rrjedhës së punës do të bazohen në një regjistër të autoritetit si pjesë e regjistrit të blerësit, i cili i ruan lejet e përdoruesit për kryerjen e aktiviteteve të autorizuar të prokurimit.

Ruajtja e kredencialeve dhe e profileve të përdoruesve në mënyrë të kriptuar dhe të sigurt, që të mos dekriptohen nga administruesit e bazës së të dhënave, duhet të jetë e detyrueshme.

Sistemi i prokurimit elektronik jep mundësinë për regjistrim të njëhershëm Single Sign-On (SSO), në mënyrë që përdoruesit të regjistrohen një herë dhe të kenë mundësinë që t'u qasen të gjitha shërbimeve të duhura, me autorizimet e krijuara për përdoruesin në sistem. Sistemi i prokurimit elektronik mundëson qasjen në përmbajtjen dhe në shërbimet e bazuara në llojin dhe përdorimin e përmbajtjes, që vihet në dispozicion përmes sistemit në bazë të roleve të përdoruesve.

Menaxhimi i profilit të përdoruesit përfshin edhe ruajtjen e sigurt të të dhënave personale të përdoruesit, ndërsa autorizimi përcakton role të ndryshme që mund t'i ketë përdorues brenda sistemit të prokurimit elektronik. Profilet e përdoruesve ruhen në bazën përkatëse të të dhënave, ku identifikohen të gjithë përdoruesit e sistemit dhe rolet që janë të ndërlidhura me përdoruesit e sistemit. Është me rëndësi të ruhen në mënyrë të koduar dhe të sigurt, informatat dhe profilet e besueshme të përdoruesit që nuk mund të dekodohen nga administratorët e bazës së të dhënave.

6.6 Sistemet e sigurisë së informacionit

Sistemi i e-Prokurimit është përgjegjësi e KRRPP, që është dhe pronar i sistemit, përgjegjës për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, procedurave dhe të rregulloreve përkatëse. KRRPP ka kodin burimor të sistemit, informatat e nevojshme dhe qasjen në softuer, i cili mundëson modifikimin dhe përshtatjen e aplikacionit, nëse është e nevojshme.

Për të vepruar me sukses, sistemi i e-Prokurimit kërkon një mjedis të sigurt. Masat efektive të sigurisë përfshijnë kontrollin mbi qasjet në të dhënat, përpunimin, transmetimin dhe ruajtjen e tyre. Prokurimi elektronik ka të bëjë me informata të ndjeshme (p.sh., përgjigjet për ofertat, informata komerciale etj.) të cilat duhet të ruhen mirë dhe të mos dekonspirohen. Për këtë bëhet kodimi i tyre, të dhënat ruhen në module të ndryshme, në bazat e të dhënave, në sistemin LDAP apo të skedarëve, përmes algoritmit të njohur për kodim. Kjo rrit sigurinë e sistemit të informacionit dhe mbron të dhënat edhe kur personi i autorizuar ka qasje në serverin apo serverat nikoqirë.

Sistemet e sigurisë që zbatohen në prokurimin elektronik duhet të garantojnë ruajtje të sigurt të dokumenteve; të ofertave të futura në sistem. Përdorimi i "certifikatave të serverit" këshillohet për qëllime të komunikimi të sigurt gjatë sesionit të koduar SSL mes përdoruesve të prokurimit elektronik (shfletues i internetit i përdorur nga entitetet e prokurimit dhe nga furnitorët) dhe serveri i internetit për prokurim elektronik. Dokumentet e ruajtura nuk duhet të jenë të qasshme për çdo përdorues, sipas rregullave dhe kufizimeve të caktuara. Kodimi bëhet sipas parimit: “prej përdoruesit të fundit deri te përdoruesi i fundit”, kur pranohen dokumentet në serverin e internetit dhe ruhen sistemin e prokurimit elektronik.

Lidhur me këtë, nga strukturat përgjegjëse duhen mbajtur parasysh:

a) Qasja logjike dhe fizike, dhe rrjeti i infrastrukturës, kontrollit, identifikimi dhe qasja do të analizohen dhe vlerësohen për efektivitetin në arritjen e objektivave të sigurisë së informacionit dhe shmangien e humbjeve që rezultojnë nga ekspozimi. Trajtimi i incidentit në aspektin e sigurisë do të vlerësohet për efektivitetin dhe reagim të shpejtë dhe/ose përshkallëzim të problemeve.

b) Menaxhimi i Sigurimit të Sistemeve të Informacionit duhet të lehtësojë dhe të zbatojë një program të sigurisë së informacionit nëpër institucione, që përfshin analizën e ndikimit të biznesit, planin e vazhdimësisë së biznesit, si dhe planin e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, në mbështetje të proceseve kritike të biznesit të institucioneve.

c) Sistemi i e-Prokurimit mbështet dhe siguron strukturat për: nënshkrimin digjital/elektronik të të gjitha dokumenteve, formularët dhe komunikimet; lëshimin e nënshkrimeve digjitale ose metodave tjera alternative në mungesë të nënshkrimit digjital të bazuar në Infrastrukturën e çelësave publike për identifikimin dhe enkriptim (sigurimin) e të dhënave të miratuara; për të garantuar transaksionet e siguruara dhe të autorizuar në sistemin e e-Prokurimit.

d) Sistemi duhet të sigurojë të dhënat e fundit, kur transmeton përmes rrjeteve publike dhe WAN. Bartja e të dhënave ndërmjet serverit të aplikacionit dhe klientit (shfletuesit të uebit) sigurohet duke përdorur *Secure Socket Layer* (SSL). Kalimi nga transmetimi në deponim duhet siguar (*enkriptuar*) në baza rrjedhëse (*streaming*) dhe të vazhdueshme.

Në objektivat e sigorisë për të përmbushur kërkesat e biznesit të organizatës, pa dyshim përfshihen edhe:

Sigurimi i disponueshmërinë së vazhdueshme të sistemeve të informacionit dhe të të dhënave;

- Sigurimi i përputhjes me ligjet, rregulloret dhe standardet e aplikueshme;
- Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave të ndjeshme gjatë deponimit dhe në tranzit.

Sipas praktikave më të mira dhe standardeve aktuale (p.sh. ISO 27001 dhe COBIT 5), siguria e mjaftueshme e informacionit mund të arrihet vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse në raport me rreziqet përkatëse. Ndër të gjitha masat e sigorisë të aplikueshme për ofrimin e shërbimeve elektronike, procedura e qasjes (vërtetimit) luan një rol themelor në zbutjen e rrezikut të fshehtë të vjedhjes së identitetit. Në mënyrë që ky rrezik të zbutet, mund të zbatohet vërtetimi i fuqishëm.

Siguria e sistemit të informacionit shtrihet edhe në aktivitetet e administrimit të materialeve të auditimit, si raportet, regjistrimet dhe monitorimet. Inspektimi i herëpashershëm i regjistrave të auditimit mund të zbulojë përpjekjet për ndërhyrje të palejueshme në dokumentet e ofertimit, për shembull, për falsifikimin e tyre nga përdoruesi i autorizuar, pas skadimit të afatit për dorëzim, gjurmimi i ngarkimit/shkarkimit të ofertës, versionet e ndryshme, miratimet. Në regjistrimet gjithëpërfshirëse të auditimit, në formate të caktuara paraprakisht, gjenden hetimet e bëra për përdoruesit (përdoruesi i veçantë i autoritetit blerës, ofertuesit, administratorët e sistemit, etj.), tenderi, koha, transaksionet, llojet e prokurimit dhe parametrat e tjerë të mjekësisë ligjore, gabimet, problemet, zbatimi i kërkesave ligjore dhe qëllimeve të tjera të auditimit.

Këto regjistrime të auditimit arkivohen nëpërmjet mekanizmit për arkivimin e të dhënave që zbatohet për prokurim elektronik. Ato ruhen në arkiv dhe mund të shfrytëzohen për të mbështetur rastet e hetimeve të incidenteve të sigorisë apo kontesteve. Qasja në regjistrat dhe në të dhënat e auditimit është e kufizuar për falsifikimet/ndryshimet/fshirjet e paautorizuara. Prej përdorimit të tyre hartohen raporte gjithëpërfshirëse nga ana e subjektit të autorizuar të prokurimit apo nga autoritetet e qeverisë për operacionet e përditshme, planifikimin kombëtar, auditimin dhe vendimet strategjike, si dhe për qëllime të tjera.

Nga ana tjetër, edhe vetë sistemi i prokurimit elektronik duhet të jetë i sigurt, të përdorë antivirusët, që kontrollojnë të gjitha informacionet, dokumentet/komunikimin që vijnë nga përdoruesit etj. Gjithashtu, duhet të kufizohet komunikimi i çfarëdo përmbajtjeje të paautorizuar dhe të dëmshme. Asnjë dokument/komunikim (postë elektronike) nuk duhet të pranohet dhe të ruhet nëse nuk kontrollohet për praninë e viruseve.

6.7 Komunikimi dhe kërkimi përmes SPE

Përdoruesit e SPE, gjatë procesit të përgatitjes së njoftimit të procedurave të prokurimit, si dhe gjatë vlerësimit të kualifikimeve të ofertuesve, kanë nevojë edhe për komunikime përmes internetit. Por shumë prej tyre ende komunikojnë me operatorët ekonomikë nëpërmjet letrave zyrtare apo takohen me ta kur shkojnë në zyrat e autoriteteve kontraktuese. Shumë pak nga AK-të përdorin SPE për të komunikuar me OE-të gjatë procesit të prokurimit përmes menusë “Kërkesat e mia”. Zyrtarë të tyre ende nuk janë aftësuar të komunikojnë me OE-të përmes menusë “Kërkesat e mia”, që kërkon përdorimin e SPE-së.

Një numër anëtarësh të Komisioneve të Verifikimit të Ofertave vazhdojnë të mbajnë procesverbale me shkrim për vendimet që marrin gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, për t'i përdorur në rast se marrin një kërkesë për sqarim ose për informacion mbi dokumentet e ofertës. Po ashtu, disa AK ende preferojnë shkresat zyrtare në letër.

Por vazhdimi komunikimeve me letra apo me kontakte të drejtpërdrejta cenon sigurinë e informacionit, ruajtjen dhe fshehtësinë e tij. Ndërsa përdorimi i mesazheve elektronike ofron siguri të materialeve dhe të informatave. Gjithashtu operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktuese lehtësohen shumë, fitojnë kohë, pasi eliminohen kontaktet e drejtpërdrejta mes zyrtarëve dhe shkresat në letër.

Instrumentet e avancuara të kërkimit duhet t'u ofrohen të gjithë përdoruesve të e-Prokurimit publik. Këto instrumente u mundësojnë të gjithë përdoruesve (duke përfshirë edhe atyre anonim dhe të paregjistruar) shfrytëzimin e instrumentit për kërkim për të gjitha ofertimet në dispozicion dhe ftesat për ofertim, si dhe identifikimin që mund të ketë interes potencial për ta. Kërkimet dhe njoftimet duhet gjithashtu të kenë ndërveprim edhe me teknologjinë e telefonave mobilë, pasi sjell shumë lehtësi dhe kursim kohe.

Në aspektin e kërkimit, sistemi duhet të ketë në dispozicion një numër të dhënash të rëndësishme. Për shembull, ftesat për ofertim (duke përfshirë emrin, kodet e CPV-së, fjalën kryesore dhe vendin), pasi kështu u jepet mundësi përdoruesve të zgjedhin ftesën e caktuar për ofertim nga rezultatet e kërkimit dhe t'i shikojnë hollësitë e saj. Varësisht prej hollësive dhe statusit të ftesës, furnitorëve mund t'u jepen aktivitetet që ata duhet t'i realizojnë.

Gjithashtu, mund të parashihet edhe opsioni që përdoruesit e fundit t'i kombinojnë këto kritere, mund të ofrohen operacionet logjike të Advanced Boolean (DHE, OSE dhe precedenca e tyre), të cilat u mundësojnë përdoruesve realizimin e kërkimeve më të rafinuara, të përcaktojnë fushat që duhet të përdorin për paraqitjen e rezultateve të kërkimit dhe të parametrave përzgjedhës të përdorur.

Sistemi mund të përdorë edhe një instrument të jashtëm kërkimi, për të përfituar nga karakteristikat e ofruara nga instrumenti i veçantë për kërkim, siç është përkrahja për kodimin e karaktereve UTF-8, kërkimi i bazuar në përmbajtje, kërkimi i përmbajtjeve të ruajtura brenda disa llojeve të dokumenteve të popullarizuara (doc, xls, pdf, plain text, etj.).

Kodimi i karaktereve të sistemit është metodë e kodimit të tekstit të futur në cilëndo fushë. Kodimi i karaktereve UTF-8 (Unicode) mund të përkrahet me karaktere jolatine. Baza e të dhënave gjithashtu mund të ketë nevojë për konfigurim në mënyrë që UTF-8 të funksionojë. Për shembull, versionet më të vjetra të MySQL nuk kanë përkrahur Unicode-in, mirëpo ka qenë i mundur konfigurimi i drajverëve JDBC për të përdorur Unicode-in me rastin e përpunimit të teksteve. Shumica e bazave të të dhënave dhe komponentët e interfejsit të informatave të futura të përdoruesve sot përkrahin Unicode-in.


Për një komunikim sa më efikas SPE ka edhe një mekanizëm të sigurt dhe të besueshëm, siç është *shënimi i kohës*. Ky mekanizëm zbatohet nga përdoruesit e shumtë për verifikimin e kohës së trajtimit të çështjeve të caktuara. Për shembull, me këtë mekanizëm shihet nëse oferta është dorëzuar para afatit etj. Gjithashtu, sistemi i prokurimit elektronik duhet të regjistrojë datën dhe kohën e saktë për të gjitha aktivitetet që ndërmerren, duke e marrë atë kohë nga burimi i përcaktuar për sistemin.

Koha mund të merret përmes përdorimit të protokollit të shënimit të kohës dhe Autoritetit për Shënimin e Kohës (ASHK), i cili nxjerr kohë të shënuara me datën dhe kohën unike të çdo veprimi me prokurim elektronik. Shënimi digjital i kohës mund të përdoret për të dëshmuar se dokumenti elektronik është transmetuar te serveri i prokurimit në kohën e shënuar. Sistemi i prokurimit elektronik mund të sinkronizohet vazhdimisht me ASHK përmes pranimi të sinjaleve kohore të transmetuara. Përmes këtij mekanizmi, gjurmimi i auditimit që zbatohet në prokurimin elektronik mund të përdorë shënimin e saktë të kohës për regjistrimin e të gjitha aktiviteteve të realizuara.

Menjëherë pas plotësimit të bartjes së dokumenteve nga faqja e klientit, të gjithë ato dokumente mund ta marrin kohën nga ana e serverit. Dokumentet me nënshkrime elektronike mund të ndërlidhen me shënim të saktë të kohës, nëse dokumentet dërgohen tek ASHK, i cili vulos dokumentet me datë dhe kohë ligjore.

Aspektet kryesore të zbatimit të prokurimit elektronik janë përcaktuar më parë, ashtu si në kornizën që është dhënë në figurën më poshtë,

Figura 7 - Aspektet kryesore të zbatimit të prokurimit elektronik



6.8 Riinxhinierimi i Procesit të Punës (RPP)

Gjatë fazave të ndryshme të procesit të prokurimit, departamentet e blerësit përgatisin dokumente të ndryshme për komunitetin e furnitorëve dhe të blerësve dhe për palët e tjera të interesuara. Këto dokumente duhet të jenë standarde. Mes të tjerash, në to përfshihen planet vjetore të prokurimit, lajmërimet për informim të hershëm, lajmërimet për ftesë për oferta, lajmërimet për parakualifikim, dokumentet e ofertës, raportet përmbledhëse të prokurimit e shumë të tjera.

Kosova përdor dokumentacion standard të prokurimit. Megjithatë, ai duhet rishikuar, me qëllim që kërkesat për informata të jenë digjitale e jo analoge. Po ashtu, duhen standardizuar edhe proceset e tjera jostandarde. Ky standardizim i proceseve kyçe të prokurimit sjell rritjen e efikasitetit dhe transparencës në prokurimin publik. Ky shqyrtim e përcakton funksionin RPB.

Mendojmë se në procesin e standardizimit duhen futur edhe dokumentet në vijim: planet vjetore të prokurimit; planet individuale të prokurimit; njoftimet për informim të hershëm; EOI-të/Ftesat për parakualifikim; njoftimet përmbledhëse të ofertave; formatet e garancive bankare për depozitimin e sigurisë dhe garancitë e performancës; shkresa e dhënies së kontratës; informatat që paraqiten në njoftimet për dhënie të kontratës; raportet e vlerësimit; si dhe dokumentet e tjera të sistemit të blerjeve elektronike dhe të ankandeve elektronike.

Standardizimi i REOIs / ftesave për parakualifikim, termat, kushtet dhe dokumentet e ofertimit varen nga lloji i prokurimit dhe duhen përgatitur në formate standarde. Kuptohet, mund të ketë variacione të formave të standardizuara, si mes ministrive dhe pushtetit vendor.

Tabela 5 i paraqet disa dokumente standarde të prokurimit që mund të kërkojnë nga RPB të marrin produktivitetin më të lartë nga teknologjia:

Tabela 7 Lista e dokumenteve standarde

Lloji i prokurimit	Dokumentet ofertuese
Mallra	Parakualifikimi për mallra Dokumentet standarde ofertuese për mallra Afatet dhe kushtet standarde
Punime	Parakualifikimi për punime (me kupon të ditarit) Parakualifikimi për punime (pa kupon të ditarit) Dokumentet standarde të ofertimit Afatet dhe kushtet standarde
Shërbime konsulente	Kërkesa për propozim për konsulent individual Kërkesa për propozim për firma të shërbimeve konsulente Kërkesa për propozim për oferta të konsorciumeve Afatet dhe kushtet standarde
Sisteme informative	Kërkesa për propozim për SI (sistem informativ) – Një fazë Kërkesa për propozim për SI – Dy faza

Dokumentet e tjera standarde kërkojnë si për blerjen elektronike, kuotimin elektronik dhe ankandet elektronike. Mbulueshmëria indikative e dokumenteve standarde të ofertimit për mallra dhe punime është paraqitur në tabelën 6.

Tabela 8 Mbulueshmëria e dokumenteve standarde të ofertimit

Pjesa	Titulli	Përshkrimi
1	Procedurat e ofertimit	
1.1	Udhëzime për ofertuesit	Kjo pjesë ofron informata relevante për t'i ndihmuar ofertuesit me përgatitjen e ofertave të tyre. Po ashtu, jepen informata edhe për dorëzimin, hapjen dhe vlerësimin e ofertave dhe rreth dhënies së kontratave. Pjesa 1 përmban dispozita që duhet të zbatohen pa ndonjë modifikim.
1.2	Fleta e të dhënave të ofertës	Kjo pjesë përmban dispozita që janë specifike për çdo prokurim, dhe i plotëson informatat

		apo kërkesat që përfshihen në pjesën 1 – Udhëzime për ofertuesit.
1.3	Kriteret për kualifikim	Kjo pjesë përmban kriteret e kualifikimit dhe metodologjinë e propozuar për zgjedhjen e ofertës më të mirë të përgjegjshme.
1.4	Formularët e ofertimit	Kjo pjesë i përmban formularët që duhet të plotësohen nga ofertuesi dhe të dorëzohen si pjesë e ofertës.
2	Kërkesat për punime/furnizime	
2.1	Parallogaritja e sasive/parallogaritja e materialeve (kërkesat për punimeve/kërkesat për furnizim me mallra)	Për punime: Kjo pjesë përmban specifikacionin, skicat dhe informatat shtesë që i shpjegojnë punimet që do të prokurohen OSE Për mallra: Kjo pjesë përmban listën e mallrave dhe të shërbimeve përkatëse, oraret e dërgesës dhe të përfundimit, specifikacionet teknike dhe skicat që i shpjegojnë mallrat dhe shërbimet përkatëse që do të prokurohen.
3	Kushtet e kontratës dhe format e kontratës	
3.1	Kushtet e përgjithshme të kontratës	Kjo pjesë përmban klauzolat e përgjithshme që vlejné për kontratat. Teksti i klauzolave në këtë pjesë nuk duhet të modifikohet.
3.2	Kushtet e posaçme të kontratës	Për punime: Kjo pjesë përbëhet prej Pjesës A: Të dhënat e kontratës dhe Pjesës B: Dispozitat e posaçme, të cilat i përmban klauzola specifike për secilën kontratë. Përmbajtja e kësaj pjese e plotëson pjesën e Kushteve të përgjithshme dhe duhet të përgatitet nga blerësi. Për mallra: Kjo pjesë përmban klauzola specifike për secilën kontratë që e modifikojné apo e plotësojnë pjesën VII, Kushtet e përgjithshme të kontratës. Kushtet e posaçme vlejné më shumë sesa kushtet e përgjithshme në rast të ndonjë dallimi mes të dyjave.
3.3	Formularët e kontratës	Kjo pjesë përmban formularët e kontratës, të cilat sapo të plotësohen, bëhen pjesë e kontratës.

Sistemi i prokurimit elektronik duhet t'i ofrojë këto shabllone, në mënyrë që dokumentet standarde të ofertimit të mund të gjenerohen automatikisht përmes kombinimit të pjesëve statike (të pandryshueshme) të dokumentit dhe inputeve të përdoruesit (për pjesët e përshtatura). Sistemi i prokurimit elektronik duhet ta mundësojë autogjenerimin e dokumenteve të tjera të prokurimit në format standard, përmes përdorimit të inputeve të ofruara nga autoriteti prokurues. Gjenerimi automatik dhe shpallja automatike e dokumenteve duhet të mundësohet në çdo fazë të procesit të prokurimit.

Sistemi i prokurimit elektronik duhet të jetë i qasshëm me lehtësi, të garantojë pengesa minimale në qasjen e konkurrenive përmes prokurimit elektronik, asnjëherë të mos e komprometojë konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave dhe gjithmonë të sigurojë transparencë dhe jodiskriminim. Këto kërkesa mund të përmbushen vetëm me një prokurim elektronik shumë të sigurt. Qeveria duhet t'i specifikojë kërkesat e sigurisë sipas pritjeve të saj.

Annex – Specifikimi teknik dhe funksional

Kjo pjesë paraqet specifikacionet e minimumit të kërkesave funksionale për sistemin e prokurimit elektronik në Kosovë. Në vazhdim është paraqitur specifikacioni për jetësimin e proceseve afariste dhe funksioneve të tjera mbështetëse, si dhe kërkesat e përdoruesit. Këto do të formojnë kërkesat funksionale për angazhimin e një zhvilluesi të sistemit.

r.	Procesi	Funksionet afariste të prokurimit elektronik (subjekt i politikës)	Kërkesat teknike
	Të përgjithshme	Hyrje e vetme: Hyrje e vetme në portalin qendror për të gjitha palët e interesit për t'u lejuar qasje në të gjitha informacionet dhe shërbimet e autorizuara Funksioni “Kërko” Kur të zgjidhet mundësia e tenderit, do të shfaqen të dhënat e plota të atij tenderi në veçanti –originali i njoftimit në gazetë i tenderit, ndryshimet, korrigjimet, njoftimet lidhur me tenderin, etj. Kërkimi duhet të ofroj një mundësi të kompletuar të zgjedhjes së kriterëve me një kombinim të kërimit të kriterëve të mundësive të prokurimit nga plani i prokurimit, statusi i tenderit (tenderët aktiv, tenderët e mbyllur, të anuluar, të ritenderuar, të dhënë, vlerësimi i progresit, etj.), ofertuesit/furnitorët/konsultantët, agjencitë e prokurimit, mallrat, shërbimet, punimet, data e publikimit, data e mbylljes, lokacioni gjeografik, vlera dhe të tjera. Funksioni “Kërko” do të ofroj gjithashtu listën e mundësive më të fundit të prokurimit (tenderët, kërkesa për shprehje të interesit, kërkesa për kuotim, kërkesa për propozime, etj.) së bashku me mundësitë për tender (tenderi, kërkesa për shprehje të interesit, kërkesa për kuotim, kërkesa për propozime, etj.), numrin e referencës, emrin e tenderit, datën	Sistemi duhet të zhvillohet me një Arkitekturë të Orientuar nga Shërbimi (AOSh) në përputhje me politikat e ndërveprimit dhe të arkitekturës së Kosovës, e cila mund të ndërveproj me sistemet tjera, të cilat janë të afta për t'ju qasur shërbimeve përmes një ndërlidhjeje të hapur. Sistemet e tilla për kanalet e tjera të shpërndarjes janë paraqitur në Strategjinë e qeverisjes elektronike në Kosovë 2009-2015. Ndërlidhja e sistemit të prokurimit elektronik do të sigurohet duke përdorur shërbimet e internetit dhe ndërlidhjes të bazuara në XML. Regjistrimi në sistem do të jetë i bazuar në fjalëkalimin e mbrojtur dhe vetëm një vlerë e përzier (hash value) e fjalëkalimit do të ruhet në bazën e të dhënave..

	e shpalljes, datën e fundit për dorëzim, dhe subjektin e prokurimit që bënë shpalljen, etj. Ofertuesi të ketë mundësinë të ndërmarr një kërkim përmes kombinimit të fjalëve kryesore. Të mësuarit online: Portali do të ofroj udhëzues vizual të të mësuarit online ndarazi, për agjencitë e prokurimit, kontraktuesit/furnitorët/konsulentët/bankat, për të mësuar funksionet e sistemit. Qasje të përgjithshme në njoftime, statistika të prokurimit për informim të publikut, listën dhe lajmet mbi përjashtimet, ftesën për informata kthyese Portali do të ofroj një hyrje të vetme për palët e interesit për të pasur qasje në një gamë të gjerë të lajmeve, funksioneve, formularëve dhe dokumenteve duke përfshirë: Legjislacionin dhe politikën, udhëzuesit, etj. Mundësitë/planet e prokurimit Përgatitja e tenderit dhe njoftimi në gazetë Ftesa për ofertim (ftesë për ofertim, shprehje të interesit, kërkesë për propozime,) Procedurat e ofertimit Udhëzimet për ofertuesit, duke përfshirë tërheqjen apo korrigjimet e ofertës	Përdorimi i vërtetimit njerëzor të bazuar në testin krejt të automatizuar për t'i dalluar njerëzit dhe kompjuterët (CAPTCHA1) është për të mbrojtur regjistrimin e automatizuar dhe postën elektronike të padëshiruar me rastin e lidhjes (login spamming). Duhet të sigurohen udhëzues/këshilla online për ofertuesit për përdorim të portalit të sistemit. Udhëzuesit duhet të jenë informues, intuitiv dhe ilustrues. Siguron një strukturë për të zgjedhur opsione të ndryshme të njoftimit (si, për postë elektronike, SMS, RSS) për të pranuar njoftimet automatike të gjeneruara nga sistemi. Njoftimet duhet t'u dërgohen përdoruesve vetëm nëse përdoruesi i sistemit të prokurimit elektronik është i prirur të pranojë njoftimet kur ndonjë ngjarje e rëndësishme ndodh. Nëse zgjidhet posta
--	---	---

1 CAPTCHA - Completely Automated Public Turing test to tell Computers and Humans Apart / Test krejt i automatizuar për t'i dalluar njerëzit dhe kompjuterët

		Kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit Formularët e ofertimit Formulari i dorëzimit të ofertës Lista e çmimit nëse është relevante Siguria e ofertës (garancioni bankar) Deklarata e sigurisë së ofertës Autorizimi i prodhuesit Vendet e pranueshme Specifikacionet teknike Testimet dhe inspektimet Kushtet e përgjithshme të kontratës Kushtet e veçanta të kontratës Formularët e kontratës Marrëveshja e kontratës Siguria e performancës Menaxhimi i kontesteve për dhënie të kontratës, etj.	elektronike, njoftimi do të dërgohet në adresën elektronike të dhënë gjatë kohës së regjistrimit (apo ndryshimit të regjistrimit). Nëse zgjidhet SMS porosia, njoftimi do të dërgohet në adresën e celularit të dhënë gjatë kohës së regjistrimit (apo ndryshimit të regjistrimit). Tavolina ndihmëse dhe mbështetja për pyetjet e shpeshta duhet të jenë në dispozicion në portalin e sistemit. Sistemi i prokurimit elektronik duhet të siguroj menaxhimin e faqes dhe opsionet për konfigurimin e rregullave për të marrë qasje në një numër të caktuar të informacioneve, funksioneve, formularëve dhe dokumenteve duke bazuar në autoritetin dhe në përgjegjësitë e deleguara. Sistemi do të siguroj për shqyrtim publik treguesit e performancës, rezultatet dhe statistikatat përfundimtare. Do të publikohen njoftimet për dhënien e kontratës dhe për përjashtimin e ofertuesve. Do të bëhet publikimi i planeve vjetore të prokurimit dhe do të sigurohen opsionet e ‘Listës kontrolluese/Watch list’
--	--	---	---

			për komunitetin ofertues. Sistemi i prokurimit elektronik duhet të ketë një mundësi që të kryej metoda të ndryshme të prokurimit për prokurimet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë, d.m.th. Kuotimin, tenderimin e hapur, tenderimin e kufizuar, prokurimet e veçanta, prokurimet e bazuara në parakualifikim dhe në shprehje të interesit, urdhrave për blerje përmes marrëveshjeve kornizë, si dhe prokurimet e tjera në mallra, shërbime dhe punë.
--	--	--	---

Përgatitja dhe parakushtet	Regjis trimi i centralizuar/ Përfshirimi/ Vlerësimi i performancës	Regjistrimi online përmes hyrjes së vetme do të jetë për të gjitha subjektet e prokurimit duke përfshirë kompanitë, individët, kompanitë me angazhime të përbashkëta duke përfshirë të dhënat: Dokumentet dhe certifikatat e identitetit të kompanisë, duke përfshirë kompanitë me angazhime të përbashkëta Kategoria e kompanisë mund të jetë si në praktikë në vend Deklarata mbi veprimtarinë Historiku Të dhënat mbi taksat Të dhënat kontaktuese Zyrtarët kryesor Fushat e interesit (kategoritë e interesit, mallrat, shërbimet apo punët, TI, etj.) Kriteret si industria dhe statusi i NVM-së, kodi i lokacionit Përcjellja automatike e regjistrimeve na baza vjetore për veprimet e vazhdimet (ripërtrirjes) dhe përfundimit dhe njoftimet për përdoruesit e regjistruar për ripërtrirje me lidhje automatike dhe kanale të prirura për njoftime. Kompania duhet gjithashtu të jetë në gjendje të azhurnoj online profilin e saj të regjistrimit në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së regjistrimit të saj. Procedura e prokurimit për menaxhimin e përjashtimit e ndërmarrur nga KRPP-ja përmes faqes qendrore me një regjistër të vetëm i cili integron informatën mbi anulimin / refuzimin në mënyrë që të sigurohet që kontraktorët / furnitorët / konsulentët e tillë të mos ndërmarrin veprimtari të mëtejshme të prokurimit me qeverinë e	Ofertuesi mund të shikoj dhe të ndryshoj të dhënat e profilit të tij/saj të dhëna gjatë regjistrimit duke përdoruar opsioni ‘Shiko profilin’ Si pjesë e kësaj do të kërkohej vërtetimi. CAPTCHA (test krejt i automatizuar për t’i dalluar njerëzit dhe kompjuterët) duhet të përfshihet Do të nevojitet që kompanitë, individët të jenë në gjendje të paguajnë online taksën e regjistrimit ashtu siç është e caktuar nga KRrPP-ja. Zonat e interesit duhet të përzgjidhen nga katalogu i klasifikimit (CPV). Përmes shërbimeve të faqes së internetit (nëse këto shërbime janë të disponueshme online), duhet të jetë i mundur vërtetimi në kohë reale i autencitetit të regjistrimit të kompanisë, licencave tregtare, pagesës së taksave dhe të TVSH-së. Për formimin e kompanive me investim të përbashkët (Joint Ventures) nevojitet që të sigurohet një memorandum i mirëkuptimit për pjesëmarrje në ndonjë
----------------------------	---	--	--

		Kosovës. KRPP-ja do të aprovoj/refuzoj aplikacionet për regjistrim duke u bazuar në sistemin e procesit të punës dhe në rregullat afariste. Historiku i performancës do t'i bashkëngjitet çdo regjistrimi në mënyrë automatike, si përqindja e tenderëve të fituar, puna e kryer kundrejt kohës së kaluar, pagesat përkatëse të kryera, punët e vazhduara, vonesat dhe një gamë e treguesve kryesor të performancës me qëllim të gjenerimit të raporteve duke përfshirë rezultatet e NVM-ve për përputhje me politikat e qeverisë	tender të veçantë, kështu që nevojitet një formular i dedikuar në sistem me rregulla të ndërlidhura. Procesi i vlerësimit të performancës, përjashtimit dhe të regjistrimit të kompanive kontraktuese, të konsulentëve dhe të furnitorëve kalon përmes procesit të punës të caktuar sipas mandatit të KRrPP-së për mirëmbajtjen e bazës qendrore të të dhënave të kontraktuesit. Për pagesat nevojitet ndërlidhja me portën/hyrjen e pagesave Pajisja e MSI-së për analiza duhet të jetë në dispozicion për KRrPP-në, AQP-në, Thesarin dhe financat, auditorin e përgjithshëm, dhe për të autorizuarit e tjerë. Njoftimet në lidhje me përjashtimet duhet të publikohen në pjesën e sistemit për publikun dhe po ashtu t'u dërgohen shoqatave profesionale siç është Oda Ekonomike e Kosovës dhe të tjera, në mënyrë që ofertuesit e tjerë të mundshëm të jenë të informuar lidhur me etikën dhe kodin e mirësjelljes në prokurim.
--	--	---	---

	Regjis- trimi i zyrtarit të prokurimit	Çdo zyrtar i prokurimit i përfshirë në procesin e prokurimit sipas sistemit të prokurimit elektronik duhet të jetë i regjistruar online përmes subjektit të prokurimit. Menaxhim përmes regjistrimit online – regjistrimi i informatave të detajuara personale, identifikuesi i listës së pagave, informatat mbi departamentin/sektorin, informatat mbi përgjegjësinë, informatat e detajuara kontaktuese të përdoruesit. Subjektet e prokurimit dhe përdoruesit duhet të bëjnë dallimin midis tyre dhe lidhjen e tyre me nivelin qendror të qeverisë apo autoritetet lokale. Regjistrimi duhet të përmbaj nivelin e akreditimit (ku është në dispozicion) duke ndaluar regjistrimin e paautorizuar Një përdorues nga secili subjekt duhet të caktohet si Administrator i përdoruesve, dhe ai do të krijoj/ largoj/modifikoj/ricaktoj të gjithë përdoruesit e nevojshëm të subjektit, procesin e punës, skemën e përgjegjësisë dhe autoriteteve të deleguara. Përshkallëzim automatik i autoritetit më të lartë për aprovime dhe ç'kyçe online, Ofron lidhje dhe anulime automatike, përshkallëzim automatik të regjistrimeve dhe ç'regjistrim online të autoritetit më të lartë.Shkaktues të anulimit manual dhe automatik	Kërkesa për regjistrimin e subjekteve të prokurimit duhet të aprovohet nga ana e KRRPP-së. Vërtetimi/autenciteti duhet të bëhet përmes opsionit të përzierjes (hash option), CAPTCHA, apo ndonjë opsioni tjetër të vërtetimit të miratuar nga qeveria Duhet të sigurohet matrica e të drejtave dhe përgjegjësi për secilin përdorues të subjektit të prokurimit, duke përfshirë delegimin me shkrim, dhe duhet të krijohet regjistri i autoritetit.Caktimi në ndonjë detyrë të re, transferimi dhe promovimi i oficerëve apo ngjarjet e tjera nuk duhet të pengojnë procesin e prokurimit. Duhet gjithherë të jetë në dispozicion opsioni i shkallëzimit ose opsioni i ridelegimit të përgjegjësi (duhet të jetë në kuadër të KRPP-së dhe EP-së për rregullat e delegimit).
	Regjis- trimi i komisioneve	Regjistrimi i komisionit të vlerësimit do të bëhet online nga ana e AQP-së, autoriteteve lokale dhe subjekteve të prokurimit duke përdorur autoritetet e tyre për të formuar komisionet sipas ligjit të prokurimit Secili anëtar i komisionit gjatë regjistrimit online duhet të nënshkruaj kodin e konfidencialitetit dhe kodin e etikës Përshkallëzim automatik në autoritet më të lartë për ç'regjistrim	Lidhet me modulën e rrjedhës së punës, duke kërkuar proces të qartë çdo herë Komisionet e vlerësimit mund të mos kenë madhësi të qëndrueshme. Numrat mund të ndryshohen apo komitetet mund të hiqen sipas arritjes së pajtimit për

		Secili anëtar i komisionit duhet të jetë subjekt i nominimit nga ana e autoritetit më të lartë të regjistruar. Nominimi duhet të regjistrohet në mënyrë automatike për auditim. Regjistrimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe të dhënat mbi: Emrat / identifikuesit e individëve në komision Departamentin, rolin, pozitën Identifikimin e komisionit me kushtet me të cilat aplikohet kontrata Raportimi mund të parashoh referencimin e rregullt dhe ad-hoc të llojeve të të dhënave dhe të anëtarësimeve për auditim, etj.	riprojektimin e proceseve dhe rekomandimeve ekzistuese. Identifikuesit e listës së pagave apo një mori e identifikuesve të tjerë do të identifikojnë anëtarët individual. Disa nga anëtarët mund të mos jenë shërbyes civil. Një panel i aparaturave i dedikuar dhe i sigurt me qasje në funksionalitetet e mandatuara për komitetet duhet të jetë në dispozicion menjëherë pasi të jenë regjistruar komisionet. Pas kompletimit të detyrës së tyre, duhet të jetë e mundur që raportet dhe rezultatet të përcillen/përshkallëzohen në sistem përmes procesit të konfiguruar të punës për prokurime të veçanta. Subjekti i prokurimit duhet të lejohet të konfiguroj një proces të tillë të punës, dhe nëse është e nevojshme, ta modifikoj procesin e punës. Sistemi gjithashtu duhet të lejoj një përdorues të autorizuar të ndryshoj përbërjen e komisioneve, nëse është e nevojshme, në çdo kohë gjatë procesit të prokurimit. Aktivitetet e komisioneve duke përfshirë datat dhe orën, si dhe ndryshimet e
--	--	---	---

			komisioneve duhet të regjistrohen automatikisht në bazën e të dhënave të auditimit. Integrohet me MSI-në për informimin e komisionit dhe raportimin e performancës së tyre
	Biblioteka e modelit të dokumenteve standarde	Qasja e hyrjes së vetme në bibliotekën e modelit për kontratat me terma dhe kushte të përbashkëta, dokumente ofertuese, kërkesa për pagesa, etj. Modelet duhet të jenë të editueshme sipas autorizimit të caktuar të regjistruar online.	Biblioteka e modeleve të dokumentit standard siguron një mjet për të shkarkuar modelet e dokumenteve standarde në formatet më të përhapura siç janë MS Word, MS Excel, PDF, XML dhe të tjera. Dokumentet standarde duhet të përfshijnë modele të dokumenteve për metoda të ndryshme të prokurimit për prokurim të mallrave, punëve, shërbimeve si dhe modele mbështetëse përkatëse siç janë paramasa dhe parallogaria, plani i punës, CV, specifikacioni teknik, hyrjet në katalog, modelet e vlerësimit, etj.
	Krijimi, grumbullimi, vlerësimi dhe aprovimi i kërkesës	Grumbullimi i kërkesës përdoret posaçërisht për hartimin e kërkesave nga njësi të ndryshme të subjekteve të prokurimit dhe të autoriteteve lokale për përgatitjen e planeve vjetore të prokurimit. Për marrëveshjet kornizë kërkesat mund të grumbullohen nga subjekte të ndryshme të prokurimit apo në bazë të artikujve individual në nivelin qendror mbarëkombëtarë.	Në rast të prokurimit të punëve, lehtëson ruajtjen në sistem të Listës së Normave për përdorim gjatë përgatitjes së vlerësimit Lehtëson ngarkimin e Listës së Normave përmes një skedari Excel.

	Do të lehtësohet krijimi online i kërkesave në formate të standardizuara. Sistemi duhet të gjeneroj vet numrin e kërkesës. Gjithashtu duhet të lejoj ngarkimin e specifikacioneve teknike në formate të ndryshme. Në rast të prokurimit të mallrave, ofron modele online për vlerësimin e kërkesës nga departamente të ndryshme apo nga autoritetet lokale. Mbështet konsolidimin nga ana e AQP-së të kërkesave të shumta në një kërkesë të vetme Në rast të prokurimit të mallrave, mbështet vlerësimin e kostos duke përdorur çmimin e fundit të kërkesës (përmes integritetit me modulin e kërkesës së menaxhimit të katalogut) apo ndonjë çmimi tjetër të caktuar nga krijuesi i kërkesës. Në rast të prokurimit të punëve, mbështet gjenerimin e vlerësimit përmes specifikimit të sasisë së punës dhe përmes përdorimit të listës së normave të aprovuar paraprakisht. Lehtëson lidhjen e numrit të kërkesës me kodin e përgjithshëm të projektit, nëse prokurimi është pjesë e një projekti më të madh me prokurime të shumëfishta, dhe bënë llogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme të projektit duke u bazuar në prokurimet (kërkesat) individuale të lidhura me kodin e projektit.	Lehtëson konfigurimin e procesit të ndarë të punës varësisht nga lloji dhe vlera e punës së përzgjedhur gjatë kohës së krijimit të kërkesës (p.sh.: punë e vogël apo e madhe, origjinale apo e riparuar, etj.). Lehtëson sigurimin e komenteve, etj., së bashku me kërkesën. Sistemi duhet të regjistroj në çdo fazë komentet nga aprovuesit e autorizuar. Azhurnon/fshin numrin e kërkesës duke u bazuar në rezultatet e shqyrtimit nga ana e aprovuesve të autorizuar. Mirëmban regjistrime të auditueshme për të gjitha veprimet në lidhje me kërkesat (krijimin, aprovimin, refuzimin, etj.). Lejon ndërlidhjen me SIMF për të lehtësuar miratimin e shpenzimeve të projektit (kërkesës) me buxhetin e departamentit në dispozicion, dhe për të mënjanuar tejkalimin e shpenzimeve të projektit, po ashtu edhe gjendjen e inventarit. Lehtëson gjenerimin e raportit të gjendjes që tregon historinë e kërkesës në aspektin e datës dhe orës së krijimit,
--	--	--

			dërgimin tek aprovuesi i fundit, fazën e fundit të procesit të punës, kohën e kaluar për të aprovuar kërkesën nga ana e aprovuesit, etj. Koha e kaluar nga ana e autoriteteve për të aprovuar kërkesën do të paraqitet duke përdorur grafika dhe ngjyra lehtësisht të pranueshme. Mbështet procesin e punës për Agjencinë Qendrore të Prokurimit për të pranuar kërkesa nga departamente të shumta, përgatit vlerësimin e shpenzimeve dhe ua dërgon ato departamenteve përkatëse për aprovim. Për më tepër, merr aprovimin nga departamentet dhe fillon procesin e tenderimit (nëse vendoset).
	Planifikimi vjetor i prokurimit	Duhet të ekzistoj një model online në bibliotekën e modeleve për planin e prokurimit të korporatave (departamenteve), si dhe plani vjetor i prokurimit për secilin subjekt të prokurimit duhet të kompletohet dhe të regjistrohet në regjistrin e planit të prokurimit Publikimi i planit për qasje të publikut. Të aprovohet pas përshkallëzimit automatik të autorizimit. Të dhënat standarde që duhet të përfshihen në planin e prokurimit janë përshkrimet e prokurimit, lloji dhe metoda e prokurimit, lloji i buxhetit, kostoja e përlogaritur, data e planifikuar për shpallje në gazetë, nënshkrimi i kontratës, data e kompletimit dhe të dhëna të tjera të	Lidhet në modulën e procesit të punës Mund të ketë funksionalitet të ndërlidhet me SIMF për të vërtetuar buxhetin e caktuar. Integrohet me SIM për regjistrimin automatik të të dhënave në lidhje me kohën e shpenzuar për ta kompletuar atë, kohën për ta reklamuar, numrin e ndryshimeve gjatë vitit, mospërputhjen midis shpenzimeve të planifikuara dhe atyre aktuale. Ky integrim

		rëndësishme të etapave të ndryshme të ciklit të prokurimit, performanca dhe objektivat e prokurimit.	gjithashtu duhet të lejoj planifikimin për planet e tanishme të prokurimit dhe të atyre në të ardhmen. Statusi e marrëveshjeve kornizë dhe e marrëveshjeve tjera duhet të jetë e mundur për t'u verifikuar përgatitjen e planit të prokurimit. Raportimi i performancës duhet të gjenerohet sipas - raporteve standarde për publikim, planifikimit të ardhshëm dhe vendimeve strategjike. Për qëllime të analizave duhet të jetë i mundur të bëhet unifikimi nën një ministri të vetme i të gjitha planeve vjetore të prokurimit të departamenteve të ndryshme.
	Planif ikimi individual i prokurimit	Ekzistimi i një plani të autorizuar të prokurimit është një parakusht automatik për procedurën e përzgjedhjes së prokurimit, përveç nëse prokurimi është në kategorinë e përjashtuar Kategoria e përjashtuar duhet të zgjidhet në mënyrë automatike. Përjashtimi do të jetë për të gjitha prokurimet përmes marrëveshjeve kornizë dhe/apo nën pragun e vlerës. Zyrtarët e zhvillimit të planifikimit të përfshihen në regjistrimin e planit për qëllime të monitorimit dhe të auditimit Plani individual i prokurimit i secilit prokurim duhet të jetë në linjë me planin dhe buxhetin e përgjithshëm të subjektit të prokurimit	Lidhet në modulën e procesit të punës Mund të ketë funksionalitet për t'u ndërlidhur me SIMF dhe çdo sistem të menaxhimit të inventarit për të konfirmuar gjendjen e inventarit të artikujve të ndryshëm të prokurimit, nëse këto ndërlidhje janë të ndërtuara për të ndërlidhur. Prokurimi dhe analizat e artikujve duhet të jenë në dispozicion për analizën e vlerës për para.

	Kontr ollimi i tenderit	Siguron një objekt për të shënuar planin individual të prokurimit, tenderët, subjektet e prokurimit, mundësitë lokale në Listën e kontrollit për secilin ofertues të regjistruar. Lidhur në mënyrë automatike 'Listën e kontrollit' me të gjithë tenderët e reklamuar, subjektet e prokurimit dhe ofertuesit e regjistruar, duke u ruajtur paraprakisht në Listën e kontrollit. Në mënyrë automatike, lista është rregulluar sipas radhës së artikullit të shtuar në listë, mirëpo duhet të ketë në dispozicion edhe opsione të tjera të filtrimit dhe të renditjes. Siguron objektin për të hequr një artikull nga Liste e kontrollit	Për çdo mundësi të tenderimit në dispozicion nga burimet në Listën Kontrolluese duhet të njoftohen automatikisht ofertuesit e mundshëm përkatës.
	Specif ikacionet	Sistemi i prokurimit elektronik duhet të ofroj një mjet për të mbledhur specifikacionet e detajuara teknike, afariste dhe funksionale, të vendos kriteret dhe nënkriteret e vlerësimit, kërkesat standarde të cilësisë dhe performancës, rëndësinë/peshën, vlerën minimale të kalimit, pikët maksimale për secilin kriter, të gjeneroj listën e ngushtë dhe/apo rezultatet e vlerësimit. Dorëzon raportin/përmbledhjen e vlerësimit autoriteteve përkatëse të subjektit të prokurimit. Vlerësimet inxhinierike dhe të dhënat tjera nga departamentet apo inxhinierët e konsultuar, etj., duhet të ruhet në mënyrë të sigurt në pjesën e të dhënave të tenderit të veçantë	Lidhet në modulën e procesit të punës Specifikacionet teknike, standardet e përgatitura të cilësisë dhe ato të performancës duhet të planifikohen me një kod të artikullit dhe të klasifikohen sipas kategorisë përkatëse për të lejuar ndërtimin e një katalogu i cili mund të përdoret prapë për prokurime të ndryshme duke përfshirë marrëveshjet kornizë, ankandin e anasjelltë, prokurimin e drejtpërdrejtë, etj. Specifikacionet teknike duhet të arsyetohen siç duhet.
	Doku menti i projekt- tenderimit	Duke përdorur modelet e dokumenteve standarde të tenderit (DST) nga biblioteka online e modelit të sistemit, subjekteve të prokurimit do t'u epet një mjet për të përgatitur dokumentet e tenderit në	Siguron integrimin me sistemin informativ ekzistues të menaxhimit të projektit/buxhetit për të lehtësuar miratimin e kostos së projektit me buxhetin në

	dhe zhvillimi i kontratës	përputhje me llojin dhe metodën e prokurimit, buxhetin dhe objektivat e qeverisë. Menaxhimi i etapave përkatëse duke u bazuar në llojin e prokurimit (punë, mallra, shërbime). Në rast të shërbimeve, publikimi i kërkesës për shprehje të interesit, afatet për dorëzimin e shprehjes së interesit, vlerësimi dhe lista e ngushtë, data e lëshimit të kërkesës për propozime, data e takimit të parapropozimit, afatet për dorëzimin e propozimit, vlerësimi i propozimit, negociimi, datat e aprovimit, nënshkrimi i kontratës, data efektive e kontratës, data e kompletimit të kontratës, etj., duhet të regjistrohen dhe të azhurnohen në përputhje me rrethanat. Në rast të prokurimit të mallrave, ndërmerr përlogaritjen e kostos duke përdorur çmimin e fundit të kontratës kornizë (përmes integritetit me modulin e menaxhimit të katalogut) ose një çmim tjetër standard siç specifikohet nga ana e vlerësuesit. Në rast të prokurimit të punëve, përgatit paramasën dhe parallogarinë për përdorim gjatë përgatitjes së vlerësimit. Për të gjitha rastet (mallrat, punët, shërbimet) datat të jenë racionale në mënyrë të njëpasnjëshme. Kapaciteti i cili do të përfshihet për rregullat e afatit kohor duhet të inkorporohet (si, data për mbylljen e kërkesës për tenderim nuk duhet të jetë më pakë se 15 ditë pune pas reklamimit të kërkesës për tenderim). Afatet kohore duhet të jenë të disponueshme në mënyrë automatike për prezantim grafik.	dispozicion të departamentit, dhe për të mënjeluar tejkalimin e shpenzimeve të projektit – lidhet gjithashtu me procesin e autorizuar të punës. Subjektet e prokurimit duhet të jenë në gjendje të përgatisin dokumentet jashtë internetit dhe online dhe të bëjnë azhurnimin në sistem. Por të gjitha azhurnimet në sistem për përgatitjen e tenderit duhet të jenë sipas procesit standard të punës. Autoritetet e autorizuar paratenderuese dhe zyrtarët e tjerë të prokurimit duhet të kenë qasje në dokumentet gjatë përgatitjes dhe procesit të aprovimit. Pas aprovimit online të dokumenteve përfundimtare nga ana e zyrtarit të autorizuar, duhet të jetë i mundur reklamimi i ftesës për tenderim, kërkesës për shprehje të interesit, apo kërkesës për kuotim. Ekzistojnë metoda të prokurimit të bazuara në kohë dhe në shumë të madhe parash për shërbimet siç janë QCBS, QBS. Plani i punës, menaxhimi i personelit profesional si dhe përcjellja e performancës
--	---------------------------	--	--

			janë kërkesat kryesore. Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (MNSh) së bashku me performancën dhe pritjet e cilësisë, si dhe me matjen e rezultateve dhe të përputhjes duhet të jenë pjesë e kontratës dhe të kenë mundësi të futen në modulën e përcjelljes së kontratës. Duhet të jetë e mundur që artikujt nga paramasa dhe parallogaria të ngarkohen në dokumentin e kontratës.
Përzgjedhja dhe dhënia e tenderit	Lajmërimi në gazetë (Reklamimi) i ftesës për tenderim	Përgatit dokumentet standarde të njoftimit për aprovim për shprehjen e interesit, kërkesës për propozime, kërkesës për tenderim, kuotim, etj. Kërkesa për tenderim do të publikohet drejtpërdrejt nga ana e subjekteve të prokurimit në datën dhe orën e caktuar në sistem nga ana e subjektit të prokurimit (pas verifikimit nga ana e KRPP-së, nëse është e nevojshme) Lehtëson ngarkimin e korrigjimeve dhe të shtojcave të shumta U dërgon alarmet automatike palëve të regjistruara të interesit në lidhje me ftesën për tender të ri, dhe për korrigjime. I lejon krijuesit të 'Ftesës për tenderim' të specifikoj kërkesat minimale të cilat duhet të plotësohen online nga ana e tenderuesit kundrejt çdo parametri të vlerësimit. Lejon përzgjedhjen e fazave të shumfishta të vlerësimit të tenderit (parakualifikimi, 1- zarfi, 2- zarfi, etapa të shumfishta, etj.) duke	Lidhet me modulën e procesit të punës për komplet ciklin e përgatitjes së reklamimit. Mund të lidhet me planin vjetor të prokurimit dhe me planin individual të prokurimit gjithashtu. Në mënyrë automatike lejon apo nuk lejon veprimet e përdoruesit të cilat korrespondojnë me orarin e tenderit të specifikuar në sistem. Për shembull: nuk lejon shkarkimin e formularit të tenderit pas datës së fundit të specifikuar të prokurimit të dokumenteve të tenderit, nuk lejon shikimin e tenderit asnjërit nga personeli para datës dhe orës së hapjes së tenderit, etj.

	u bazuar në llojin, natyrën dhe vlerën e vendosur në tender dhe të specifikuar nga ana e subjekteve të prokurimit. Lejon njoftimet e kërimit të tenderit online në mënyra të ndryshme duke përfshirë numrin e tenderit, përshkrimin gjenerik, lokacionin, autoritetin lokal, subjektin e prokurimit, publikimin, natyrën dhe kategorinë e punës, etj. Lejon, nëse kërkohet dhe nëse lejohet nga KRPP-ja apo nga udhëzimet e qeverisë, të specifikoj dhe zgjedh lokalitetin (qarqet, komunat), rajonin, vendet për të ftuar për tenderim, shprehje të interesit, kuotim dhe lloje të prokurimeve. Menjëherë pasi që të publikohen lajmerimet në gazetë për ftesën për tenderim, të gjithë tenderuesit e regjistruar të regjistruar sipas asaj kategorie të veçantë duhet të pranojnë në mënyrë automatike njoftimin në postën e tyre elektronike apo përmes SMS porosisë duke u bazuar në preferencën të cilën ata e kanë zgjedhur për të pranuar auto alarme.	Lehtëson mënyrën e përcjelljes së tenderëve duke përdorur numër unik të tenderit i caktuar për çdo tender të ri. Përcjellja për të mbuluar fazat e procesimit dhe të komenteve të siguruara nga autoritete të ndryshme gjatë shqyrtimit dhe aprovimit, si dhe koha e kaluar për secilën fazë. Nuk lejon që fazat kohore të janë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga KRPP / Ligji i Prokurimit. Të jetë e mundur që ndryshimet e rregullave për prokurimet individuale të autorizohen nga KRPP-ja. Lidhet me portën e pagesave për pagesat të cilat nevojiten për shkarkim të dokumenteve, etj., ku/kurdo që aplikohet. Të gjitha njoftimet e prokurimit duhet tu shkojnë gjithashtu edhe shoqatat profesionale siç është Oda Ekonomike dhe të tjera, në mënyrë që anëtarët e regjistruar dhe të paregjistruar të marrin njohuri mbi mundësitë dhe që kompanitë e paregjistruara të inkurajohen të regjistrohen në sistemin e prokurimit elektronik.
--	---	--

		Të dhënat e ofertuesve të mundshëm dhe të atyre pjesëmarrës do të ruhen në sistemin e prokurimit elektronik, mirëpo emrat e tyre dhe të dhënat tjera nuk do t'u epen subjekteve të prokurimit. Subjektet e prokurimit do të dinë vetëm numrin e dokumenteve të shkarkuara. Emrat dhe të dhënat tjera nuk do tu zbulohen subjekteve të prokurimit derisa të mbahet sesioni i hapjes së ofertave. Publikimit në portalin e sistemit duhet t'i epet status zyrtar i barasvlershëm si të një publikimi zyrtar.
Pagesat për dokumente, regjistrim apo shërbime të tjera	Mund të kërkohet nga furnitorët e mundshëm që të paguajnë për një lot të vetëm, si dhe opsione të tjera të pagesës për dokumentet, proceset apo shërbimet e tenderit. Ofertuesit të cilët kanë qasje në dokumente duhet të regjistrohen dhe në mënyrë të automatike të njoftohen për çdo ndryshim. Ofertuesit nuk do të ngarkohen për dokumentet e ndryshuara. Sistemi duhet të ketë kapacitet të aplikoj një tarifë për dorëzimin e tenderit (kjo metodë një formë shumë e mirë nga pikëvështrimi i praktikave më të mira të pagesës për dokumente të tenderit) Sistemi duhet të siguroj një objekt për të regjistruar të gjithë personat të cilëve u janë lëshuar/shituar/shkarkuar dokumentet e tenderit dhe ato të dhëna duhet të kenë numrin e referencës dhe datën/orën e pagesës për dokument dhe të përfshijnë të gjitha të dhënat kontaktuese	Lidhet me portën e pagesave për pagesat e kërkuara Ofertuesi duhet të lexoj me kujdes termat dhe kushtet e sistemit dhe si çfarëdo mohimi tjetër, njoftim të rëndësishëm dhe para dorëzimit të tenderit të pajtohet me to pa kushtëzim. Nëse ofertuesi nuk pajtohet me termat dhe kushtet, atëherë dorëzimi i tenderit nuk mund të kryhet dhe kontrolli duhet të ridrejtohen në panelin e aparaturave të ofertuesit.

			Ofertuesit duhet t'i sigurohet mundësia që të zgjedh një metodë të përshtatshme të pagesës, pagesës bankare apo portës së pagesës. Në panelin e aparaturave të ofertuesit duhet të ketë një panel të aparaturave i cili mundëson zgjedhjen e preferencës së pagesës. Siguron qasje në faqen e pagesave, duke nxitur ofertuesin të shkruaj/zgjedh identifikimin e tenderit, emrin/identifikimin e subjektit të prokurimit, identifikimin dhe fjalëkalimin e përdoruesit, të dhënat e llogarisë së subjektit të prokurimit, shënimin e komenteve dhe verifikimin CAPTCHA. Sistemi duhet të shfaq një porosi si dhe duhet të shfaq numrin e referencës së konfirmimit (si, pagesa e suksesshme, numri i konfirmimit të pagesës është 00000001'). Porosia do të dërgohet në postën elektronike apo në celularin e preferuar të ofertuesit. Siguron ofertuesit mundësinë e shtypjes së ofertës duke përdorur opsionin e shtypjes në shfletimin për qëllime të referimit.
--	--	--	---

	Përgatitja e tenderit	Tenderuesve ju siguron kapacitet për të shfrytëzuar formularët e modeleve të dokumenteve standarde dhe për të përgatitur dokumentet e tenderit online. Kjo do të zvogëloj kohën e shpenzuar për ngarkimin e dokumenteve dhe do të minimizoj gabimet njerëzore. Tenderuesve ju siguron opsionin për të ngarkuar dokumentet e kompletuara të tenderit në formate të përshtatshme gjatë kohës së dorëzimit të tenderëve. Nëse dokumentet janë krijuar për t'u importuar në sistem (në formatin MS Excel apo në formatet CSV), sistemi duhet të importoj në mënyrë automatike të dhënat nga skedari dhe të plotësoj tabelat përkatëse të bazës së të dhënave me masat e sigurisë të përshkruara në modulet e sigurisë Sistemi duhet të siguroj një mjet për të azhurnuar ofertën e tenderit në çdo kohë derisa tenderi të jetë dorëzuar përfundimisht. Sistemi gjithashtu duhet të ofroj një mundësi për të ngarkuar dokumentet tjera të ndërlidhura (si, broshurat, vizatime të formateve me madhësi të vogël dhe të madhe, etj.)	Sistemi duhet të ofroj një objekt për të gjeneruar në kohë reale vlerën e përzier) gjatë kohës së ruajtjes së të dhënave të formularit për çdo të dhënë të formularit të tenderit dhe ta ruaj atë në bazën e të dhënave dhe të verifikoj për çdo korrigjim dhe ndryshim të atyre të dhënave. Pjesë dhe tekste statike dhe fikse të dokumentit të tenderit, siç janë udhëzimet mbi tenderët, kushtet e përgjithshme të kontratës duhet t'u epen ofertuesve në formatin shërben vetëm për t'u lexuar. Siguron një mjet për përzgjedhje nga një listë e mundësive nga kutitë e përzgjedhjes ose nga menyja rënëse kur të bëhet futja në mënyrë sa më të përshtatshme dhe sa më të saktë të mundshme të të dhënave në dokumentin e tenderit. Kjo do të zvogëloj gabimet njerëzore.. Sistemi DUHET të ketë mundësinë për shikim paraprak të dokumenteve para publikimit/shtypjes së dokumenteve të tilla. Dokumentet/formularët e plotësuar nga ofertuesi mbeten si draft derisa ofertuesi të dëshiroj ta DORËZOJ PËRFUNDIMISHT atë. Ofertuesi mund të
--	------------------------------	--	--

		tërheq tenderit në çdo kohë para kohës së mbylljes së ofertimit përmes procesit të tërheqjes së tenderit. Tërheqja e tenderit apo ndryshimi i tenderit nuk duhet të fshij dokumentet origjinale. Për më tepër dorëzohet dokumentacion shtesë për të lehtësuar rikodimin e ndryshimeve. Siguron mundësinë për të gjeneruar dokumentin komplet të tenderit në MS Word, PDF, XML apo ndonjë format tjetër të kërkuar.
Dorëzimi i tenderit	Tenderi mund të dorëzohet nëse tarifa për dokumentet e tenderit apo për dorëzimin e tenderit si dhe për sigurinë e tenderëve është paguar dhe nëse statusi i Paguar është aktiv në sistem për tenderin e përzgjedhur. Ofertuesi duhet të dorëzoj vetëm një tender. Dorëzimi përfundimtar në pjesë nuk lejohet. Mirëpo para dorëzimit përfundimtar, gjatë kohës së përgatitjes së tenderit, lejohet që të bëhet modifikimi, azhurnimi dhe fshirja. Ofertuesi duhet të plotësoj formularët dhe të ngarkoj të gjitha dokumentet e detyrueshme. Dështimi për të ngarkuar dokumentet e detyrueshme shkakton pezullimin e dorëzimit të tenderit dhe ofertuesi nuk do të ketë mundësi të dorëzoj tenderin. Nëse lejohet të importohen dokumentet në sistem (si, në formatin MS Excel apo në formatet CSV), sistemi do të importoj në mënyrë automatike të dhënat nga skedari dhe do të plotësoj tabelat përkatëse të	Nëse ofertuesi dëshiron të dorëzoj dokumentet e përgatitura jashtë linjës si internetit, duke përdorur modelin e dokumentit standard, ai/ajo duhet të bëjnë gati të gjitha dokumentet e tenderit në sistemin e përdoruesit siç përcaktohen në listën e faqes së dokumentit. Siguron opsionin “shfleto” për të zgjedhur dosjen e cila përbëhet nga skedarët në formatin pdf / zip / xls të cilët duhet të ngarkohen. Pas përzgjedhjes së dosjes, zgjedh skedarin i cili duhet të ngarkohet. Përsërit këtë proces për të ngarkuar të gjithë skedarët.

	bazës së të dhënave me masat e sigurisë të përshkruara në modulet e sigurisë Lehtëson ngarkimin e dokumenteve mbështetëse siç janë vizatimet (në formatin CAD si dhe në formatet e skanuara), specifikacionet teknike, termat dhe kushtet e kontraktorit/furnitorit, si dhe të dhënat për prokurim së bashku me tenderin. Ofron një listë kontrolli online për të siguruar që dokumentet e kërkuara mbështetëse janë ngarkuara nga ofertuesi. Lehtëson skanimin për virus të dokumenteve të ngarkuara para se ato të pranohen dhe të ruhen në server. Shfaq në mënyrë të qartë, në ekranin e duhur, orën në sistem (server) si dhe kohën e mbetur në orë dhe minuta deri në mbylljen e dorëzimit të tenderit. Pasi të jetë dorëzuar në mënyrë të suksesshme, sistemi do të shfaq në ekran dhe në postën elektronike të ofertuesit njoftimin mbi dorëzimin e suksesshëm. Dorëzimi i plotë i tenderit do të konsiderohet i kompletuar në mënyrë të suksesshme vetëm kur të gjitha dokumentet e kërkuara të jenë ngarkuar në mënyrë të suksesshme si dhe kur të gjithë formularët e nevojshëm të jenë plotësuar me miratimin e sistemit Pjesa për dorëzimin e tenderit duhet të ofroj një paralajmërim për ofertuesin nëse ndonjë nga dokumentet e detyrueshme nuk është ngarkuar. Nëse një dokument i detyrueshëm nuk është ngarkuar apo dorëzuar, sistemi nuk duhet të lejoj ofertuesin të vazhdoj më tej përveç se të anuloj, përderisa dokumentet e ngarkuara dhe formularët e plotësuar	Sistemi do të mirëmbaj opsionet vijuese automatike, përveç nëse në Pjesën e Konfigurimit konfigurimi është bërë ndryshe. Udhëzimet në vazhdim duhet të paraqiten në secilën faqe ku ngarkimi është i lejuar: Këshillë për të nxjerr dhe për të verifikuar përmbajtjen e skedarëve të kompresuar për të shmangur diskualifikimin. Çdo madhësi e skedarit duhet të jetë e konfigurueshme nga administruesi i sistemit ndarazi për punët, mallrat dhe shërbimet. Madhësia për skedarin e punëve mund të jetë më e madhe se sa për mallrat dhe shërbimet. Pas kalimit të afatit për dorëzimin e tenderit, skedarët e ngarkuar nuk do të jenë të dukshëm për ofertuesin. Siguron mundësinë e enkriptimit automatik dhe e ruan në bazën e të dhënave të sistemit. Kur dokumentet të jenë të enkriptuara dhe të ngarkuara, atëherë duhet të paraqitet porosia ‘Dokumentet tuaja janë të enkriptuara dhe të dhe ngarkuar me sukses’.
--	---	--

	mbeten të vlefshëm në sesion, kështu që ofertuesi ka mundësinë të ngarkoj dokumentin i cili i mungon dhe të kompletoj dorëzimin. Ashtu siç është përcaktuar në Preferencat, ofertuesi njoftohet mbi përmbledhjen e dorëzimit të tenderit me datën dhe orën, numrin e referencës, numrin e përdoruesit, kohën e fillimit të dorëzimit, kohën e kompletimit të dorëzimit, përzierjen e skedarëve të ngarkuar si dhe për tenderin e pranuar nga sistemi. Pas dorëzimit përfundimtar të tenderit, nuk lejohet që ofertuesi të shikoj apo të shkarkoj tenderin e dorëzuar. Ofertuesit duhet të jenë në gjendje të modifikojnë ofertën e tyre të dorëzuar brenda kohës së dorëzimit dhe para mbylljes, përmes ngarkimit të dokumenteve të modifikimit. Megjithatë, sistemi do të ruaj dokumentin e dorëzuar paraprakisht	Sistemi duhet të siguroj një mundësi për të gjeneruar në kohë reale vlerën e përzier gjatë kohës së ruajtjes së të dhënave për të gjitha të dhënat e formularit të tenderit dhe ta ruaj atë në bazën e të dhënave si dhe të verifikoj për çdo rikthim të atyre të dhënave. Butoni për dorëzimin e tenderit do të jetë aktiv vetëm kur të bëhet pranimi i pagesës nga subjekti i prokurimit përmes mjeteve elektronike dhe kur flamuri I PAGUAR të vendoset në mënyrë automatike në PO së bashku me të dhënat tjera të pagesës. Ofertuesi mund të shoh në çdo kohë statusin e tenderëve përmes zgjedhjes së butonit/linkut “Shiko” statusin në secilin tender të regjistruar në Regjistrin e progresit të tenderëve,. Dorëzimi i tenderit duhet të kaloj përmes procesit të verifikimit (elektronik, fjalëkalimit apo infrastrukturës kyçe publike) dhe duhet të ruhet në mënyrë të sigurt në sistem derisa të kaloj koha e përcaktuar e hapjes së tenderit.
--	--	---

	Mena xhimi i takimit të paratenderimit	Duhet të jetë e mundur që takimi paratenderues të mbahet online dhe procesverbali i takimit duhet t'u dërgohet ofertuesve të cilët kanë dorëzuar tenderët menjëherë pasi që procesverbali të jetë përgatitur dhe aprovuar. Ofertuesit duhet të kenë një mundësi nga tabela e tyre e aparaturave për të dorëzuar kërkesat për sqarim. Nuk priten emaila, fakse apo kanale të tjera.	Duhet të ndërlihdhet me SIM dhe me historinë e veçantë të tenderit. Anëtarët apo zyrtarët e komitetit të paratenderimit të emëruar nga subjektet e prokurimit do të mbajnë online takimin e paratenderimit.
	Ndryshimi i tenderit	Në çdo kohë para përfundimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, subjekti i prokurimit, me iniciativën e vet apo si përgjigje ndaj ndonjë kërkesë të ofertuesit apo si rezultat i takimit paratenderues, duhet të jetë në gjendje të modifikoj dokumentet e tenderit. Rregullat e KRPP-së do të aplikohen në lidhje me atë se çfarë lloji i vazhdimit të kohës së reklamimit/shpalljes në gazetë do të aplikohet kur të jenë bërë ndryshimet. Ndryshimet e tenderit mbesin si një pjesë përbërëse e tenderit origjinal. Prandaj, ndryshimet duhet të shfaqen në mënyrë të dukshme në listën publike të tenderëve dhe në të dhënat e tij.	Ndryshimi i tenderit kalon përmes procesit të aprovimit. Sistemi duhet t'u dërgoj në mënyrë automatike njoftimet për dokumentet e ndryshuara ofertuesve pjesëmarrës. Sistemi duhet të ruaj historinë dhe ndërlihdjen me SIM Nëse ndonjë specifikacion është ndryshuar, edhe hyrjet në katalog duhet të jenë në gjendje për t'u azhurnuar gjithashtu. Fazat në një tender të vetëm duhet të jetë të lidhura në mënyrë logjike dhe të kalojnë përmes procesit të punës. Duhet të ruhet historia dhe ndërlihdja me SIM.
	Pranimi i tenderëve	Lehtëson azhurnimin e pranimi të tenderëve së bashku me dokumentet mbështetëse siç janë garancionet dhe certifikatat. Tenderët nuk pranohen përveç nëse pagesat janë azhurnuar, gjithashtu edhe nëse i nënshtrohen ndonjë kriteri të kualifikimit	Subjekti i prokurimit nuk duhet të dijë emrin e ofertuesit deri në hapjen e tenderit. Para hapjes duhet të tregohet vetëm numri i tenderëve të pranuar.

		Alarmet e postës elektronike do t'u dërgohen ofertuesve duke i njoftuar ata për pranimin e dokumenteve mbështetëse nga ana e departamentit. Ofron për shqyrtim online të statusit lidhur me pranimin e tenderëve dhe dokumenteve mbështetëse duke përdorur numrin e dorëzimit të tenderit.	Sistemi duhet të verifikoj në mënyrë automatike nëse letrat me vlerë të tenderit janë adekuate ashtu siç është përcaktuar në kërkesën për tenderim. Çdo siguri (letër me vlerë) e tenderit duhet të përgatitet ashtu siç parashihet në dokumentin e ofertimit përmes një banke apo kanaleve tjera dhe të ngarkohet/shkarkohet së bashku me tenderin (politika e KRPP-së duhet të jetë ashtu që letrat me vlerë të tenderit të jenë të fshehta nga subjektet e prokurimit derisa të kompletohet hapja e tenderit). Sistemi duhet që në mënyrë automatike të mbaj shënim mbi pranimin e tenderëve.
	Hapja e tenderit	Ofron qasje në dokumentet e tenderit dhe në informatat tjera në lidhje me tenderin për komisionin e hapjes së tenderit (KHT) apo komisionin për hapjen e propozimeve (KHP) vetëm pas kalimit të apo gjatë datës/orës së hapjes së tenderëve. KHT/KHP duhet t'u epet qasje në dokumentet e tenderimit/kërkesën për propozim shitur/lëshuar për tender. Ofron formularë për regjistrimin e të dhënave/listat kontrolluese të hapjes së tenderëve për t'i regjistruar leximet nga hapja e tenderëve.	Formati i leximin online të hapjes së tenderit duhet të jetë e disponueshme në bibliotekat e modelit dhe të përzgjidhet në mënyrë automatike nga secili tender për gjenerimin e të dhënave të hapjes, të cilat do t'i dërgohen komisionit vlerësues përmes procesit të punës ashtu siç është konfiguruar. Sistemi do të përgatis të dhënat e hapjes së tenderit duke i tabeluar në mënyrë

		Ofron pajisjet për të përgatitur dhe për t'i dorëzuar autoritetit të subjektit të prokurimit raportet e hapjes së tenderit/propozimit/shprehjes së interesit (leximet, procesverbalet me deklarata).	automatike informatat e veçanta nga ofertat e dorëzuara. Informatat online të hapjes duhet të ndahen me ofertuesit
	Procesi i punës së vlerësimit të tenderit	Regjistron komentet nga aprovuesit nëpër etapa të ndryshme të vlerësimit të tenderit dhe lehtëson bashkëngjitjen tenderit të rezultateve të vlerësimit. Përgatit raporte mbi përputhshmërinë e tenderëve teknik për të ndihmuar në vlerësim komisionin e vlerësimit të tenderit. Gjeneron grafike krahasuese të tenderëve të pranuar komercial për të ndihmuar në identifikimin e kontraktorit/furnitorit të preferuar të tenderimit. Raporton rekomandimet duke ofruar arsye për vendimet, në përputhje me rregullat afariste të qeverisë. Për refuzimin e një tenderi në çfarëdo faze, përgatit raport standard si në modelin e bibliotekës. Sistemi duhet të gjeneroj një raport të vlerësimit të bazuar në kriteret e konfiguruar. Shumica e krahasimit të çmimeve duhet të gjenerohet në mënyrë automatike gjatë kohës së hapjes së tenderit, kuotimit, apo propozimit. Vë në dispozicion të ofertuesve të regjistruar rezultatet e vlerësimit të tenderit pasi të jetë kompletuar procesi i vlerësimit. Matricat në dispozicion të ofertuesve nuk duhet të zbulojnë informata konfidenciale nga firma tenderuese. Komisioni mund të mos zgjedh asnjë, të zgjedh një apo shumë ofertues të suksesshëm nga ata të cilët kanë dorëzuar tenderët.	Procese të ndara të punës për vlerësimin e tenderit të bazuara në numrin dhe llojin e fazave të përzgjedhura (fazat e vlerësimit teknik, komercial dhe tekniko-komercial dhe të parakualifikimit). Mirëmban regjistrime kohore të proceseve. Tabelimi krahasues i vlerësimit duhet të përgatitet nga sistemi për krahasim të kërkesave të përputhjes të artikujve të paramasës dhe parallogarisë, specifikacioneve të kërkuara dhe të ofruara, krahasimin e ofertës financiare, ngarkimeve ballore dhe indikacioneve të tjera të praktikave të fshehta, dhe të listës së renditjes së rekomandimeve për dhënie të kontratës. Raportet krahasuese të ofertave të çmimit të tenderit të bazuar në paramasën dhe parallogarinë, CV-të, listën kontrolluese të përputhjes, autencitetin dhe disponueshmërinë e letrave me vlerë duhet

		Specifikon përqindjen e dhënies së kontratës për secilin ofertues, nëse kërkohet. Mbështet procesin e punës për vlerësim dhe aprovim (nga autoritetet kompetente, komisionet e vlerësimit të tenderit, etj.). Mbështet procese të ndara të punës për vlerësimin e tenderit duke u bazuar në numrin dhe llojin e fazave të përdorura (faza e parakualifikimi, fazat e vlerësimit teknik, financiar dhe tekniko-financiar) dhe anëtarëve të komisionit të vlerësimit i cakton qasje në tabelën e aparaturës.	të gjenerohet duke përdorur modelet e formularëve të duhur të procesit të vlerësimit të konfiguruar për secilën metodë të prokurimit. Anëtari i komisionit vlerësues duhet të ketë qasje në sistem në mënyrë individuale dhe duhet të ketë të mundur futjen e mendimeve individuale. Të gjitha aktivitetet kalojnë përmes modulit të procesit të punës Kryesuesi i komisionit ia përcjell rekomandimet e tij autoritetit përkatës. Lehtëson përcjelljen e sistemit të procesit të vlerësimit. Dërgon alarme të sistemit dhe përshkallëzon në rast të vonesave në çfarëdo faze të procesit. Mirëmban regjistrime kohore për gjenerimin e SIM. Arkivon të gjitha veprimet. Regjistron komentet nga aprovuesit nëpër faza të ndryshme të vlerësimit të tenderit dhe lehtëson bashkëngjitjen tenderit të rezultateve të vlerësimit.
	Njoftimi për Dhënie të	Siguron regjistrin e njoftimeve për dhënie të kontratës (dhënie të tenderit, listën e shkurtër të shprehjes së interesit, dhënien e kontratës për shërbime, etj.) me mundësinë e numrit të referencës, emrin e tenderit,	Modeli “Njoftimi për dhënie të tenderit” për lloje të ndryshme të prokurimit

	Kontratës (NDhK)	datën e shpalljes, datën e fundit për dorëzim dhe njoftimin për dhënie të kontratës, subjektin e prokurimit që bënë shpalljen, etj. Kur bëhet shpallja e njoftimit për dhënie të kontratës, duhet të specifikohet në mënyrë të qartë afati për dorëzimin e sigurisë së performancës dhe të bëhet nënshkrimi i kontratës Projekt kontrata duhet të shpërndahet së bashku me njoftimin për dhënie të kontratës dhe kërkesën për nënshkrim të kontratës	duhet të jetë në dispozicion në bibliotekën e modelit standard. Ndërlidhja me SIM për llogaritjen e ditëve ndërmjet publikimit të njoftimit të tenderit dhe lëshimit të njoftimit për dhënie të tenderit me qëllim të përmirësimit të kohës së përpunimit në të ardhmen.
	Prani dhe nënshkrimi i marrëveshjes për dhënien e kontratës	Siç kërkohet, ofertuesi duhet të pranoj njoftimin për dhënie të kontratës dhe të ofroj sigurinë e performancës. Kontrata/marrëveshja e nënshkruar (MNSh dhe dokumentet e sigurimit, nëse aplikohen) duhet të ngarkohet në sistem, po ashtu edhe paramasa dhe paralogaria e negociuar dhe e miratuar, plani i punës, orari i pagesës, të dhënat mbi shumën si dhe çfarëdo informate tjerr e rëndësishme nga kontrata duhet të jetë në dispozicion për modulën e menaxhimit të kontratave.	Autorizimet dhe aprovimet, njoftimet e komplet raportimit të autoriteteve Pas nënshkrimit të kontratës, të dhënat e dhënies së kontratës duhet të publikohen në pjesën publike të sistemit të prokurimit elektronik. Të dhënat duhet të përfshijnë emrin e kontratës, vlerën e kontratës, emrin e ofertuesit të cilit i është dhënë kontrata, nënshkrimin e kontratës, datën e fillimit, datat e objektivave kryesore të ndërmjetme dhe të kompletimit si dhe emrin dhe adresën e subjektit të prokurimit. Të gjitha dokumentet e kontratës duhet të arkivohen në sistem për regjistrim dhe gjithashtu të jenë në dispozicion gjatë menaxhimit të kontratës. Objektivat dhe kriteret, si dhe oficerët dhe autoritetet mbikëqyrëse duhet të shënohen në

			regjistrimet e modulit të menaxhimit të kontratës
--	--	--	---

Menaxhimi i kontratës, menaxhimi i procesit të punës dhe marrëveshjet kornizë	Mena xhimi i kontratës	Funksionet kryesore të menaxhimit përfshijnë: Menaxhimi dhe monitorimi i progresit të kontratës Menaxhimi dhe monitorimi i performancës së kontratës Menaxhimi dhe monitorimi i pagesave të kontratës Menaxhimi dhe monitorimi i ndryshimeve të kontratës (kur të aplikohet në Kosovë) Menaxhimi i kompletimit të kontratës dhe i vlerësimeve përfundimtare Menaxhimi i çfarëdo garancie Modelet e kontratës dhe udhëzuesit e praktikave më të mira. Faturimi – Procesi i prokurimit duhet të jetë në gjendje të kalkuloj, paraprakisht, datën e caktuar për pagesë duke u bazuar në kushtet e kontraktuara të pagesës dhe të ofroj për përcjellje dhe mirëmbajtje llogarinë e paradhënies dhe progresin e pagesave. Përcjellja – Menaxhmenti i prokurimit duhet të jetë në gjendje të përcjell / azhurnoj shpërndarjen, progresin e punës/shërbimeve, objektivat, të cilat do të jenë në dispozicion të subjektit të prokurimit për verifikim të progresit të kontratës/punës/shërbimeve/shpërndarjes para lëshimit të pagesës dhe lëshimit të urdhrit për pagesë, kompletimit të certifikatës, certifikatës së cilësisë dhe të pranimi. Menaxhmenti i prokurimit duhet të jetë në gjendje të përcjell kohën dhe artikujt për garancion, mbështetje dhe mirëmbajtje, shërbime mbështetëse, etj. Përcjellja duhet të jetë e lidhur me inspektimet dhe shqyrtimet tjera, të cilat gjithashtu do të lidhen me autorizimin e pagesës. Letrat me vlerë – Menaxhmenti i prokurimit duhet të jetë në gjendje t'u përcjell ofertuesve njoftimet mbi kalimin e vlefshmërisë,	Lidhet me modulën e tenderimit elektronik Lidhet me planin e dakorduar të punës, orarin e angazhimit të personelit, orarin e shpërndarjes, garancinë, regjistrin e përcjelljes së performancës, dhe me orarin e shqyrtimit. Lidhet me modulën e pagesave nga SMIF
---	------------------------	---	--

		lëshimin e çfarëdo letre me vlerë, dhe t'i ofroj ofertuesit pajisje për të kërkuar vazhdimin e periudhës së vlefshmërisë, datës së lëshimit sigurisë së tenderit, sigurisë së performancës, mbajtjes së parave, etj. Pagesat – Menaxhmenti i prokurimit duhet të kalkuloj datën e caktuar për pagesë duke u bazuar në kushtet kontraktuale të pagesës dhe të përcjell datat e caktuara të atyre njoftimeve, si dhe të jetë i aftë për të përcjell dhe për të mirëmbajtur llogarinë e paradhënies dhe të progresit të pagesave të ofertuesit. Duhet të jetë i mundur ndryshimi i datave të caktuara gjatë kontratës, subjekt i rregullave të KRPP-së. Mirëmban depon qendrore të informatave të kontratës – Statusin e kontratës, palët e kontraktuale, periudhën e kontratës, mallrat dhe shërbimet e mbuluara, dhe personi/personat kontaktues. Në rast të marrëveshjeve kornizë, regjistrimet duhet të alarmojnë autoritetet e interesuara dhe gjithashtu edhe furnitorët e kontraktuar kur marrëveshja t'i afrohet datës së përtëritjes së saj. Në rast të marrëveshjeve kornizë duhet të lejoj vazhdimin sipas nevojës e cila do të përcaktohet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.	
	Kontr olli i shumëfishtë	Ofron protokolle për kontroll të dyfishtë atëherë kur një funksion ka nevojë të aprovohet nga një përdorues tjetër me autoritet më të lartë. Në raste të tilla, nevojiten dy përdorues me autoritet të mjaftueshëm për të kompletuar funksionin, ku njëri do vendos të dhënat dhe tjetri do të aprovoj atë. Për shembull, nëse të dhënat e vlerësimit inxhinierik zhvillohen nga ana e ndihmës inxhinierëve dhe nëse nevojitet që inxhinieri kryesor t'i autorizoj ato, atëherë inxhinieri kryesor do të njoftohet si pjesë e procesit të aprovimit.	Siguron formularë të konfigurimit për kontroll të shumëfishtë të roleve dhe autoriteteve.

	Planif ikimi i procesit të punës	Menaxhmenti i prokurimit duhet të siguroj planifikimin e procesit të punës i cili tregon secilin proces/hap të prokurimit me departamentin e veçantë, detyrën/rolin, të drejtën dhe lejen për të shtuar, edituar, azhurnuar, fshirë, shtypur, nënshkruar, dërguar, kopjuar atë rol, nyjën e ardhshme dhe të mëparshme në procesin e punës, ngritjen apo rolin alternative, të dhënat/udhëzuesit e detyrës specifike, etj. Duhet të ekzistoj gjithashtu edhe një bazë e të dhënave e rregullave për procesin e punës në lidhje me regjistrin e autoritetit, në mënyrë që ai proces i punës të jetë mjaft i zgjuar për të nxitur veprimin e ardhshëm në procesin e punës dhe të alarmoj autoritetet e interesuara për vëmendjen dhe veprimin e ardhshëm.	Procesi i punës mund të personalizohet nga subjekti por sistemi do të sugjeroj një opsion automatik. Procesi i punës duhet të jetë lehtësisht i menaxhueshëm për të lejuar EP-të të vendosin vet vendimet e tyre.
	Rruga e detyrës - delegimi dhe përshkallëzi mi i detyrave	Detyrat mund të caktohet dhe të ricaktohen, përndryshe ato përshkallëzohen në rrjedhën normale të autoritetit.	Lidhet me regjistrat për të siguruar që detyra nuk i është caktuar dikujt që nuk është i autorizuar
	Përcje llja e kontratës / projektit	Përcjell kontratën apo projektin përgjatë etapave të ndryshme – aktive, mbyllur, përfunduar. Mbështet fazat e parakontratës, si: është duke u ndërtuar (dokumenti i kontratës është duke u ndërtuar) dhe duke u negociuar (vazhdojnë negociatat ndërmjet departamentit dhe kontraktorit). Lehtëson hyrjen apo regjistrimin e zyrtarëve të departamenteve në fjalë me qëllim të futjes së informatave në lidhje me projektin dhe për të siguruar aprovimet nëpër faza të ndryshme. Lejon futjen e informatave për verifikimin e palës së tretë mbi progresin e projektit, kontrollin e cilësisë në sistem.	Grafiku vizual i Gantt-it apo forma të tjera të mjeteve vizuale të përcjelljes duhet të integrohen dhe të lejojnë perspektiva të ndryshme për t'u analizuar.

		Personeli i caktuar duhet të jetë në gjendje të ngarkoj në sistem, për shqyrtim nga ana e autoriteteve më të larta, raportet e inspektimit, fotografitë, etj. Lejon dokumentet, sipas nevojës, që të bashkëngjiten me kontratën, siç janë materialet konsumuese, njoftime të lëshuara kontraktorit, etj. Ofron raportim duke treguar historinë e kontratës apo projektit në aspektin e datës dhe orës së krijimit, dorëzimin aprovuesit të fundit, fazën aktuale në procesin e punës, kohën e shpenzuar për të aprovuar projektin nga ana e aprovuesit, etj.	
	Kontr ollimi i statusit të procesit të punës	Menaxhmenti duhet të jetë në gjendje të vlerësoj statusin e procesit të punës të ngjarjeve në vazhdim kur kjo të kërkohet nga palët e interesit (ofertuesit, subjektet e prokurimit, autoritetet kontraktuese, auditorët, etj.) përmes rolit dhe autoritetit të përshtatshëm: Regjistrimi Vlerësimi i tenderit Dhënia e tenderit Lëshimi i pagesës Mbyllja e tenderit Dorëzimi i tenderit Ndryshimet në tender Testimi i pranueshmërisë Certifikata e kompletimit Ndryshimi i adresës	Procesi i punës duhet të integrohet me regjistrimet e auditimit dhe SIM që të siguroj një raportim dhe analizë gjithëpërfshirëse të veprimtarive. Tabelimi i tërthortë i ndonjë faktori me ndonjë kombinim tjetër duhet të jetë në dispozicion të subjekteve të autorizuar.

		E të tjera Sipas nevojës, moduli i procesit të punës do të sjell proceset e nevojshme të lidhura me datën gjithashtu. Procesi i punës do të siguroj që hapat apo procedurat nuk mund të harrohen dhe do të përcjell veprimtaritë e vonuara për auditim dhe shqyrtim	
	Përcje llja e aktiviteteve	Siguron përcjelljen, duke caktuar data të ndryshme për veprim, burime (personel) të ndryshëm për punë, veprim në pajisjet e aktivizuara të punës me rastin e pranimit të njoftimit për këto ngjarje. Shembull i këtyre ngjarjeve mund të jetë si në vazhdim: Çdo ofertues i ri është regjistruar/çregjistruar Ofertuesi pranoi letrën/postën elektronike për ndryshimin/korrigjimin e tenderit, procesverbalin e takimit të paratenderimit/ftesën për negociim/ftesën për marrëveshje të kontratës, Sigurimi i tenderit është pranuar, Sigurimi i tenderit ka skaduar, Sigurimi i performancës është pranuar, Sigurimi i performancës ka skaduar, Komunikimi nga ofertuesi është pranuar, Kërkesat për pagesë janë pranuar, ekzekutuar, Kërkesa për mbajtjen e parave është pranuar apo koha për lirimin e parave të mbajtura Kompletimi i objektivave dhe/apo njoftimi për projektin, Verifikimi i arritjes së objektivave Certifikata është kërkuar, Ankesat janë dorëzuar, dhe	Sistemi duhet të jetë në gjendje të regjistroj të dhënat në vazhdim, së paku në regjistrimet e ngjarjeve. ID e përdoruesit Roli, autorizimet e përdoruesit Data e ngjarjes Koha/ora e ngjarjes Aktiviteti është kryer Sistemi duhet të ketë mundësinë që përdoruesit e autorizuar të shohin regjistrimet e ngjarjeve përmes një ndërlidhjeje të përshtatshme të përdoruesit në aplikacion. Kjo duhet të lejoj përdoruesin (menaxhimin e një subjekti) që të zgjedh regjistrimet për ndonjë datë dhe orë të caktuar për të cilën të dhënat kërkohen. Sistemi duhet të siguroj një mundësi për përdoruesit e autorizuar që të shohin ngjarjen e ndërlidhura me ndonjë të dhënë të veçantë

		Njoftimet në lidhje me përkujtuesit e tjerë të rëndësishëm të objektivave të tenderit, etj.	
Lëshi mi i urdhrave për fillimin e punës	Zakonisht urdhrat për punë apo urdhri për fillim lëshohet pas nënshkrimit të kontratës, gjë e cila duhet të specifikoj qartë datën e fillimit, vëllimin e punës, koston e punës si dhe detajet tjera. Sistemi duhet të verifikoj pranimin e marrëveshjes së nënshkruar në mënyrë digjitale apo elektronike (si përgjigje ndaj njoftimit për pranimin e tenderit) nga kontraktori para lejimit të lëshimit të urdhrit për punë. Lejon lëshimin e urdhrit për punë kontraktorit të zgjedhur online.	Periodha e kontratës zakonisht është e kalkuluar si referim i datës së fillimit, kështu që duhet të shënohet në regjistrat e përcjelljes dhe historisë së projektit.	
Ndryshimi i kontratës	Siguron aprovimin e bazuar në procesin e punës të ndryshimit të kontratës (kur është në dispozicion).Siguron formularin për azhurnimin e të dhënave të ndryshimit të kontratës (kur është në dispozicion)	Vet gjeneron letrën e ndryshimit të kontratës	
Përcjellja e garancive	Siguron formularin për të regjistruar inventarin e garancive të të gjitha mallrave dhe shërbimeve.Gjeneron vet alarmin mbi skadimin e garancisë dhe vendos flamurin për veprim të nevojshëm nga ana e autoriteteve.Siguron opsionin për të regjistruar garancinë e vazhduar dhe detajet e saj		
Përcjellja e letrave me vlerë	Paraqet listën e tenderëve, subjektit të prokurimit, sigurive sipas kategorisë (siguria e tenderit, siguria e performancës), mbajtja e parave, data e lëshimit, vlefshmëria, kalimi i vlefshmërisë, vazhdimi i vlefshmërisë, banka, etj., për menaxhimin e duhur dhe me kohë të këtyre sigurive. Ofertuesve u ofron njoftime përmes alarmit në lidhje me kalimin e vlefshmërisë, lëshimin e sigurive përmes RSS.	Siguron lidhjen me modulën e menaxhimit të kontratës për përcjelljen e letrave me vlerë.	

		Ofron modelin e letrës për të kërkuar lëshimin e sigurisë së tenderit, sigurisë së performancës dhe mbajtjes së parave pas kompletimit të veprimtarive të caktuar përkatëse.	
	Mena xhimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve	Ofron modelin për të regjistruar ankesat me detajet e kontratës dhe për të përcjell procesin e trajtimit të ankesës Ofron përcjelljen e statusit të zgjidhjes së ankesave Ofron formularin për regjistrimin e shënimit përfundimtar të zgjidhjes dhe të nivelit të kënaqësisë së subjektit të prokurimit/kontraktorit Ndërmerr analiza statistikore, dhe auditim të ankesave	Ndërlidhet me SIM për të analizuar shpeshtësinë e kontesteve, arsyet e tyre dhe për të përmirësuar zonën e problemit në prokurim
	Përgatitja automatike e faturës	Mbështet gjenerimin automatik të faturës bazuar në termat dhe kushtet e verifikuara të marrëveshjes së kontratës. Aplikon në faturë çfarëdo takse të shërbimit, taksën e shitjes, etj., ashtu siç aplikohet në nivel lokal. Përcjell vonesat e projektit në pjesën e kontraktorit dhe në përputhje me rrethanat aplikon dispozita ndëshkuese gjatë kohës së përgatitjes së faturës. Përcjell vonesat në pagesa të kontraktorit dhe aplikon dispozitat e pagesës së interesit sipas termave dhe kushteve të marrëveshjes së kontratës. Përcjell të gjitha objektivat dhe veprimtaritë e tjera kritike	Duhet të lejohet që vetëm taksat dhe detyrimet të shkruhen në mënyrë manuale.
	Administrimi i katalogut	Mbështet proceset për azhurnimin e katalogëve si, regjistrimi, editimi, shqyrtimi dhe lëshimi i katalogëve për publikim. FPP (Fjalori i Përbashkët i Prokurimit) të adoptohet për katalogun e klasifikimit.	Katalogu ndërtohet gjatë çdo prokurimi të ri. Ndërlidhet me statusin e inventarit për planifikim të prokurimit.

		Siguron që mirëmbajtja e katalogëve individuale të kontrollohet në përputhje me kushtet e një marrëveshjeje individuale ndërmjet departamentit dhe furnitorëve të tij në veçanti.	Ndërlidhet me SIM për statistikat e shfrytëzimit të artikujve të katalogut dhe planifikimit të strategjive të prokurimit
	Krijimi dhe aprovimi i kërkesës	Përdoruesi të krijoj një kërkesë Opsioni i bashkimit të kërkesave, me dispozitën për nivele të shumta të aprovimit Gjeneron një numër unik të kërkesës për çdo kërkesë të re duke lejuar që ajo të përcillet dhe të regjistrohet. Lejon lidhjen e numrit të kërkesës me kodin e përgjithshëm të projektit nëse prokurimi është pjesë e një projekti më të madh me prokurime të shumta. Lejon vendosjen e periudhës së konsolidimit të kërkesës për qëllime të bashkimit. Kjo periudhë kohore do të vendos se sa shpesh urdhrat për blerje u lëshohet furnitorëve.	Siguron qasje në formularët e kërkesës për shënime të kërkesës dhe për aprovim të njëpasnjëshëm Aprovimi i kërkesës duhet të kalojë përmes procesit të planifikimit.
	Informata të marrëveshjes kornizë	Katalogu i marrëveshjes kornizë duhet të përmbajë emrin e artikullit, kodin e artikullit, përshkrimin e artikullit, njësinë matëse, emrin e furnitorit, numrin e pjesës së furnitorit (nëse ka), çmimin për njësi të marrëveshjes kornizë, etj. Katalogu i marrëveshjes kornizë duhet të lejoj çmimin diferencial përmes specifikimit të mëtejshëm të tarifave të transportit të mallrave (sipas zonës), taksave lokale, zbritjes për përdoruesit e veçantë, etj., për shpërndarje në lokacione të ndryshme të lejuara. Nënshkrimi i dokumentit të marrëveshjeve kornizë në formatin e bazës së të dhënave	Integro me katalogun dhe SIM

		Lejon përdoruesit të shikojnë bazën e të dhënave të marrëveshjes kornizë (opcion). Lejon kategorizimin e marrëveshjeve kornizë	
	Krijimi i marrëveshjes kornizë	Ofron një sistem të thjeshtë, të bazuar në formë për të ngarkuar informatat e marrëveshjes kornizë Sistem i regjistrimit për kalimin e afatit të marrëveshjes kornizë Ofron një sistem për administrimin e marrëveshjeve kornizë Mirëmban një regjistër të ndarë për secilën marrëveshje kornizë të negociuar	
	Procesi i punës për aprovimin e kërkesës	Lejon çdo departament të blerjes që merr pjesë të përcaktoj procesin e punës, privilegjet dhe të caktoj parametrat të cilat qeverisin proceset e aprovimit të domosdoshme për parashtrim të kërkesave. Parametrat mund të jenë, por duke mos u kufizuar vetëm në: Përdoruesi: Për çdo kërkesë të regjistruar nga ky përdorues Shuma: Për çdo kërkesë mbi këtë shumë Furnitori: Për çdo kërkesë të paracaktuar për një furnitor të specifikuar Përshkrimi: Natyra e shpenzimeve, llogaria në librin e përgjithshëm dhe qendra e kostove Lokacioni: Lokacioni gjeografik i përdoruesit Artikulli: Për çdo kërkesë për këtë artikull Në rast të editimit/refuzimit të kërkesës nga aprovuesi, për të njëjtën do të kërkohet nga aprovuesi që të ofroj arsye në sistem.	
	Menaxhimi i	Nën marrëveshjen kornizë duhet të jetë e mundur përcjellja e kontraktorëve, furnitorëve.	Sistemi duhet t'i siguroj menaxherit të kontratës një tabelë të aparaturave për

	marrëveshjes kornizë	Duhet të lejohet përcjellja e bilancit të furnizimeve apo dërgesave nga secili furnitor/kontraktor Duhet të ekzistoj dispozita e ndryshimit të marrëveshjes pas kompletimit të marrëveshjes ekzistuese (Shënim: ligji i Kosovës aktualisht pengon ndryshimet e kontratës, por marrëveshjet kornizë nuk janë kontrata) Duhet të jetë e mundur përfshirja e kontraktorëve/furnitorëve të ri sipas marrëveshjes aktuale përmes procesit të rregullt për t'u dhënë mundësinë lojtarëve të ri në treg dhe gjithashtu për të mbajtur të papenguara furnizimet. Duhet të jetë e mundur ndërprerja e çfarëdo marrëveshje të mbetur nga ana e agjencive blerëse dhe furnitorëve/kontraktorëve në vazhdim të procesit të ndërprerjes.	shqyrtim krahasues të statusit të marrëveshjes dhe të furnizimeve Duhet të ndërlidhet me modulën e pagesave Duhet të jetë në gjendje të shoh statusin e secilës marrëveshje kornizë sipas kushteve të pagesës, vlefshmërisë, shpërndarjes/furnizimit, sipas furnitorit, lokacionit/rajonit dhe artikullit.
	Integrimi me modulën e buxhetimit	Lehtëson miratimin e kostos së porosisë me buxhetin në dispozicion të departamentit, për të shmangur tejkalimet e kostos	Ndërlidhet me planin dhe aprovimet individuale dhe vjetore të prokurimit
	Krijimi i urdhrit për blerje	Krijimi automatik i UB-së, pasi të jetë aprovuar kërkesa nga autoriteti i duhur. Sistemi duhet të lidh numrin e UB-së me numrin e kërkesës për të mundësuar përcjelljen. Sistemi duhet të plotësoj vet UB-në me detajet e departamentit dhe të ngarkesës, etj. Megjithatë, përdoruesi duhet të jetë në gjendje të anashkaloj informacionin e sistemit (të ofroj adresë tjetër të ngarkesës/transportit të mallrave, etj.).	Lejon mënyrat vijuese të lëshimit të urdhërblërjes për furnitorët: Azhurnimin e drejtpërdrejt të sistemeve operacionale të furnitorëve, nëse janë në dispozicion Postën elektronike me shtojcë (të bashkangjitur) Faksin Rezultatet e shtypura

		Sistemi duhet të konsolidoj UB-të bazuar në parametrat e specifikuar nga ana e departamentit Lejon editimin/anulimin nga blerësi/departamenti i blerjes i UB-ve të gjeneruara nga sistemi para lëshimit. Lehtëson futjen e komenteve/arsyeve për editim/anulim të UB-ve të gjeneruara nga sistemi. Sa u përket UB-ve, duhet të mbështetet pikat në vazhdim Krijo dhe lësho UB-në furnitorit të vetëm të zgjedhur. Krijo dhe lësho UB-në e ndarë furnitorëve të zgjedhur. Krijo dhe lësho UB-të në një pjesë (lot) apo në porosi të shumta të bazuara në kërkesë. Krijimi i bilancit midis politikave dhe destinacioneve të lehta dhe të vështira të shpërndarjes siç përcaktohet nga departamenti. Dispozitë për një UB të vetme e cila përmban artikuj të shumtë nga marrëveshjet e shumta kornizë. Blerësi/departamenti i blerjes duhet të jetë në gjendje të lëshoj UB-të në mënyrë selektive. Vet programimi i UB-ve duhet të i konfigurueshëm.	Bënë ruajtjen në inboxin përkatës të siguruar për furnitorin në faqen e internetit. Mirëmban shënimet e të gjitha urdhërblereve të lëshuara sipas furnitorëve për vlerësimin e kërkesës, dhe për auditim dhe për analiza të tjera.
	Pranimi i mallrave	Mbështet azhurnimin e informatës së pranuar në sistem si vijon: Pranimi i sasive më shumë apo më pakë se sa sasia e UB-së, mirëpo në kuadër të tolerancës së specifikuar Kthimi i pjesëve të porosisë sipas zërave buxhetor, duke ofruar arsye për kthim / anulim nëse furnitori dorëzon më pakë apo të një cilësie të papranueshme	Ndërlidhet me katalogun dhe me sistemet e inventarit

	Faturi mi	Sistemi do të krijoj fatura subjektit të prokurimit. Ofertuesi duhet të jetë në gjendje të shtoj/heq rreshtat e faturës dhe të shkruaj formulat bazike si SHUMA (SUM), %, etj. Sistemi duhet të kalkuloj në mënyrë automatike datën e duhur të pagesës bazuar në kushtet e kontraktuara të pagesës, përveç nëse anashkalohen në mënyrë manuale. Ofertuesi duhet të jetë në gjendje të ruaj faturat si draft dhe programoj dërgimin automatik/manual të faturave tek subjekti i prokurimit. Sistemi do të ofroj një mundësi për të përcjell dhe mirëmbajtur llogarinë e progresit të pagesave dhe të paradhënies së ofertuesit.	Ndërlidhet me orarin e punës, kushtet e pagesës dhe me modulet e pagesës.
	Zgjidhja e pagesave	Lejon shlyerjen/rregullimin e pagesës të përshtatur në tri mënyra (faturë, urdhërblere, vërtetim për pranimin e mallrave) qoftë në sistem apo në sistemin e brendshëm financiar të departamentit. Lejon delegimin e rregullimit të përgjegjësisë së pagesës departamentit të centralizuar. Lejon integrimin me portat e pagesës online të siguruar nga palët e treta për qëllim të zgjidhjes.	Ndërlidhet me modulën e pagesës dhe regjistrin e autoritetit Duhet të mbaj shënime të auditimit për të gjitha transaksionet
	Monitimi dhe shqyrtimi	Menaxhmenti duhet të jetë në gjendje të vlerësoj veprimtaritë dhe të zhvilloj raporte: Numri i përgjithshëm i të dhënave në fillim të periudhës në secilën fazë Numri i të dhënave në pritje në fillim të periudhës në secilën fazë Numri i të dhënave të përpunuara gjatë periudhës në secilën fazë Numri i përgjithshëm i të dhënave në secilën fazë në fund të periudhës	Ndërlidhet me SIM për analitikë Regjistrime gjithëpërfshirëse të auditimit në formate të caktuara paraprakisht – duhet të ketë të mundur të hetoj duke u bazuar në përdoruesin (përdoruesi i veçantë i autoritetit blerës, ofertuesit, administratorëve të sistemit, etj.), tenderin, kohën, transaksionin, llojet e

	Numri i të dhënave në pritje në fund të periudhës në secilën fazë Etj. Analitikë e projektit Informatat mbi analitiken e projektit, të tilla si përqindja e punës së kompletuar kundrejt kohës së kaluar, pagesat e kryera përkatëse, vazhdimet e punës, vonesat, etj., për qëllime të gjenerimit të raporteve Gjurmët e auditimit Mirëmban të gjitha gjurmët e raporteve/auditimit siç kërkohet nga zyra e auditorit të përgjithshëm për qëllime të auditimit. Përputhja me dispozitat përkatëse të manualit të punës, kodit të llogarisë, kodit të financave, statutit të duhur, etj. Raportimet dhe regjistrimet e auditimit Mirëmban të dhënat e auditueshme të të gjitha kërkesave, UB-ve, aprovimeve, refuzimeve, shpërndarjeve dhe ciklit kohor të këtyre proceseve. Raportet të gjenerohen për të lehtësuar ciklin kohor dhe analizën e fytit të ngushtë (bottleneck), masat e performancës së furnitorit, etj.	prokurimit dhe parametrat e tjerë të mjekësisë ligjore për hetimin e gabimeve, problemeve, kërkesave ligjore dhe qëllimeve tjera të auditimit.
--	---	---

Shitja e aseteve	Ankanditet	Funksionaliteti i ankandit përdoret për kërkesën e shitjes së aseteve, tepicës së shitjes, licencimin, etj. Sistemi i prokurimit elektronik duhet të lehtësoj krijimin e pakove për ankand. Informatat e ankandit zakonisht përfshijnë: numrin e pjesës (lot), sasinë, çmimin fillestar, rregullat e ankandit dhe periudhën e ankandit. Duhet të ofroj mundësinë për të ftuar ofertuesit dhe ofertat në ankand Lejon ofertimin e autorizuar nëse dokumenti i ankandit lejon atë opsion. Duhet të jetë i mundur importi dhe plotësimi i bazës së të dhënave të ankandit përmes përgatitjes së artikujve të ankandit.	Ankandi zhvillohet në kohë reale dhe duhet të njoftoj si administruesin e ankandit ashtu edhe ofertuesit pjesëmarrës mbi kohën e mbetur për mbylljen e ankandit deri në sekondën e fundit. Ndërlidhet me statusin e inventarit Ndërlidhet me regjistrin e aseteve.
SMIP	SIM të Prokurimit (SMIP)	Totali i rezultateve të veprimtarive duhet të regjistrohet dhe të përdoret për SIM të prokurimit Totali i ciklit të prokurimit dhe të gjitha fazat e tij, veprimtaritë e procesit të punës duhet të regjistrohen për analizë nëse treguesit e prokurimit kanë identifikuar rezultatet e performancës së prokurimit. SIMP duhet të integrohet me arkitekturën e ndërmarrjes për të lehtësuar planifikimin dhe politikë-bërjen. Duhet të ofroj mundësinë për të gjeneruar raporte gjithëpërfshirëse për qëllime të ndryshme në kontekste të ndryshme, dhe mjaft fleksibile për të personalizuar formatin e raporteve dhe të dhënat. Raportet/informatat duhet të jetë e mundur të gjenerohen nga baza complete e të dhënave të prokurimit nga ana e subjektit të autorizuar të prokurimit apo nga autoritetet e qeverisë për operacionet e përditshme, planifikimin kombëtar, auditimin dhe vendimet strategjike.	Një grumbull i treguesve të performancës duhet të aprovohen duke u bazuar në objektivat e jetësimit të sistemit të prokurimit elektronik dhe të objektivave të pritura të ligjit të prokurimit, si dhe të ligjeve dhe politikave të tjera përkatëse. KRRPP-ja, politikbërësit, zyrtarët e prokurimit, auditorët si dhe palët tjera përkatëse të interesit duhet të kenë qasje në SMIP. Treguesit kryesor të performancës dhe statistikave të rezultateve të prokurimit duhet të publikohen për shqyrtim publik në pjesën për publikun.

KAPITULLI VII KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

7.1 Përfundime të përgjithshme

Ky studim doktoral ka si objekt problemet e prokurimit publik dhe, kryesisht, domosdoshmërinë e zbatimit të sistemit të prokurimit elektronik në Kosovë, i cili ka filluar të implementohet vetëm në vitet e fundit. E zgjodhëm këtë temë pasi kjo çështje përbën një risi dhe për të ka mungesë literature dhe punimesh të mirëfillta shkencore.

Për rëndësinë e madhe që ka në zhvillimin e vendit, në kushtet e ekonomisë së tregut, sistemi i prokurimit elektronik po vlerësohet dhe po përqafohet gjithnjë e më shumë, si nga institucionet qeveritare në Kosovë, ashtu edhe nga aktorë të tjerë që përfshihen në prokurimin publik, nga institucionet publike, bizneset private, nga mediat dhe shoqëria. Këto po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme për avantazhet e mëdha që ka përdorimi i teknologjisë informatike në procesin e prokurimit publik.

Në studim bëhet një vështrim historik i zhvillimit të prokurimit publik, mbështetur në kërkimet që kemi bërë në botime dhe në literaturë, të vendit dhe të huaj, si dhe në burime dokumentare të strukturave të qeverisë dhe të organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Më pas trajtohen më në detaje aspekte koceptuale teorike dhe juridike të kësaj fushe, duke u ndalur posaçërisht në përkufizimin dhe kriteret e prokurimit publik, në legjislacionin vendas dhe atë europian, të prokurimit publik.

Duke marrë në konsideratë vërejtjet e drejta të dhëna në vlerësimin metodologjik të dizertacionit doktoral, kemi reflektuar dhe kemi bërë modifikimet e nevojshme, si në përcaktimin më të qartë të Hipotezave të studimit dhe të pyetjeve kërkimore, ashtu edhe në strukturimin përmbajtësor të kapitujve të punimit, në qartësimin e konkluzioneve përfundimtare të studimit dhe në paraqitjen e rekomandimeve.

Metodologjia e përdorur dhe zbatimi i metodave të analizës sasiore dhe cilësore, krahasuese, kanë ndihmuar për një analizë të hollësishme të çështjeve që ka në fokus punimi, duke i dhënë dizertacionit, krahas karakterit *përshkrues*, edhe karakter *shpjegues* dhe *analizues*. Në këtë mënyrë është bërë e mundur që krahas paraqitjes së arritjeve në fushën e prokurimit publik në Kosovë, të nxjerrim edhe problematikat, mangësitë, vështirësitë që pengojnë zhvillimin efikas, transparent, konkurrues të prokurimit publik. Studimi thekson idenë se këto pengesa, si dhe veprimet korruptive në tenderat publikë mund të reduktohen dhe të eliminohen duke implementuar sistemin e avancuar të prokurimit elektronik. Ky problem zë edhe vendin më të madh në tërë punimin doktoral.

Studimi vënë dukje se megjithëse sistemi i e-Prokurimit ende nuk është implementuar plotësisht, rezultatet e deriranishme të projektit për vendosjen e këtij sistemi janë premtuese për një shtrirje më të gjerë të kësaj platforme të avancuar dhe mjaft efikase në Kosovë.

Është krijuar bindja se metoda tradicionale, manuale, prokurimit publik, e bazuar në letër, për joeficiencën dhe rreziqet që ka, duhet zëvendësuar me përdorimin e teknologjisë informative

dhe të internetit në procesin e prokurimit publik. Studimi argumenton *domosdoshmërinë* e implementimit të këtij sistemi dhe arrin në përfundimin se në Kosovë janë të gjitha *mundësitë* që kjo të realizohet me sukses.

Pasi konkludohet se edhe në këtë periudhë të shkurtër të fillimit të implementimit të prokurimit elektronik ka dalë qartë në pah potenciali i madh i përfitimeve nga ky sistem, studimi konkludon se, në Kosovë ai duhet të përballojë sfida të shumta dhe vështirësi objektive dhe subjektive. Ende ka mungesa të kapaciteteve të nevojshme teknologjike, por edhe të burimeve njerëzore të kualifikuara dhe të afta për prokurimin elektronik. Përmirësime të mëdha duhen bërë në qeverisjen e prokurimit publik, në punën e agjencive përgjegjëse qeveritare të kësaj fushe, në sistemet menaxheriale dhe sidomos në drejtim të parandalimit dhe të luftës së korrupsionit në prokurimet publike.

Fakti që potenciali i softuerit të zhvilluar dhe harduerit të implementuar ende nuk po shfrytëzohet si duhet, shpjegohet në punimin doktoral me mungesën e përvojës, me mungesën e kualifikimit të zyrtarëve të prokurimit, por edhe me faktorë të tjerë, si të politikës, ashtu dhe organizative, teknike apo të menaxhimit. Prandaj në studim vihet theksi te nevoja që në vazhdim të hartohen dhe të zbatohen strategji dhe politika, që jo vetëm do të zgjerojnë shtrirjen e këtij sistemi, por edhe do të përmirësojnë përdorimin dhe efikasitetin e tij. Kërkohen përpjekje të mëtejshme nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse të këtij sektori që të arrihen përfitime maksimale nga e-Prokurimi në të ardhmen e afërt. Në studim theksohet se, krahas kësaj, lypsen përmirësime të mëtejshme në legjislacionin e kësaj fushe, harmonizimi i tij me atë të BE-së, si dhe njohja e përvojës së vendeve të tjera, duke synuar praktikatat më të mira dhe përshtatjen e tyre në kushtet konkrete të Kosovës.

Nga shtjellimi dhe analizimi i aspekteve teknike, institucionale e menaxheriale dhe nga nxjerrja e defekteve në zbatimin në praktikë të sistemit elektronik të prokurimit, studimi arrin t'u japë përgjigje Pyetjeve kërkimore të punimit doktoral, si dhe të bëjë vërtetimin e Hipotezave të tij. Gjithashtu, me evidencimin e masave dhe të rrugëve të përmirësimit të implementimit të prokurimit elektronik dhe të zgjerimit të tij në Kosovë, jemi përpjekur për formulimin e disa rekomandimeve, që mund të shërbejnë për përmirësimin e prokurimit elektronik në të ardhmen e afërt dhe në perspektivë.

7.2 Përgjigjet për Pyetjet kërkimore dhe vërtetimi i Hipotezave

Në këtë syth po ndalemi në përgjigjet që u jep studimi pyetjeve kërkimore të shtruar në fillim, me synim vërtetimin e Hipotezave që lidhen me *domosdoshmërinë* dhe me *mundësitë* e implementimit gjerësisht të sistemit të prokurimit elektronik në rastin e Kosovës. Tri Hipotezat janë:

Hipoteza 1: Në Republikën e Kosovës është plotësisht i mundshëm zëvendësimi i formës tradicionale të prokurimit publik me prokurimin elektronik dhe shtrirja më masive dhe cilësore e prokurimit elektronik, pasi, tashmë, është krijuar një model i digjitalizimit të proceseve të prokurimit publik dhe i adaptimit në qeverisjen elektronike.

Hipoteza 2: Në Kosovë, në aspektin formal, ekziston korniza ligjore që rregullon funksionimin e sistemit të prokurimit publik elektronik, por sfidues mbetet zbatimi i këtyre ligjeve në praktikë.

Hipoteza 3: Sfidat e shumta, me të cilat ndeshet zbatimi i sistemit të prokurimit elektronik në Kosovë, janë të përballueshme, pasi institucionet qeveritare dhe agjencitë përgjegjëse të prokurimit e kanë gatishmërinë për kapërcimin e tyre.

Për vërtetimin e **Hipotezës 1** na ndihmojnë përgjigjet e këtyre tri pyetjeve kërkimore:

1. Cilët janë modulet dhe shkalla e përdorimit të prokurimit elektronik nga biznesi dhe nga institucionet qeveritare në Kosovë?

Në Republikën e Kosovës prokurimi elektronik është në krijim e sipër dhe tani është arritur në fazën testuese të softuerit për modulën bazik tenderimi elektronik. Nga përvoja e deritanishme del se janë bërë hapa për vendosjen e një modeli dhe *infrastruktura teknologjike* të digjitalizimit të proceseve të prokurimit publik dhe të adaptimit të qeverisjes elektronike. Tashmë, janë krijuar kushtet dhe mundësitë objektive për zbatimin e prokurimit elektronik në Kosovë dhe shkalla e përdorimit të tij po rritet çdo ditë e më shumë.

Infrastrukturën e duhur elektronike e telekomunikimit, mbulon pothuajse të gjitha zonat e vendit. Institucionet e qeverisë, pushteti vendor dhe bizneset janë pajisur me kapacitete të caktuara elektronike të ruajtjes dhe të nxjerrjes së informatave. Po ashtu, janë ndërtuar edhe modulet e funksionimit të e-prokurimit, si:

- moduli i tenderimit elektronik, përmes të cilit realizohen hapja elektronike e tenderave, ofertimi elektronik, marrja e vendimeve elektronike dhe dhënia e kontratave elektronike. Të gjitha këto bëhen me funksione relativisht të thjeshta.

- moduli i automatizimit të rrjedhës së punëve të prokurimit publik, si në përpunimin dhe përcjelljen e dokumenteve të prokurimit, në hartimin e regjistrin e autorizimeve të përdoruesve, regjistrin auditimit;

- moduli për menaxhimin e kontratave, që i mundëson agjencisë qeveritare të mirëmbajë dhe të mbikëqyrë punët, mallrat e ofruara, kontratat dhe shërbimet e ofruara;

- moduli ndihmues, i cili ofron për tërë sistemin e prokurimit këshilla, me grafika lehtë të përdorueshme, me shfletim të faqes së internetit, prezantim të përmbajtjes etj.

Për rrjedhojë, tani kërkesat e prokurimit publikohen përmes internetit. I tërë procesi i prokurimit, nga fillimi në fund, bëhet në mënyrë elektronike, përmes internetit.

Nga ana tjetër, me vullnetin e lartë të qeverisë e të politikës për këtë reformë, është instaluar një infrastrukturë e mirë e telekomunikimeve, një rrjet dhe portal elektronik qeveritar mjaft i mirë.

Rezultate të kënaqshme konstatohen në Kosovë edhe për sa i përket shkallës së përdorimit të platformës elektronike të prokurimit publik, nga autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomikë dhe nga entitetet e tjera që përfshihen në procesin e prokurimit publik, përfshi edhe pushtetin vendor dhe bizneset. Tashmë, ka një interesim më të madh për të operuar përmes internetit, sesa

me takime personale dhe me mënyrën tradicionale të bazuar në shkresurat me letër. Kjo premtë për rritjen e shkallës së përdorimit të SPE dhe për shtrirjen e tij më gjerësisht në Kosovë.

Po ashtu, rezultatet e vlerësimit të *gatishmërisë* për implementimin e prokurimit elektronik tregojnë se në Kosovë gatishmëria e përgjithshme për zbatimin e këtij sistemi është në nivel të lartë. Si te strukturat qevitare, ashtu edhe tek aktorët e tjerë që përfshihen në veprimtarinë e prokurimit shihet predispozicioni për të vepruar me metodat e përdorimit të teknologjisë informatike. Kjo ka rritur ndjeshëm shkallën e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik.

2.Çfarë pajisjesh teknologjike dhe platformash janë përfshirë në krijimin e sistemit të informacionit dhe në realizimin e prokurimit elektronik?

Siç del edhe nga studimi, për prokurimin elektronik në Kosovë janë siguruar, tashmë, pajisjet e nevojshme teknologjike, si servera të aplikacioneve dhe të bazës së të dhënave, servera mbështetës (serveri për ruajtjen e regjistrave, kontrollorët e domenit, serveri për shënimin e kohës), ku përpunohen dhe ruhen shumica e të dhënave; rrjeti, i cili mundëson komunikimin mes klientit dhe serverit. Këto elemente përmbajnë komponentet e nevojshme, si harduerë, softuerë, procese, procedura etj. Është ngritur dhe vendosur njësia qendrore e përpunimit të të dhënave; pajisjet për ruajtje; pajisjet hyrëse (tastiera, portet serike, mausi etj.); pajisjet dalëse (monitorë, printerat etj.); kabllo.

Pjesë e rëndësishme e platformës është pakoja softuerike e projektit, që funksionon si një sistem i plotë i prokurimit elektronik. Përmendim *softuerin e teknologjisë informative*, që shërben për furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e informacioneve kryesore teknologjike në qendrën e të dhënave të pajisjeve harduerike, në arkitekturën efektive softuerike, për shërbimet e nevojshme për drejtimin e sistemit të prokurimit elektronik; zgjidhja standarde softuerike, e quajtur @Spin, e zhvilluar nga INFODOM. Kjo është implementuar duke i shtuar disa funksione të përshtatura me infrastrukturën elektronike që kemi.

Përmes këtyre pajisjeve dhe platformave realizohen tenderimi elektronik; menaxhimi online i kërkesave, dhe paralogaritjeve; hartimi i kuotimit elektronik; menaxhimi online i marrëveshjeve kornizë dhe i kontratave elektronike; blerjet elektronike, menaxhimi i katalogut; pagesat elektronike etj. Po ashtu, grumbullohen informata, që mund të përdoren për matjen e performancës të entiteteve të prokurimit në prokurimin publik.

Në dispozicion të përdoruesve, të shfletuesve kompjuterikë dhe të teknologjive të tjera operuese, janë një sërë aplikacionesh kompjuterike, teknologjitë e bazuara në internet, përdorimit i faqeve informuese/konfirmuese dhe mekanizmave të lajmërimit të automatizuar, si dhe të gjitha gjuhët që i njej sistemi.

Sistemi i prokurimit elektronik gjithashtu, përmban përdorimin e protokollit të shënimit të kohës, mekanizmat e përcjelljes së auditimit për çdo prokurim elektronik; mekanizmin për arkivimin e të dhënave dhe të regjistrave të auditimit. Gjithashtu, funksionon edhe Faqja për

Rimëkëmbje në rast Rreziku (FRRr), që përfshin lidhje të pandërprerë të internetit dhe furnizim shtesë me energji elektrike.

Në dispozicion të përdoruesve janë edhe doracakët, magjistarët (wizards), kalimet (walkthroughs) dhe demonstruesit në internet, që ndihmojnë shumë për të kuptuar funksionalitetet e shërbimeve të ofruara nga sistemi. Po ashtu, ekzistojnë dokumente ndihmëse në internet, fjalorthë, udhëzues për përdoruesit, që shpjegojnë në hollësi GUI e prokurimit elektronik.

Ndër aplikacionet e sistemit elektronik të prokurimit përmendim edhe aplikacionin Interfejsi Grafik i Përdoruesit (IGP), i cili përfshin teknika të zbatimit të tij në mënyrë më të thjeshtë dhe më efikase; Interfejsi SMIP, Interfejsi Sistemin Informativ për Menaxhim Financiar (SIMF), interfejsi i përdoruesit dhe gjuhës së përdorur.

3. Cilat janë përfitimet nga zbatimi i prokurimit elektronik dhe sfidat me të cilat përballlet zbatimi i këtij sistemi në Kosovë?

Studimi ka arritur të evidencojë qartë përfitimet potenciale nga përdorimi i prokurimit elektronik dhe se ato janë të shumta. Këto përfitime e tejkalojnë shumë herë investimin për vetë sistemin dhe kanë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe në klimën e investimeve. Karakteristike në prokurimin elektronik janë: mundësia e këtij sistemi për të fuqizuar qeverisjen; shtimin e transparencës, të konkurrencës dhe barazisë në tendera; përmirësimin e qasjes në informata menaxheriale dhe të auditimit; rritjen e efikasitetit për qeverinë, por edhe për sektorin privat.

Përmes prokurimit elektronik arrihen ndërveprimi i këtij sistemi me sistemet e tjera të menaxhimit; automatizimi i shumë proceseve të prokurimit, përfshi përzgjedhjen e furnitorëve, krijimin e metodologjive të reja ekonomizuese të prokurimit; ofrimin e mjeteve menaxheriale për furnizim, reduktimin e kostos, riorganizimin e procesit, përputhshmërinë e përmirësuar të kontratës; kursimet në ekonomizimin e transaksioneve, standardizimin e praktikave të prokurimit, zvogëlimet e çmimeve etj.

Gjithashtu, SPE sjell: ulje të vlerës së inventarit; ulje në blerjet pa kontratë me furnitorë – përmirësim në përputhshmëri; paksim të gabimeve, për shkak të eliminimit të proceseve manuale; paksim të proceseve prej blerjes në pagesë; ulje deri në 80% të kohës së ciklit të prokurimit, pra, të kohës që nevojitet për përpunimin e porosive, pranimit të mallrave, faturimit, dërgesave; lehtësira për të ofertuar, transfertat e dokumenteve, transaksione; raporte të mira me furnitorët; përmirësim i kapaciteteve analitike dhe i kontrollit të menaxhimit etj.

Por studimi konstaton se shërbimet e prokurimit elektronik në Kosovë përballen me shumë sfida, pengesa dhe vështirësi, nga të cilat veçojmë:

Përpara agjencive përgjegjëse të prokurimit mbetet detyra të ushtrojnë me më shumë efektivitet autoritetin dhe kompetencat e tyre për ta udhëhequr, administruar dhe zhvilluar më gjerësisht sistemin e prokurimit elektronik. Qeveria, KRRPP dhe sidomos institucionet e auditimit duhet të bëjnë hapa konkretë për eliminimin e këtyre mangësive dhe për të realizuar dispozitat

ligjore, lidhur me prokurimin publik, objektivat e Strategjisë Kombëtare të Prokurimit publik për progresin e sistemit të prokurimit elektronik në Kosovë.

Të tjera sfida kanë të bëjnë me dukuri të tilla, si: mungesa e ekspertizës në planifikimin dhe në kryerjen e procedurave të tenderimit, sidomos në autoritetet kontraktuese të vogla; niveli jo i mjaftueshëm i profesionalizmit të zyrtarëve të prokurimit etj. për përdorimin e teknologjisë dhe të praktikave moderne të prokurimit; rritja e cilësisë në planifikimet e prokurimit, në specifikimin e secilit aktivitet; harmonizimi më i mirë kërkesave të çdo prokurimi me mundësitë e buxhetit; mungesa e efektivitetit të punëve që kryhen gjatë implementimit të plotë të kontratës e deri në përfundimin e saj; në përdorimin e kontratave kornizë vërehen mjaft shkelje dhe parregullsi etj.

Nga studimi del se një problem i mprehtë është perceptimi i përgjithshëm nga aktorët e prokurimit publik, nga organizmat ndërkombëtarë, mediat dhe nga publiku i gjerë se sistemi është i cënueshëm nga korrupsioni; se veprimet korruptive dhe shpërdorimi i fondeve publike janë shqetësuese dhe kërkojnë masa të forta për reduktimin dhe eliminimin e tyre. Kjo dikton nevojën e ndryshimeve dhe të përmirësimeve të infrastrukturës ligjore të prokurimit publik, afrimin e tij me legjislacionin europian.

Por sfida emë e madhe në këtë fushë është lufta për zbatimin e ligjeve në praktikë, për forcimin e kontrollit dhe të auditimit në këtë fushë.

Rritja e transparencës në veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe e aksesit të publikut dhe të bizneseve në informacionin e mbajtur nga qeveria; rritja e transparencës në menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore, publikimi i informacioneve financiare, forcimi i auditit lidhur me korrupsionin, janë një tjetër sfidë e vazhdueshme.

Evidencimi i këtyre dhe i sfidave të tjera në këtë studim është shoqëruar me konstatimin dhe perceptimin se në Kosovë punohet me përkushtim nga të gjithë aktorët për përmirësimin e gjerndjes në këto aspekte dhe se është rritur ndërgjegjësimi se përballimi i këtyre sfidave e problemeve është një domosdoshmëri dhe kusht për progresin në fushën e zbatimit të SPE.

*Bazuar në këto përgjigje të hollësishme dhënë këtij grupi pyetjesh, arrijmë në përfundimin se në Kosovë, tashmë, ekziston infrastruktura e teknologjisë informatike që garanton përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik, në shkallën e duhur dhe me prirje për t'u shtrirë më tej dhe për ta ngritur në nivele të reja përdorimin e teknologjisë nga aktorët e prokurimit publik. Me shfrytëzimin e potencialeve të pajisjeve elektronike të instaluar në sistem mund të merren realisht përfitimet e shumta që ai ofron dhe që i kemi evidencuar. Po ashtu, prania e klimës së shëndetshme lidhur me gatishmërinë e qeverisë dhe të politikës, por edhe të palëve të ndryshme që përfshihen në prokurimin publik për ta implementuar sa më gjerësisht dhe për ta përdorur prokurimin elektronik, si dhe lufta që zhvillohet praktikisht për përballimin e sfidave në këtë fushë, na bindin për vërtetimin e **Hipotezës 1** të këtij studimi.*

Për vërtetimin e **Hipotezës 2**, po japim përgjigjet që gjenden në studim për dy pyetjet kërkimore lidhur me legjislacionin e prokurimit publik dhe atij elektronik.

4. Si e rregullon legjislacioni i Kosovës veprimtarinë e prokurimit publik dhe prokurimin elektronik?

Në studim është trajtuar gjerësisht dhe është paraqitur në mënyrë të hollësishme se legjislacioni ekzistues i Kosovës i Prokurimit Publik rregullon me efektivitet zhvillimin dhe zbatimin e prokurimit elektronik në Kosovë. Me parametrat që ka, ai është mjaft përkrahës dhe mund të lehtësojë zhvillimin e prokurimit publik. Në legjislacionin primar, përmendim Ligjin e prokurimit publik Nr. 04/L-042, i cili ka një rëndësi themelore për krijimin e kushteve të barabarta dhe të drejta për të gjithë aktorët. Me këtë ligj, mundësohet zvogëlimi i hapësirës për korrupsion në prokurimin publik. Synimi i këtij ligji është të sigurojë shfrytëzimin sa më efikas, më transparent dhe më të drejtë të fondeve publike, të burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Ai përcakton qartë kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ai vlerësohet se është sipas standardeve bashkëkohore dhe se përfshin dispozita që paraqesin qartë kriteret bazë të prokurimit publik, metodologjitë e prokurimit në internet, autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e kësaj veprimtarie, standardet dhe kërkesat për zhvillimin e procedurave të prokurimit elektronik, për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave publike për punë, mallra dhe shërbime. Ligji mbulon të gjithë sektorët utilitarë, qeveritarë dhe të sektorëve të tjerë, deri edhe tek ai privat dhe përcakton edhe sanksionet dhe penaltitetet administrative në rast shkeljesh, për t'u dhënë më shumë përgjegjësi anëtarëve të komisioneve të procedurave të prokurimit.

Edhe legjislacioni dytësor i miratuar, mbulon tashmë shumë aspekte. Në të përfshihen Rregullorja e prokurimit publik dhe udhëzuesi operativ; Rregullat mbi procedurat e prokurimit (formularë, njoftime, dosja e tenderit, raportet e hapjes dhe të vlerësimit, dokumente të tjera standarde); Rregullat për menaxhimin e kontratës (plani i menaxhimit të kontratave); Kodi etik i prokurimit dhe deklaratat nën betim; Rregullat mbi shitjen e aseteve dhe 7 formularë; Rregullat për shqyrtimin e ankesave; Dokumentet për misionet diplomatike të Kosovës (udhëzimet dhe 9 formularë).

Me rëndësi është fakti që legjislacioni i prokurimit publik është i botuar në tri gjuhë (shqip, anglisht dhe serbisht), në ueb-faqen <http://krpp.rks-gov.net>

Duhet thënë se dispozitat dhe kushtet bazë legjislative për prokurimin elektronik dhe tregtinë elektronike, përgjithësisht, janë të thjeshta, me status juridik, dhe kërkohet që të ketë dokumente elektronike dhe nënshkrime elektronike. Ligji përcakton se qeveria është e autorizuar

të nxjerrë rregulla lidhur me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese, metoda që ta bëjnë sa më dinamik sistemin e blerjeve elektronike. Gjithashtu, autorizohet qeveria që, në koordinim me KRRPP-në të nxjerrë rregulla për pajisjet e dorëzimit elektronik dhe pranimin e tenderave, për pajisjet e pranimit elektronik të kërkesave për pjesëmarrje në tendera etj.

5.Sa i harmonizuar është ky legjislacion me atë të Bashkimit European dhe me legjislacionin e vendeve të rajonit?

Në Kosovë është synuar dhe punuar vazhdimisht, edhe me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë që legjislacioni i prokurimit publik të hartohet dhe të përmirësohet duke u harmonizuar dhe u përputhur me legjislacionin dhe kërkesat e BE-së, duke shfrytëzuar përvojën dhe praktikën më të mira të shteteve anëtare të BE-së në fushën e prokurimit publik.

Legjislacioni i prokurimit publik në Kosovë rezulton në përputhje me kërkesat që dalin nga Direktivat e Prokurimit të BE-së. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e BE, Ligji për Prokurimin Publik Nr. 2003/17 të vitit 2004 dhe Ligji i ndryshuar Nr. 02 / L-99, i cili hyri në fuqi më 6 qershor 2007, janë afruar dhe përputhur me legjislacionin e vendeve të BE. Në të janë përfshirë shumica dërrmuese e kërkesave të dy Direktivave të fundit të KE-së, nr. 17/2004, që rregullon fushën e prokurimit publik në sektorin e shërbimeve dhe ajo nr.18/2004.

Por meqë Komisioni European ka bërë rishikimin e këtyre, Kosova po vazhdon hapat për ta përputhur legjislacionin e saj të Prokurimit Publik me Direktivat e reja 2014/24/EU (që zëvendëson direktivën 2004/18/EC), dhe 2014/25/EU (që zëvendëson direktivën 2004/17/EC).

Procesi i këtij harmonizimi ka synuar të sjellë sisteme dhe praktika të prokurimit publik të vendeve të tjera, por edhe nga vende që përgatiten për anëtarësim në BE, në përputhje me standardet e anëtarit shtet para pranimit. Përfshirja dhe zbatimi i standardeve të legjislacionit european e ka bërë legjislacionin e prokurimit publik të Kosovës më bashkëkohor dhe më efikas.

Në këtë drejtim po punohet për rishikimin e LPP, për ta përmirësuar atë, që të kemi një ligj që të trajtojë problematikat që ka aktualisht sistemi i prokurimit, por edhe zhvillimet e reja. Organet qendrore të prokurimit, duhet të analizojnë problemet për të caktuar opsionet e reja dhe për të hartuar politika të zhvillimit perpspektiv të prokurimit publik. Është në funksionin e KRRPP-së që të analizojë dhe të krahasojë LPP-së ekzistuese me kërkesat e Direktivave të reja të BE dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme në ligj.

Një kujdes i veçantë po tregohet nga përfaqësuesit e agjencive të prokurimit publik të Kosovës për të njohur legjislacionin e prokurimit publik të vendeve të rajonit dhe me gjerë. Sidomos në takimet apo veprimtaritë ndërkombëtare lidhur me prokurimin publik, ata njihen me përvojat në legjislacionin e vendeve të tjera dhe praktikën e mira të zbatimit të këtij sistemi në praktikë.

Megjithëse legjislacioni i prokurimit publik konsiderohet se është në pajtim me *acquis*, përcjellja e ndryshimeve të fundit të direktivave të BE-së për prokurimin publik mbetet detyrë

strategjike gjatë gjithë kohës së zbatimit të SPE. Vazhdon puna për rishikimin e legjislacionit ekzistues dhe për hartimi eligjit të ri të prokurimit publik. Tani mbetet sfida më e madhe, ajo që ka të bëjë me implementimin e legjislacionit të prokurimit. Me angazhimin maksimal të të gjithë faktorëve, implementimi i Ligjit do të shënojë progres në të ardhmen.

*Referuar përgjigjeve të mësipërme rezulton se legjislacioni ekzistues i Kosovës i Prokurimit Publik rregullon me efektivitet zhvillimin dhe zbatimin e prokurimit elektronik në Kosovë dhe se ai po përputhet dhe harmonizohet gjithnjë e më mirë me kornizën ligjore të BE-së, konkludojmë se edhe **Hipoteza 2** e studimit vërtetohet plotësisht.*

Hipoteza 3 e punimit doktoral do të vërtetohet bazuar në përgjigjet e dhëna në studim për pyetjet e mëposhtme kërkimore.

6.Sa u përëgjigjen kërkesave të kohës strategjia kombëtare dhe politikat qeveritare të prokurimit publik dhe roli i agjencive përgjegjëse dhe i qeverisë në zhvillimin e suksesshëm e të ndershëm të prokurimit publik elektronik?

Siç ka dalë nga hulumtimi strategjia e prokurimi publik është plotësisht në funksion të zhvillimit ekonomik e social të Kosovës dhe ndihmon që prokurimi publik të kryejë misionin e tij dhe të arrijë objektivat kryesore, si efikasiteti dhe transparenca, përgjegjësia, llogaridhënia, ngritja e kapaciteteve, harmonizimi i legjislacionit me ligjet e BE-së etj.

Me vizionin, objektivat që përmban kjo Strategji, Qeveria me politikat e saj të prokurimit publik ka marrë masa dhe ka ndërmarrë hapa të kujdesshëm për zhvillimin efikas të sistemit të prokurimit publik, duke e bërë këtë një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik të vendit. Ajo ka realizuar reformat e duhura për krijimin e kornizës ligjore për prokurimin publik dhe ka bërë që aspektet kryesore të prokurimit publik të zhvillohen në mënyrë sa më efikase, me synimin që të arrijnë objektivat madhorë të Strategjisë, që: sistemi i prokurimit elektronik të jetë një nga shtyllat për rritjen e *transparencës dhe të efikasitetit* në prokurimin publik; përcaktimi i qartë dhe zbatimi i *përgjegjësisë* të institucioneve qeveritare, administrative dhe i agjencive të prokurimit në zhvillimin e procedurave efikase të prokurimit publik; sigurimi i *burimeve njerëzore* dhe kualifikimi i tyre përmes trajnimeve bazë dhe të avancuara; vazhdimi i punës për *harmonizimin e legjislacionit* shqiptar të prokurimit publik me direktivat e reja të BE-së për prokurimin publik; dhe rritja e *komunikimit dhe e informimit* të palëve të interesuara për prokurimin, si dhe të publikut, për

përmirësimin e përceptimit dhe ngritjen e vetëdijes për punën që bëhet në sistemin e prokurimit publik.

Me zbatimin e Strategjisë kanë marrë jetë një sërë politikash, projektsh dhe aktivitetsh të koordinuara dhe planifikuara përmes një plani veprim në shkallë vendi, që kanë mundësuar udhëheqjen dhe qeverisjen e aktivitetit të prokurimit publik, veçanërisht të atij elektronik, me synimin për të rritur cilësinë e zhvillimit të tenderave dhe të proceseve të tjera të prokurimit.

Agjencitë e mirorganizuara dhe të përgjegjshme, si KRRPP, AQP, OSHP, IKAP dhe institucione të tjera, duke zbatuar strategjinë e prokurimit publik, po luajnë rolin kryesor për prokurimin publik në Kosovë. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (organ rregullator), Organi Shqyrtues i Prokurimit (shqyrtimi i ankesave) dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (prokurimet e përbashkëta), kanë krijuar, tashmë, një përvojë të mirë në punën e tyre dhe kanë arritur rezultate të kënaqshme.

KRRPP, mbështetur në Strategjinë Kombëtare ka funksionuar mirë për realizimin e përgjegjësisë së saj, që kanë të bëjnë me: ngritjen e vetëdijes të AK dhe OE për prokurimit publik në tërësi dhe për prokurimin elektronik, në veçanti; me ofrimin e asistencës për zbatimin dhe interpretimin e kornizës ligjore, me monitorimin e përputhshmërisë së AK nëpërmjet sistemeve manuale dhe elektronike dhe me mbështetjen e IKAP-it lidhur me trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve të prokurimit. Ai siguron në mënyrë sistematike dhe analizon informacionin mbi procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna, përgatit dhe i dorëzon Kuvendit Kombëtar raportet vjetore, si dhe bashkëpunon me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik, duke dhënë një ndihmesë të madhe në përmirësimin e këtij procesi.

Edhe OSHP ka dhënë kontributin e vet me shqyrtimin e ankesave lidhur me LPP dhe Ligjit për Procedurën për dhënien për koncesione, duke shqyrtuar mjaft vendime administrative të institucionet qendrore të prokurimit, si dhe ka ndikuar për rishikimin në mjaft raste të ankesave nga tenderuesit.

AQP, si agjenci e pavarur për procedurat e prokurimit të nivelit qendror është marrë me blerjet qendrore, duke vendosur për procedurat e prokurimit që duhet të udhëhiqen nga vetë ajo, në vend të autoritetit kontraktues, për arsye të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime, siç është formuluar në Ligjin e Prokurimit Publik.

Edhe institucionet e tjera, si Instituti i Kosovës për Administratë Publike, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Agjencia Antikorrupsion, Thesari në Ministrinë e Financave, që kanë rol në prokurimin publik, sipas profilit të tyre, japin një ndihmesë të madhe në mbarëvajtjen e proceseve të prokurimit në Kosovë.

7.Në ç'nivel është ndërveprimi në procesin e prokurimit elektronik dhe sa ndikon ai në rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë së operatorëve ekonomikë në sistemin e prokurimit elektronik dhe te përfitimet nga zbatimi i tij?

Studimi arrin në përfundimin se në sajë të infrastrukturës teknologjike të avancuar, prokurimi elektronik në Kosovë realizohet duke zhvilluar një ndërveprueshmëri në nivel të mjaftueshëm të sistemeve të ndryshme operationale, me sistemet dhe aplikacionet që janë në zhvillim e sipër.

Ndërveprueshmëria e sistemit të prokurimit elektronik, si pjesë e rëndësishme e përfitimeve nga teknologjia, po jep impaktin e vet pozitiv në rritjen e transparencës së prokurimit publik, në zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta mes aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit e planifikimit të buxhetit, përfshirë aspektet e pagesave, caktimin paraprak të orareve dhe të zotimeve të kontratave, vlerësimin e performancës dhe raportimin. Pajisjet teknologjike ekzistuese kanë krijuar mundësi që në mjedisin e prokurimit elektronik të ketë ndërlidhje të duhura dhe të hapura edhe me Sistemin Informativ për Menaxhim Financiar (SIMF) dhe me sistemet e tjera të menaxhimit. Realizimi i këtij ndërveprimi mes sistemit financiar dhe sistemit të prokurimit elektronik është mjaft i rëndësishëm, pasi ai konsiderohet si parakusht për pagesat elektronike të kontratave.

Përmes ndërveprimit midis komponenteve themelore, zbatuesit e sistemit të prokurimit elektronik kanë mundur të sigurojnë përmirësimin domethënës të fleksibilitetit të sistemit, rritjen e komunikimit në distancë në mënyrë të përshtatshme dhe efikase, si dhe lidhjen e aplikacioneve me sistemet e ndryshme të informatave të ndërmarrjeve, me sistemet e bazës së të dhënave.

Ndërveprimi i sistemit të prokurimit elektronik ka bërë të mundur edhe këmbimin efikas të informatave mes entiteteve dhe institucioneve kryesore qeveritare, bizneseve dhe ndërmarrjeve. Këto mundësi dhe lehtësi, që rezultojnë nga ndërveprimi i sistemit të prokurimit elektronik, kanë ndikuar edhe në rritjen e besueshmërisë së përdoruesve të vetë sistemi dhe të përfitimit që sjell ai.

*Përgjigjet e mësipërme vërtetojnë **Hipotezën 3** të studimit, pasi argumentojnë që Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik, me vizionin, objektivat që përmban, dhe Qeveria, me politikat e saj të prokurimit publik me masat dhe hapa që ka ndërmarrë për zhvillimin efikas të sistemit të prokurimit publik, e kanë bërë këtë një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik të vendit. Sfidat e shumta, me të cilat ndeshet zbatimi i sistemit të prokurimit elektronik Kosovë, siç doli dhe nga përgjigjet e pyetjeve, janë të përballueshme, pasi edhe institucionet qeveritare dhe autoritetet kontraktuese të Kosovës kanë gatishmërinë për kapërcimin e tyre, edhe vetë infrastruktura teknologjike e sistemit të prokurimit elektronik ndihmojnë në përmirësimin e zbatimit të këtij sistemi.*

Në mbyllje të vërtetimit të Hipotezave të studimit, jemi përpjekur të formulojmë edhe disa propozime dhe rekomandime për përmirësimin e punës për zgjerimin e përdorimit të sistemit elektronik të prokurimit në Kosovë.

7.3 Rekomandime

Nisur nga konstatimet dhe përfundimet e studimit, kemi gjykuar se për përmirësimin e punës për zbatimin sa më efikas të procesit të prokurimit publik, mund të shërbejnë edhe rekomandimet e mëposhtme:

Për qeverinë e Kosovës:

- Ta ketë në pronësi dhe nën kontroll sistemin e vet të prokurimit.
- Të sigurojë për të interesuarit dhe për publikun akses te ligjet dhe rregullat mbi prokurimin publik.
- Të lidhë më shumë prokurimin publik me sistemet e menaxhimit financiar, për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë, si dhe për të përmirësuar vlerën e parave.
- Të rrisë bashkëpunimin me sektorin privat dhe ta mbështesë më mirë për t'u përfshirë në tendera publikë.
- Të bëjë publik vendimin e saj për operacionalizimin e një sistemi gjithëpërfshirës të prokurimit elektronik.
- Të ndërtojë politika të studiuara të menaxhimit të burimeve njerëzore, të investojë më shumë për të tërhequr zyrtarë shumë të kualifikuar me aftësitë e duhura për prokurimin publik dhe t'i mbështesë ata me informacion, udhëzime etj.
- T'u sigurojë furnitorëve dhe kontraktorëve informacion të qartë rreth procesit të prokurimit publik dhe të mbrojë informacionin konfidencial; të promovojë transparencë për furnitorët dhe aksionerët e tjerë lidhur me kontratat, por edhe për të gjithë ciklin e prokurimit publik.
- Të forcojë kontrollin e korrupsionit në procesin e prokurimit.

Për KRRPP-në:

- Të kërkojë nga qeveria miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të prokurimit elektronik.
- Të nisë një fushatë të fortë ndërgjegjësuese të palët e interesuara lidhur me përfitimet nga prokurimi elektronik.
- Të krijojë sa më herët mjete bashkëpunuese dhe një njësi për zbatimin dhe menaxhimin e projektit të SPE.
- Të vendosë mekanizma efikasë për të zbuluar dhe për të identifikuar parregullsitë dhe shfaqjet e korrupsionit në prokurimin publik
- Të angazhojë një konsulent teknik për mbikëqyrjen e zhvillimit të sistemeve teknike. Bashkë me një konsulent të prokurimit ai të veprojë edhe në rastet kur kemi të bëjmë me çështje strategjike.

- Të hartojë një listë të objektivave të performancës së projektit të SPE dhe ajo të përdoret si bazë për raportim.
- Të shqyrtojë politikat e prokurimit që ato të jenë në përputhje me funksionimin efektiv dhe ekonomizues të teknologjisë së prokurimit.
- T'i kërkojë kabinetit qeveritar që ta marrë parasysh dhe ta mbështesë strategjinë e prokurimit elektronik dhe planin e zbatimit.
- Të krijojë një grup të caqeve të performancës së projektit dhe ato të përdoren si bazë për t'i raportuar qeverisë.
- Në negociim me një zhvillues, të rafinojë një orar kohor për zhvillimin e fazave të prokurimit elektronik, i cili i merr parasysh çështjet menaxheriale, çështjet e politikave dhe të trajnimeve dhe çështjet e biznesit të përcaktuara më sipër.
- Të zhvillojë një program për inkorporimin e menaxherëve të prokurimit në mjedisin e e-prokurimit.

Lidhur me procesin e procesin e Prokurimit Publik

- Të krijohet sporteli ndihmës gjatë zbatimit të moduleve. Në sportelin ndihmës të punojnë persona me etikë të orientuar drejt shërbimit, të cilët njohin edhe fushën që kërkohet, si dhe vendin për ta gjetur kërkesën.
- Sistemi i prokurimit elektronik duhet të ofrohet nga qendra, si infrastrukturë e përbashkët unike e teknologjisë informative.
- Të hulumtohet mundësia për përdorimin e konsolidimit të SMIP për t'i shqyrtuar edhe rregullat dhe proceset aktuale të menaxhimit, me qëllim identifikimin të atyre që mund të azhurnohen, modifikohen apo të shfuqizohen për mjedisin elektronik.
- Të krijohet një qendër e integruar e të dhënave me harduer, softuer shtesë dhe arkitekturë të re.
- Të themelohet Faqja për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë (FRF) me dyfishimin e njëjtë të qendrës së të dhënave.
- Zhvillimi i SMIP të bëhet pjesë qendrore e axhendës së prokurimit elektronik, ku të gjitha dokumentet e standardizuara si dhe udhëzimet, politikat dhe legjislacioni të jenë në dispozicion në internet në kohë reale.
- Procesi RPB-së të përfshihet në një fazë të hershme të këtij programi.
- Klasifikuesi i katalogut të jetë kodi ndërkombëtar që përdoret në BE.
- Të përdoren për shumicën dërrmuese të transaksioneve dy metodat kryesore të prokurimit publik, tenderimi elektronik dhe marrëveshja kornizë.
- Të mënjanohej në sistemin e prokurimit elektronik kërkesa e certifikatave digjitale dhe PKI për vërtetim, dhe të zbatohet një zgjidhje alternative siç është paraparë në planin e zbatimit.
- Të themelohet një komision RPB që përfshinë zhvilluesin e sistemit apo ofruesin e shërbimit, si dhe entitetet kryesore të prokurimit, i cili do të jetë përgjegjës për

shqyrtimin e dokumentacionit standard ekzistues dhe për minimizimin e kërkesave për informim analog.

- Praktika që procedurat tradicionale me letër mund të përdoren paralelisht gjatë kalimit në prokurim elektronik të zgjatë për një periudhë kohore shumë të kufizuar.

Në fushën e Legjislacionit

- Të përmirësohet Ligji për prokurimin publik, duke hequr paragrafi 4 të nenit 129, formulohet dispozita që lë KRRPP-së urdhërimi i sistemit sipas nevojës, siç ka bërë tani me urdhërimin e shpalljes së tenderit në faqen qendrore të internetit.
- Të rishikohen dy nenet 81 dhe 87 të LPP, sipas të cilëve KRRPP-së i jepen mandat dy funksioneve që krijojnë përplasje. Të shihet dhe të eliminohet kjo mospërputhje dhe kundërvënie në ligj.
- Të reflektohen më shumë në legjislacionin e Kosovës kërkesat e Dokumentit të Gjellbër të KE-së për prokurimin elektronik.
- Të gjejë më shumë pasqyrim në legjislacionin e Kosovës Konventa për komunikimet ndërkombëtare elektronike, e elaboruar nga UNCITRAL.
- Të mundësohet akomodimi i variacioneve të kontratës në specifikacionet teknike dhe funksionale të sistemit të prokurimit elektronik
- Sistemi i prokurimit elektronik të funksionojë në nivel qendror dhe të ketë një infrastrukturë të përbashkët dhe unike të teknologjisë informative, për të evituar zhvillimin e ndarë të e-Prokurimit brenda ministrive apo departamenteve veç e veç.
- Të themelohet një komision RPB, për shqyrtimin e dokumentacionit standard ekzistues dhe për minimizimin e kërkesave për informata analoge.
- Programi i trajnimit të përgatitet nga zhvilluesi/ofruesi i shërbimit dhe të miratohet nga KRRPP.
- Të krijohet një program trajnimesh që zyrtarët e prokurimit nga departamentet të njoftohen me sistemet dhe të kenë mundësi të punës me to.

RACI chart	RACI është shkurtesa per Responsible, Accountable, Consulted and Informed, e cila tregon kush eshte përgjegjës, kompetent, i konsultuar dhe informuar, të cilat janë katër parametrat në një matricë të përdorura në vendimmarrje. RACI tabela përshkruan aktivitetet e ndërmarra në kuadër të një organizate nga personat apo rolet
RPO – Recovery Point Objective (Objektivi i pikës së rimëkëmbjes)	RPO është e përcaktuar me planifikimin e vazhdimësisë së biznesit . Kjo është periudha maksimale e shenjestuar në të cilën të dhënat mund të jenë të humbura nga një shërbim IT për shkak të një incident
RTO – Recovery Time Objective (Objektivi i kohës së rimëkëmbjes)	RTO është kohëzgjatja e shënjestuar e kohës dhe një nivel i shërbimit në të cilin një proces i biznesit duhet të rikthehet pas një fatkeqësie (ose nderprerje), në mënyrë që të shmangen pasojat e papranueshme që lidhen me një nderprerje në vazhdimësinë e biznesit
Secure Socket Layer - SSL	Është standard i teknologjise të sigurisë për vendosjen e një lidhje të koduar në mes të një ueb serveri dhe një shfletuesi. Kjo lidhje siguron që të gjitha të dhënat qe kalojnë në mes të ueb serverit dhe shfletuesit të mbeten private dhe integrale
Streaming	Është një teknikë për transferimin e të dhënave në mënyrë që të mund të jenë të përpunuara si një rrjedhë e qëndrueshme dhe e vazhdueshme
Swim Lane	Shumë metodologji per modelimin e proceseve përdorin konceptin e swimlanes, si një mekanizëm për të organizuar aktivitetet në kategori të veçanta vizuale në mënyrë për të ilustruar aftësi të ndryshme funksionale apo përgjegjësi (rolet organizative). Është një element vizual i përdorur në skemat e rrjedhës ose flowcharts, që vizualisht bën dallimin dhe ndarjen e punës dhe përgjegjësi për nën-proceset e procesit të biznesit
UNIREF - Unified Reference Payment Code	Instrument i perdorur per identifikimin e klasifikimin e pagesave, si dhe regjistrimin e tyre ne SIMFK
Update (përmirësim)	Është procesi për shtimin e informacionit të ri ose për të bërë korrigjimet shtesë
User Acceptance Test-UAT	Është faza e fundit e procesit të testimit të softuerit. Gjatë UAT, përdoruesit aktualë softuerike testojnë softuerin për të siguruar se mund të trajtojë detyrat e kërkuara në skenarët e botës reale, sipas specifikave. UAT është një nga procedurat e fundit dhe kritike të projektit softuerik që duhet të ndodhin para se softueri i zhvilluar lansohet per shfrytezim
	një sistem kompjuterik shërbimje informacione. Sistemi mund të jetë në mes të programeve, pajisjeve kompjuterike, pajisjeve periferike, njerëzve dhe kombinimet e tyre
M-Technologjia	Shkurtesa prej Mobile Technology, e cila mundeson qasjen dhe shfrytezimin e sistemit nga pajisjet mobile
Patch (arnim)	Një arnim është një pjesë e softuerit e projektuar për të rinovuar një program kompjuterik apo të dhënat e saj mbështetës
Public Key Infrastructure-PKI (Infrastruktura e Çelesave Publike)	është një grup i roleve, politikave dhe procedurave te nevojshme për të krijuar, menaxhimin, shpërndarjen, përdorimin, deponim, dhe revokimin e certifikatave dixhitale dhe për të menaxhuar shifrimi publik-Çelesave

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

BIBLIOGRAFIA

Literaturë/Dokumente

1. Arrowsmith, Sue, Thomson, Swet & Maxwell: The Law of Public and Utilities Procurement, 2014, UK.
2. Neupane Arjun, J. Soar, K. Vaidya, J.Yong: “Role of Public e-Procurement technology to reduce corruption in government procurement”, International Public Procurement Conference, August 17-19, Seattle, Washington, 304-334, 2012.
3. Arrowsmith Sue, Lineareli John, Wallace Don. Jr.,”Regulating Public Procurement” National and International Perspectives 2000; xxix; Kluwer Law International; The Hague – London – Boston.
4. Arrowsmith, Sue “Government Procurement in WTO”: The concept and importance of Procurement” School of Law University of Nottingham.
5. Duli, Ilaz Mr.Sc “Reformat e Prokurimit Publik në Kosovë – Dekada e Parë”, BPC – Ballkan Procurement Consultancy; faqe 63; korrik 2011, Prishtinë
6. Erzen, Dr.Tina,”Legal Protection in Public Procurement Procedures”; Ljubljana 06.
7. Sundstrand, Andrea – Public Procurement “Procurement outside the EC-directives” June 1, 2009.
8. Document – Kosovo: <http://ec.europa.eu/enlargement/countries/strategy-and-progress-report>
- 9.B.Karasin, Reparti për prokurim public, Drejtoria për Tregun e Brendshëm, Konferenca e tretë e Rrjetit për Prokurim Publik, Lublanë, Mars, 2005.
10. EU Public Procurement Indicators 2010; Brussels, 4 November 2011.
11. Hoxha, Safet Dr.Sc “Bazat e Prokurimit Publik” – Universiteti “Ukshin Hoti”, 2016, Prizren.
12. Blomberg. Peter, Dr. Transparency and the problem of corruption in the field of public procurement, www.assistum.se
13. ShcAQPer, Paul, Dr. “E-Procurement Readiness and Roadmap” Pristina – Republic of Kosovo, October 2012.
14. OECD/SIGMA: Assessment – Kosovo Public Procurement System; May 2009; <http://www.oecd.org>
15. Robert Glass, Facts and Fallacies of Software Engineering, botuar 2002.
16. Smaka, Riza dhe Gojani, Skender, E Drejta Biznesore, Prishtinë, 2012.

- 17.** Udhëzues Operativ për Prokurim Publik: www.krpp.rks-gov.net
- 18.** World Bank: Kosovo Operational Procurement Review; June 2004; Operational Policy and Services Unit Europe and Central Asia Region – faqe 9.
- 19.** Grayst, John and Trepte, Peter: International Public Procurement: A Guide to Best Practice; London SE19AG United Kingdom – 2009 Globe Bussines Publishing Ltd; “Public Procurement in the European Union.
- 20.** HAJDARI, Besnik Mr.Sc “TECHNICAL REQUIREMENTS FOR THE CREATION AND IMPLEMENTATION OF ELECTRONIC PROCUREMENT IN KOSOVO” European Journal of Mathematics, Technology and Computer Science - ISSN 1946-4690, Staromestska, Bratislava – Slovakia, 2014.
- 21.** Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i Auditimit mbi implementimin e Kontratës për Sistemin e Prokurimit Elektronik, Dokumenti nr:24.34.9-2015-08 - Prishtinë, Korrik 2016.
- 22.** Aberdeen Group. (n.d.). Best practice to e-procurement.
- 23.** COBIT. (2015). Retrieved from ISACA: <http://www.isaca.org/cobit>
- 24.** DIRECTIVE 2014/24/EU. (2014). DIRECTIVE 2014/24/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL.
- 25.** EU. Retrieved from <http://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0024&from=EN>
- 26.** e-ID. (2014). e-ID. Retrieved from MPB: www.mpb-ks.org/?page=1,244
- 27.** IGS-PPRC. (2012, October). e-Procurement Readiness and Roadmap. PPRC. International Governance Solutions.
- 28.** Interoperability Framework. (2013, April 4). Interoperability Framework of the Republic of Kosovo. Ministria e Administratës
- 29.** Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Prishtine: Ministria e Administratës Publike. Retrieved from
- 30.** <https://map.rks-gov.net/institucion/Plan-and-Strategies/Korniza-e-Interoperabilitetit-e-Republikes-seKoso.aspx?lang=en-US>
- 31.** ISO/IEC 20000. (2011). ISO/IEC 20000-1:2011 Information technology -- Service management. Retrieved from ISOInternational
- 32.** Standards Organization: http://www.iso.org/iso/catalogue_detail?csnumber=51986
- 33.** ISO/IEC 27001. (2011). ISO/IEC 27001 - Information security management. Retrieved from ISO-International Standards
- 34.** Organization: <http://www.iso.org/iso/home/standards/management-standards/iso27001.htm>
- 35.** ITIL. (2011). ITIL - best practices solutions. Retrieved from Axelos: <https://www.axelos.com/best-practice-solutions/itil>
- 36.** Komtel, H. (2015). HelpDesk. Retrieved from KomtelPe: www.komtelpe.net/HD
- 37.** Ligji nr. 05/l-068. (2016, January 6). Ligji nr. 05/l -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik

38. të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-237. Kuvendi i Republikës së Kosovës,.

39. Prishtine: Gazeta Zyrtare e Republikes se Kosoves. Retrieved from <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>

40. PSMP/PPRC/1B2.1/2014-02/03. (2014, December 8). Contract for Procurement of Development or customization of

41. transactional modules for e-procurement system, including ICT infrastructure and contract management

42. information system. RFP No.PSMP/PPRC/1B2.1/2014-02/03.

43. Raporti Vjetor i Prokurimit 2014. (2015). Raporti Vjetor i Prokurimit 2014. KRPP.

44. Tatimi ne Prone. (2015). Fatura e Tatimit ne Prone. Retrieved from <https://fatura.tatimineprone-rks.org/>

45. UA-01/2010. (2010). UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2010 –MAP MBI SIGURINË DHE QASJEN NË BAZAT E TË

46. DHËNAVE. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e

47. Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7833>

48. UA-01/2015. (2015). UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAP) NR. 01/2015 PËR UEB FAQET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE.

49. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së

50. Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

51. UA-02/2010. (2010). UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2010 PËR MENAXHIMIN E SIGURISË INFORMATIVE.

52. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së

53. Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7864>

54. UA-02/2015. (2015). UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAP) NR. 02/2015 PËR LLOGARITË ELEKTRONIKE ZYRTARE.

55. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së

56. Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11011>

57. UA-03/2010. (2010). UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2010 PËR PËRDORIMIN E SOFTUERIT DHE HARDUERIT.

58. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së

59. Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7965>

60. UA-04/2010. (2010). UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 04/2010 PËR SHFRYTËZIMIN E POSTËS ELEKTRONIKE

61. ZYRTARE NË INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e

62. Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=7966>

63. World Bank PSMP. (n.d.). Public Sector Modernisation Project. Retrieved from Project Status:

64. <http://www.worldbank.org/projects/P101614/public-sector-modernization?lang=en&tab=details>